MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

ROYAUME D'ALBANIE
CONSEIL D'ÉTAT

KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE e RREGULLORE

TË VJETIT

1927

RECUEIL DES LOIS, DÉCRETS-LOIS ET RÉGLEMENTS

DE L'ANNÉE 1927

BKSH

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 4 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
PUBLICATION DU CONSEIL D'ÉTAT
RECUEIL DES LOIS, VOLUME N° 4
TIRAN 1939

S 16
A
44

342.52 (496.5)(094.4)"1927"

BKSH

MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE E RREGULLORE

TË VJETIT

1927

BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE
47059

KONTROLLI
1974 - 1976

BKSH

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 4 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË 1939

BKSH

LIGJE

DEKRET LIGJE

RREGULLORE

BKSH

BKSH

SHTYPUR NË SHTYPSHRONJËN „TIRANA" NË TIRANË

Nr. 1

LIGJË, 22 Dhetuer 1926.

Mbi transferim krediti prej fr.ari 146.000 në buxhetin 1926-1927 të Komandës së P. të Gjindarmeris

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Art. I. — Autorizohet bartja e nji shume prej 146.000 Fr.ari nga kapitulli II. „Rroga aspirantash, graduatash e Gjindameris" të budgetit të ushtrimit financjar 926-927, të Komandës së P. të Gjindarmeris, tue i u mveshë Kapitullit III. „Shpenzime të ndryshme" në mënyrë të posht shenueme:

N'art. 2. Shpenz. mobilesh, telefon automob.	Fr. ari	28,000
« « 5 Udhëtim e dijete . . .	« «	5,000
« « 7 Shëndetsi	« «	3,000
« « 10 Rroga	« «	90,000
« « 11 Meremetime godinash .	« «	20,000
Shuma .	« «	146,000

Art. II. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Art. III. — Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 290 datë 18-XII-926 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 2

LIGJË, 22 Dhetuer 1926.

Mbi transferim krediti prej Fr. ari 10 000 nga Kap. 1. Art. 3 „Bartje postash" në Kap. të tjera

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e Pun. Botore e Bulqësisë, me bartun nga Kap. 1. Art. 3, shkronjë, bartje postash (dispozicjon) Fr. ari 10.000 të budgetit 1926-927 të Drejtoris së P. të Postelegrafave.

Art. 2. — Prej shumës së përmendun fr.ari 4.500 i shtohet Kap. 5 Art. 2 shkronjë material telegrafike, fr.ari 3.000 Kap. 2, Art. 12 shkronjë udhtim djete fr.ari 2000 Kap. 7 Art. 2, shkronjë shpenzime gjithfarësh radiosh e fr.ari 500 Kap. 6, shkronjë përkëthime, të budgetit 1926-927 të Drejtoris së P. të Postelegrafave.

Art. 3. — Kjo ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes.

Art. 4. — Ministrija e P. Botore e Bulqësiës dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave legjislative si mbas shkresës Nr. 281 datë 18-XII-926 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 3

LIGJË, 26 Dhetuer 1926.

Mbi ndryshimin e artikujve 3 e 4 të traktatit nënshtetësis lidhun me 15 Dhetor 1923 midis Republikës Turke dhe Qeveris Shqiptare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1923, Nr. 1)

Na, Kryetar' i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë proto-

kolin e nënshkruem në mes të Ministris së P. të Jashtme, të Turqisë e të Ministris t' onë fuqi-plotë t' Angorës, me datë 8 Qershuer 962 mbi zgjatimin dhe nji mot t' afatit t' optimit të Shqiptarëvet në Turqi,

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Pranohet protokoli i çkëmbyem midis Qeverivet Turke e Shqiptare me 6 Qershuer 1926 për zgjatimin, dhe nji vjet, duke fillue në mbarimin e afatit, të kohës caktueme për opcjonin e nënshtetësis në bazë t' artikujve tre e katër të traktatit nënshtetësis lidhun me 15 Dhetuer 1923 midis Republikës Turke, dhe Qeverisë Shqiptare.

Art. 2. — Ky Dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

Art. 3. — Ministria e P. të Jashtme dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimit e kësaj Ligje, të pranueme dhe prej Dhomave legjislative, si mas shkresës Nr. 273 datë 18-XII-1926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 26-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme — H. VRIONI

Zav. Min. i P. të Mbrendëshme — MUSA JUKA

Nr. 4

LIGJË, 25 Dhetuer 1926.

Mbi traktat tregtije Shqiptaro-Gjerman

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer me datën e sotshme,

DEKRETOËJM:

Art. 1. — Duke pritun ligjen e nji traktatit definitif tregtije, në mest të Republikës Shqiptare, e t' asaj të Gjermanisë, arti-

kujt prej origjini e provenjence Gjermane që do t' importohen në Shqipëri, ashtu edhe artikujt prej origjini e provenjence Shqiptare që do t' eksportohen në Gjermani, do të gëzojnë në bazë të parimit të reciprocitetit tratamentin doganuar e Kombit ma të favorizuem.

Art. 2. — Këjo Dekret-Ligje hyn në fuqi, tet dit pas shpalljes në Gazetën Zyrtare dhe mund t' anullohet kurdoherë, duke lajmëruar mbi këtë tre muej ma parë Qeverinë Gjermane.

Art. 3. — Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje, të pranuem dhe prej Dhomave legjislative si mbas shkresës Nr. 272 datë 18-XII-928 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 25-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 5

LIGJË, 26 Dhetuer 1926

Mbi transferim kredije prej kapitujve 15 e 16 të budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme e prej Kap. 3 Art. 1 Kap. 2 Art. 7 e Kap. 5 Art. 3 e 4 Dega Botore e prej Kap. Dega Bujqësis të buxhetit të Ministris së P. Botore e Bujqësis t' ushtrimit 926-927, në Kap. 11 Art. 2 të Budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Art. 1. — Zbriten prej kapitullit 15 instalim Emigrandësh fr.ari 3000 (trimij) dhe nga Kap. 16 ngrehje burgut në Porto-Palermo fr.ari 4000 (katërmij) të Budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme ushtrimi 926-927.

Art. 2. — Zbriten nga kapitulli 6 (të pa pagueme në mungesë të fondit) fr.ari 2000 (dymij) të Degës Bujqësis, nga Kap. 3 Art. 1 Udhtim-djete fr.ari 1500 (njimij e pesëqind), nga Kap. 2

Art. 7 (Qira) fr.ari 1500 (njimij e pesëqind), nga Kap. 5 Art. 3 personali provizor fr.ari 3000 (trimij) e nga Kap. 5 Art. 4 vegla teknike fr.ari 5000 (pesëmij) degës Botore të Budgetit të Ministris së P. Botore e Bulqësis t' ushtrimit 926-927.

Art. 3. — Përmbledhja e shumave të zbrituna prej kapijtuve e artikujve të përmendun, në nenin 1 e 2 të këtij Projektligji fr.ari 20.000 (njizetëmij) i mveshen Kap. 11 Art. 1 «shpenzime automobilistave nënshtetas të huej përdorue prej Qeveris revolucjonare» të Budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme ushtrimi 1926-927.

Art. 4. - Ministrija e P. të Mbrendshme e Financave dhe ajo e P. Botore e Bulqësis ngarkohen me zbatimin e kësajë ligje.

Art. 5. — Kjo ligjë hynë në fuqi që ditën e shpalljes.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 284 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 26-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 6

LIGJË, 27 Dhetuer 1926.

Interpretimi i nenit 4. i Shtojcës së Ligjës mbi burgimin e Dhetarve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1).

Në qoftë se dhetari e dorëzanësi, nuk paguajnë detyrën në kohën e caktueme që prej datës së ditës së fundit t' afatit deri në 8 dit, Kryetarët e Financavet me të shpejtë kan me fillue veprimet ligjore mbi riburgimin e dhetarit e të dorëzanësit të ri dhe mbi sekuestrimin e pasunis së tundshme e të pa-tundëshme të tyne.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimin e Interpretimit të Nenit 4 të shtojçës së ligjës mbi burgimin e dhetarve, të pranuem dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 286 datë 20-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 27-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 7

LIGJË, 26 Dhetuer 1926.

Mbi shtesën e tagrit doganuer të pamukut, të leshit, të mëndafshit, e të gjanavet të punueme prej tyne

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Art. 1. — Autorizohet Qeverija me marrë nji shtesë 50% mbi tagrın doganuer t' artikujve që përshkrujnë kategoritë 14. 15, 16, 17, 18, të tarifës doganore në fuqi të cilat importohen prej së jashtëmi.

Përjashtohen nga kjo shtesë të gjithë ato artikuj qi parashikohen me traktate tregtije të posaçme.

Art. 2. — Sasinat e gjanavet të naltë diftueme, qi kanë m'u gjend nër depo të doganave i shtrohen kësaj shtesë si mbas Art. 113 të Statutit themeltar.

Art. 3. — Këjo ligjë hyn në fuqi si mas Art. 2 dhe qysh prej ditës se shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mvëshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimin e kësaj ligje, të pranueme dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 295 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 26-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 8

LIGJË, 26 Dhetuer 1926.

Mbi krijim kapitujsh dhe transferim krediti në buxhetin e Ministris së Drejtësisë 1926-27

(e botueme në Fletorn Zyrtare 5 Kallnuer 1927, Nr. 5)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Neni 1. – Nga kursimet e bamuna në budgetin e Ministris së Dreitësisë, të vjetës 1926-927 kap. 1. Art. 1 Rrogë për nji shumë fr. ari, 16.500 në katër muejt e parë të vjetës, krijohen artikujt qi vazhdojnë:

Kap. 1 Art. 2 Rrogë zavendësije me nji shumë 2.000, Kap. 2- Art. 12 Mobilje e makina shkrimi fr. ari 7000.

Neni 2. – I mveshen kapitujve e artikujve shumat qi vazhdojnë: Kap. 2 Art. 1 landë-shkresina fr ari 2.000, kap. 2 art. 7 Qira 1.800 kap. 3 Udhtim djete për hetime e dëshmitarë fr. ari 3.700.

Neni 3. – Kjo Dekret- ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes.

Neni 4. Ministrija e Drejtësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjisltive si mas shkresës Nr. 270 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 26-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Nr. 9

LIGJË, 13 Nanduer 1926.

Mbi pranimin e marrëveshjes në mes të Shqipnis e të Britanis së Madhe mbi mallnat e eksportueme

(e botueme në Fletoren Zyrtare 5 Kallnuer 1927, Nr. 1)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, në bazë të vendimit me datë 25-11-925 të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË

1. – Pranimin e marëveshtjes së nënshkrueme me 10 Qershuer 925, në mest Z. H. C. A. Eyres, Ministër Fuqiplotë i Britanis së Madhe e të Z. Mufid Libohovës aso kohe Ministër i Financavet e Zav. Ministër i P. të Jashtme i Republikës s'onë mbi mallnat e eksportueme prej të dy shteteve për t'u importue po ndër to, qi të gëzojnë tratamentin e Kombit ma të favorizuem si mbas kopjes së marrë-veshjes këtu ngjit.

2. – Ministrija e Financavet detyrohet me zbatimin e këtij Dekret-ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranuem dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 194 datë 7-XI-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 13-XI-1926.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme — H. VRIONI

Ministri i Financavet — S. STAROVA

Nr. 10

LIGJË, 22 Dhetuer 1926.

Mbi Laboratoriumin Kimik të Shtetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

1. – Themelohet Laboratoriumi Kimik i Shtetit.

2. – Laboratoriumi Kimik, formohet në Drejtori të veçantë dhe i bashkohet Ministris së Financavet.

3. — Qëllimi i këtij laboratoriumi, asht analizimi kimik i gjithë sendeve qi i dërgohen prej Ministris së Financavet.

Ç' do tjatër Ministri ose Zyrë e Shtetit ka të drejtë t' i dërgojë laboratoriumit sendet qi ka nevojë për analizim, tue kreditur Ministrin e Financavet me çmimin e analizimit të caktuem si pas tarifës së veçantë, që do të bahet prej seksjonit të laboratoriumit.

Gjith' ashtu kanë të drejtë t' i dërgojnë laboratoriumit sende për analizim dhe institutat e tjerë si dhe ç' do persone private a juridike, gjer sa nuk ndalohen punrat e Shtetit dhe tue paguar, çmimin e analizimit si mbas tarifës së sipërthanun.

4. — Personali i këtij laboratoriumi përbahet prej:

1) Nji kimisti me gradën e rrogën e Drejtorit.
2) Nji ndihmës-pregatitës me rrogën si pas budgetit.
3) Nji shërbtor me rrogën si pas budgetit.

5. — Emnohet si Kryetar-seksioni i laboratoriumit ay që:

a) ka dipllomë të skencave fizike dhe të ketë shërbyer në ndonji laboratorium kimik për 3 vjet, ose ay qi ka dipllomë kimis-ingjiner prej Universitet.

b) cilsit e tjera të lypuna prej ligjës për nëpunnsit.

6. — Si ndihmës përgatitës emnohet ay që:

a) ka dipllomë gjimnazore ose liceum dhe të ketë nji dije të mjaftë mbi skencën kimike dhe aprovimin e Kryetarit të seksionit të laboratoriumit.

b) cilsit e tjera të lypuna prej ligjës për nëpunësit.

7. — Detyrat e të drejtat e personalit të laboratoriumit caktohen me ligjë të veçantë të pregatitun sa ma shpejtë prej Ministris kompetente.

8. — Përjashtohen nga tagri doganuer veglat e landat e para të nevojshme për ngrefjen dhe punimin e laboratoriumit.

9. — Zbatimi i kësaj ligjë i ngarkohet Ministris së Financavet.

10. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të pupullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË

aprovimin e zbatimin e këtij Ligji, të pranuem dhe prej Dho-

mave legjislative, si mas shkresës Nr. 280 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 22-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 11

LIGJË, 22 Dhetuer 1926,

Për urdhnin e Besës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

Art. 1. — Për shenjën e kjartë të meritimeve krejt të posaçme për Atdhenë ndër qarqet ushtarake e civile, të cilat, vërtetohet se kapërcejnë mbi meritimet e dhanjes t' urdhnit Skenderbeut, krijohet Urdhni i Besës.

Ky mund t'i jepet dhe të huejve, me gjithë këtë, vetëm Kryetarëve të Shtetit e Shefavet Qeveris (Grand Cordon).

Art. 2. — Urdhni i Besës përbahet prej klasavet që vijojnë:

Klas e I. Grand Cordon me hyll.

Klas e II. Grand oficier, që d. m. th. Komanduer me pllake Oficier.

Klas e III. Komanduer.

Klas e IV. Oficier (vetëm pllakë oficieri).

Klas e V. Kavalier.

Art. 3. — Forma e klasave të ndryshme e shiritat përkatës do të shifen prej skicavet përkatshme.

Art. 4. — Mënyra e bartjes s' urdhnit:

Klas e I. Sheriti Grand Cordonit prej supit të djathtë në kërllokëll (gallgan) të majtë, hylli në anën e djathtë të krahnorit.

Klas e II. Komanduer me shirit reth qafës, pllaka e oficjen'anën e djathtë krahnorit.

Klas e III. Komanduer si naltë.

Klas e IV. Pllakë oficieri si naltë.

Klas e V. Kavalier n' anën e majtë të krahnorit naltë.

Art. 5. — Urdhni Besës, vehet në ç' do klasë para klasës së njinjishme të Urdhnit Skender-Beut.

Art. 6. — Propozimet dhe për dhanjet e Urdhnit Besës, vijojn dispozitat e Statutit t' urdhnit Skender-Beut.

Art. 7. — Dhanja e rregullshme e Urdhnit bahet me datën 28 Nanduer.

Art. 8. — Numri i Urdhnavet qi do të nepet (tuj mos llogaritë dhanjet e Urdhnavet për të huej) kufizohet si vijon:

Klasi i I. copë 5
Klasi i II. copë 10
Klasi i III. copë 20
Klasi i IV. copë 40
Klasi i V. copë 80

Art. 9. — Në dhanjen e nji gradës të naltë të Urdhnit, grada ma e ultë do të këthehet mrapa.

Art. 10. — Shenjat e Urdhnit mbas vdekjes së Proprietarit do t' i këthehen mrapë Qeveris.

Art. 11. — Gjykimi për shkak të nji delikti çnderushëm bje në vedi bjerjen e shënjit të Urdhnit (do të shënohet veçanërisht në gjykimin) që do të merret.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovranë të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 291 datë 18-XII-926 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22-XII-926

A. ZOGU

Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 12

LIGJË, 30 Dhetuer 1926,

Mbi krijimin e nji Drejtorije Policije

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

Art. 1. — Krijohet Drejtoria e Policiës e lidhun me Ministriën e P. Mbrendëshme me të drejtat e kompetencat që kanë Drejtorit e tjera t' asaj Ministrije.

Art. 2. — Drejtoria e Policiës ka me pasë një Drejtor me 400 Fr. ari, dhe Sekretar me 300 Fr. ari rrogë mujore.

Art. 3. — Shuma prej Fr. ari 2450 që lypset për rrogën e

Drejtorit e të Sekretarit, kanë me u përballue prej kursimevet të bamuna në bugetin e Ministriës së P. të Mbrendëshme, për vitin financjar 1926-1927.

Art. 4. — Kjo ligjë hyn në veprim që prej ditës së shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Art. 5. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji, të pranuem dhe prej Dhomave legjislativë si mas shkresës Nr. 287 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 30-XII-926

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 13

LIGJË, 22 Dhetuer 1926.

Mbi shtesën e rrogave të personalit të Gjyqit Politik

(e botueme në Fletorne Zyrtare, 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

Art. 1. — Kryetarit dhe dy anëtarëve qi janë oficera për veç rrogës, ju jepet dhe nga nji shtesë sa gjysa e rrogës që marrin.

Art. 2. Prokurori merr nji rrogë mujore 440 Fr. ari.

Art. 3. — Dy antarë civila dhe Gjykatësi Hëtuës marrin nga 400 fr. ari në muej.

Art. 4. — Dy sekretarët marrin nga 200 fr. ari, Kopisti 150, dhe shërbëtori 100 fr. në muaj.

Art. 5. — Për t' i bamë ballë shtesave të rrogave dhe shpenzimeve t' udhëtimit e djetave të personalit të Gjykatës Politike deri në mbarim të vjetit financjare 1926-1927, i akordohet nji kredit prej fr. ari 6000 tue i kursye nga Kap. 1 e 12 të Budgetit 926-927, të Ministris së Drejtësis,

Art. 6. — Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 7. — Ministrija e Drejtësis, e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet detyrohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kretari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 269 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 22-XII-926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 14

LIGJË, 22 Dhetuer 1926

Mbi krijimin e Zyrës post-telegrafike komunale

(e botueme në Fletoren Zyrtare 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

1. — Ministrija e P. Botore e Bulqësiës, autorízohet me marrë masa për krijimin të zyrave Postelegrafike; komunale.

2. — Zyrat komunale kan m' u krijue mbas dëshirës të nji katundit ose vendi tjatër, dishir qi ka m' u çfaq me shkres zyrtare drejtue autoritetevet kompetente.

3. — Shpenzimet gjithmare të postelegrafike komunale paguhen vetëm prej t' ardhunavet të tyne, teprica ka m' u shti në financat e Shtetit, dhe në qoftë se s' mjaftojnë kan m' u plotsue prej komunit ku qindron zyra.

4. — Veç t' ardhunavet, Shteti ka me pague fillin dhe izolatoret për zgjatim të vijës telegrafike dhe ka me plotësue nevojat e tyne për të shtypunat zyrtare.

5. — Shtyllat, puntorët për ngrehje e mirëmbajtjes të vijës i ngarkohen komunit.

6. — Nëpunsat për t-u emnue n' ato zyra kanë m' u zgjedh prej administratës qëndrore e cila ka me pasë të drejtë kontrollimi dhe urdhni sikur zyrat shtetnore tjera. Rrogat e nëpunsave në fjalë kanë me u caktue po prej administratës në fjalë,

7. — Për krijimin dhe rregullimin të veprimeve të kētyne zyrëve administrata e Postelegrafeve ka me lidh kontratë të rregullshëm me se i cillin komun qi ka me lyp zyra postelegrafike.

8. — Ministrija e Financës dhe ajo e P. Botore e Bulqësisë, ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë qi ka me pas fuqi qysh prej ditës së shpalljes saj në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj liigje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 289 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 22-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 15

LIGJË, 26 Dhetuer 1926.

Mbi ndryshimin e neneve 5, 19, 21, 26, 27, 28 të Ligjës së Rrugave

(e botueme në Fletoren Zyrtare 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, në vendimet me d. 30-XII-925, të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

Art. 5. — Të gjithë nënshtetasit Shqiptar, si edhe të huejt prej 18 gjer në 58 vjet, qi s'janë sakat, student, ushtarë, dhe nga trupi dipllomatik i të huejve, janë të detyruem të punojnë prej 8 (tetë) deri 10 (dhjetë) dit në mot, si mas largësis së vendit të punimit qi përshkruhet në nenin 19. Ata qi kanë të ardhuna ose fitime gjer me 100 (njiqind) napolona ari në mot, nuk paguajnë taksë rruge veç dhjetë dit veprën e tyne.

Të gjithë tjerët Shqiptarë, Shqiptarka e të huej pa u marrë parasysh mosha e tyne, qi kanë t'ardhuna ose fitime prej pasu-

nis tregtis, ose ç do burimi tjetër ma tepër se 100 (njiqind) napolona në mot. janë të detyruem edhe me pagesat e poshtëshënueme :

Të gjithë ata që kanë t' ardhuna e fitime përmbi 100 (njiqind) napolona gjer më 500 (pesëqind) napolona në mot, detyrohen të paguejnë $2^{0}/_{0}$ (dy për qind) taksë rrugë dhe prej 501 deri me 1000 (njëmijë) $2^{1}/_{2}{}^{0}/_{0}$ (dy e gjysëm përqind) taksë rrugë, e kështu tue u shtue gjysmë për qind për çdo 500 napolona t' ardhuna ose fitime qi të ketë.

Progreja e përqindjes nuk do të kapërzejë $6^{0}/_{0}$ (gjashtë përqind). Për shëmbëll nji qi ka t' ardhuna 450 napalona në mot, paguejnë nëntë napplona taksë e nji qi ka 8000 napolona në mot, paguejnë 480 napo. ar.

Neni 19. — Të dëtyruemit me punim rrugë, detyrohen të punojnë në çdo rrugë ose pjesë rrugë që ndodhet mbrenda qarkut Prefekturës ku banon. Në qoftë se vendi i punimit nuk kapërçen 15 km. prej Lagjës së bamniit, detyra e punimit ashtë dhetë (10) ditë, ose me pague 15-25 fr. ari. Por në qoftë se vendi i punimit ashtë përmbi 15 km. largësi nga lagja, atëhere vetëm 8 (tetë) ditë ose me pague 15-25 fr. ari.

Neni 21. — I zoti nji ose ma shumë mjetë mbartëse si qerrë, kuaj, mushka, gomare asht i detyruem me punue në vit nga 3 ditë me secilin mjet të tij, ose me pague :

Për qerre	fr. ari	15	deri	30
Për kalë ose mushkë . .	»	»	12	»	14
Për gomar	»	»	6	»	9

Kuer njeri zotnon ma shum se tre nga mjetet e përmenduna qofshin këso nji lloj ose të ndryshme, detyrimi me punë ose me të holla, simbas këtij artikulli asht vetëm për tre nga mjetet e të mbartunit, qofshin këtë nji llojë ose të ndryshme. Teprica e mjeteve të tjera i falet. Në këto rast Administrata Botore zgjedh mjetin ma të dobishëm të shërbimit.

Neni 26. — Nji ditë punë e çdo njeriut, i ngarkuem me punë rrugë ka me ju caktue me ditë ose me sistem metrik, tue marrë para sysh shkallën mesatare të punimti që mund të kryej nji njeri, nji kalë, nji mushkë, nji magar, nji qerre, e nji tjetër veglë mbartjeje.

Tue marrë para sysh këtë masë të caktueme kanë me ju diftue masat e punimit për 8 (tetë) ose për (dhet) ditë, si mbas largësisë së vendit të punimit si është parapa në Art. 19 dhe 21.

Neni 27. — Të detyruemit me punë Botore do t' a kryejnë detyrën e tyne kur t' a kërkojnë Administrata e P. Botore, por gjith nji tue marrë para sysh që banorët mos të pengohen në kohët e punimeve bujqësore.

Neni 28. — Pagesa e parapame n' artikullat 19, 21 bëhet n' Administratën e P. Botore, por kjo Administratë asht e detyrueme për këto të holla të mbajë llogarin në rregull e të rregjistrojë në bazë të ligjevet financjarë d.m.th. në çdo marrje ose shpenzime të hollash të përdorën dublikata dorë të shtypuna e të regjistrueme në regjistra të vulosuna.

Këshilli Administratës së vendit bashkë me dy antarë të Bashkisë dhe me dy antarë të Dhomës Tregtare, dhe ku mungon kjo me dy tregtare të vendit kanë me caktue pagesën mbrenda shumës së përmendun në artikullin 19, 21.

Kjo Këshillë ka me caktue pagesa dy herë në vit, në muajin e Prillit dhe në muajin e Shtatorit të ç' do viti.

Ministrija e P. Botore e Bulqësis, Ministrija e Drejtësis, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe Ministrija e Financavet, janë të detyruem me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimin e kësaj Dekret-ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 202/I datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 26-XII-1926.

A. ZOGU

Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Nr. 16

LIGJË, 25 Dhetuer 1926

Mbi marrëveshtjen provizore midis Shqipnis e Bullgarisë

(e botueme në Fletoren Zyrtare 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

1. — Pranohet marrëveshtja e përkohëshme e nënshkrueme me datë 31 Tetor 1826, midis Z. Hysein Vrioni, Minister i P.

ЧСО-Іи

të Jashtme i Republikës s' onë, dhe Z. Ivan Iconomoff i ngarkuem me Punë i Mbretnis Bullgare mbi eksportimin dhe importimin e mallnave në mes të dy Shtetevet në bazë të pranimit të reciprocitetit dhe të tratamentit të kombit ma të favorizuem si pas kopjes këtu ngjitun: (1)

2. – Kjo marrëveshtje mund të denoncohet kurdoherë prej secilës nga të dy anët kontraktuese me nji paralajmim të nji muejshëm.

3. – Ky ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Gazetën Zyrtare.

4. – Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJMË:

aprovimin e zbatimin e kësajë ligje, të pranueme dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 283 datë 18-XII-1926 të Kryesis Senatit.

Tiranë. më 25-XII-1926. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet S. STAROVA

Ministri i P. të Jashtme H. VRIONI

---

(1) Shkëlqesis së Tij
Z. Hysein Vrioni
Ministër i P. të Jashtme të Shqipnis,

Zotni Ministër,

Në gjegje të notës me datën 25 Tetuer vazhduës nën Nr. 2999-III me të cilën Shkëlqesa e Juej ka pasun mirësinë me më njoftue së Këshilli Ministruer, në vendimin e tij me datën 21 Tetuer vazhdues, ka pranue proponimin e Qeveris Bullgare me lidhun nji ujdi tregtare të përkohëshme në mes të dy vendeve t' onë, kam nderin duhësisht i autorizuem, me dekllarue që Qeverija Mbretnore Bullgare dhe Qeverija e Republikës Shqiptare kanë rá në marrëveshtje për të lidhun nji ujdi tregtare të përkohëshme me anë të secilës të dy anët zotohen me aplikue reciprokisht në marrëdhënjet e tyne tregtare clause-n e Kombit me të favorizuem.

47059
BIBLIOTEKA KOMBETARE
TIRANE

Kuptohet se kjo ujdie do t' aplikohet mbas përmbushjes së formalitetevet të përshkrueme nga ligjët e mbrendëshme të secilës nga të dy anët kontraktuese.

Kjo ujdi mund të denoncohet prej secilës nga të dy anët me anë të nji paralajmimit të nji muejshëm.

Ju lutem Zotni Ministër, të pëlqeni sigurimet e konsideratës s' eme të naltë.

I ngarkuem me Punë të Bullgaris
I. Iconomoff

Zotnis
Ivan Th. Iconomoff
I ngarkuem me Punë të Bullgaris
Tiranë

Zotni,

Në përgjegje të notës me datën 27 vazhduës nën Nr. 249 që ju keni pasun mirësin me më dërgue e qi i përket ligjës e të nji ujdisë tregtare të përkohëshme në mes të dy vendevet tona, kam nderin duhësisht i autorizuem me deklarue se Qeverija e Republikës Shqiptare dhe Qeverija Mbretnore Bullgare kanë rae në marrëveshtje për të lidhun nji ujdije tregtare të përkohëshme me anë të cilës të dy anët zotohen me aplikue reciprokisht në marrëveshtjet e tyne tregtare clause-n e kombit ma të favorizuem.

Kuptohet se kjo ujdije do t' aplikohet mbas përmbushjes të formalitetevet të përshkrueme nga ligjët e mbrendëshme e të secilës nga të dy anët Kontraktuese.

Këjo ujdi mund të denoncohet prej së cilës nga të dy anët me anët të nji paralajmimit të nji mue'shëm.

Ju lutem Zotni i ngarkuemi me Puné të pëlqeni sigurimet e konsideratës s' eme të naltë.

Ministri P. të Jashtme
H. VRIONI

Nr. 17

LIGJË, 25 Dhetuer 1926.

Mbi pranimin e marrëveshjes midis Shqipnis e Çekosllovakisë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Kallnuer 1927, Nr. 2)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit, tue bamë dhe vendimin Nr. 608 datë 9-XII-1926 të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

1) Pranimin e Marrëveshjes së nënshkrueme me datë 19 Kallnuer 1926, midis z. Hysen Vrionit Ministër i P. të Jashtme i Republikës s' onë dhe të Z. Kadlec, Konsull i Republikës Çekosllovake mbi eksportimin dhe importimin e mallnave në të dy Shtetët në bazë të reciprocitetit dhe të tratamentit të kombit ma të favorizuem si mbas kopjes këtu ngjitun. (1)

2). Ky Dekret-Ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3) Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij Dekreti-Ligji.

Na, Kryetari i Republikës, Shqiptare,i mveshun prëj vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij dekret-ligji të pranuem dhe prej Dhomave legjislative si mas shkresës Nr. 271 datë 18-XII-1926 të Kryesís Senatit.

Tiranë, me 25-XII-1926 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

---

(1)

Tiranë, me 19 Kallnuer 1926

Zotni Ministër

Dyke rëfyer dëshirën e gjallë për favorizimin e zhvillimin e marrëdhanjevet ekonomike midis dy vendevet, kam nderin i autorizuem për këtë çeshtje, t' i konfirmoj Ekselencës s' Uej se deri sa të lidhet nji traktat tregtijê definitiv, Qeverija e Republikës Çekosllovake erdhi në marrëveshtje me Qeverin Shqiptare për të rregulluar marrëdhanjet tregtare midis dy vendevet mbi bazën e aplikimit mutuel të konditës së kombit ma të favorizuem.

Me gjithë këtë dispozitat e kësaj marrëveshtje nuk mund t' aplikohen regjimit të veçantë i stabilizuar për trafikun kufizuer në nji gjanësi mesetare 15 km. nga ç' do anë të kufinit.

Është e vendosur se në rast nevoje një marrëveshtje e veçantë mbi aplikimin e shtrëngatave dhe t' importimit e t' eksportimit do të lidhet midis dy vendevet për të lehtësuar tra-

fikun reciprok edhe po në kohën që njena ose tjetra nga anët kontraktuese do të jetë e shtrënguar të mbajë ndalimet dhe shtrëngata e nalt-tregueme

Kjo marrëveshtje do të hyjë në fuqi, 20 ditë pas datës së kësaj notë dhe mund të denoncohet nga e cila prej të dy anëve kontraktuese me nji paralajmim tre muejsh.

Ju lutem Zoti Ministër të pëlqeni nderimet e konsideratës s' eme të naltë.

Jos. M. Kadlec
Konsull
me cilësi të fuqiplotës e Rep. Çekosllo.

Ekselencës së Tij
H. Vrioni
Ministri i P. të Jashtme të Rep. Shqip.
Tiranë

Tiranë, me 19 Kallnuer 1926

Zoti Konsull

Duke rëfyer dëshirën e gjallë për favorizimin dhe shvillimin e marrëdhanjevet ekonomike midis dy vendevet kam nderin i autorizuem plotësisht për ketëçësht je, të ju konfirmoj se, deri sa të lidhet nji traktat tregtije definitiv, Qeverija e Republikës Shqipëtare erdhi në marrëveshje, me Qeverin Çekosllovake, për të rregulluar marrëdhanjet tregtare midis dy vendevet, mbi bazën e aplikimit mutuel të konditës së kombit ma të favorizuem.

Me gjithë këtë dispozitat e kësajë marrëveshtje, nuk mund t' aplikohen regjimit të veçantë, i stabilizuar për trafikun kufizor në nji gjanësi 15 km. nga çdo anë të kufinit.

Esht e vendosur se në rast nevoje një marrëveshtje e veçantë mbi aplikimin e shtërngatave dhe ndalimeve t' importimit e t' eksportimit, do të lidhet midis dy vendeve për të lehtësuar trafikun reciprok edhe po në kohën që njana ose tjetra nga anët kontraktuëse do të jetë e shtrënguar të mbajë ndalimet dhe shtrengatat e nalt-tregueme.

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi, 20 ditë pas datës së kësaj note dhe mund të denoecohet nga secila prej të dy anëvet kontraktuëse me nji paralajmin tre muejsh.

Pranoni ju lutem Zotni Konsull, çfaqjen e nderimeve të mija ma të çquara.

Ministri P. të Jashtme
H. VRIONI

Zotni
Josef Kadlec
Konsulli i Republikës Çekosllovake
Tiranë

N. 18

LIGJË, 26 Dhetuer 1926.

Mbi Koncesionin e fabrikës Birrë në Shkodër

(I botuem në Fletoren Zyrtare, 7 Kallnuer 1927 Nr. 2)

I bamë ndërmjet Ministris së P. Botore e Bulqësis e Përfaqësuëme prej z. Musa Juka, me nji anë, e m' anën tjetër Z.z. Vllazën Kakarriqi (Mark, Tush, Luigj, Lin) asht konvenue e vendue sa vazhdon:

Art: 1. — Qeverija Shqiptare, me kondita e detyrime të posht shënueme i jep Konçesionarit Z.z. Vllazën (Mark, Tush, Luigj Lin) me ngrehë nji fabrikë Birret, në qytetin e Shkodrës.

Art. 2. — Konçesjonari, qysh prej datës të ratifikimit e të shpalljes në Fletoren Zyrtare, detyrohet të fillojë nga importimi i veglave mbrenda 6 (gjashtë) muejve e prej kësaj kohe mbrenda 18 (tetëmbëdhetë) muejve t' a ketë fillue fabrikacionin e birrës d. m. th. gjithsejt 2 (dy) vjet.

Art. 3. — Qeverija Shqiptare, i përjashton për 30 vjet nga taksa doganore e taksa tjera sendet e poshtë-shenueme:

a) gjith materjalet, veglat për ngrehjen e ndërtesës të fabrikës dhe për instalimin e maqinave;

b) gjith materjalet e para (mevadi-iptidaije) të quejtuna shentifikisht Humulue, Lupulus gjith ashtu edhe Malto.

c) esportacionin e sendeve të fabrikueme prej kësaj industrie.

Art. 4. — Konçesjonari, për posë përjashtimeve të taksave që u përmend, ma sipër asht i përjashtuem dhe nga ç' do lloj taksit q' i ngarkohet kapitalit t' investuem për qëllimin e këtij konvencionit.

Art. 5. — Për në qoftë se si mbas studimeve e konstatimeve kuptohet që landa e prueme pa taksë doganuer, kapërxen sasinë që asht shpenzue për materjalin e fabrikuem dhe ate që ndodhet në fabrikë i pa përdoruem, për tepricën kon-

çesjonari, detyrohet me dhanë nji taksë doganuer, dy fish e në rasë të përsëritjes për posë taksa që merret si u tha ma sypri, por humbet dhe të drejtën mbi faljen e gjithë taksavet.

Art. 6. — Materiali i përjashtuem nga taksa doganore do të shkojnë drejt për drejt në magazinën e posaçme të fabrikës dhe do të shpenzohen vetëm për fabrikimin e birrës e qi ka për qëllim ky konvensjon. Ky material nuk mund të nxirret e të mbahet n' asnji mënyrë jashtë magazinës së caktueme, e në rasën e kundërt materiali në fjalë konfiskohet, e në përsëritje merret prej konçesjonarit si gjobë çmimi i landës dhe nji herit bjerrë të gjithë të drejtat qi ka mbi të falunit e taksave.

Art. 7. — Konçesjonari i paguen Qeveris Shqiptare, mbi sasiën e prodhimit të pronditun e për çdo hektolitër birret, nji shumë prej fr. ari 2.75 (dy e shtatëdhetë e pesë) detyrim i cili do të paguhet tremujorisht e në bazë të konstatimeve qi kanë me u ba.

Art. 8. — Në qoftë se prej anës së konçesjonarit nuk i paguhet Qeveris shuma e caktueme n' artikullin e ma parshëm. Qeverija ka të drejtë me gjobitë me dy fish t' asaj shume dhe kjo gjobitje asht e preme e pa apelueshme dhe pa kenë e lidhun me rregulla proceduriale.

Art. 9. — Konçesjonari. për çdo vjetë detyrohet të i paraqesi Qeveris nji pasqyrë qi do të përmbajë shumat e sasis të pronditun dhe atë të konsumume së bashkut me nji justifikacion.

Art. 10. — Konçesjonarit i lejohet eksportimi i birrës atëher kur të ketë plotësue me konditat e nevojshme sasin qi lypet për t' u konsumue në vend.

Art. 11. — Konçesjonari detyrohet me shtie në punë të gjithë nëpunsat, puntorët me nënshtetësi Shqiptare, për posë teknikëve specialistëve të cillët nuk mund të gjinden në Shqipni, gjithë ashtu detyrohet me i mjekue me mjeksinat e veta puntorët a puntoret.

a) të sëmuëm ;

b) të plagosun.

Mjeksinat e barnat do t' u nepen puntorëve gratis.

Art. 12. — Përjashtimi nga tagri doganuer të landës së parë e (mevadi iptidaije) i përmendun n' art. 3 të këtij Konvencioni, do të vehet n' eksekutim prej anës së Qeveris atëhere kur konçesjonari, të ketë zbatue shtimet e art. 2 e të jetë gati për fabrikacionin e birrës.

Art. 13. – Konçesjonari, detyrohet me ju shtrue të gjitha mënyrave të nevojshme, për konstatimin e materialit të fabrikuem në bazë të së cilit, konstatim ka për t' u nxjerrë shuma e detyrimit të marrun prej anës së konçesjonarit siç banë fjalë art. 7 (VII) i ma parshëm.

Art. 14. – Konçesjonari i shtrohet ç' do lloj tagri apo taksi të sotshëm a po i pritshëm për veç përjashtimeve të parapame në këtë konvencjon.

Art. 15. – Qeverija angazhohet me vue nji taksë importimit e kjo taksë do të jetë me atë masë sa me mbrojtë industriën e birrës së vëndit kundra konkurencës së jashtme.

Art. 16. – Për çdo konsekuencë juridike të lindun prej ushtrimit të këtij konvencioni, konçesjonari zgjethë për banim të tij Qytetin e Shkodrës dhe në rasë qi ndërmjet të Qeverisë e të këtij dalin kundërshtime anët kundërshtuese, përpara se t' i drejtohen Gjyqit do të i u shtrohen nji arbitrazhit i formuem prej së cillës anë kundërshtare në nji arbitër, e për nji të drejtë zgjidhet Kryetari i Gjyqit ma i naltë qi gjindet n' atë qytet.

Në qoftë se anët kundërshtare nuk i shtrohen vendimit arbitrazhit atëhere çashtja ka për t'u i sjellë gjyqit kompetentë i cili ka me dallue çashtjen definitivisht.

Art. 17. – Në qoftë se konçesjonari nuk ka përmbushë detyrimet qi ka marrë në këtë koncencjon, Qeverija ka të drejtë me anulue konçesjonin pa kurrfarë detyrim shpërblimi.

Art. 18. – Ky Konvencjon hyn në fuqi pasi të jetë vërtetue nga Pushteti Legjislativ e të shpallet në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin ë zbatimin e këtij Kanvencjoni të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 281 datë 18-XII-926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 26-12-926.

A. ZOGU

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 19

LIGJË, 22 Dhetuer 1926.

Mbi zbritjen e taksit t' eksporimit të qitrave bakalle

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Kallnuer 1927, Nr. 3)

Art. 1. — Taksa e shënueme në paragrafin (b) të Nr. 50 Kap. III. të pjesës s' ekspportimit të tarifës Doganore me datë 15-VI-1926 zbritet në fr. ari 1 (nji).

Art. 2. — Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

Art. 3. — Ministrija e Financavet detyrohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetıt të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJMË:

aprrovimin dhe zbatimin e kësaj Ligjë, e pranuem dhe prej Dhomave legjislative, si mas shkresës Nr. 285 datë 18-XII-1926 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 22-XII-1926.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 20

DEKRET-LIGJË, 10 Kallnuer 1927.

Mbi transferim krediti prej fr. ari 21.000 në buxhetin e Ministris së P. të Mbrendëshme 1926-27

(e botueme ne Fletoren Zyrtare, 11 Kallnuer 1927, Nr. 3)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin D. 7-I-1927 të Këshillit Ministruar.

DEKRETOJMË:

I. Autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme me transferue nji kredi prej 21.000 fr. ari nga Kapitulli 15 në Kapitullin «Propagand Shtypi» të budgetit të saj t' ushtrimit financjar 1926-27.

II. Kjo Dekret-ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

III. Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-ligje.

Tiranë, me 10-I-1927.

A. ZOGU

Nr. 21

LIGJË, 27 Dhetuer 1926.

Mbi Shitje të pasunive të patundëshme Shtetnore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 25 Kallnner, 1927 Nr. 6)

Art. 1. – Autorizohet Qeverija, me shitë pasunitë e patundëshme, të Shtetit, qi janë të shënueme në listën anëkse të kësaj ligjë, me anën e nji Komisjoni i përbamë prej:

a) Nëpunsit të Financavet,
b) Antarit të Këshillit Administratës,
c) Nëpunësit të Kadastrës,
ç) Nëpunsit të Bujqësisë (n' asht se ka),
d) Antarit të Bashkis,

tue qënë i kryesumnn prej nëpunësit të Financavet, dhe i syrvejuem prej Prefektit ose Nënprefektit.

Art. 2. – Antari i Këshillit t' Administratës, zgjidhet e emnohet me vendim t' atij Këshilli, dhe aji i Bashkis me vendim të Këshillit të saj.

Art. 3. – Pasunija që diftohet në lishtën anëkse të kësaj ligje, shitet n' adjudikatë me anë të Komisjonit që përmendet n' art 1.

Lista anëkse, përbahet prej 158 (njiqind e pesëdhet e tetë) faqe, përmbanë numrin 1 (nji), vërtetimin e Ministris së Financavet, konfirmimin në ç' do faqe me vulën e Dhomës së Deputetvet, dhe nënshkrimin të Kryetarit të saj.

Art. 4. – Leçitja e këtyne pasunive, vazhdon 30 dit dhe shitja definitive 15 dit; në rast që leçitja e parë mos të ketë aritun çmimin e pëlqyeshëm; leçitja në fjalë vetëm për nji herë zgjatet edhe 30 dit të tjera, zgjatimi i afatit të parë do të bëhet me vendimin e Komisjonit tue u tregue shkaqet justifikative. Leçitjet (shpalljet) do te bëhen me anën e të gjitha Bashkivet, të shtypit vendit e me anën e kasnecavet (tellallvet) tue u caktue ne këto shpallje ditët e fillimit, të vartunit si edhe të mbarimit t' afatit t' adjudikatës.

Art. 5. — Ofertat pranohen mbassi të depozitojnë n' arkën e Financavet ofertuësit 15% (pesëmbëdhetë për qind) mbi çmimin që do t'i caktojë Komisjoni leçitës pasunis që ndodhet n' adjudikatën e cila depozitë mbetet vetvetiu n' arkën e Financavet në rasë që ofertuësi mos të dorëzoj shumën e blerjes në tre dit e sipër pas ditës së nesërmes të shitjes.

Shpenzimet e leçitjes dhe kadastrore do të paguhen nga blerësi si mbas ligjevet relative.

Art. 6. — Zyra Kadastrore ban të gjitha veprimet ligjore për kalimin të pasunis së shitun n' emën të blesit tue u bazue në aktin e shitjes Zyrtare.

Art. 7. — Të gjitha dispozitat e Kodit Civil, të ligjës së Tokavet e të Kadastrës që flasin mbi të drejtat preferuëse fqinjore e shoqnore (shufa, Haliti Sherif, Haki Ruxhhan) për sa i përkasin zbatimit të kësaj ligje, janë të rëzueme nga vleftat ligjore; merren parasysh vetëm në rasë kur t' interesuëmit që kanë të drejtat e përmenduna në këtë artikull, pranojnë blerjen e pasunis me shumën e shitjes definitive deri në kohën e fundit t' adjudikatës.

Tokat në qytet mbi të cilat janë të ngrehuna shtëpira prej privates dhe për të cilat toka, këta paguajnë nji qira (ixharizemin) nuk qitën n' ankand, por u shitën banuësve me nji vleftë të caktuëme prej Komisjonit i përbamun si mbas artikullit 1 (nji) dhe vlefta e caktueme paguhet në këste mbrenda 3 (tri) vjetve.

Art. 8. — Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në gazetën Zyrtare.

Art. 9. - Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJË:

aprovtmin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 265 datë 18-XII-1926 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 27-XII-1926

A. ZOGU

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Pasunit shtetnore të përndame qi duhen shitë

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
1	Shkodër	Galladë	N'at anë Bunet	Truell shpije	Gjith	—	$2^1/_2$	—	Mali Rruga e madhe	Çë më 12-7-1327	
2	»	»	»	»	»	—	»	—	Mali Rruga Magazina e Kupsht i Shtetit		
3	»	Tepe	»	Prozhëm	»	—	21	—	Halil Troshani Isuf Hobi Rruga	Çë më 25-4-1328	
4	»	Top-hanë	»	Shtëpi	»	—	—	—	Meraja Mali Rruga	Çë më 5-7-1329	
5	»	Tepe	Draçin	Prozhëm	»	1320	—	—	Rruga Nut Flami Halil Troshani Selman Daka	Çë më 2-9-1328	
6	»	Lugu Çesme	»	Sekretaria (Kalëmod.)	»	—	—	—			
7	»	Galladë	N'at anë Bunet	Roje (Kaush)	»	—	—	—			
8	»	»	»	» me kopsht	»	—	—	—			
9	»	Tabakë	T'u xhamija	Ish depot e municjonit	»	—	—	—			
10	»	»	Ura e Bahçallëkut	Nji copë vënd me nji ahër të rënduem	»	—	—	—			
11	»	»	»	Kaush e rëndueme	»	—	—	—			
12	»	Dervish Tepe	»	Tri kazerna të rënduem	»	—	—	—			
13	»	Çesme	Lugu çesme	Dy kazerna të rënduem	»	—	—	—			

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
14	Shkodër	Tarabosh	Lugu çesme	Kazernë e rëndueme	gjith	—	—	—			
15	»	Bërdicë	»	2 kazerna 2 kaushë të rënduem	»	—	—	—			
16	Durrës	—	—	Tokë ndërtimi	»	375	—	500	Rruga kulla rendi e muri kalas Hotel Llarda	Çë moti	
17	»	—	—	Tri magaze të rendueme	»	—	—	15000	Pasuni Shteti Rruga e Fusha e depot-s së Doganës	E konfiskueme Esad Toptani	
18	»	—	—	Tokë ndërtimi	»	1265	—	3000	Rruga Ismail H. Ballhysa Hajrie Isuf Hikaçeviq Truell Shteti	Çë moti	
19	»	—	—	Moçal	»	2700	—	1000	Rruga Kopshti i Shaban Çerlajt, Rruga e Skelës, Deti		Asht përmirësue pjesërisht
20	Tirana	Lagja e ré	Tokë	Tokë	»	—	9	—	Rruga Rruga e Shkodrës Muharrem Bakalli		
21	»	Myzez	»	Mullij	$^1/_2$	—	—	—	Islam Alla Via Rruga		
22	»	Damë e pashme	»	Tokë	gjith	—	30	—	Rruga Qanije Libohova Ismail Shehu		
23	»	Breg Lumi	»	Mullij	$^1/_2$	—	—	—	Rruga Rrugicë Toka e Derhemve		
24	»	Mushqeta		2 ullij	gjith	—	—	—	Xhem Rama Prue Vetë		

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicioni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
25	Tiranë	Mush-keta		2 ullij	gjith				Lush Bajrami Mehmet Azizi Bajram Tahir Mal Mahmuti		
26	»	»		13 ullij					Rruga Proni Vorrezët Ali Musta		
27	»	»		10 ullij					Mahmud Isufi Mal Lala Nurie Hamit Vorrezet		
28	»	»		15 ullij					Vorrezet Mal Sala Ali Musta Selim Beu		
29	»	»		22 ullij					Tahir Tafa Mal Saba Deja Bajramit		
30	»	»		24 ullij					Xhem Rama Veseli Selmani Rruga		
31	»	»		17 ullij					Rruga Proni		
32	»	»		20 ullij					Vorrezët Proni Mehmed Hafëzi		
33	»	»		8 ullij					Rruga pa krye Rrugë Proni Vesel Targa		
34	»	»		21 ullij					Rruga Proni Ibrahimi Mal Sala		
35	»	»		19 ullij					Mal Sala		
36	»	»		18 ullij					Rruga Hasan Islami Hasan Islami		
37	»	»		12 ullij					Rruga Rruga pa krye Proni Ramazani		

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
38	Tiranë	Mysh-keta		2 ullij	gjith				Hasan Sallufi Alush Sallufi Sadin Rruga		
39	»	Linza		8 ullij					Hysejn Guxha Selim Tusku		
40	»	»		2 ullij					Pylla Rruga Salih Qesaraku		
41	»	Lana Bregas		34 ullij					Grifsha Rruga Sinuri i katundit Lana		
42	»	Priska e madhe		18 ullij					Në kullotje të katundit		
43	»	»		3 ullij					Rruga Lik Brahimi Kopësht i Vajës		
44	»	»		3 ullij					Hasan Kushi Rruga Idris Qerdja Proni		
45	»	»		13 ullij					Ibrahim Krohi Hysejn Bajrami Proni		
46	»	Hekalle		8 ullij					Në kullotje të katundit		
47	»	»		1 ulli					Lana Met Selmani Hamdi Proni		
48	»	»		1 ulli					Kopshti i Dikut Rruga		
49	»	»		1 ulli					Rruga Rruga Met Selmani		
50	»	»		2 ullij					Prroni Kopshti i Hidës Rruga		
51	»	»		1 ulli					Rruga Vetë Rruga		
52	»	»		11 ullij					Met Gjoshi Can Tafa Proni		
53	»	»		2 ullij					Met Selmani Man Saka Rruga		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (Pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
54	Tiranë	Hekalle		4 ullij	gjith				Him Saka Adem Saka Rruga Shkambi		
55	»	»		4 ullij					Lam Aliu Ali Isufi Mal Daja Rruga		
56	Kavajë	Spa-nesh		Tokë			15		Asllan Kotri Tahir Aga Rruga	Nga Banka e Bujqësis	
57	»	Tilej		24 ullij	$\frac{163}{753}$				Kostantin Goga Kostantin Goga Kostantin Goga Kostantin Goga	»	
58	»	»		Tokë	$^{13}/_{20}$				Kostantin Goga Kostantin Goga Kostantin Goga Kostantin Goga	Që moti	
59	»	Bullutej			$\frac{163}{753}$		$15^{3}/_{4}$		Molla Saliu Rruga Hajdar Bej	Nga Banka e Bujqësis	
60	»	»			$^{1}/_{5}$		8		Rruga e madhe Rruga e vogël		
61	»	»			gjith		7		Veli Dëlmrozi Ali Bluti Bajram Delmrozi		
62	»	»			»		5		Adem Bej Ibrahim Xhahy-sa Sali Demir Hajdar		
63	»	Vora-zen			$\frac{163}{763}$		$66^{1}/_{2}$		Muharrem Meh-med Natixhe Hanka		
64	»	»			»		$33^{1}/_{2}$		Rexhep Ismajli Rruga		
65	»	»			$^{73}/_{206}$		$27^{1}/_{2}$		Rruga Osmani		
66	»	»			»		$39^{1}/_{2}$		Ymer Ismail Rruga		
67	»	»			gjith		15		Zeman Hoxha Hajdar Bej Gorga Prroni		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
68	Kavajë	Vorazen		Tokë	gjith		15		Isuf effendi Ymer Katorri Rruga Ymer Alush		
69	»	»			»		6		Adem Muha Jakup Shehu Hasan Shemzi	Nga Banka e Bujqësis	
70	»	Gërmuji			$^{73}/_{266}$		10		Sheh Mahmud Ali Proni		
71	»	»			»		10		Proni Selmani Rruga		
72	»	»			gjith		20		Sheh Ilias Nuredin Abdi Meta Selmani		
73	»	Havanaj		1 shtëpi	$^{1}/_{5}$				Vetë edhe Shteti		
74	»	»			$\frac{71}{1940}$						
75	»	»			»						
76	»	»			»						
77	»	»			»						
78	»	»			»						
79	»	»			»						
80	»	»			»						
81	»	Levanaj		Shtëpi	»				Vetë dhe Shteti	»	
82	»	»		Tokë	»		$2^{1}/_{2}$		Shteti dhe Isufi		
83	»	»			»		$4^{1}/_{4}$		Ramazani Hasan Isufi		
Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
753	Malla-kastrë	Fratár	Ara Le-zos	Arë	gjith		1	—	Lumi Shabani Ahmedi Ataullahu	Nga Banka e Bujqësis	
754	»	»	Dushke	»	»		2	—	Burhani Jaho Udha Shabani		
755	»	»	Ple-pes	»	»		8	—	Udha Shabani Hamidi Burhani		
756	»	»	Drizâ	»	»		3	—	Hamidi Burhani		
757	»	»	Shko-za	»	»		2	—	Burhani Lumi Jaho		
758	»	»	Moçale Mehm.	»	»		3	—	Lumi Taullahu Jaho		
759	»	»	Bre-gu	»	»		3	—	Hamidi Zylali Udha		
760	»	»	Skua-pa	»	»		1	—	Burhani Udha		
761	»	»	»	»	»		2	—	Zylali Lumi Jaho Udha e Ataullahut		
762	»	»	Kavo linë	»	»		7	—	Telo Mahmud Zapo Lumi		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
763	Malla-kastrë	Gjerber	Bre-gu	Arë	gjith		4		Suloja Fejzoja Izeti	Nga Banka e Bujqësis	
764	»	»	Koqi-na	»	»		3		Jaçe Hamidi Jusufi Lumi		
765	»	»	Yrte	»	»		2		Nure Hamid Zejnel Udha		
766	»	»	Ishto-gola-ne	»	»		6		Hamid Beqir Bazo Lumi		
767	»	»	Ke lumi	»	»		15		Mustafaj Salushi Udha Lumi		
768	Berat	Allam-brez	Ura	»	»		12		Udha Shabani Kapo		
769	»	»	Je-shile	»	»		5		Elmas Ceno Sako Resuli Ragipi		
770	»	»	Ga-ranci	»	»		4		Udha Meso Rushidi Cane		
771	»	»	»	»	»		8		Lumi Shabani Haxhiu Elmazi		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
772	Malla-kastrë	Lofkënd	Mole	Arë	gjith		4	—	Hasani Udha Hamidi Lumi	Nga Banka e Bujqësis	
773	«	«	Loke	«	«		6	—	Hamidi Lumi Murati		
774	«	«	Mo-çale	«	«		6	—	Hamidi Hazli Mehmedi Udha		
775	«	«	Raha	«	«		4	—	Lumi Udha Hamidi		
776	«	Fratár	Gro-pa	«	«		2	—	Suloja Ali Rapo		
777	«	Lofkënd	«	«	«		2	—	Ish i zoti		
778	«	«	Ara e Os-manit	«	«		—	—	Ali Mehmed Hamid Bej		
779	«	«	Re-gele	«	«		-	—	Ali Rapo Udha		
780	«	«	Ara e Sa-liut	«	«		1	—	Ali Rapo Haxhi I zoti i për-parëshëm		
781	«	«	Ara Lu-lesh	«	«		2	—	Izeti Ali Rapi		
782	«	«	Jyrte	«	«		2	—	Udha Ali Rapi Izeti		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
783	Malla-kastrë	Lofkënd	Va-dini	Arë	gjith		1	—	Ali Rapi Ali Udha	Nga Banka e Bujqësis	
784	«	«	Jyrte	«	«		5	—	Ali Rapi Lumi Daçe		
785	«	«	Lubi-shte	«	«		1	—	Izeti Ali Rapi		
786	«	«	Istru-ze	«	«		3	—	Udha Ali Rapi Rexhepi		
787	«	«	Va-dhize	«	«		4	—	Dajlani Udha		
788	«	«	Ara e Xha-ferit	«	«		100	—	Ali Izet Ferhet Mehmed		Nuk do shitet mbasi asht çiflik
789	«	«	Gro-pa	«	«		2	—	Udha Ali Rapi Izeti		
790	Berat	Drobo-nik	Gori-ca	«	«		32	—	Prroi i Stilës Fusi Dekos Lumi i Shkozës Mali Dyle Nazo e Sulej. Zeqir	Kun-drejtë detteve	
791	«	Cukalat	«	Shtëpi	«		—	—	Udha Shabani Shabani		
792	«	«	«	«	«		—	—	Udha Duqanet reke Ish i zoti		
793	«	«	«	«	«		—	—	Udha Ish i zoti		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
794	Berat	Cukalat	Gori-cë	10 ullij	gjith		—	—	Izeir Udha Ish i zoti	Kun-drejtë detteve	
795	»	»	»	15 ullij	»		—	—	Udha Sadiku		
796	»	Kikias	Ka-ninë	Arë	»		8	—	Pasuni e Shtetit Beqir Beu		
797	»	»	Arë-za	»	»		4	—	Abdullah Effendi Shahin Beu Udha Kisha		
798	»	Luar	»	150 ullij	»		—	—	Udha Adili Hamidi		
799	»	»	»	9 ullij	»		—	..	Hamidi Metullahu Meçani		
800	»	»	»	20 ullij	»		—	—	Udha Isaja Ish i zoti		
801	Malla-kastrë	Siqese	»	Mulli	»		—	—	Ish i zoti Udha		
802	Berat	Peshtan Nahije	Ara jyrte	Arë	»		5	—	Neimi Esat Beu Mahmudi Ish i zoti		
803	»	»	Ara e ma-dhe	»	»		10	—	Udha Neimi Mahmudi Salihi		
804	»	»	»	»	»		10	—	Neimi Mahmudi Lumi Ymeri		

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
805	Berat	Peshtan Nahije	Talla	Tokë	gjith		15	—	Neimi Mersini Lumi Udha	Kundrejtë detteve	
806	»	»	Badra	«	«		2	—	Neimi Tahiri Duçe Mahmudi		
807	»	»	Ara ke mullijt	«	«		5	—	Bilali Sulejmani Salihu Duçe		
808	»	»	Ara Çivire	«	«		3	—	Halili Udha Jufani Neimi		
809	»	»	Lajthi	«	«		2	—	Bilali Mahmudi Sulejmani		
810	»	»	Zozdë	«	«		5	—	Neimi Mustafaj Mahmudi Musaja		
811	»	»	Lehre	«	«		4	—	Neim, Pasho Udha Myslimi		
812	»	»	Çemeçeli	«	«		5	—	Sulejmani Tahiri Udha Mustafaj		
813	»	»	Fusha	«	«		3	—	Selimi Udha Haliti Kajabe		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
814	Berat	Beshtan Nahije	Kop-shti	Tokë	gjith		3	—	Neimi Myslimi Karajfili Udha	Kun-drejtë detteve	
815	«	«	Kuqi-ni	«	«		3	—	Myslimi Neimi Udha Karajfili		
816	«	«	Xhea ze	«	«		3	—	Mustafaj Selim, Ahmed Udha		
817	«	«	Kuqe ne	«	«		13	—	Udha Mustafaj Ferhati Lumi		
818	«	«	Çai-re	«	«		15	—	Karafili Myslimi Mahmudi Udha		
819	«	«	Në fshat	«	«		10	—	Myhedini Myslimi Duçe Nefize		
820	«	«	Gro-pa	«	«		5	—	Mustafa Asim Myslimi Tahiri		
821	«	«	Kall-dre-mi	«	«		1	—	Asimi Myslimi Haliti Tutulani		
822	«	«	O-xha-ke	«	«		2	—	Karafili Myslimi Mahmudi Ferhati		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
823	Berat	Peshtan Nahije	Strade	Tokë	gjith		5	—	Udha Myhedini Myslimi Halili	Kundrejtë detteve	
824	«	«	Driza	«	«		15	—	Lumi Myhedini Jeni Udha		
825	«	«	Tek guri	«	«		10	—	Mahmudi Udha Myslimi Mahmudi		
826	«	«	Lladiza	«	«		6	—	Duçe Myslimi Halidi Myslimi		
827	«	«	Ne lumi	«	«		6	—	Mahmudi Tutulani Ferhati Karafili	Çë prej kohësh	
828	Mallakastrë	Spir		«	«		8	—	Zeqir Xhaferi Ali Dalipi Dervis Duga Prroni		
829	«	«		«	«		25	—	Sabri Muço Dervish Duro Karafil Merci Bektash Sejfo		
830	«	«		«	«		10	—	Udha Hasan Sulçe Prroni		
831	«	«		«	«		30	—	Jahja Shuaibi Prroni Hysejn Rexhep Prroni		

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
832	Malla-kastrë	Spir		Tokë	gjith	—	12	—	Mehmed Rushidi Prroni Ibrahim Asimi Jahja Shabani	Çë prej kohësh	
833	«	«		«	»	—	20	—	Siko Beko Udha		
834	«	Graçan		«	»	—	7	—	Dano Mehmed Muke Rushid Sadik Isuf		
835	«	«		«	»	—	9	—	Dano Mehmedi Prroni Karafil Mehmedi		
836	«	«		«	»	—	10	—	Prroni Reshat Qerim Sadik Isuf Ish i zoti		
837	«	«		«	»	—	8	—	Sadik Isuf Prroni Ish i zoti		
838	«	«		«	»	—	6	—	Karafil Mehmed Udha e Pusis Udha e përgjith.		
839	«	Ballsh		Shtëpi e pambulue-me	»	—	—	—	Fejzo Karshi		
840	«	«		Shtëpi për-dhese me nji dhomë	»	—	—	—	Udha Ndërtesa e shpis Fejzo Mursel Fejzo Mursel		
841	«	«		«	»	—	—	—	Ndërtesa e shpis Fejzo Mursel Fejzo Mursel Fejzo Mursel		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (Pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
842	Fier	Bishana-kë	Bej-llëk	Tokë (banimi) ndërtimi	gjith		33	–	Udha Omer Pashaj Pasuni e shtetit Lagja e kishës dhe udha	Çë prej kohësh	
843	»	Krapcë		Mullij	«	1800	–	–	Lio Plaqi Rruga		
844	»	Marge-llicë		Kullotje	«		64$^1/_2$	–	Rruga	Kun-drejtë detteve	
845	»	»		Tokë	«		30	–	Rruga		
846	»	«		137 ullij	«		–	–	Rruga		
847	»	Rerës		Kullotje	«		7	–	Rruga		
848	»	»		Tokë	«		51	–	Rruga		
849	»	»		32 ullij	«		–	–	Rruga		
850	»	»		1 shtëpi	«		–	–	Rruga		
851	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	«		1$^1/_2$	400	Rruga Rruga Rruga Kil Belo	Çë prej kohësh	Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
852	»	»		«	«		1$^1/_2$	400	Xhaxhi Koç Goga Kil Belo Filo Llazo		
853	»	»		«	«		1$^1/_4$	400	Liç Tetova Koç Goga Rruga		
854	»	»		«	«		1	400	Lol Kalajxhiu Rruga Rrugacë		

BLSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
855	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		$^1/_2$	200	Nas Qëndo Liç Tetova Taq Spiro Rrugacë	Çë prej kohësh	Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
856	«	«		«	«		–	200	Pilo Llazo Liç Tetova Taq Spiro Rrugacë		
857	«	«		«	«		–	200	Xhoxhi Liç Tetova Nas Qendro Ban Plaka		
858	«	«		«	«		–	200	Xhoxhi Pilo Llazo Gil Tesho Kiç Kasapi		
859	«	«		«	«		1	250	Gil Tesho Rrugacë Mars Ciroku Rrugacë		
860	«	«		«	«		1	250	Mit Ndrio Rrugacë Rruga Rrugacë		
861	«	«		«	«		$^1/_2$	200	Ram Plaka Rrugacë Rrugacë Lil Goga		
862	«	«		«	«		$^1/_2$	200	Taq Lipe Rrugacë Ngjel Shandro Zoj Liçi		
863	«	«		«	«		1	500	Zoj Liçi Rrugacë Rruga Rrugacë		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
864	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		$^1/_2$	200	Kiç Harapi Ban Plaka Zoj Liçi Rrugacë	Çë prej kohësh	Ngrenë shtepi me ixhare zemin
865	«	«		«	«		—	200	Taq Llazo Ban Plaka Taq Lipi Tançi Prifti		
866	«	«		«	«		—	200	Taq Lipe Rrugacë Ngjell Skandro Rrugacë		
867	«	«		«	«		$^1/_4$	150	Rrugacë Kil Kasapi Laz Vasili Rrugacë		
868	«	«		«	«		—	200	Tanç Prifti Rrugacë Lil Vasi Rrugacë		
869	«	«		«	«		—	300	Llaz Vasili Rrugacë Rruga Gil Kapo		
870	«	«		«	«		$^1/_2$	400	Rrugacë Lil Xhaxhi Tonç Prifti Rrugacë		
871	«	«		«	«		$^1/_4$	200	Rrugacë Liç Xhamirxhi Liç Xhoxhi		
872	«	«		«	«		1	400	Liç Xhoxhi Rrugacë Papa Nani		
873	«	«		«	«		$^1/_4$	100	Pet Xhaxhi Rrugacë (3 anë)		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vendi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
874	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		2	700	Rrugacë Mehmed Vrapi Rruga	Çë prej kohësh	Nuk do shitet mbasi asht truell i bujkut të pasunis së Shtetit
875	»	»		«	»		3	760	Rruga Cane Like Kisha		
876	»	»		»	»		$^1/_4$	100	Rruga Beço Dhima Bam Kosova Bam Kosova		Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
877	»	»		«	»		1	100	Rrugë Abdi Tusha Bam Kosova Pal Kiçi		
878	»	»		«	»		1	200	Taq Bozo Prof Bili Rruga Prroni		
879	»	»		«	»		2	500	Isak Gjeçi Idajet Zelo Rruga Trifon Shani		
880	»	»		«	»		$^1/_4$	60	Hamite Qazim Bilbili Jorgj Lala Gjeçi		
881	»	»		»	»		$^1/_4$	60	Vasil Bano Qazim Bilbili Tob Bano Gjeçi		
882	»	»		»	»		1	500	Rruga Qazim Bilbili Hamide Rrugacë		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
883	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		1	500	Mi Jania Ngjel Cano Gjeçi Rrugacë	Çë prej kohësh	Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
884	»	»		«	«		$^1/_4$	200	Rrugë Rrugacë Llaz Dokoani Ngjel Bano		
885	»	»		«	«		1	600	Mit Lama Gjoçi Taq Pishkopia Rruga		
886	»	»		«	«		$^1/_2$	300	Rruga Ngjel Bano Gjeçi Rruga		
887	»	»		«	«		1	400	Rruga Prroni Vasil Gjeçi Rrugacë		
888	»	»		«	«		1	400	Rruga Ahmed Tyrku Ram Gjyla Prroni		
889	»	»		«	«		$^1/_2$	100	Rruga Fuka Ram Gjyla Kozma Tushe		
890	»	»		«	«		4	700	Rrugacë Vasil Gjeçi Rruga		

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
891	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith	–	$1^1/_2$	400	Liko Sefa Hysejn Dervishi Nebi Sefa Prroni	Çë prej kohësh	Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
892	«	«		«	»	–	1	400	Haxhi Dardha Shaban Pashja Rruga Rruga		
893	«	«		«	»	–	2	500	Zan Muka Rruga Kalem Kareshi Kalem Kareshi		Batall
894	«	«		«	»	–	$2^1/_2$	400	Din Kuka Rruga Emin Malobu		Ngrehë shtëpi me ixhare zemin
895	«	«		«	»	–	3	600	Din Kuka Shaban Kruja Rruga Rruga		
896	«	«		«	»	–	40	300	Gul Sefa Rruga Osman Dervishi Rustem Tyrku		Batall
897	«	«		«	»	–	$2^1/_4$	60	Pasunia e Shtetit Pasunia e Shtetit Mal Daka		
898	«	«		«	»	–	$3^1/_4$	80	Ragip Daka Pasunia e Shtetit Mustafa Vokopola		
899	«	«		«	»	–	–	80	Rruga Dud Puka Vasil Gjeçi Proc Ko		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
900	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		5	160	Rruga Dervish Sefa Çel Bajrami	Çë prej kohësh	Batall
901	»	»		»	»		$6^3/_4$	200	Çel Bajrami Sul Sefa Balla		
902	»	»		»	»		11	300	Pasunia e Shtetit Rystem Tyrku Xhamia Braçe Kareshi		
903	»	»		»	»		$4^1/_2$	100	Kullota Prroni Dervish Shabani Prroni		
904	»	»		»	»		–	250	Salih Dervishi Rruga Ali Beu Salih Dervishi		Në përdorim të buj-qëve privatë
905	»	»		»	»		1	100	Salih Dervishi Kareman Beu Pasunia e Shtetit Bejtelli		
906	»	»		»	»		$7^1/_2$	700	Kareman Beu Kareman Beu Nebi Sefa Bejtelli		
907	»	»		»	»		$2^3/_4$	200	Pasunia e Shtetit Isak Gjeçi Pasunia e Shtetit Vasil Gjeçi		
908	»	»		»	»		$2^1/_2$	100	Glaqe Halid Pasunia e Shtetit Zan Bani Cane Lerke		Nuk do të shitet mba-si asht truell i bujkut të pasunis së Shtetit
909	»	»		»	»		–	100	Glaqe Halid Zan Mbani Çel Rustemi Çel Lenkë		

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
910	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		2	200	Nebi Sefa Sul Sefa Dem Dervishi Rruga	Çë prej kohësh	Në përdorim të bujkut privat
911	»	»		»	»		7	400	Trush Jemini Vorezët Rruga Muharrem Bejte		
912	»	»		»	»		$12^1/_2$	800	Rruga Mustafa Voko- pola Prroni Braçe Koreshi		
913	»	»		»	»		$5^1/_4$	200	Mehdi Like Shefa Zylyfi Sul Sefa Sul Sefa		
914	»	»		»	»		1	100	Dervish Shabai Sefa Like		
915	»	»		»	»		$5^3/_4$	300	Kareman Beu Rruga Ymer Gjyle Karaman Beu		
916	»	»		»	»		$1^1/_4$	100	Sul Sefa Braçe Koreshi Nebi Sefa Met Sefa		
917	»	»		»	»		1	100	Met Sefa Met Sefa Met Sefa Rruga		
918	»	»		»	»		$3^3/_4$	120	Salih Dervishi Trush Semin Dervish Shaban Çel Çania		Batall

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
919	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		$2^3/_4$	100	Mustafa Voko-pola Prroni Prroni Rruga	Çë prej kohësh	Batall
920	«	«		«	«		1	60	Dud Puka Elmas Koreshi Prroni Rruga		
921	«	«		«	«		1	60	Prroni Ymer Daka Dervish Sefa Dud Puka		
922	«	«		«	«		$2^1/_2$	160	Selman Dervish Elmas Loko Rruga		Në përdorim të bujkut privat
923	«	«		«	«		$1^1/_2$	100	Mustafa Voko-pola Selman Dervish Rruga		
924	«	«		«	«		3	180	Rruga Met Xhefo Diko Tyrku		
925	«	«		«	«		$2^1/_4$	120	Elmas Loga Mehdi Lika Hysejn Haxhi Elmas Loga		Batall
926	«	«		«	«		5	250	Dervish Shabani Dino Kasapi Pasunia e Shtetit Rruga		Në përdorim të bujkut privat
927	«	«		«	«		$3^3/_4$	60	Dervish Shaban Ahmed Sefa Din Kasapi Pasunia e Shtetit		Batall
928	«	«		«	«		$9^1/_2$	340	Meh Daka Rruga Haxhi Gjyla Zylyf Halidi		Në përdorim të bujkut privat

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
929	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		3 1/2	160	Naum Gjeci Pasunia e Shtetit Elmas Kogo Brahim G.	Çë prej kohësh	Batall
930	«	«		«	«		1 1/4	300	Nebi Sefa Idriz Zelo Naum Gjeçi Dud Puka		Në përdorim të bujkut privat
931	«	«		«	«		5 1/4	100	Idriz Zelo Mesut Kuka Xhemile Zelo Nebi Sefa		
932	«	«		«	«		6 1/4	200	Islam Musaj Rruga Dem Tufa Met Sefa		
933	«	«		«	«		3 1/2	200	Selma Dervishi Mustafa Mesut Mustafa Mesut		Batall
934	«	«		«	«		2 1/2	160	Vasil Gjeci Shaqir Beu Dervish Shaban Rruga		Në përdorim të bujkut privat
935	«	«		«	«		1 1/2	100	Ragib Daka Mustafa Voko-pola Xhamija Rruga		
936	«	«		«	«		–	160	Ragip Daka Mustafa Voko-pola Xhamija Rruga		
937	«	«		«	«		1 1/2	120	Mustafa Voko-pola Rruga Ali Musaj Islam Mustafaj		
938	«	«		«	«		3	160	Muç Bani Rruga Salih Dervishi		Batall

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
939	Lushnjë	Qytet		Tokë ndërtimi	gjith		$5^{1}/_{2}$	200	Qamil Hamid Prroni Muç Bani Selman Kasa	Çë prej kohësh	Në përdorim të bujkut privat
940	«	«		«	«		$6^{1}/_{4}$	260	Osman Dervishi Rruga Mustafa Halid Ragip Daka		
941	«	«		«	«		2	80	Roç Kaleshi Dervish Shabani Dervish Shabani Rruga		Batall
942	«	«		«	«		$6^{1}/_{4}$	200	Xhamija Mustafa Voko-pola Met Tan Nebi		
943	«	«		«	«		4	160	Lalo Duka Shaqir Beu Pasunia e Shtetit Rruga		
944	«	«		«	«		$43^{3}/_{4}$	400	Pasunia e Shtetit Nikoll Bozo Mustafa Voko-pola Tërbufi		
945	«	«		«	«		70	700	Brahim Shefa Rruga Dervish Shabani Tërbufi		
946	«	«		«	«		$7^{1}/_{2}$	140	Sul Sefa Xhemal Beu Rruga Rruga		

Tiranë, 24-IX-1926.

Nr. 22

DEKRET-LIGJË, 18 Kallnuer 1927.

Mbi transferim krediti prej fr. ari 30.000 të Drejtoris së P. të Shëndetsis 1926-27

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 26 Kallnuer 1927, Nr. 7)

Na, Kryetar' i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Prej Kap. 1 Art. 2 rrogë personali qarqesh të budgetit të Drejt. Përgj të Shëndetsis ushtrimi Financjar 1926-1927 të bartet shumë prej fr. ari 30.000 (tridhetmijë) në Kap. 2 Art. 18 që i shtohet këtij budgeti nën emërtimin «Ronteqen».

Art. 2. – Prej shumës fr. ari 30.000 do të përballohet rroga e specialistit dhe të shpenzimeve për blerjen instalim etj. nevojë të makinave.

Art. 3. – Ky dekret-ligjë hyn në fuqi që me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Me zbatimin e këtij dekret-ligji ngarkohet Ministria e P. të Nbrendshme dhe ajo e Financavet.

Tiranë, me 18-I-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet — S. STAROVA

Zav. Min. i P. të Mbrendëshme — MUSA JUKA

Nr. 23

DEKRET-LIGË, 22 Kallnuer 1927.

Mbi ndryshime të ligjës mbi taksimin e duhanit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 26 Kallnuer 1927, Nr. 7)

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË;

Art. 1. – Paragrafi i parë dhe i dytë i art. 16 të ligjës mbi taksimin e duhanit ndryshohet si ma poshtë:

Enët që përdorën për duhan të grimë do të përshijnë nga

një sasi duhani neto prej gramësh: 25, 50, 250, 500, dhe enët që përdorën për cigare do të përfshijnë nga një sasi duhani neto prej gramësh 10, 15, 20, 25, 50 të cilavet u ngjiten banderolat e gramet përkatës që kan të shenueme.

Kutijave me cigare që kapërxejn respektivisht peshat e përmenduna ma nalt u ngjitet edhe nga një banderolë prej gramët 1, 2, ose 3 për me plotësue diferencat simbas nevojës.

Art. 2. — Neni 17 i ligjës relative mbi vulosjen e enëve me duhan e cingare anulohet.

Art. 3. — Paragrafi i parë i art. 23 të ligjës së nalt-dëftueme, ndryshohet si ma poshtë:

Ata që nuk i shtrohen dispozitave t' art. 18 të ligjës relative dënohen me konfiskimin e duhanit të xanun kontrabandë dhe pagimin të nji gjobës sa tri herë taksa ligjore e tij.

Art. 4. — Aplikim i masave ndeshkimore të parapame n' art 21, 22, dhe në paragrafin e parë t' art 23 të ndryshuem si ma sipër, për sa i përket caktimit të gjobës dhe të konfiskimit të gjasë së kontrabandueme, vendohet me anë të komisionit të formuem si mbas art. 5 të kësaj Dekret-ligjë mbassi të jen kryem hetimet e duhuna prej nëpunësit kompetent.

Art. 5. — Komisioni i Financavet përbahet prej:

a) Drejtorit ose Kryenëpunësit të financavet;

b) Llogaritarit, *(c)* nëpunsit të duhanit (e kur nuk ndodhet ky) nëpunësit të gjanave të monopolizueme (e në mos ndodhëjen edhe të këtij prej Nënpunësit të Vergjiës.

Art. 6. — Vendimet e Komisionit i njoftohen t' interesuemve me anë të Noteriës. Po kje se t' interesuemit nuk i kundërshtohen vendimeve mbrenda 15 ditëve qysh nga data e komunikimit, vendimet marrin formën e prëme edhe vehen n' ekzekutim.

Art. 7. — Në qoftë se t' interesuemit nuk i binden vendimit të Komisionit i drejtohen gjyqit kompetent mbrenda 15 ditëve dhe zyrat financjare veprojnë si mbas vendimit të gjyqit.

Art. 8. — Duhani i grimë ose i bamë cingare qi asht rregjistrue me anë të Komisioneve në rastë të zbatimit të ligjës përkatëse e qi asht i kualitetit të dobët, të zotët nuk kanë pague taksën relative dhe e kan lanë në dispozicion të zyrave kompetente, shitet me nji çmim t' arsyeshëm.

Art. 9. — Për duhanin që asht destinue për me u ba cingare pranohet një firë prej 3% mbi peshën e duhanit të gjithë,

Nëpunësi kompetent asht i detyruem me nxjerrë taksën e banderolave mbi peshën neto. Në qoft se bandrolat ju tepërojnë fabrikantave edhe mbassi të jet zbrit fira, nëpunësi kompteent i merr prej tyne e mban nji proçes-verbal dhe i djeg përpara komisionit të shenuem n' art. 4.

Art. 10. – Ministrija e Financavet autorizohet të syrsharzhojë pullat fraksionarë prej gramësh 25 e 50 që gjenden në dispozicion të sajë në peshat prej gramësh: 10, 20, 22, e t'i përdorojë në vend të bandrolave.

Art. 11. – Bandrolat e peshave prej gramësh: 1, 2, 3, 10, 15, 20, 25, 50 që përdorën për cingare; autorizohet Ministria e Financavet me i shtypë në formë të pullit. Pullat do të ken masën që pason: Ato me gram 1, 2, 3, gjatësi C; m. 2, 1-2, gjanësi 1 1 2. Ata me gram 10, 15, 20, 25, 50 c. m. 5 gjanësi 2,

Art. 12. – Kjo dekret ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 13. – Ministria e Financavet dhe ajo e Drejtësies ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-ligjë.

Tiranë, me 22-I-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis — J. KEDHI

Ministri i Financavet — S. STAROVA

Nr. 24

DEKRET-LIGJË, 25 Kallnuer 1927.

Mbi ndalimin e kontrabandavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Kallnuer 1927, Nr. 8)

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit;

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Ç'do njeri që importon, transporton gjana qi i shtrohen tagrit Doganuer, asht i detyruem, t'i paraqesë në Zyrën e Doganës.

Art. 2. – Veprimet qi bahen kundra nenit të nalt-përmendun, ose në mënyrat e poshtë shënueme quhen veprime kondrabande.

a) Të nxjerrunit e gjanave qi janë të ndalueme, ose të Monopolizueme, ose të lira të importim, eksportim, transitim e tranbordim jashtë vendeve të Caktueme prej zyrave Doganore, gjith ashtu dhe inisjativet mbi veprat kësodore.

b) Të vuemit e të ndodhunit e gjanave në rastin e kqyrjes (muajenë) ndër vënde të jashtzakonëshme të mjeteve bartëse,

c) Të qitunit e gjanave prej zyrës së Doganës tue e tregue verbalisht, ose veprimisht se asht pague tagri Doganuer, ose tue i tregue këto si gjana të tregtiës së mbrendëshme.

d) Të treguemit me nji emën të ndryeshëm t' atyne gjanave të cilat janë të ndalueme të shtihen ndër magazina e entrepote të Doganave.

dh) Të shkarkuemit në Dogana, ose të gjendunit në mjete mbartëse detare t' atyne gjanave të cilat tue qënë destinue për t' u shkarkue në vendin ku ndodhet mjeti i mbartjes nuk janë të shenueme në manifestën origjinale.

Përjashtohen, vetëm ato gjana qi me anën e dokumentavet të vlefshme të paraqituna Doganës, vërtetohen arsynat e mos regjistrimit të tyne në manifestënn origjinale të cilat i shtrohen vetëm tagrit Doganuer.

Përjashtohen gjith ashtu dhe gjanat e lira të cilat në vënd qi të shkarkohen në destinacion, gabimisht shkarkohen në Doganë pa manifesta kurse për vendin qi janë destinue kan pas manifeste,

Nuk i shtrohen manifestës edhe gjanat qi sjellin me vehte udhëtarët me dy, ose tre valixha, baulle, arka etj.

e) Të ndodhunit e gjanave të ndalueme për importim, ose të Monopolizueme në nji nga mjetet mbartëse detare, ose toksore qi nuk janë shënue në manifeste, ose në letër-ngarkim.

f) Të mshefunit e të shdukunit të gjanave në mënyrë qi nuk asht e mundun të shtihen në dorë.

i) Të mshefunit e gjanave tue i hedhurë në det, ose tue i mshefun në tokë të cilat ma vonë shtihen në dorë.

KAPTINA II.

Mbi kontrabandistët

Art. 3. — Kush do qi ndodhet në nji nga veprat e naltshenueme, edhe si kur të mos jetë i zoti i gjasë qi kondrabandohet, quhet vepruesi origjinal i kondrabandës.

Në rastin qi mbi hetimet e bamuna prej zyrave kompetentë, ose mbi vendimin e gjyqit rezulton se i zoti i gjasë se kondrabandueme asht nji person tjetër veç vepruesit, ose vepruesavet origjinal të kontrabandës, dhe ay person quhet vepruës origjinal.

Art. 4. Edhe ata qi shoqërojnë në veprat e nalt-shenueme në nji mënyrë qi pa qënë shoqërimi i tyne të mos jetë e mundur të kryemit e veprës, quhen vepruesa origjinal.

Art. 5. Ata qi në fillim të veprave të shenueme të kondrabandës, ose në vijim, a në mbarim të tyne deri sa të shtihet në dorë gjaja e kondrabandueme, ose të konstatohet shdukja e saj, ndodhen në nji vepër lehtësore, quhen ndihmësa të vepruësit origjinal.

Art. 6. — Përsëritës quhen ato vepruësit origjinal të kondrabandës si edhe ndihmat tyne të cilët mbrenda 5 vjetve tue fillue nga data qi merr formën e preme vendimi i gjobitjes dhe i dënimit të tyne, përsëritin nji nga veprat e nalt-përmenduna të kondrabandës.

KAPTINA III.

Mbi konfiskimin gjanave të kondrabandueme

Art. 7. — Konfiskohen gjithë ato gjana qi janë të ndalueme, ose të Monopolizueme qi kondrabandohen me ç'do mënyrë të tregueme n'art. 2 të kësaj ligjë.

Gjith ashtu edhe ato gjana qi janë të lejueshme për importim, exportim, transitim e trasbordim qi kondrabandohen në mënyrën e tregueme në paragrafin a) dhe c) t' art. 2 të kësaj ligjë.

KAPTINA IV.

Mbi gjobat e ndeshkimit

Art 8. — Vepruesit origjinal të kondrabandë për të gjitha gjanat e kondrabandueme e për veç atyne qi i shtrohen konfiskimit si mbas art. 7 të kësaj ligjë, janë detyruem të paguejnë tagrin relativ të Doganës, gjithashtu gjobiten edhe me tre-fishimin e tagrit Doganuer të gjasë së kondrabandueme me konditë qi gjoba në fjalë të mos kalojë gjysmën e vleftës t' asaj gjaje.

Art. 9. — Vepruesit origjinal të kondrabandës së gjanave qi i shtrohen konfiskimit si mbas art. 7 të kësaj ligjë gjobiten

edhe me pagimin e nji sasie të hollash sa vlenë gjaja e konfiskueme.

Art. 10. — Dispozitat e konfiskimit edhe gjobitjet e tregueme në art. 9 nuk ndalojnë ndeshkimin relativ të Kodit Penal e të ligjit të Monopolit për ata vepruesit origjinal dhe ndihmësit e tynë në kondrabandë të gjanave të ndalueme, ose të Monopolizueme.

Art. 11. — Vepruësit origjinal qi kondrabandojnë gjana në mënyrën e paragrafit *f)* t' art. 2 të kësaj ligjë në rastin qi të konstatohet vleftja e gjasë të shdukun, detyrohen me pagimin e taksit Doganuer dhe gjobiten në tre fish gjobë.

Në rastin qi të mos jetë e mundun konstatimi i vleftës, pa u marrë parasysh tagri Doganuer, gjobiten me nji gjobë kjo prej 10 deri më 2000 fr. ari.

Art. 12. — Vepruësit origjinal të kontrabandës për pagimin e gjobës janë përgjegjës solidarisht.

Art. 13. — Ata qi pa krye formalitetet ligjore përshkojnë nëpër Dogana gjanat e lira, ose të tregtiës së mbrendëshme të cilat nuk i shtrohen tagrit Doganuer, gjobiten me nji deri 5% pesë përqind advallorem.

Art. 14. — Vepruësit origjinal të kondrabandës për veç gjobitjes, dënohen edhe me burgim qi prej nji muej deri nji vjet si mbas randësiës së veprës së tyne.

Art. 15. — Ndihmësit e vepruesve origjinal të kondrabandës dënohen me gjysmën e dënimit të caktuem për vepruësit origjinal.

Art. 16. — I zoti i mjetevet mbartse të përdoruna për të kryemit e kondrabandës gjobiten edhe me gjysmën e vleftës së mjetit mbartës.

Art. 17. — Në rastin e përsëritjes gjoba edhe dënimi i vepruesvet origjinal si dhe ndihmësavet të tyne dyfishohen.

Art. 18. — Vepruesit origjinal të kondrabandës si dhe ndihmësat e tyne në qoftë se janë nga nëpunsat civilë ose ushtarakë ose të tjerë persona të paguem prej arkës së Shtetit, dënohen prej nji deri më tre vjet burgim dhe largim të përjetshëm nga ç' do shërbim shtetnorë.

Art, 19. — Kur zyrat kompetente informohen sigurisht se nji, ose ma shumë persona merren me kondrabandë që nuk asht e mundun të provohet rregullisht veprimi i tyne dhe e

shofin të dobishëm largimin e tyne nga qarku qi ndodhen, atëhere mund t' i drejtohen gjyqit kompetent për me lidhë çashtjen me nji vendim, dhe gjyqi mbi drejtimin e bamun zyrtarisht në këtę rast po të bindet me dy dit e sipër nga data e adresimit ep vendim për internimin e personave kësodore prej tre muej deri më nji vjet.

Art. 20. – Se cili do prej nëpunsave të Doganës, të Financës, t' Administratës, të Gjindarmeriës dhe të policiës në rastin që të takojnë mbi ngjarjen e nji veprës së kondrabandës janë të detyruem për me u kujdesue për të shtimunit në dorë të gjasë së kondrabanduem edhe për të nxjerrunit në sheshë vepruësin dhe në rastin që të lajmërohen janë të detyruem të lajmërojnë pa vonesë zyrat kompetente mbi dijenin e tyne rreth veprës së kandrabandës.

Nga nëpunsat e naltë-përmendun ata që neglizhojnë në të kryemit e detyravet të nalt-tregueme, dënohen në rastin e parë prej tre muej deri më nji mot burgim edhe në rastin e dytë prej nji muej deri më 6 muej burgim.

KAPTINA V.

Mbi veprimet proceduriale

Art. 21. – Nënpunsat e treguem n' art. 20 të kësaj ligjë mbas detyrës që kanë proces verbalin që do të mbajnë mbi mënyrën, vendin dhe kohën e ngjarjes edhe mbi zanjen e gjasë kondrabanduem do t' i a dorëzojnë nëpunsit të Doganës, ose të Financës që ndodhet ma afër bashkë me gjanë e kondrabanduem edhe me vepruësit e ndihmsat e tyne në rastin që këta të kenë ram në dorë.

Art. 22. – Këshilli Doganuer në Drejtorina, përbahet prej titullarit të zyrës, llogaritarit, arkëtarit, ose sekretarit.

Dhe Këshilli i Drejtorinave të Financavet përbahet nga Drejtori, Llogaritari, nëpunsi i Monopolit ose prej nëpunsit të trupit vërtetues.

Dhe Këshilla ndër zyra financjare përbahet prej nën-Drejtorit (Kryenëpunsit), llogaritarit, edhe nji nëpunsit të trupit vërtetuës.

Art. 23. – Detyra e hetimevet mbi gjanat e kondrabandueme e të dhanunit vendim për konfiskimin e tyne edhe mbi gjobitjen e vepruësvet origjinal e të ndihmësavet të tyne i përket Këshillavet Doganore e financjare.

Art. 24. — Zyrat Doganore në rasën që të takoj në nji vepër kondrabande nënpunsi i Doganës tue u ndodhur pranë tij Krahinari, ose Komandanti i Gjindarmeriës, përmbaron hetimet e duhuna; gjithashtu në rastin që të paraqitet ndonji procesverbal simbas Nenit 21 të kësaj ligjë simbas nevojës plotëson hetimet dhe tue depozitue në zyrën e tij gjanat e kondrabandueme edhe tue dhanë vepruësit nji dëftesë të rregulltë, aktet hetimore i a paraqit Drejtoris përkatëse për të dhanë vendimin e duhun.

Art. 25. — Këshillat e përmenduna mbi hetimet e bamuna prej tyne, ose mbi hetimet e bamuna prej zyrave Doganore të cilat passi t'i plotësojnë të mbetat që mund t'i shohin simbas dispozitave të kësaj ligjë, tue tregue artikullin përkatës mbi mënyrën e kondrabandës, mbi konfiskimin e gjasë edhe mbi gjobitjen e vepruesve vendosin me vota të përbashkëta, ose me shumicë votash për konfiskim dhe gjobitje.

Art. 26. — Drejtori i Doganës, i Financavet, dhe nëpunsi i zyrës Doganore janë të detyruem të përfundojnë çashtjen të shumtën mbrenda nji muej.

Art. 27. — Vendimet e Këshillavet do të përmbajnë arsyenat ligjore mbi mënyrën e veprimit të kondrabandës, sasin e tagrit doganor, mënyrën e konfiskimit dhe sasin e gjobës që caktohet tue tregue artikujt e ligjës mbi të cilat asht bazue vendimi; gjithashtu ma në fund do të përmbajnë edhe shënime se vepruësit origjinal dhe ndihmësit e tyre duhet të dënohen nga an' e gjyqit përkatës dhe me burgim tue tregue edhe në këtë rasë artikullin përkatës të kësaj ligjë.

Art. 28. — Nga nji kopje e vërtetueme e vendimevet të dhanuna në bazë t'artikullavet 25, 26, 27 mbrenda në tri dit nga data e vendimit do t'i dërgohen gjyqit paqtues kur ndodhet në zhyridikcionin e atij gjyqi, ose Kryetarit të Gjyqit të Shkallës së I-rë kur ndodhet në zhyridikcionin e tij, për me i a komunikue t' interesuemvet simbas dispozitavet ralative të Procedurës Penale.

Art. 29. — Gjyqet në fjalë në rastin që i dënuemi prej këshillit, të mos ketë banim të ditun mbrenda kufis së Republikës Shqiptare, komunkimin do t'a bajë me anën e fletores të vendit, ose të qarkut tue dhanë nji muej afat nga data e shpalljes dhe kështu e nesërmja e mbarimit t' afatit quhet komunikim ligjor edhe në ketë mënyrë nga kjo ditë fillon afati i apelimit.

Art. 30. – Vepruesit origjinal të kondrabandës edhe ndihmësat e tyne kanë të drejtë t' apelojnë vendimet e dhanuna nga këshillat e Doganave, ose të Financavet me 15 dit e sipër tue fillue afati i apelimit nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Apelimi bahet në gjyqet që gjykojnë deliktet e që këshillat të cilat kanë dhanë vendimin ndodhën të zhuridikcionin e tyne.

Art. 31. - Vepruesit origjinal të kondrabandës, ose ndihmësat e tyne në qoftë se mbrenda afatit të caktuem për apelim nuk e apelojnë vendimin e këshillit të Doganës e të Financës dhe kështu nji vendim merr formën e preme për sa i përket pagimit të tagrit Doganuer edhe gjobës, atëherë nëpunsi kompetent i Doganës, ose i Financës i dërgojnë aktet relative gjyqit paqit po t' i përkasij gjykimi atij, prokurorit me rasë që t'i përkasij gjykimi Gjyqit të Shkallës së I-rë.

Gjyqi kompetent thret të pandehunin rregullisht dhe mbi aktet e paraqituna cakton dënimin e tij në burgim si pas art. relativ të kësaj ligjë, a merrë parasyshë në se asht provuem faji.

Ipandehuri në ketë rasë do të ketë të drejtë të mbrojnë vehten e tij vetëm nga pikpamja e caktimit të dënimit.

Dhe në rastin që vepruesit origjinal të kondrabandës ose ndihmësit e tyne n' afatin ligjuer apelojnë vendimin e këshillit të Doganës, ose të Financës, atëherë gjyqi do të gjyrmojë dhe do të gjykojë simbas nevojës edhe themelin e çashtjes.

Art. 32. – Gjyqet kompetente çashtjet kësodore, tue i konsiderue nga çashtjet ma të ngutshëme, janë të detyruem t'i përfundojnë me shpejti.

Art. 33. – Vendimet e gjyqevet të dhanuna apelisht, tue i u shtruem rregullavet të përgjithshme, janë të diktueme. Por në rastin që të diktohen nga ana e vepruesavet origjinal si dhe nga ndihmësat e tyne të përmendunit janë të detyruem të depozitojnë n' arkën e Doganës ose të Financës gjobën edhe tagrin Doganuer për të cilat banë fjalë akt-gjykimi që do të diktohet.

Art. 34. – Refuzodet kërkesa diktimore për sa i përket gjobës dhe tagrit Doganuer në rast që diktuesi nuk respekton dispozitën e paragrafit të fundit t' art. 33 të kësaj ligjë.

Art. 35. – Tagri Doganuer dhe gjoba e gjykueme nxjerret me anën e përmbarimit nga pasunia e të dënuemit simbas dispozitave të ligjit të përmbarimit edhe kur i dënuemi të mos

ketë pasuni do të veprohet sa për tagrin Doganuer simbas ligjit të përmbarimit edhe për gjobën simbas nenit përkatës të kodit Penal.

Art. 36. – Gjanat e kondrabandueme në rastin që të jenë shtie në dorë, do të bahen të depozitueme deri sa vendimi i Këshillavet relative të marrij formën e preme.

Në qoftë se gjanat e kondrabandueme janë nga ato që prishen, zyrat kompetente para se t' apin vendim për kondrabandë gjanat në fjalë tue lajmërue të zotin e tyne, i shesin me adjudikatë dhe të hollat i mbajnë si depozitë.

Kur të merret vesh se gjaja e kondrabandueme që nuk asht e ndalueme, ose e monopolizueme pjesërisht i ban ballë tagrit Doganuer edhe gjobës relative, zyrat kompetente janë të detyrueme me ja kthye të zotıt tepricën e saj.

Vepruesit origjinal kurdoherë kanë të drejtë tue depozitue tagrin Doganuer dhe gjoben relative të kërkojnë kthimin e sendeve të kondrabandueme që nuk janë të ndalueme, ose të monopolizueme, në ketë rasë zyrat përkatëse nuk kanë të drejtë kundërshtimi.

Paragrafi 1 e 3 dhe i 4 i këtij artikulli aplikohet edhe për mjetet mbartëse.

Art. 37. – Kur vendimet e këshillavet përkatëse të marrin formën e preme edhe gjaja e kondrabandueme ndodhet e depozitueme, përmbarimi d. m. th. veprimet e shitjes n' adjudikatë bahen me anën e zyrave Doganore e Financjare tue lajmrue edhe t' interesuemit.

Art. 38. – Kur gjaja e kondrabandueme që shtihet në dorë por mbi hetimet e bamuna vepruesit e kondrabandës edhe i zoti i gjasë së kondrabandueme të mos dalij në sheshe këshillat kompetente me vendimin e tyne tue u bazue mbi arsynna ligjore edhe tue lajmërue Ministrin e Financavet i shesin n' adjudikatë.

Art. 39. – Kur hetohet se gjanat e ndalueme, a të monopolizueme ase ata që i shtrohen vetëm tagrit Doganuer janë qit kondrabandë me ndonji shtëpi ose magaze, Drejtoria ose Nëpunsi i Doganës, e i Financës, ose i ngarkuemi i tyne shkon për kontrollim ditën në vend ku ndodhen gjanat e kondrabandueme tue pasë pranë nëpunsit e administratës, polict, gjindarmët, si dhe Pleqsin e Lagjes, ose të katundit dhe në ketë mënyrë bahet veprimi i duhun.

KAPTINA VI.

Mbi të ndamit e gjobave

Art. **40**. – Gjobat ndahen si ma poshtë vijon.

A) Kur ka lajmëtar		Kur s' ka lajmëtar
45%	Xanësit e kondrabandës	60%
25%	Lajmëtarit	–
15%	Arkës së Shtetit	20%
15%	Këshillit Doganës ose Financës	20%

B) Gjoba që i përket xansave të kontrabandës ndahet Nëp. Rojtari 6-10-4-10. Nji nëpunsi civil dhe nji rojtari ushtar gjindarm e usht. 4-10-6-10. Nji ushtar dy gjindarm 3-10-7-10. Nji ushtar tre a ma tepër.

C) Gjoba që i përket Këshillit Doganuer ose Financës 4-10 Drejtori ose Kryenëpunsi 6-10 tjerët.

Art. 41. Prej shumës së shitjes adjudikisht të gjanave të konfiskueme mbasi të zbriten shpenzimet e bamuna dhe tagri doganuer e sa të mbetet ndahet si u diftue n' art. 40.

Art. **42**. Në rasë që tagri Doganuer kapërcen çmimin e shitjes së gjasë adjudikisht atëhere gjymsa e shumës shitjes adjudikisht regjistrohet tagër doganuer e gjysma tjetër njehet gjobë e ndahet si mbas art. 40.

Art 43. Kjo ligjë hynë në fuqi qysh ditën e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare,

Art. 43. Ministrija e Financavet e Drejtësies dhe ajo e P. të Mbrendëshme autorizohen me zbatimin e sajë.

Tiranë, me 25-I-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 25

DEKRET-LIGJË, 25 Kallnuer 1927.

Mbi huan që do t'i dorëzohet nga Ministria e Financavet Bashkivet Tiranë Durrës e Shkodër

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Fruer 1927 Nr. 9)

Na Kryetari, i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Autorizohet Ministria e Financavet me i dorëzue si hua Bashkiës së Tiranës Fr. ari 600.000 Bashkiës së Durrësit 400.000 Bashkiës së Shkodrës 300.000.

Art, 2. — Ministria e Financavet shumat e shenueme n' art 1, do t' i përballë nga huaja që do t' i dorëzohet prej Bankës Kombëtare.

Art 3. — Bashkia e Tiranës Durrësit dhë e Shkodrës shumën e marrun hua prej Ministriës së Financavet e të caktueme n' art. 1. do të kthejë mbrenda në 10 vjet duke pague ç' do vjet e para 60.0C0, e dyta 40.000, dhe e treta 30.000 Fr. ari.

Art. 4. — Bashkiët Tiranë, Durrës e Shkodër detyrohen me i pague Ministriës së Financavet veçanërisht edhe një interesë prej 9% e 4% provizion mbi shumën e thjeshtë të huasë duke i pague edhe këta për sa i takon çdo viti rregullisht deri sa të shlyhet plotësishs huaja e marrun.

Art. 5. — Këjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6. — Ministria e Financavet dhe ajo e P. Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj dekret-ligje.

Tiranë, me 25-I-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
Zav. Min. i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 26

ĐEKRET-LIGJË, 26 Kallnuer 1927.

Mbi marrëveshtjen tregtare Shqiptare - Rumune

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Fruer 1927 Nr. 10)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

1. – Pranohet marrëveshja tregtare provizore e nënshkrueme me datë 14 Janar 1927 midis Zotit Husein Vrioni, Ministri i P. të Jashtme i Republikës s' onë dhe Zotit Jean Trandafiresco, Ministrë i Mbretënisë Rumune në Tiranë mbi eksportimin e mallnavet në të dy Shtetet në bazë të reciprositetit dhe të tratamentit të kombit ma të favorizuem si pas kopjes këtu ngjitun.

2. – Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi tet dit pas çpalljes në Gazetën Zyrtare dhe mund t' anulohet nga të dy anët kontraktuese me nji paralajmim tre muejshe.

3. – Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji.

Tiranë, me 26-I-1927.

A. ZOGU

Ministri P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ekselencës së Tij
Zoti Hysejn Vrioni
Ministri i P. të Jashtme

Zoti Ministrë,

Në gjegje të Notës të Eklselencës s' Uej Nr. 171-V të 14 Kallnuer vazhdues, kam nderin t' i njoftoj se Qeverija Mbretnore e Rumanisë ësht d' akord me Qeverinë e Republikës Shqiptare për regullimin e marrëdhenjevet tregtare midis Shqipëris dhe të Rumanisë me një ujdi provisore në bazën e aplikimit reciprok të klauzës së kombit ma të favorizunme me detyrim për anët kontraktuëse të mos munden të dënoncojnë ketë ujdi, veç se pas një paralajmimi tre muajsh.

Ju lutem të pëlqeni, Zoti Ministrë ndijesinat e konsideratës s' eme të naltë.

Tiranë, me 14 Janar 1927

Ministri i Rumanisë
J. Trandafiresco d. v.

Ekselencës së Tij
Jean Trandafiresco
I Dërguar Jashtza. e Minis.
Fuqiplotë të Madhnisë së Tij
Mbretit Rumanisë
Tiranë

Zoti Ministrë,

Në gjegje të Notës të Ekselencës s' Uej Nr. 736 të 27 Dhjetor të kaluar, kam nderin t' a informojë se Qeverija e Republikës Shqiptare pranon propozimin e Qeveris Mbretnore së Rumanisë për regullimin e marrëdhanjevet tregtare midis Shqipëris dhe të Rumanisë me një ujdi provizore në bazën e aplikimit reciprok të klauzes së kombit ma të favorizueme dhe me detyrim për anët kontraktuese që të mos munden të dënoncojnë ketë ujdi veç se pas një paralajmimi tre muejsh

Duke i njoftur sa më sipri Ekselencës s'Uej, i lutem të ketë mirsin të pëlqej ndisinat e konsideratës s' eme të natlë.

Tiranë, me 14 Janar 1927.

Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Nr. 27

DEKRET-LIGJË, 20 Fruer 1927.

Mbi shpërndamjen e misrit gratis të vobektëve të Kelmendit

(e botueme në Fletoren Zyrtare 27 Fruer 1927 Nr. 16)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. Prefektura e Shkodrës, autorizohet me ble në mënyrë paksimi 600 (gjashtëqindë) kuintal misër prej dhetarëve të Shkodrës.

Art. 2. – Misri në fjalë t' u shpërndahet gratis prej Prefekturës së Shkodrës të vobektëve të rrethinës Kelmendit në bazë të vendimit qi t›epet prej Këshillit t' Administratës sẹ Nënprefekturës M. Madhe.

Art. 3. – Ministrija e Financavet autorizohet me u a zbritë dhetarëvet nga detyra e të dhetavet çmimin e sasis së misrit qi do t' i dorëzojnë Prefekturës Shkodrës.

Art. 4. – Me zbatimin e këtij dekret-ligji ngarkohet Ministria e Financavet e ajo e P, të Mbrendshme.

Art. 5. – Ky dekret ligjê hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, me 20-II-1927.

A. ZOGU

Zav. Ministri Drejtësis
J. KEDHI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Zav. Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 28

DEKRET-LIGJË, 20 Fruer 1927.

Mbi transferim kredije 1926-27

(e botueme në Fletoren Zyrtare 27 Fruer 1927 Nr. 16)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Prej Kap. 16 «Ngrehje e burgut të Porto Palermos të budgetit të Ministriës së P. Mbrendëshme ushtrimi 926-927 bartën Fr. ari 25.000 (njizetepesëmijë) në Kap. 20 po të këtij budgeti qi caktimisht për këtë i shtohet nën emërtin «shpenzime për bartje, transportë e ushqim t' akuzuemve me faje politike».

Art. 2. Ky dekret-ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Tiranë, me 20-II-1927. **A. ZOGU**

Zav. Ministri Drejtësis
J. KEDHI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Zav. Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 29

DEKRET-LIGJË, 27 Fruer 1927.

Mbi ndëshkimet qi do t'ushtrohen për bagtiët (dhen e dhi) e mëshefuna

(e botueme në Fletoren Zyrtare 5 Mars 1927, Nr. 18)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Bagëtiët e thiët që nuk i deklarohen komisionit për numërim dhe regjistrim me qëllim qi mos të paguejnë taksën e xhelepit, konsiderohen si gja të mëshefuna dhe të zotërit e tyne detyrohen të paguejnë nji gjobë sa pesë fishe taksa e xhelepit për se cilën kokë të mëshefun.

Art. 2. – Gjoba e bagëtivet të mëshefuna nxirret me nji herë, në vend, prej tagrambledhësavet kundra nji diftesës së rregulltë e në rast të mos pagimit të gjobës sekvestrohet nji pjesë bagtije e mjaftueshme për me mbulue gjobën pjesë e cila shitet n'ankant prej Zyrës së Financës së vëndit.

Art. 3. – Gjysa e gjobës së sipër-pëmendun regjistrohet në t'ardhunat efektive e gjysma e mbetur ju dorëzohet lajmëtarëvet në bazë të nji proces-verbalit të mbajtun nga Prefekti a Nënprefekti dhe nga drejtori a kryenëpunsi i Financës tue lajmërue Ministrin e Financavet.

Art. 4. – Nëpunsat e Financavet dhe t' administratës, qi si mbas ligjës janë të detyruem të kujdesohen për vërtetimin e taksës së xhelepit ndëshkohen nga autoriteteti qi varen si mbas randësis së fajit me gjobë ose me pushim nga puna në rast qi të vërtetohen mos kujdesimi i tyne dhe i dorëzohen gjyqit.

Art. 5. – Pleqësiët e lagjeve dhe të katundeve qi abuzojnë detyrën qi u ngarkon ligja e xhelepit dënohen mbas ligjeve në veprim.

Art. 6. – Këjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 7. – Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj dekret-ligje.

Tiranë, me 27-II-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Zav. Ministri i P. të Jashtme
H. VRIONI

Zav. Ministri i Drejtësis
J. KEDHI

Nr. 30

LIGJË, 27 Mars 1927.

Mbi shtojcën e nenit 19 të ligjës së advokatëvet me datë 30-XII-1922

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Mars 1927, Nr. 25)

1. – Kur nji advokat i rendit të parë ose të dytë, pa ndonji shkak t' arësyeshëm, refuzon me ju bindë urdhnit të gjyqit që e thëret, për me plotësue trupin gjykuës, ose nuk don me pranue mprojtjen e nji të pandehurit me krim, të cilën ja ngarkon gjyqi, ndëshkohet me gjobë nga 20 deri në 200 fr. ari; dhe në rasë përsëritjeje me pezullim nga ushtërimi i avukaturës për nji kohë nga 1 deri në 3 muaj.

Këto faje gjykohen po prej atij gjyqi që ka thëritur avoka-

tin me përmbush atë detyrë, dhe gjykimi bahet mbrenda 8 ditëvet që prej ditës që ashtë bamë faji.

Vendimet që jepen në këto raste janë të kundërshtushëm dhe të diktushëm; afati për kundërshtim asht 8 ditë që prej ditës së komunikimit t'akt gjykimit të dhanun në mungesë dhe afati i diktimit ashtë 5 ditë dhe fillon, për vendimet e dhanuna çfaqësisht, që prej datës shqyptimit të tyne dhe për ato në mungesë, që prej datës që mbaron afati i kundërshtimit.

Vendimet e dhanuna çfaqësisht prej ndonjanës nga degat e diktimit diktimohen në këshillin e përgjithshëm të këtij gjyqi.

Sa për procedurën që duhet me u ndjek, në gjykimin e fajeve të sipër-treguem, kanë me u aplikue dispozitat e procedurës relative në gjykimin e deliktevet.

2. – Kjo shtojcë ligje hyn në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

3. – Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e saj.

Na, Kryetari i Republikës Shqipëtare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj shtojcë-ligje te pranueme edhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 21 datë 23-III-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, 27-III-1227. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 31

LIGJË, 29 Mars 1927.

Mbi çeljen e shkollës së Drejtësiës së Kryeqytetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Prill 1927, Nr. 26)

Art. 1. – Nën mbrojtjen e shkëlqesis së Tij Kryetarit të parë të Republikës Shqiptare çelet shkolla e Drejtësiës në Kryeqytet.

Art. 2. – Shkolla e përmendun do të quhet «Shkolla e Drejtesiës».

Art. 3. – Shkolla e Drejtësiës do të bahet prej tre rendesh studimi, sejcili rend do të vazhdojë nji vit, që për tre rendet tre vjet.

Art. 4. – Mësimet në këtë shkollë do të bëhen në gjuhën kombëtare.

Art. 5. – Profesorët e kësaj shkolle do t'emnohen me propozimin e Ministris së Drejtësiës, me pranimin e Këshillit Ministruer dhe me pëlqimin dhe dekretimin e Kryetarit të Republikës.

Art. 6. – Mënyra e mësimit të shkollës si edhe pranimi i nxanësve, trajtohet me një rregullore të posaçme nga grupi i profesoravet e cila do të vërtetohet edhe prej Këshillit Ministruer.

Art. 7. – Këjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes.

Art. 8. – Ministrija e Drejtësiës detyrohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqipëtare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 25 datë 26-III-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 29-III-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 32

RREGULLORE, 8 Prill 1927.

Mbi inspektimet dhe të drejtat e shpenzimevet të udhëtimit për këtë qëllim

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 16 Prill 1927, Nr. 29)

1. – Me përjashtimin e ngjarjevet me randësië, Komandanti i Zonës ka të drejtë inspektimi në reth e Post Komanda tri herë në vjet, dhe Inspektorët katër herë, Reth-Komandantat nër Postat e tyne 6 herë në vjet.

2. – Zon-Komandantët dhe Inspektorët në rast t'inspekti-

mit mbi gjendjen e përgjithëshme të retheve e të Post-Komandave parashtrojnë spjegimet dhe mejtimin e tyne në librin e inspektimit qi mbahen prej Komandave në fjalë.

3. — Komanda e Përgjithëshme raportohet vetëm për çashtjet me randësië si RESERVAT (të mbëshefta) etj. q' i takojnë titullarit të Komandës Rethit e Postës.

4. — Sikurse u përmend dhe në Nr. 2 ç'do Komandë Rethi e Poste, kan me mbajt një libër inspektimi dhe ky do t'i nepet prej Komandantit Rethit ose Postës oficerit inspektuës për të ba shënime mbi inspektimin e bamun dhe do të nënëshkruhet prej tij, Reth e Postë Komandant raportit qi përshkruhet në këtë libër tekstualisht i nxjerin nji kopje dhe i a paraqisin Komandës së Përgjithëshme direkt pa vonesë.

5. — Inspektimi që bahet nër udhë që nuk punon automobili, bahet me kuaj dhe për ata oficera që kanë kal dhe marrin usbqim, shpenzime udhëtimi nuk paguhen, në rrugat e regullta udhëtimi bahet me automobilat e Komandave dhe për kësi lloj udhëtimesh paguhen prej arkës benzini etj. të nevojshme. Natyrisht këto shpenzime paguhen tue u marrë parasysh gjatësia e udhëtimit me kilometra.

6. — Për udhëtimin që bahen në rajonin e Prefekturës ku banon personali i zz. Oficerëve dijetë nuk paguhen, për ata që bahen mbrenda rajonit Zonës po jo ma pak se 40 km. largësije dijetet paguhen gjymës dhe jashta rajonit të Zonës paguhen plotësisht në bazë të regullores.

7. — Pa u paraqitë në Komandën e Përgjithëshme raportet e inspektimit, shpenzimet e udhëtimit që kërkohen për këtë qëllim nuk autorizohen për pagesë.

8. — Inspektorat dhe Zon-Komandantët për bisedim, konferencë e nevoja të tjera mund të thirren në qendër, por përpara se të nepet ky urdhën duhet marrë pëlqimi dhe autorizimi i Kryesiës së Republikës.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregullorje.

Tiranë, me 8-IV-1927. **A. ZOGU**

Nr. 33

LIGJË, 20 Prill 1997.

Mbi transferim kreditash në budgetin 1926-1927 të Komandës së P. të Fuqis Armate

Art. 1. – Auktorizohet Ministrija e Financavet me transferue në budgetin 1926-1927 të Komandës së P. të Fuqis Armate fr. ari 4.000 prej Kap. 1. Art. 1. «Rrogë Oficeri»; fr. ari 18.000 prej Kap. 1 Art. 4. «Studjim»; fr. ari 10.000 prej Kap. 2. Art. 3. «Transport»; fr. ari 5.000 prej Kap. 4. Art. 2. «Pajim mbathje kafshësh»; fr. ari 2.000 prej Kap. 4. Art. 8. «Vegla shëndetësie veterinare»; fr. ari 286.800 prej Kap. 6. Art. 4. «Armatim municion»; fr. ari 13.940 prej Kap. 6. Art. 5. «Zbrazje e pastrim armësh»; fr. ari 2.200 prej Kap. 6. Art. 6. «Manovra» e fr. ari 4.000 prej Kap. 6. Art. 7. «Vegla korespondence»; gjithsejt fr. ari 345.940, nga të cilat fr. ari 8.980 në Kap. 1. Art. 3. «Rrogë Ushtari»; fr. ari 75 në Kap. 2. Art. 1. «Shkresinë»; fr. ari 10.000 në Kap. 2. Art. 2. «Udhtim e djete»; fr. ari 75 në Kap. 2. Art. 4. «Të vogla»; fr. ari 60 në Kap. 2. Art. 5. «Festime»; fr. ari 52.250 në Kap. 3. Art. 1. «Ushqim Ushtari»; fr. ari 1.500 në Kap. 3. Art. 3. «Zjarm e dritë»; fr. ari 250.000 në Kap. 4. Art. 1. «Veshje e mbathjë Ushtarësh»; fr. ari 5.000 në Kap. 4. Art. 3. «Mobilje e vegla kan.»; fr. ari 10.000, në Kap. 4. Art. 4. «Auto e mjete transporti»; fr. ari 5 000 në Kap. 6. Art. 1. «Shëndetësi veterinari» e fr. ari 3.000 në Kap. 6. Art. 3. «Shtypshkrime».

Art. 2. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 40 datë 15-IV-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, me 20-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 34

LIGJË, 20 Prill 1927.

Mbi bartje kreditash

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Prill 1927, Nr. 31)

1. – Autorizohet Ministrija e Financave me ba në budgetin e Drejtoris së P. t'Arësimit ndryshimet e tregueme këtu ma poshtë:

a) Nga Kap. 4. «Udhtim e djete» të Qendrës barten fr. ari 1296 në Kap. 4. «Udhtim e djete» të Qarqevet;

b) Nga Kap. 2. Art. 5. «Shtypshkrime» të Qendrës barten fr. ari 4.000 në Kap. 1. Art. «Rrogë» të Qarqeve;

c) Nga Kap. 8. «Ndërtime» të Qendrës fr. ari 10.000, nga Kap. 6. Art. 1. «Scautizëm e Sport» të Qendrës fr. ari 1.000, nga Kap. 6. Art. 8. «Kurs i shpejtë e shkolla të natës» të Qendrës fr. ari 1.000, gjithsejt fr. ari 12.000 barën në Kap. 3. Art. 1. «Bursa të mbrendëshme» të Qendrës;

ç) Nga Kap. 1. Art. 1. «Rrogë» të Qendrës fr. ari 225, nga Kap. 1. Art. 2. «Rrogë Zavëndësije» të Qendrës fr. ari 395, e nga Kap. 2. Art. 9. «Kërkime dokumentash» të Qendrës fr. ari 1.000 gjithsejt fr. ari 1.620, barën në Kap. 1. Art. 2. «Rrogë zavëndësije» të Qarqevet;

d) Nga Kap. 2. Art. 4. «Mobilje» të Qarqevet fr. ari 3,081, nga Kap. 2. Art. 5. «Shtypshkrime» të Qendrës fr. ari 10.541 nga Kap. 6. Art. 1. «Scautizëm e Sport» të Qendrës fr. ari 100 e nga Kap. 6. Art. 6. «Mbajtje e Muzeut Kombëtar» të Qendrës fr. ari 1578, gjithsejt fr. ari 15.300, barën në Kap. 5. «Shpenzime për ushqim veshje etj. konviktesh» të Qarqevet.

2. – Kjo ligjë hyn në fuqi me datën e shpalljes.

3. – Ministrija e Drejtësiës dhe ajo e Financavet janë të ngarkueme me zbatimin e sajë

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative, si mbas shkresës Nr. 37 datë 14-IV-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 20-IV-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 35

LIGJË, 22 Prill 1927.

Mbi shpërndarjen e 600 kuintal misrit gratis të vobektëvet të Kelmendit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1927, Nr. 32)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme, për me blemë në paksim 600 (gjashtëqind) kuintal misër prej dhetarëvet të Shkodrës tue i akordue për këtë veprim 10.000 (dhetëmijë) fr. ari në Kap. t' ushtrimit financjar 1926-1927, të cillat përballohen me tepricën e të mbledhunave të mbrapambetunavet.

Art. 2. – Misri në fjalë t' u shpërndahet gratis prej Prefekturës së Shkodrës të vobektëve të rrethinës Kelmendit, në bazë të vendimit qi të epet prej Këshillit t' Administratës të Nënprefekturës së Malsisë së Madhe.

Art. 3. – Ministrija e Financavet, autorizohet me ja u llogaritun Dhetarëve në detyrat e të dhetavet çmimin e sasisë së misrit qi do t' i dorëzohet Prefekturës së Shkodrës si mbas art. 1. të kësaj ligje.

Art. 4. – Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Mbrendëshme.

Art. 5. – Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M Ë :

aprovimin dhe zbatimin e kësaj Dekret-Ligje të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës 53 datë 19-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22-IV-1917. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet *Min. i P. të Mbrendëshme*
F. ALIZOTI A. DIBRA

Nr. 36

LIGJË, 22 Prill 1927.

Mbi lidhjen e nji pensioni familjes së z. Sylejman Delvinës

Art. 1. – Tue marrë para sysh gjendjen e vështirë të familjes të z. Sylejman Delvinës e për të lehtësue mjetet e jetesës së sajë, i nepet nji pension i përmuejshëm prej fr. ari 300 (treqind) Zonjës Sylejman Bej Delvinës bashkë me dy vajzat e saja.

Art. 2. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

Art. 3. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M Ë :

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 56 datë 19-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 37

LIGJË, 22 Prill 1927.

Mbi shpërndamjen e 2.000 kuintal misrit gratis të vobektëve të qarkut të Dukagjinit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1927, Nr. 32)

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme me blemë me anë të Prefekturës së Shkodrës prej dhetarve të atij qarku me mënyrë paksimi 2 000 (dymij) kuintal misër.

Art. 2. — Kjo sasi misri, t'u shpërndahet gratis nj'atyne të vobektëve të qorkut të Dukagjinit e të Malsive të Shkodrës që do të shënohen me listë prej Këshillit Administratës së Nënprefekturave përkatse.

Art. 3. — Çmimi i kësaj sasije misri ka m'u zbritë prej detës së dhetarëve dhe për me i ba ballë këtij liquidimi i shtohet budgetit të Ministris së Financavet të vjetit 1926-1927, nji fond prej fr. ari 40.000 (katërdhetmijë) qi do të përballet prej të mbrapambetunavet.

Art. 4. — Me zbatimin e kësaj ligje detyrohet Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet.

Art. 5. — Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 54 datë 19-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 22-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 38

LIGJË, 21 Prill 1927.

Mbi ndryshimin e nenit 12 të ligjës ndeshkimore për faje politike me d. 21-XII-1925

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1927, Nr. 32)

1. — Çdo vendim i gjyqit të përmendun për veç atyne që përmbajnë dënimin me vdekje, do të vërtetohet prej Ministriës së P. të Mbrëndëshme, dhe në rasë kundërshtimi për mos vër-

tetim me arsyena që do të tregohen nga ajo Ministri, çashtja do t'i parashtrohet Këshillit Ministruer; i cili vendos vërtetimin ose anulimin e vendimit.

2. — Këjo ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

3. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësiës ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 43 datë 19-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 21-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme A. DIBRA

Nr. 39

LIGJË, 16 Prill 1927.

Mbí interpretimin e artikullit 4 të ligjës mbi burgimin e dhjetarve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Prill 1927, Nr. 32)

Së ndershmes
Kryesiës së Këshillit Ministruer,

Përgjegja e shkresës s'Uëj Nr. 547 datë 1-IV-1927.

Kam nderin të i bëj me ditë asaj së ndershme Kryesije se Dhoma e Deputetve, dhe Senati, tue marrë parasysh artikullin 4 të ligjës mbi burgimin e dhetarëve që ishte absolut dhe në kundërshtim me artikullin 35 të ligjës së përmbarimit, për të mos i lanë shteg konfliktit midis administratës e Drejtësis, e interpretoj në mënyrë që: (Për sa i përket vetëm kohës së burgimit lypset me vepruë si mbas artikullit 35 të ligjës Përmbarimit.

Me nderime të posaçme

Kryetar' i Senatit
P. EVANGJELI

AQSH

DEKRET

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e interpretimit të nenit 4 të ligjit mbi burgimin e Dhetarëve n' atë mënyrë që përshkruhet në shkresën e sipërme të Kryesiës së Senatit dhe urdhërojmë zyrat kompetente për zbatimin e tij.

Tiranë, me 16-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 40

LIGJË, 22 Prill 1927.

Shtojcë e art. 47 të ligjës mbi Financat e Bashkiëve më 7-VI-1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Prill 1927, Nr. 32)

Art. 1. – Nëpër Bashkiët formohet nji komision i përbamun prej Këshillit të Bashkiës, t'Administratës, dhe dy prej antarëve të Dhomave tregtare, dhe në mungesë të këtyne, dy tregtarë të njoftun në fushën e tregtiës.

Art. 2. – Kamisioni i caktuem n' art. 1. do të caktojë damet që kanë pá sipërmarrësit e taksave të ndryshme të Bashkiës, me rastin e anulimit të kontratavet si mbas dispozitavet të art. 47 të ligjës mbi Financat e Bashkiëvet më 7-VI-1926.

Art. 3. – Damet e caktuëme si mbas art. 2. i referohen Kryesiës së Bashkiës për pagim nga një shtyllë e budgetit të sajë që do të vendoset prej Këshillit të Bashkiës.

Art. 4. – Këjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. – Me zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet MInistrija e P. të Mbrëndëshme.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 55 datë 19-IV-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, më 22-IV-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 41

LIGJË, 26 Prill 1927.

Mbi ndalimin e dhënies me qira të tokave rurale për nji kohë më tepër se 20 vjet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Maj 1927, Nr. 34)

Art. 1. – Ndalohet të dhanunit me qira të tokavet rurale private drejt për drejt ose tërthurazi, për nji kohë më tepër se 20 vjet (njizet vjet).

Art. 2. – Çdo kontratë e lidhun kundra dispozitës t'art. 1. të kësaj ligje asht e pa fuqishme përveç se po të jetë bamun prej ndonji zyrë noteriale shqiptare përpara hyrjes në fuqi të kësaj ligje.

Art. 3. – Qira marrësit ndalohen të punojnë ose të eksploatojnë tokën rurale me puntorë ose bulqë që kanë nënshtetësin e huaj përveç teknisienëve në qoftë se nuk gjenden teknisienë vendës gjith ashtu ata qiramarrës ndalohen t'a japin tokën me qira marrësve të tjerë.

Art. 4. – Një tokë e pajtueme (dhanë me qira) pa mbaruem afati i kontratës nuk mund të përtrihet e të pajtohet me një kontratë tjetër.

Art. 5. – Kundra vajtësit e dispozitavet të kësaj ligjë dënohen me 6 (gjashtë) muaj deri më 2 (dy) vjet burg tue shkaktue dhe anulimin e kontratës.

Art. 6. – Këjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare tue respektue dispozitat e nenit 2 (dy) të naltë përmendun.

Art. 7. – Ministrija e Drejtësiës dhe ajo e P. Botore e Bulqësiës ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij dekret-ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. **31**/I datë 20-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 26-IV-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 42

LIGJË, 27 Prill 1927.

Mbi krijimin e një pulle për Kryqin e Kuq

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Maj 1927, Nr. 34)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, në bazën e vendimit të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

1. – Anulohet pulla për emigrantë e krijohet një pullë për fitim të Kryqit të Kuq Shqiptar me vleftje 10 qind. ari.

Instituti i Kryqit të Kuq Shqiptar merr përsipër dhe ndihmën e emigrantëve.

2. – Pulla e Kryqit të Kuq Shqiptar i ngjitet ç'do objekti që i shtrohet pullës së Monopolit e që mbrin ose kalon taksën 10 qindarka ari.

3. – Pulla e Kryqit të Kuq administrohet prej këtij, por shtypet e ruhet nën kontrollimin e Ministriës së Financavet.

4. – Dispozitat e tjera në fuqi për pullat e monopolit, zbatohen edhe për pullën e Kryqit të Kuq.

Dispozita të përkohëshme

5. – Deri sa të shtypen pullat e veçanta si mbas shëmbëlltyrës (modelit) të bashkangjitun, Kryqi i Kuq do të përdorë pullat e shtypuna për muhaxhirë tue u vumë një syrsharzë nën kontrollimin e qeveris, si edhe ato të Kryqit të Kuq qi janë sot në qarkullim (cirkolacion).

6. – Këjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletore Zyrtare.

7. – Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij dekret-ligji të pranuëm dhe prej Dhomave Legjislative, si mbas shkresës Nr. 26/III datë 23-IV-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, më 27-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Nr. 43

LIGJË, 27 Prill 1927.

Mbi ndryshimin e kuadrit presidencial

1. – Kuadro e Komandës së Gardës Presidenciale e pranueme prej pushtetit Legjislatif në rasë të votimit të budgetit 1926-1927, rëzohet nga fuqija edhe vehet në zbatim për deri në mbarim të vitit budgetuer kuadro e bashkangjitun pa i u ba barrë budgetit.

2. – Këjo ligjë hyn në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

3. Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të Popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 38 datë 23-IV-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, më 27-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

KUADRO E APROVUEME

Gradat	Seria	Rroga mujore Fr. ari	Shuma e përgjith. Fr. ari
Kapiten	1.	280	280
Toger	3.	230	690
N/Toger	2.	200	400
Aspirant	6.	150	900
Intendancier	1.	200	200
Kapter	8.	110	880
Reshtar	16.	90	1.440
Tetar	27.	80	2.160
Gjindarm	220.	70	15.400
SHUMA MUJORE			22.350

KUADRO E SOTSHME

Gradat	Seria	Rroga mujore Fr. ari	Ushq. Fr. ar	Shuma e përgjith. Fr. ari
Kapiten	1.	280	–	280
Toger	1.	230	–	230
N/Toger	1.	200	–	200
Aspirant	11.	150	–	1.650
Kapter	7.	110	–	770
Reshtar	19.	90	–	1.710
Tetar	44.	80	–	3.520
Gjindarm	311.	70	–	21.770
Rekrut	45.	2	24	1.170
SHUMA MUJORE				31.300

BKSH

Nr. 44

LIGJË, 22 Prill 1927.

Mbi lidhjen e nji pensioni familjes Turhan Pashajt

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Maj 1927, Nr. 36)

Art. — Tue marrë parasyshë shërbimet qi i ka bamë Shqipnisë i ndieri Turhan Pasha, e për të lehtësue gjendjen e vështrë financjare të familjes së tij, i nepet nji pension i përmuejshëm prej 250 fr.ar. Zonjes, e 250 fr.ari vajzes së tij.

Art. 2. — Kjo ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes.

Art. 3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit- me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranuéme edhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 52 d. 19-IV-927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 22 IV-927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 45.

LIGJË, 11 Dhetuer 1926.

Mbi Traktatin Shqiptaro-Italian

Letrat e shkëmbyera midis Ministrit të Shqipëris në Romë dhe Ministrit të P. të Jashtme t' Italis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Maj 1937, Nr. 45)

Me date 26 Prill të vitit vazhdues midis Ministrit të Shqipëris në Romë Z. Djemil Dino dhe Shkelqësis së Tij Kryetarit të qeveris italiane dhe Ministrë i P, të Jashtme Z. Mussolini u çkëmbyen letrat që pasojnë;

«*Zotni Kryeministrë,*

Qeverija e Republikës Shqiptare, tue dëshiruem t'api një tjetrë vërtetim solem të solidaritetit dhe t' akordit të plot që ekziston midis saj dhe Qeverisé Italiane nër të gjitha çashtjet që mund të rrjedhin nga pakti miqësie dhe sigurimi të stipulluem

në Tiranë më 27 Nanduer 1926, e që sido, u perkasin raportevet lumtërisht eksistuese midis të dy qeverivet, më ka dhanun barën onorifike të konkordoj bashk me Shkelqesin e Juaj deklaratën që vijon:

«Qeverit Shqiptare dhe Italiane deklarojnë se, po të thirren, së bashku ose veç e veç, prej një ose ma shumë Pushtetesh, për të nisun marrëveshtje që i përkasin interpretimit o zbatimit të paktit Tiranës, ose participimit në të, Shtetesh të tretë ose që si do u përkasin raportevet midis Shqipënis dhe Italis, as nji prej të dy qeverivet nuk do t'adheroj në të tilla marrëveshtje para se të mos ketë midis Shqipënis dhe Italis nji konsultim prevantiv mbi çeshtjen. nji akord i plotë dhe marrja pjesë e njihershme (contemporaine) e të dy palëvet në negoiciatet».

Ju lutem të pranoni Z. Kryeministër aktet e konsideratës s'ime më të naltë.

D. DINO

MINISRIJA E P. JASHTME
22038 2/8

«Zotni Minister,

I shtym prej dëshirës me dhënë përsëri dhe nji afirmim solenel të solidaritetit e t'akordit të njinjishëm që ekzistojnë në mest qeveris italiane dhe të qeveris të Republikës Shqiptare në të gjitha çështjet që mund të rrjedhin nga pakti i miqësis e i sigurimit të lidhun në Tiranë më 27 Nanduer 1926 e qi në çdo mënyrë munden me pasë relacion në marredhanjet që fatëbardhesisht ekzistojnë në mest të dy qeverive, kam nderin me u gjet në nji mendim me Ekselencën e Juaja në deklaratën që vijon :

«Qeverit Italiane dhe Shqiptare deklarojnë se po të thirren së bashku ose veç e veç prej nji ose ma shumë Pushtetesh, për të nisun marrëveshtje q'i përkasin interpretimit ose zbatimit të paktit të Tiranës, ose participimit në të Shtetesh të tretë ose që si do u përkasin raportevet midis Italis dhe Shqipëris as nji prej të dy qeverivet nuk do të adheroj në të tilla marrëveshtje para se të mos ketë midis Italis dhe Shqipnis nji konsultim prevantif mbi çështjen, nji akord i plotë dhe marrja pjesë e njiherëshme (contemporaine) e të dy palëvet në negociatet».

Ju lutem të pranoni Z. Ministër aktet e konsideratës s'ime ma të naltë.

MUSSOLINI

Nr. 46

LIGJË, 12 Maj 1927.

Mbi transferim një krediti prej 2560 fr. ari në budgetin e Ministris së Drejtësis

Neni 1. — Nga Kapitulli 1, artikulli 1 «Rroge» transferohet nji shume prej fr. ari 2.560 (dymij e pesëqintë e gjashtë dhetë) «Gjyqi i posaçëm për faje politike».

Neni 2. — Këjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes.

Neni 3. — Ministrija e Drejtësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË :

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 81 datë 9-V-1937 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 12-V-1927,

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Nr. 47

LIGJË, 13 Prill 1927.

Për mbi zgjerim e tokavet Shtetnore me ekspropriјim tokash private në Kryeqytet për instalimin e nëpunsavet e tjerë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Maj 1927, Nr. 38)

Art. 1. — Për të ngrehur shtëpija, nëpunsit Shqiptarë në Kryeqytet, Oficerët Shqiptarë qi për detyrat e veta kanë zyra të pa tundëshme në Kryeqytet, Senatorët, Deputetët, dhe Ministrat, autorizohet Komisioni i posaçëm i formuem si mas art. 4 të këtij ligji.

a) T' ekspropriјoje gjithë tokat Shtetnore e trullat (arsa) qi ndodhen në Shallvare e rrethanat e saja me çmimet dhe mënyrat e treguëme në art. 2 dhe,

b) T' ekpropriјoje gjithë tokat private e trullat qi ndodhen në rreth e për qark dhe midis ase ngjitun me tokat shtetnore të tregueme ma sipër me çmimet e mënyrat e tregueme n' art. 2.

Tokat shtetnore dhe ato private qi do t' ekspropriјohen për ngrehjen e shtëpijave tregohen kjarisht në pllanin e bashkngjitun këtij ligji.

Art. 2. — Ekspropriјimi i tokavet shtetnore të tregueme n' art. 1 do të bahet duke i paguar Ministris së Financavet nga 0.30 fr.ari për çdo metro katrore në mënyrën e tregueme n' art, 2.

Gjith' ashtu ekspropriјimi i tokavet private të tregueme në art. 1 do të bahet duke u paguar pronarëvet të tokavet në fjalë nga 0.30 fr.ari për çdo metro katrore ose duke u dhanë baras aqë tokë nga ajo e Shtetit në Laprake, e rethinat e sajë, ose në nji tokë rurale tjetër nga pasunija shtetnore.

Art. 3. — Vlefta .e tokavet private t' eskproprijueme do u paguhet të zotëvet njëherësh dhe në dorë nga Ministrija e Financavet në bazë të dokumentit të përcjellë nga ana e Komisionit të posaçëm si mas art. 4 dhe Ministrija e Financavet asht e autorizuëme për të përballun këtë shumë t' u a ndaloje personavet të treguëm në art. 1 nga rroga ose shpërblimi ma i parë njiherësh.

Art. 4. — Për ekspropriјimin e tokavet shtetnore e private dhe për pjestimin e këtyne në personat e treguëme n' art. 1 dhe për çdo send qi i përket ngrehjes së shtëpijavet në konformitet të konditavet të këtij ligjit formohet nji komision i posaçem prej :

a) Kryetarit i zgjedhun prej Dhomës Deputetve dhe,

b) Katër antarësh të zgjedhun, nji nga Ministrija e P. të Mbrendëshme, nji nga Ministrija e P. Botore nji nga Ministrija e Financavet, dhe nji nga Bashkija e Kryeqytetit.

Ky Komisjon ka kompetence të thëresë si ekperta ose specialista po pa të drejtë vote, c' do njeri qi të shofë për informata.

Art. 5. — Komisjoni ne fjalë m' anën e Zyrës Teknike të Ministris të P. Botore e të Bashkis, do interesohet të pregatitet plani definitiv me devis i të gjith tokës tue u ndarë kjo në copa të katërçipta dhe tue u caktuar në ketë planë, rrugat dhe sheshet, lulishtat, parkët, teatrot, tregun e mbyllun (pazar) banjo, shkollat, dhe çdo tjetër ndërtesë për nevojat publike, të gjitha këto do të goditën nga ana e Bashkis, dhe do të jenë prona e sajë. Ky planë do të përmbaje Kishat e Xhamijat të cilat do të goditen nga ana e komunitetevet. Gjith' ashtu do të përfshije dhe ndërtesat shtetnore të cilat do të goditen, nga ana e shte-

tit ëhe janë prona e tij, përveç këtyne do të shënohen dhe pjesa tokë të poaçme për Legacjone të hueja.

Art. 6. — Ç' do personi mbas kategorive dhe mbas rrogës si tregohet n' art. 8 do i jepet nga ana e Komisjonit, 1,100-800-500, metra katrore tokë në të cilën do të ngrihet vila ose vileta për banim si mbas planevet e stilevet të caktuëme e të pranueme nga Komisjoni. Kto do rethohen me pemë e me lulishtë.

Art. 7. — Tokat prej 1.100-800 e 500, metro katrore do t' i paguhen Ministris së Financavet nga fr.ari 0.30 për ç' do metro katrore mbrenda 6 (gjashtë) muejve mbas ndarjes të tokës dhe Ministrija në fjalë detyrohet sa të paguhen të hollat të japë pohimin në Zyrën e Kadastrës e cila pa kur farë taksi kadastrial do u lëshoje blerësvet titren e zotnimit (Tapi).

I interesuemi ka të drejtë të marrë titër-zotnimi para 6 (gjashtë) muëjve në qoftë se i dorzon të hollat plotësisht.

Në vleftën e tokavet shtetnore e private qi do t' ekspropijohen nuk llogariten pjesët qi do merren për aplikimin e pllanit, si mbas ligjit të ndërtesave e të Bashkive për aplikim plani ose çelje rrugash.

Art. 8. — Personat e treguem n' art. 1 qi përfitojnë nga ligjët si mbas rregullavet të tyne ndahen në këto kategorië:

a) Ata qi kanë 400 fr.ari e lart rrogë mujore ose shpërblim konsiderohen kategori e I-rë, dhe kanë të drejtë të marrin 1.100, m. kare në klasin e I-rë.

b) Ata qi kanë 300 deri 399 fr.ari rrogë mujore konsiderohen kategorië e dytë dhe kanë të drejtë të marrin 800 metro kare, në vendin e klasit II-të.

c) Ata qi kanë 150 fr.ari deri 299 fr.ari rrogë mujore konsiderohen kategorië e III-të, dhe kanë të drejtë të marrin 500 m. kare në vend të klasit të tretë.

Art. 9. — Klasat e tokës ndahen në këtë mënyrë:

a) Klasi i I-rë, i tokës asht ajo tokë qi ndodhet në të dy anët e rrugës principale qi minimum asht e shënueme në planë me nji gjerësie 16 metrosh e lart, si edhe tokat rreth parkëvet e lulishtevet.

b) Klasi i II-të, i tokës asht ajo tokë në dy anët e rrugës gjerësi e së cilës asht maksimum 12 metro.

c) Klasi i III-të, i tokës asht ajo tokë qi ndodhet në të dy anët e rrugës gjerësi e së cilës asht 8 metro.

Art. 10. — Vilat e vilezat që do të goditen në klasat e ndryshme të treguemë n'art. 7 do të janë në këtë mënyrë:

a) Klasi i I-rë, facada e të cilës para rrugës principale ose të parkut do të ndërtohet të paktën me nji largësi (distance) prej murit t'avllis 8 metro vend i cili do të jetë lulishte e gjelbër dhe shtëpia do të ketë nji suel (bodrum) me nji largësi nga nivelua e rrugës 1.75 meter dhe me nji peron përpara, dhe avllija para rrugës principale do të jetë në nji metro e lart hipur me grilla prej hekurit.

b) Klasi i dytë do të goditet në mënyrën e treguemë në alinjatin A), dhe po nuk kje e mundun në këtë mënyrë atëherë facada e shtëpisë para rrugës do të ndodhet të paktën në nji distancë prej 5 (pesë) metrash nga muri i avllisë, vendi i cili do të jetë lulishte dhe avllija do të jenë nji metro e lartë hipur me grilla prej hekurit. Facada e kësaj klasi do të goditet me nji muratori të fortë e të rregullte e me nji stil të kundërshme.

c) Klasi i III-të, do të goditen në mënyrën e treguemë në alenatin b), dhe po nuk kje e mundun atëherë facada e murevet që duken, do të jenë me nji muratori të bukur e me nji stil të pëlqyeshëm.

Shtëpiat do të goditen në tre katet shkallë si mbas klasit e gjendjes ekonomike të personavet të treguemë në Art. 1 të kësaj ligje.

Art. 11. — Tokat si mbas art. 1 si të ndahen në tri klasa, copavet të tokavet të ç'do klasi Komisjoni i ve nga nji numer dhe me nji mënyrë të caktueme, heq llotin dhe mbas llotës ban shpërndarjen e tokës.

Janë t'autorizuem gjithë ata që dëshirojnë të shkëmbejnë tokat midis tyre mbrenda dhetë ditëve ç'prej ditës së shpërndarjes, të bajnë veçanërisht duke marrë shenime nga Komisjoni mbi ndryshimin e bamun në pjesët e tokës mbas llotës.

Art. 12. — Komision'i posaçëm asht i autorizuem të bajnë marrëveshtje me shoqënina sipërmarrëse shqiptare ose të huaja qi janë në shkallë të ngrehin vila ose vileza si mbas kondîtave të caktueme në këtë ligjë e mbas shpalljes qi do të bahen si mbas ligjit.

Gjith ashtu garanton dhe grupet e nëpunësvet që bajnë marrëveshtje të veçanta dhe kombinazone me shoqëtinoq për ngrehjen e shtëpivet.

Art. 13. — Ç'do marrëveshtje e lidhueme nga Komisioni

me shoqëri sipërmarrëse hyn në veprim mbas proponimit të Këshillit Ministruer e aprovimit të Kryesisë së Republikës tue garantue shoqërin sipërmarrse Ministrija e Financavet.

Ministrija e Financavet e autorizuëme me i garantue shoqënis sipërmarrëse se ka me i paguëm kestin e vendosun dhe të kontraktuëm nga personat e treguëm n' art. 1 tue i a ndaluëm këtyne prej shpërblimeve e rrogave ose ma vonë prej pensioneve por ky kest nuk mundet me kapërcye kurr të katërtën e shpërblimit ose të rrogës e vijon me ketë sasije kur nëpunsi të shkojë në pension.

Ndalimi i shpërblimeve, i rrogave ose i pensioneve të treguëm ma sipër do të filloj qysh prej datës qi fillon goditja e shtëpive prej Shoqënis sipërmarrëse.

Në rast të shpërndarjes të Dhomës ose në mbarim të periudhës të Senatit e të Dhomës së Deputetevet, si dhe në rast qi nëpunësit hiqen nga puna dhe nuk janë në gjendje të paguajnë detën mujore për ngrehjen e shtëpis ose vdesin dhe fëmijet e tyne nuk mund t' i përgjigjen pagimit, atëherë Ministrija e Financavet në llogari të sajë i a shetë shtëpinë me gjithë tokë në adjudikatë si mbas rregullës dhe nga shuma e shitjes, herën e parë i paguën t' interesuëmit ose fëmijës së tyne sasin e të hollave qi i kanë dhanë Shoqënis, poguejnë dhe Shoqënin për të drejtat qi ka për të marrë nga këta dhe teprica mbetet në dobi të thesarit Shtetnuër.

Art. 14. — Në rast që nuk prezantohet no nji shoqëni sipërmarrëse për konstruksionin e shtëpivet ose kur personat që përfitojnë nga ky ligjë dëshërojnë t' a goditin shtëpinë me të hollat e tyne, atëherë komisioni ashtë i detyruëm të lerë ç' do person të lirë në ngrehjen e shtëpisë e cila do të fillojë maksimum mbas nji vjeti mbas dorëzimit të tokës dhe do të marrë fund mbrënda 6 (gjasht) vjetve.

Kur i zoti i tokës nuk ngreh shtëpinë mbrënda afatit të caktuem në ketë artikull, ay humbet të drejtat e veta mbi atë tokë pa pasur as kur farë pretendimi me i u kthye vlefta e paguëme për atë tokë, ose me kërkue ndonji dam shpërblim tjetër ç' do lloji që të jetë, dhe në ketë rast ajo tokë quhet pasuni Shteti dhe shitet prap me qëllimin prevedue n' art. 1.

Art. 15. — Tokat e marruna në dorëzim nuk mund të shiten as nuk mund të sikuëstrohen a të pengohen deri sa ndër to të jenë goditur shtëpiat; dhe si të goditën këto mund të pron-

sohen si mbas rregullave të përgjithëshme në qoftë se i interesuemi asht i çkarkuar nga ç' do garanci të bamun nga Ministrija e Financës, ose shoqëri sipërmarrëse.

Art. 16. – Tokat, dhe shtëpiat e godituna ose që janë në ndertim e sipër dhe tokat që janë pasunija e pa kontestuëme e personavet të tregueme n' Art. 1. gjith ashtu trashegohen dhe zotënohen edhe në qoftë se vdesin ose transferohen a pushohen ose japin dorëhekjen, si dhe në rast shpërndarje të Parlamentit ose në mbarim periodit të Senatit e të Parllamentit, për veç rasave të parapame në paragrafin e fundit t' art 13 të kësaj ligje.

Art. 17 – Bashkija e Kryeqytetit dhe Ministrija e P. Botore, detyrahen me puntorët e vetë të Tiranës, të mbushin tokat e caktueme për goditjen e shtëpive në mënyrë qi sipërfaqja e tokës të jetë e njëjte dhe të ketë posibilitet për aplikimin e pllanit definitif për konstruksjon shtëpijash, gjithë ashtu detyrohen këto për rregullimin e kanalizimin e Lanës.

Art. 18. – Ay qi ka të drejtë me ble tokë si mbas dispozitave të këtij ligji duhet t' i paraqiti komisjonit nji lutje me anë të së cilës do tregojë sasien e rrogës dhe proposionalisht si mbas artikullit 8 e 9, sasinë e kllasin e tokës,

Ata persona qi kanë paraqitur ma parë lutjet e tyne për tokë, natyrisht nuk do të përsëritin këto, por në qoftë se disa nuk janë drejtuar rregullisht, kanë të drejtë brënda 10 ditësh që mbas shpalljes së këtij ligjit, t' i paraqitin komisjonit lutjen përkatëse; pas mbarimit të këtij afati humbasin të drejtën e marrjes së tokës.

Art. 19. – Komisioni në fjalë asht i detyrùem qi vendimet e veta qër ndamjen dhe kllasifikimin e tokave t' i sjellë në dije t' interesuemve me anë të Fletores Zyrtare dhe me përngjitë në vënde të zakonshme.

Art. 20. – Llotua që përmëndet në këtë ligjë hidhet përpara Këshillit Bashkisë dhe Komisionit tue u mbajtë proces-verbali i posaçëm i nënshkruem prej gjithë misevet të mbledhjes nën Kryesin e Kryetarit të Komisjonit dhe ky proces-verbal do të botohet në Fletoren Zyrtare, dhe n' ato private qi dalin në Kryeqytet.

Art. 21. – Ligjë për mbi zhvillimin dhe përmirësimin e Kryeqytetit me datë 8-12-925, dhe shtojcë ligja mbi zhvillimin e Kryeqytetit me datë 13-12-925, mbeten pa fuqi.

Art. 22. – Këjo Ligjë hyn në fuqi që në ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art, 23. – Ministrija e P. të Mbrëndëshme, Ministrija e P. Botore e Bujqësis, dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shpiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 78/I datë 10-V-927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 13-V-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 48

LIGJË, 12 Maj 1927.

Kontratë me shoqnin Portland Çimento Shkodër

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Maj 1927, Nr. 48)

Në mes të Ministris së P. Botore e Bujqësis e përfaqësueme prej Z. Ministrit Musa Juka në njenën anë, për t' u quejtë tash e mbrapa Qeverija. e të Shoqënis Anonime Portland Çemento Shkodra, e përfaqësueme si mbas prokurës me datë..... prej Z. Hysen Draçini, për t' u quejtë tash e mbrapa Shoqënija.

Ashtë vendue e kontraktue çka vazhdon:

1) Qeverija e lejon Shoqënin për ngrefjen e nji fabrike çementoje portland romanze e gëlqere në Shkodër me të drejtë ekslusiviteti vetëm për çemento për 20 (njizet) vjet në Prefekturën e Shkodrës.

2) Veglat, makinat e nevojshme për këtë fabrikë përjashtohen nga taksa Doganore.

3) Shoqënija përjashtohet nga taksa mbi kapitalin e investuem në këtë sipërmarrje.

4) Shoqnnija përjashtohet nga taksa mbi eksportimin prodhimeve të kësaj fabrike.

5) Qymyri që do t' importohet nga jashtë për fabrikimin e çementos do të paguej nji taksë 25 (njizetepesë) santin ari për kuintal.

5) Importimi i çementos nga së jashtmi ka për të pasë gjthnji taksën e sotme për sa të ngjasi ky konvencion.

7) Qeverija i jep Shoqënis tokat Shtetënore të nevojshme për ngrefjen e fabrikës dhe gurore si në pllanin kundrejtë nji pagese 4 (katër) fr. ari në vjetë për ç' do hektar. Në qoftë se Shoqnija ka nevojë për tokë private ka për t' a rregullue çështjen vetë me privatët.

8) Shoqnija detyrohet me i pugue Qeveris nji taksë fiks (katërqintë) fr. ari për lejen e hapjes së gurorës e cila vlenë për një 20 (njëzet) vjetë,

9) Shoqnija detyrohet me i pague Qeveris 3% (tre për qint) mbi vleftën e çementos së fabrikueme prej sajë në treg. Çmimi i çementos caktohet krye tre muejsh prej Këshilit t' Administratës së Prefekturës së Shkodrës.

10) Shoqnija detyrohet me fillue nga importimi i veglave dhe makinave mbrenda 6 (gjashtë) muejve dhe me kompletue fabrikën e çementos maksimun mbrenda dy vjetve qi prej ditës së shpalljes së kësaj kontrate në Fletoren Zyrtare.

11) Të gjithë punëtorët e nëpunësit të Shoqënis do të jenë Shqiptar përveç teknikve e specialisteve në mos u gjendëshin në Shqipni.

12) Shoqënija asht përgjegjëse për ç' do dam që mund t i shkaktojë në pusuni Shtetnore a private a personave.

13) Shoqënija detyrohet me sigurue personelin e vetë kundra reziqeve.

14) Në rast nevoje publike Shoqnija detyrohet me i dhanë Qeveris prodhimet e saja me nji vleftë 5% (pesë për qindë) ma lirë se çmimi i tregut. Sasija e kërkuëm prej Qeveris nuk do të kalojë 10% (dhet për qind) të produksionit.

15) Për mirëzbatimin e kësaj kontrate Shoqënija do t' i japë Qeveris nji garanci prej fr.ari 5.000 (pesëmij).

16) Në rast të mos përmbushjes të konditeve nga ana e Shoqënis konvencioni anullohet, dhe garancia e lanun shkon në favor të qeveris.

17) Shoqnija nuk ka me muejt me e lëshue as nji personi ose Shoqënis tjetër ketë konçesjon pa marrë lejën e Qeveris.

18) Mbi gjithë përshkrimet e kësaj kontrate Qeverija detyrohet prej anës së sajë për 20 (njëzet) vjet tue nisë nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

19) Kjo kontratë hynë në fuqi qi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit;

DEKRETOJMË

aprovimin dhe zbatimin e kësaj kontrate të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 76 dt. 9-5-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 12-V-1927. **A. ZOGU**

Ministri i P. Botore e Bujqësis
MUSA JUKA

Nr. 49

DEKRET-LIGJË, 24 Prill 1927.

Mbi marrëveshtjen tregtare shqiptaro-rumune

(e botueme në Fletoren Zyrtare 21 Maj 1927 Nr. 26)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË

1) Pranohet marrëveshtja tregtare provizore e nënshkrueme me datë 14 Janar 1927, midis Z. Hysein Vrioni Minister i P. të Jashtme i Republikës s'onë dhe Z. Jean Trandafirescu Minister i Mbretnis Rumune në Tiranë mbi eksportimin dhe importimin e mallnavet në të dy Shtetet në bazë të reciprocitetit dhe të tratamentit të kombit më të favorizuem si pas kopjes këtu-gjitun.

2) Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi tet ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare dhe mund të anullohet nga të dy anët kontraktuese me një paralajmim tre muejsh.

3) Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatmin e kësaj Dekret-Ligjë të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative mas shkresës Nr. 44 datë 19-IV-927 të Kryesis Senatir.

Tiranë, më 26-IV-1927. **A. ZOGU**

Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 50

LIGJË, 17 Maj 1927.

Mbi dhanien e nji pensioni z. Izet Borshit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1927, Nr. 39)

Art. 2. – Tue marrë parasyshë shërbimet e z. Izet Borshit si edhe pleqnin e gjendjen e vështirë financjare të tij, i nepet nji pension i përmuejshëm prej fr. ari 60 (gjashtëdhetë).

Art. 2. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

Art. 3. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresë Nr. 80 datë 14-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 17-V-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 51

LIGJË, 12 Prill 1927.

Shtojcë e art. 5. paragraf (E) të konvencjonit vojguror bamë në mest të Qeveris Shqiptare e të D. Arcy Exploration Co Ltd.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1927, Nr. 39)

Art. 1. – Konvencjonit vojguror bamë në mes të Qeveris Shqiptare dhe të D. Arcy Exploration Co. Ltd. Londrës E. C. 2, Finsbury Cirkues (Britanic House) n'art. 5 paragraf (E) i shtohet kjo dispozitë:

(Afati i tre vjetëvë caktuem n'art. 5 paragraf (E) të konvencjonit të parë si «Perjudhë kërkimesh t'imta e të thellimesh,» ka me vazhduë për nji afat edhe dy vjet të tjera tue nisë nga data 11 Mars 1928 (njimij e nandëqinde njizet e tetë).

Art. 2. – Ministrija e P. Botore e Bulqësis ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 62 datë 19-IV-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 12-IV-1927. **A. ZOGU**

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 52

LIGJË, 20 Maj 1927.

Mbi bartjen e nji kredis prej fr. ari 25.000

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Maj 1927, Nr. 40)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

1) Prej Kap. 16 «Ngrehje e burgut në Porto Palermo» të budgetit të Ministrjës së P. të mbrëndeshme ushtrimit Financiar

926-927 barten fr. ari 25.000 (njezet n pesë mijë) në kap. 7 të këtij budgeti «ushqim burgu dhe ushqim t'internuarësh dhe vrasje t'aratisunve.»

2) Këjo Dekret-ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtore.

3) Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të veshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësajë dekret ligje të pranuëme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 87 datë 16-V-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, me 20-V-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme A. DIBRA

Nr. 53

LIGJË, 20 Maj 1927.

Mbi transferimin e nji kredije prej fr.ari 21.000

(e btueme në Fletoren Zyrtare, 23 Maj 1927, Nr. 40)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, i mveshun, prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pame vendimin me d. 7-1-1927, të Këshillit Ministruer.

DEKRETOJMË:

1) Autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme me transferue nji kredi prej 21.000 fr.ari nga kapitulli 15 në kapitullin «Propagande Shtypi» të budgetit të saj t'ushtrimit financjar 1926-1927.

2) Kjo Dekret-ligje hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes.

3) Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj Dekret-Ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 66 dt. 16-5-1927 të Kryesës Senatit.

Tiranë, me 20-V-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 54

STATUT, 14 Maj 1927.

Shtim i nji paragrafi n'art. 59 të Statutit Themeltar

(e botueme në Fletoren Zyrtare, [illegible] Maj 1927, Nr. [illegible])

Senati, sa na shpejt, i përgjigjet lajmosës ose lajmoses të Kryetarit të Republikës, të cilën e ndigjon bashkërisht me Dhomën e Deputetve, në të hapun të sesjonit të parë të zakonshme.

Kryetari i Asamblës Legjislative
Kryetari i Senatit
PANDELI EVANGJELI

Nr. 55

LIGJE, 23 Maj 1927.

Mbi gradimin e gradoatve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, [illegible] Maj 1927, Nr. [illegible])

Neni 1. — Shkalla e graduatve në ushtrin Shqiptare ashtë: Tetar, Reshtar, Kapter.

Neni 2. — Graduatet ndahen në dy kategori:

a) Gradeat aktiv;

b) Gradeat me rrogë.

Neni 3. — Graduatet aktivë si mbas nevojës së kuadros zgjidhen ndërmjet rekrutavet që mirren nën armë të cilët dinë me shkrue e me këndue dhe kanë nji zotësi trupore e mendore. Këta dërgohen në Shkollën e graduatvet dhe mbasi të mbaruej në Shkollën me sukses emnohen Tetarë, dhe përndahen nëpër

trupa. Gradimi i këtyne si Reshtar e Kapter bahet si mbas vjetërsis dhe dispozitave qi caktohen në këtë ligjë për graduatët me rrogë.

Neni 4. – Graduatët me rrogë mirren:

a) Nga ata qi mbarojne shërbimin aktiv dhe dëshërojnë të mbesin në shërbim me rrogë;

b) Nga civilat qi kanë kalue perjudhën e stërvitjes aktive dhe dinë me shkrue e me këndue e janë të pëlqyeshme nga pikpamja morale e fizike dhe me sukses mbarojnë Shkollën e graduatve.

Neni 5. – Ata civila qi do të pranohen në Shkollën e graduatvet, bashkë me aktet relative duhet të japin dhe nji akt-detyrimi me të cilën do të tregojnë se kanë me shërbye dy vjet graduatë. Ky akt-detyrim mirret dhe nga graduatët që mbarojnë shërbimin dhe dëshirojnë të mbesin në shërbim me rrogë. Akt-detyrimi duhet të përsëritet në dy vjet nji herë.

Neni 6. – Graduatët me rrogë brenda n'afatin e detyrimit mund të dalin nga shërbimi vetëm kur ata kërkojnë vetë të dalin për arësyna të ngutëshme familjare që çfaqën n'afatin e akt-detyrimit ose çrregjistrohen për arësye disiplinore dhe fizike.

Neni 7. – Graduatët me rrogë gradohen si pason:

a) Tetarët për me u bamë Reshtar duhet të kenë bamë të paktën nji vjet shërbim si Tetar;

b) Reshtarët për me u bamë Kaptera duhet të kenë bamë së pakti dy vjet shërbim si Reshtar. Sa për Kapterat, këta mbasi të kenë krye tre vjet shërbim si Kaptera të pa premë e të lavdërueshëm munt të hyejnë në Shkollën ushtarake t'Aspirantavet dhe gradimi i tyne bahet si mbas ligjit të gradimit t' oficerëvet dhe të Aspirantavet;

c) Kapterat mbas 12 vjet shërbim të pa premë e të lavdërueshme në rast të transferimit si rezervë gradohen Aspiranta.

Neni 8. – Gradimi i graduatëvet me rrogë bahet aktiv mbas propozimit të Komandantavet të trupavet të tyne dhe me autorizimin e Komandës së P. të Fuqis Armate. Propozimet bahen në bazë të kuadros të ç' do trupi. Transferimi i graduatëvet në rast nevoje bahet prej Komandës P. të F. Armate.

Neni 9. – Në kohën e paqës nji gradim jashtë kohës e rradhës të caktumun në këtë ligjë mund të bahet vetëm me

rast të nji shërbimi të jashtëzakonshmë dhe të nji sakrifice të pëlqyeshme. Ky gradim bahet me proponimin e Komandës ku mvaret graduati dhe me pëlqimin e Komandës së P. të F. Armate.

Neni 10. — Graduatët me rrogë si në kohën e paqes ashtu dhe në kohën e mobilizimit marrin rrogat e poshtëshenueme:

Tetar 60 Fr. ari
Reshtar 70 Fr. ari
Kapter 90 Fr. ari.

Neni 11. — Si gjithë ushtarët dhe graduatët me rrogë u epet gratis veshje, mathje, ushqim dhe barna mjeksore. Nga kujdesimi mjeksor e barnaf fitojnë dhe familja e atyre qi janë të martuem.

Neni 12. — Të drejtat e graduatvet me rrogë që shërbejnë 12 vjet rresht i u ruhen si mbas ligjit pensjonit t' Ushtris.

Neni 13. — Graduatët me rrogë kanë të drejtë nji muej leje në vjet.

Neni 14. — Graduatët me rrogë munt të martohen, dhe ata qi kanë mbush 6 vjet shërbim të pa premë dhe kanë kalamaj marrin nji shtesë rroge 10 fr. ari e cila në ç'do dy vjet shtohet n' atë shkallë.

Neni 15. — Graduatët me rrogë të muzikës dhe Sekretarët e zyravet ushtarake që janë në gradën e graduatëvet trashëgojnë të tanë të drejtat e caktueme në këtë ligjë.

Neni 16. — Tetarët aktive që bashkë me klasët e tyne hyjnë në rezervë, në qoftë se kanë rëfyer nji sjellje dhe zotsi të pëlqyshme i u shënohet në librezën e tyne se (meriton gradën Reshtar). Gradimi i këtyne tetarëvet rezervë në gradën Reshtar, bahet në kohën e mobilizimit ose në fund të periudhavet të thirrjes së rezervës për manevra stërvitje dhe qetësi të mbrendëshme. Gradimi për Kapter bahet vetëm në kohën e mobilizimit.

Neni 17. — Gradimi i graduatëvet qi ndodhen sot në shërbim bahet si mbas dispozitavet të këtij ligji.

Neni 18. — Ky ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 19. — Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e këtij ligji.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 83 datë 19-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 23-V-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

DEKRET-LIGJË, 24 Maj 1927.

Nr. 56

Mbi shtimin e art. 9 të buxhetit 1926 27

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Qershuer 1927, Nr. 43)

Ne, Kryetar i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit, mbi propozimin e bamun me shkresën Nr. 58-II datë 21-V-1927 të Kryesiës së Senatit,

DEKRETOJMË:

shtimin e art. 9 (Organizatorë) prej Fr.ari 2708, (dymijë e shtatqint e tetë) në listën e të dymbdhjetës pjesë të muejit Prill të budgetit 1926-1927 të Ministries së P. Mbrendëshme e votueme prej Dhomave Legjislative por harrue pa u shenue, në rast të kopjimit dhe urdhënojmë zbatimin.

Tiranë, me 24-V-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 57

LIGJË, 24 Maj 1927.

Shtojcë e nenit 1, të ligjës s' organizimit të gjykatoreve të Drejtësis me datë 28-I-1923, e ndryshume me datën 5-XII-1927

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Qershuer 1927, Nr. 44)

Art. 1. — Në qendrën e Prefekturës së Vlonës formohet një Gjykatë Paqtuëse e Kl. II-të, dhe në qendrat e Nënprefekturës Mirditë të qarkut të Shkodrës dhe Bunjaj nga nji Gjykatë Paqtuëse e Kl. III.

Art. 2. — Kjo shtojcë-ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. — Me zbatimin e kësaj ligjë autorizohet Ministrija e Drejtësis.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj shtojcë-ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 86-I datë 21-V-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 24-V-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 58

LIGJË, 3 Qershuer 1927.

Mbi transferim kreditash 107.611 fr. ari në budget të Komandës së Fuqis Armate

1) Për t'i bamë ballë nevojave të trupave të riformuem transferohet nji shumë prej fr. ari 107.611 nga Arti «Blemje Armesh» të budgetit 1926-1927, të Komandës së P. të Fuqis Armate, tue i a mvesh artikujve rrogë graduatësh fr.ari 22.155, rrogë ushtari fr.ari 3486, zjarm e dritë fr.ari 2.000, blemje kafshë fr.ari 80.000.

2) Kjo ligjë hyn në fuqi prej ditës së shpalljes.

3) Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJME

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative sipas shkresës Nr. 103 datë 30-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 3-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 59

LIGJË, 3 Qershuer 1927.

Mbi mbartje kredinash për Drejtorin e P. të Shëndetësis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, [illegible] 1927, Nr. [illegible])

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit.

DEKRETOJME:

Art. 1. — Prej Kap. 1. art. 2. rrogë personeli qarqesh të budgetit të Drejtoris Përgj. Shëndetsiës ushtrimi financjar 1926-1927, të bartet shuma prej fr. ari 30.000 (tridhetmij) me Kap. 2. art. 18 që i shtohet këtij budgeti nën emnin (Rontgen).

Art. 2. — Prej shumës fr. ari 30.000 (tridhetmij) do të përballohet rroga e specialistit dhe të shpenzimeve për blerjen e Instalimin etj. nevojë të makinave.

Art. 3. — *Ky Dekret-Ligjë hynë në fuqi qi me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.*

Art. 4. — *Me zbatimin e këtij Dekret-Ligji ngarkohet Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet.*

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

DEKRETOJME

aprovimin e zbatimin e këtij Dekret-Ligji, t aprovuem dhe prej

Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 208 datë 31-V-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 3-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme A. DIBRA

Nr. 60

LIGJË, 3 Qershuer 1927.

Mbi shtimin e pensionit Z. Tahir I. Qemal Vlonës e fëmis së të ndierit Hoxha Kadritut

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Qershuer 1927, Nr. 45)

Art. 1. — Tue marrë parasyshë shtrejtësinë e sotëshme e për të lehtësue jetesën e tyne, pensioni i Z. Tahir Ismail Qemal Vlonës prej 150 fr.ari në muej rritet në 250 fr.ari si dhe ai i fëmis së të ndyerit Hoxha Kadriut prej 100 fr.ari i rritet në 250 fr.ari.

Art. 2. — Kjo ligjë hynë në fuqi qysh prej datës së shpalljes.

Art. 3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 98 datë 31-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 3-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Nr. 61

LIGJE, 4 Qershor 1927

Mbi pensionimin e Z. Ali Kokës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Qershor 1927, Nr. 40)

1. — Tue marrë para sysh shërbimet e Z. Ali Kokës ish Prefekt i Durrësit si dhe gjendjen e vështirë financiare të tij i jepet një pension prej 250 fr.ari në muej.

2. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të myeshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË :

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligje të pranuem dita prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 119 dato 31-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 4-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 62

LIGJE, 4 Qershor 1927.

Mbi pensjonimin e Z. Stathi Gjinit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Qershor 1927, Nr. 40)

1. — Tue marrë para sysh shërbimmet e bamuna të Z. Stathi Gjinit ish Antar në Gjyqin e Diktimit si edhe gjendjen e vështirë financjare të tij i napet një pension prej fr.ari 250 në muej.

2. — Kjo ligje hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

3. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të myeshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj Ligje, të pranueme prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 114 datë 31-V-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 4-VI-1928 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 63

LIGJË, 6 Qershor 1927.

Mbi shtojcën e ligjës për mbi të drejtat e bashkive me datë 25-XII-1921

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qershor 1927, Nr. 46)

Art. 1. — Çdo Bashkië, do të kujdesohet të pregatisë nji plan të zgjerimit, të përmirësimit e të zbukurimit të qytetit ose të katundit.

Në këtë plan caktohet drejtimi, zgjerimi i rrugëvet që do të krijohen ose do të ndryshohen, gjithashtu shenohen vendet e gjerësija e tregut të mbuluar, kopshtevet publike, lulishtevet, sheshevet për lodra, parkevet, dhe sheshevet të lira të ndryshme dhe vendet e tjera publike.

Në këtë caktohet mënyra e kanalizimit t'ujravet të ndyta tue u caktue dhe vendet ku këto ujra bashkë me sendet e përdorueme do të përmblidhën e do të zbrazen, dhe në e dashtë nevoja edhe mënyra e shëndetësimit të tokës.

Art. 2. — Kur një qytet sa do që të jetë numri i popullsisë së tij asht krejt ose pjesërisht i renuar prej luftës, zjarrit, tërmetit ose ç'do kataklizmi, Bashkija asht e detyrueme mbrenda nji afati të shkurtën të pregatitë simbas art. 1. të kësaj ligjë planin e përgjithshëm të sipërfaqes për pjesat që do të rindërtohen.

Deri sa plani i vijave dhe i sipërfaqes e të këtilla qyteteve nuk asht aprovuem, as nji ndreqje për veç asaj të banesave provizore si edhe as nji ngrehje godinash nuk mund të bëhet.

Art. 3. — Planet e qytetevet hartohen e pregatiten prej Ingjinerëvet të Bashkisë ose të Ministris P. Botore dhe në mungesë të këtyne prej Ingjiniervet privat t'autorizuem prej Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 4. — Shpenzimet për pregatitjen e planevet si mbas artikujve ma sipër i përkasin Bashkivet.

Por për pregatitjen dhe zbatimin e planeve të qyteteve për të cilat bahet fjalë n'art. 2. Shteti u jep Bashkivet ndihmat e duhuna financjare.

Art. 5. — Po sa që planet janë pregatitur prej Inginerëvet i parashtrohen Këshillit të Bashkisë për studim e shqyrtim.

Planet e pregatituna dhe t'aprovueme prej Këshillit të Bashkisë i paraqiten Ministris së Botore, me anë të Prefekturave ose Nënprefekturavet bashkë me mendimin e Këshillit Administratif dhe Ministrija në fjalë mbasi t'i studjojë prej Këshillit Teknik të saj i vërteton ose i ndryshon dhe kështu këto marrin formën e prerme dhe viben në veprim.

Art. 6. — Planet e hartueme si mbas Art. 1, e të vërtetueme si mbas Art. 5. me as nji mënyrë nuk mundën të ndryshohen përveç se në disa raste e nevoja teknike të shfaquna të justifikueme e të pranueme prej Këshillit të Bashkisë, Këshillit t'Administratës dhe të pëlqyeme e të vërtetueme prej Këshillit Ministruer në mbështetje të raportit të Këshillit Teknik të Ministris së P. Botore.

Art. 7. — Bashkit si mbas fuqis financjare të tyne aplikojnë planet e qytetevet pjesërisht ose me nji herë tue caktuar fondin e nevojshëm për çdo vjet në budgetin e vet, veprimet e shpronësimit të pjesës së çdo viett bëhet tre muaj para aplikimit tue lajmërue megullisht mbi cmimin e vendosur dhe t'interesuemit me letër komunikimi.

Art. 8. — Në çdo rast para se të vihet dorë mbi sendin e shpronësuem duhet që Bashkija t'i ketë pague të zotit në dorë (peshim) cmimin e caktuar.

Art. 9. — Shpronësimi i tokës për zbatimin e planevet bahet në konformitet t'Art. 3, 4, e 6, të ligjës mbi shpronësimin e pasunisë në Kryeqytet me date 13-XII-1925.

Art. 10. — Në qoftë se Bashkija qysh prej datës së komunikimit të cmimevet dhe mbrenda në tre muej nuk e vë në zbatim pjesën e caktueme t'atij vjetit, të zotët e pronës janë të lirë me meremetue e përmirësue pronat e tyne dhe Bashkija para se të fillojë zbatimi i planit detyrohet me përsëritë veprimet e shpronsimit.

Art. 11. — Art. 34, 35, të ligjës së Bashkivet me 25-XII-1921, abrogohen.

Art. 12. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 13. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Botores ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullii, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj shtojcë ligjë të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 104 dt. 1-VI-1927 të Kryesiës së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme — A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës — MUSA JUKA

Nr. 64

LIGJË, 6 Qershor 1927.

Mbi anulimin e dekret-ligjës mbi ndryshimin e nenevet 5, 19, 21, 26, 27, 28 të ligjës së rrugavet me d. 30 XII-1925 dhe mbi anulimin e ndryshimin e disa dispozitave të ligjës së rrugave me d. 26 XI 1921

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qershor 1927, Nr. 46)

Art. 1. — Dekret-ligja mbi ndryshimin e neneve 5, 19, 21, 26, 27, 28 të ligjës së rrugëve me datë 30-XII-1925 anullohet dhe mbeten në fuqi dispozitat e ligjës së rrugave me datë 26-XI-1921, në mënyrën dhe me dispozitat si ma poshtë.

Art. 2. — Artikulli 5, i ligjës së rrugave me datë 26-XI- 921, ndryshohet kështu: Të gjithë banuesit në Shqipëri prej 18 deri 55 vjeç që s'janë sakat, studenta, ushtarë dhe nga trupi dipllomatik e konsulluer i të huejve, detyrohen me pague fr. ari 15 në mot si shpërblim punimi të rrugave.

Shqiptarë, shqiptarka ose të huej pa u marrë para sysh mosha e tyne qi kanë t'ardhuna ose fitime prej pasunis, tregëtis ose ç'do burimi tjetër, ma tepër se 100 (njiqindë) napolona në mot, janë të detyruem edhe me pagesat e posht shënueme.

Gjith ata që kanë t'ardhuna ose fitime përmi 100 (njiqind) napolona deri me 500 (peseqind) napolona në mot, detyrohen të paguajnë 2% (dy për qind) dhe prej 501 deri me 1000, $2^1/_2$% (dy e gjymës për qind) taksë rruge, e

kështu tue u shtue nji gjymës për qind për ç'do 500 napolona t'ardhuna ose fitime qi të ketë.

Progreja e përqindjes nuk do të kapërcejnë 6% (gjashtë për qind) për shembull: nji qi ka 8.000 napolona në mot paguen 480 napolona arë.

Art. 3. — Nenet 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33, 35, 36, 37, 39 të ligjës së rrugëve anullohen.

Art. 4. — Neni 39 i ligjës relative anullohet dhe në vendin e tij vehet dispozita këtu poshtë:

Puntimi i rrugëvet rishtas kryhet me mënyrë sipërmarrje me adjudikatë të rregullt e mbas konvencjonit të bamë.

Mirëmbajtja e reparimi i rrugëve bahet me fondet e caktuome në budget të Ministris së P. Botore.

Art. 5. — Zyrat e Financës tue u bazue në rregjistrat e Zyrave të Shtetit Civil, në muejin Kallnuer të ç'do vjeti pregatisin nji rregjistër qi të përfshijë të gjithë të detyruemit me pagim takse rruge.

Art. 6. — Ndër rregjistrat e përmendun n'art. 5, qi do të shtypen nga ana e Ministris së Financavet për të detyruemit n'art. 2, merret shenim mbi personat qi do të shkarkohen nga shërbimi tue pague taksën e rrugës.

Art. 7. — Taksat e vertetuome si mbas kësaj ligje për të detyruemit mblidhen me anë të zyravet financiare në muejin Gusht e Dhetuer të ç'do vjeti, e rregjistrohen t'ardhuna adektive. Art. 37 i ligjës së Bashkive i cili i akordon ketyne taksën e rrugës së punëtorëve të qyteteve, abrogohet.

Art. 8. — Ministrija e Financavet në bazë të protokolit vërtetimeve qi tërhjeqë nga zyrat financiare në muejin Fruer të ç'do vjeti parashef në budgetin e ushtrimit përkatës shumat e t'ardhunave të përbame.

Art. 9. — Ç'do dispozitë e ligjeve në kundërshtim me këtë ligjë, mbetet pa fuqi.

Art. 10. — Kjo ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 11. — Ministrija e Financavet e P. të Mbrendëshme dhe ajo e P. Botore detyrohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprvimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 115/I me 1-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 65

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi ndeshkimet qi t' ushtrohen për bagtiet (dhen e dhi) e mëshefuna

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qerhuer 1927, Nr. 46)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Bagtit e thiet qi nuk i deklarohen komisjonit për numrim e regjistrim me qëllim qi mos të paguejnë taksën e xhelepit, konsiderohen si gja të mëshefuna dhe të zotërit e tyne detyrohen të paguejnë nji gjobë sa tri fish taksa e xhelepit për se cilen kokë të mshefun. Kohja e kontrollimit fillon nji muej mbas numërimit të regjtstrimit.

Art. 2. – Gjoba e bagtive të mshefuna nxirret me nji herë, në vend prej tragrambledhësvet kundra nji deftesës së rregulltë e në rast të mospagimit të gjobës sekuestrohet nji pjesë bagtije e mjaftueshme për me mbulue gjoben, pjesë e cila shitet n' ankand prej Zyrës së Financës së vendit.

Art. 3. – Gjysma e gjobës së sipër-përmendun regjistrohet në t' ardhunat efektive e gjysma e mbetur ju dorëzohet lajmëtarëvet në bazë të nji procesverbalit të mbajtun nga Prefekti a Nënprefekti dhe nga Drejtori a Kryenëpunësi i Financës tue lajmërue Ministrin e Financavet.

Art. 4. – Nëpunsat e Financës dhe t' administratës dety-

tohen si mbas ligjës të kudesohen për vërtetimin e taksës se xhelepit.

Në rastë të kundërtë ndeshkohen nga autoritetet ku mvaren si mbas randësisë së fajit me prerje roge.

Art. 5. — Pleqset e Lagjevet dhe të Katundevet qi abuzojnë detyrën qi u ngarkonen ligja e Xhelepit, dënohen mbas ligjevet në veprim.

Art. 6. — C' do ligjë në kundërshtim me dispozitat e kësaj ligjë mbetet pa fuqi.

Art. 7. — Kjo Dekret-ligjë hyn në fuqi qysh nga data e e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 8. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË

aprovimin dhe zbatimin e kësaj Dekret-Ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legislative si mbas shkresës Nr. 110/I datë 2-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
P. ALIZOTI

Nr. 66

LIGJË, 7 Qershor 1927.

Mbi marrjen e një mbi takse prej 2% mbi të gjithë t'ardhunat shtetnore e komunale për zhvillimin e Arsimit Kombëtar

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qershor 1927, Nr. 40)

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e Financavet me marrë një mbitaksë 2% (dy për qind) mbi t'ardhunat Shtetnore e Komunale (të Bashkivet) të përmenduna ma poshtë, për llogarinë e Arsimit Kombëtar, përveç atyne të përfshime në traktate konvenzjone e kontrata të ndryshme.

Art. 2. — Përqindjet e përmenduna n' art. e 1-rë, merren prej këtyne t'ardhunave:

1) Mbi t' ardhunat prej Pyjevet të Shtetit e të privatëve si dhe prej gurorëvet.

2) Mbi tatimin mbi ndërtesa.

3) Mbi xhelepin mbi berre, mbi 10 e lartë.

4) Mbi xhelepin mbi gjanë e trashë mbi 5 e lartë.

5) Mbi taksën progresive mbi t' ardhunat e fitime.

6) Mbi taksën mbi patentën tregtije;

merret 2% qi nga shumat në fr.ari 10 e lartë.

7) Nga të dhetat e të treta merret 2% nga Myltezimet me kondicjon qi të mos merren prej popullit shtesë.

8) Ç' do bashki mbi t' ardhunat përgjithësisht paguan 2% për arsim.

9) Në doganet merret 2% si taksë arësimi nga teshat qi s' janë konvencjonel.

10) Mbi taksat e Gjykatavet të Zyravet Përmbarimit 2% për mbi 10 fr.ari e lartë.

Art. 3. – Ministrija e Financavet detyrohet me mbajtë llogari të veçantë për këta t' ardhuna pa i përzi me t' ardhunat e tjera Shtetnore.

Art. 4. – Shuma e përgjithëshme e t' ardhunavet 2% do të futet në budget të përvjetshëm të Shtetit dhe do të destinohet vetëm për nevojat e arsimit Kombëtar.

Art. 5. – Kjo Ligjë hyn në fuqi qi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6. – Trupi Ministruer detyrohet me zbatim e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative, si mbas shhresës Nr. 132/I datë 3-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 67

LIGJË, 7 Qershuer 1927.

Mbi disa ndryshime të ligjës së pyjevet e të kullotave me dt. 24-I 1923

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qershuer 1927, Nr. 46)

Art. 1. – Anullohet neni 96 i Ligjës Pyjevet e kullotavet dhe këthehen në fuqi të gjitha dispozitat ligjore mbi kullotat komunale të përparshëm të Kodit Ryral; por kur këto kullosa jepen me qira prej katundeve, paguejnë 10% (dhet për qind) mbi sasinë e qirasë.

Art. 2. –. Për ata privatë qi janë nëdorës kullosash por nuk kanë dokumentat e caktueme në nenin 6 të ligjës mbi kullosat e përmenduna, Ministrija e P. Botore e e Bujqësis, nuk mund t'i shtjerë në dorë pa vendim gjyqi.

Art. 3. – Ç' do dispozitë e Ligjës së Pyjevet e kullosavet të përmendun, qi i kundra-vete dy neneve të sipërme, mbetet pa fuqi.

Art. 4. – Kjo ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes.

Art. 5. – Ministrija e Financavet, Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe Ministrija e Drejtësisë detyrohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetar i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr 97 datë 1-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 68

LIGJË, 6 Dhjetor 1927.

Mbi autorizimin e mënyrës e administrimit të monopolit të Krypës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, [illegible] Dhjetor 1927, Nr. [illegible])

Art. 1. — Qeverija autorizohet t'i a shese sipërmarresve me adjudikata e për nji kohë deri 15 vjet të drejtën eksklusive të punimit, të shitjes e të transportit të krypës në të tanë qendrat e Prefekturave e të N/Prefekturave ku krypa do të shitet me çmime egale.

Art. 2. — Çmimet e shitjes së Krypës që përdoret për konsumacjon të vendit janë këto:

Nji Klg. krypë të bardhë fr.ari 0.42
Nji Klg. krypë të zezë » 0.40

Art. 3. — Çmimet e shitjes të krypës së bardhë që përdoret për industrinë të djathit, të peshkut e të sendevet tjera që eksportohen, asht fr.ari 12 kuintali. Gjithashtu dhe çmimi i shitjes së nji kuintali të krypës së zezë që përdoret për industrinat lamike, caktohet fr.ari 10 kuintali. Sipërmarrësi do të punojë edhe krypë lëkse, çmimi i shitjes së të cilës nuk do të kapërcejë fr.ari 65 për kuintal.

Art. 4. — Në rasë të zbulimit të ndonji minjere krypës mbrenda periudhës së sipërmarrjes t'administrimit të Monopolit të krypës, Qeverija asht e lirë me eksploatue këtë me anë të sipërmarrësvet kontraktues e si mbas kondtave t'adjudikatës që do të bahet në bazë t'art. 1 ose me mos e eksploatue deri në mbarim t'asaj periudhe.

Art. 5. — Dispozitat e tjera në kundërshtim me këtë ligjë mbeten pa fuqi.

Art. 6. — Ministrija e Financavet asht e detyrueme me zbatimin e kësaj ligje.

Art. 7. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej

Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 122 datë 2-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Nr. 69

LIGJË, 7 Qershuer 1927.

Mbi përjashtimin nga taksi doganuer etj. të veglave që importohen nga shoqëni sipërmarse

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Qershuer 1927, Nr. 46)

Art. 1. – Të gjitha veglat e makinat e nevojshme qi importohen nga ç' do Shoqni sipërmarrëse qi merrë përsipër të kryemit e punimevet botore ë qi do të paguhen nga huaja e 50.000.000 (pesë dhetë milionevet) përjashtohen nga taksa doganore, nga taksa e oktrovës si dhe nga ç' do lloj i pagesës tjetër si për importimin ashtu dhe për eksportimin e tyne.

Art. 2. – Shoqënija sipërmarrëse detyrohet me dhanë garancië equivalente me taksin doganuer, se mbas mbarmit të veprimevet botore të Shtetit do t' i nxjerrë jashtë të gjitha maqinat e veglat e importueme pa taksë doganuer e tjera.

Në rasë të prishjes të këtyne makinavet e veglavet në mënyrë të pa përdorueshme, Shoqënija detyrohet të provojë me dokumenta shkatrimin e tyne për me marrë prapë equivalentin e taksit doganuer etj. lanun si garancie në zyrën e doganës ku depozitohet garancia.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës ië shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministrija e P. Botore dhe ajo e Financavet, detyrohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme edhe prej

Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 133 datë 2-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, 7-VI-1927

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Ministri i P. Botore e Bujqësis
MUSA JUKA

Nr. 70

LIGJË, 7 Qershuer 1927.

Mbi krijimin e Inspektorive të përgjithëshme

(e botuem në Fletoren Zyrtare, 8 Qershor 1927, Nr. 44)

Art. 1. — Krijohen katër Inspektoria me qendër në Kryeqytet e me kompetencat e detyrat e cilësitë e caktueme me këtë ligjë.

Art. 2. — Inspektorat e Përgjithshëm emnohen nga Kryesija e Republikës.

Art. 3. — Për me u emnue Inspektor i Përgjithshëm, duhet me pasun gjithë cilësinat e lypuna prej ligjes për emnimin e nëpunësavet, duhet me pasë nji servis n'administratë ose nji zotësi të provueme si dhe nji jetëshkrim të pastër.

Art. 4. — Inspektorat e Përgjithshëm mvaren prej Kryesis së Republikës dhe nga e cila marrin urdhënat.

Art. 5. — Ç'do Inspektor ka nji Sekretar të propozuem prej tij dhe të emnuem me dekretin e Kryesis së Republikës. Këta duhet të kenë cilësit e lypuna me ligjë.

Art. 6. — Rrogat e Inspektorëvet dhe të Sekretarëvet caktohen me budget. Këta në kohën e inspektimit dhe hetimeve jasht qendrës kanë të drejtën e marrjes së shpenzimevet dhe djetavet.

Art. 7. — Detyrat e Inspektorëvet të Përgjithshëm janë kontrollimi dhe inspektimi i gjithë veprimevet Shtetnore. Mënyra e zbatimit të detyravet t'Inspektorëvet caktohet hollësisht me nji rregullore të posaçme.

Art. 8. — Inspektorat janë përgjegjës për veprat e veta për pa kujdesit të treguem ose për shpërdorim detyre. Inspektorat ndeshkohen nga ana e Kryesis së Republikës; a) qortim verbal ose me shkresë, b) premje rroge, c) pushim.

Art. 9. – Kjo ligje hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 10. – Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mvehun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej dhomave legjislative si mbas shkresës Nr. 112/1 datë 3-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 7-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

[illegible] i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 71

RREGULLORE, 30 Maj 1927.

Mbi bursat e Shtetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, [illegible])

I.

Bursa të mbrendëshme

Art. 1. – Në bazë të ligjës me datë 28-XI-1921 mbi bursat kombtare, bursat akordohen për nxanës të varfën që kanë aftasi mendore e që dallohen ndër mësime ndërmjet nxanësvet të shkollës.

Art. 2. – Bursat mbrenda Shtetit akordohen për shkolla të mesme: a) Normale mashkullore e femnore, b) Lyce, c) Shkolla Teknike, d) Shkolla Tregëtare e dh) Shkolla Bujqësie.

Art. 3. – Bursat për shkollat fillore e plotore u jepen vetëm nxanësvet të viseve malësore ndëpër internatet fillore të Malsivet ase ndëpër internatet e tjera ndër qytete të përmbajtuna prej arsimit për edukimin e fëmijëvet t'atyne viseve ku nuk mund të çelen shkolla fillore e plotore.

BKSH

Gjithashtu jepen bursa për shkolla fillore e plotore edhe për djelmosha emigrantë familjet e të cillëvet nuk janë vendosun definitivisht ndëpër qytete ase katunde.

Bursistët e mbrendëshëm ndëpër internate fillore mbassi mbarojnë shkollën plotore për me pasë vijimin e bursës n'istitute të mesme të përmenduna n'art. 2 duhet t'i shtrohen konkursit.

Art. 4. – Bursat për shkollat e mesme të ndryshme jepen simbas kushtevet të parapame n' artikullin 1, e tue i u shtrue një konkursi të veçantë për se të cillën kategori shkolle si mbas art. 20 të ligjës mbi bursat.

Art. 5. – Konkursi do do të bahet javën e parë të Shtatorit në se të cillën shkollë të mesme.

Art. 6. – Kandidati bursist ka për t'i drejtue autoritetit arsimuer të vendit një lutje tue i tregue shkollën për ku dishiron me pasë bursën e tue i bashkëngjitë kokumentat e parapame prej artikullit 1 të ligjës mbi bursat, d. m. th. deshmi vobeksie të vërtetueme rregullisht prej Këshillit të Bashkis, prej atij t'administratës së vëndit, letër-njoftimin e Shtetit Civil, deshmin e fundit shkollore dhe një raport mjeku me anën e të cilit të vërtetohet se nuk vuen prej asnjë sëmundjeje.

Autoriteti Arsimuer i vendit mbasi të ketë sqyrtue lutjen dhe dokumentat e mbasi t'i ketë gjetë këto të rregullta dhe pa të meta, simbas përshkrimevet të kësaj rregulloreje, i a drejton drejt për së drejti Institutit tue i shfaqun edhe mendimin e vet mbi gjindjen familjare simbas art. 22/II, mbi gjindjen e veçantë familjare simbas art. 22/III, mbi gjindjen ekonomike simbas art. 22/IV, mbi largësin e vend-banimit të kandidatit simbas art. 22/V dhe mbi kapacitetin e nxanësit.

Art. 7. – Lutja bashkë me dokumentat e sipërtregueme duhet të paraqitet në Drejtori të shkollës së paku deri me 15 Gusht. Çdo lutje e paraqitun mbas kësaj datë s'mund të merret parasysh dhe kandidati s'mund të marrë pjesë në konkursin e ati vjeti shkolluer, por i jepet e drejta me u paraqitun vjetin tjetër.

Art. 8. – Komisjoni provues i konkursevet përbahet prej drejtorëvet të shkollavet të mesme dhe prej tre antarëve të zgjedhur prej Drejtoris së Përgjithshme t' Arësimit emnat e të cilëvet do të komunikohen vetëm ditën e caktueme për konkurs përpara fillimit të provimevet.

Art. 9. – Komisjoni provues kryesohet prej drejtorit t' institutit dhe jep vendim me shumicë votash.

Art. 10. – Provimet në konkurs bahen me shkrim e me gojë dhe do të kryhen në tri ditë.

Art. 11. – Komisjoni provues mbasi t'i shqyrtojë themat me shkrim të kandidatëvet ka për të dhanë vendim për pranimin e tyne në provimin me gojë.

Art. 12. – Që të mundet kandidati bursist me hymun në provimin me gojë duhet që në provën e shkrimit të ketë fitue të paken numrin e mesëm 10 në të gjitha landët me pasë numrin 20 si notën ma të naltë.

Art. 13. – Kandidatet që nuk fitojnë notën 10 në njenën nga landët e provimit me shkrim, nuk mund të pranohen në provimin me gojë e kështu e humbin të drejtën e fitimit të bursës Shtetnore.

Art. 14. – Provimi me gojë âsht një provë e dytë e cila ka për të vue bazën e të zgjedhunit e të rendimit e të gjithë kandidatëve bursistë fitues në konkurs simbas radhës dhe kapacitetit të tyne.

Art. 15. – Kandidatët bursistë për në shkollën Normale duhet të kenë mbushun të paken moshën 13 vjetsh e nuk mund të jenë ma të mbëdhej se 16 vjetsh.

Kandidatat për shkollë Teknike, bujqësië e tregëtarë do të kenë po këto kushte.

Kandidatet për klasë gatimore të Lycevet nuk do të kenë moshë ma të madhe se 13 vjetsh.

Kandidatët për klasët e para të Gjymnazevet do të jenë të paken 12 vjetsh e të shumën 15 vjetsh.

Art. 16. – Bursat akordohen për atë klasë të shkollës së mesme për të cilën kandidati ka bamun konkursin.

Asnji kandidat nuk mund të pranohet në një klasë tjetër ma të nalte nga ajo për të cilën ka dhanë provimin.

Art. 17. – Provimi për të hymun në shkollë Normale Mashkullore e Femnore e në klasën e parë të Gjimnazit do të bahet mbi landët e ndryshme të klasëve V e VI, të shkollës plotore në këtë mënyrë:

A. PROVA ME SHKRIM

1) Diktat-Orthografi : Prej 15 rradhësh tue i shtuem të shumtën pesë pyetje të ndryshme si shpiegim i kuptimit të një fjale, të një fjalie a fraze, analys gramatikuer e llogjik. Kandidatë-

vet u akordohet gjysëm ore për t'a shqyrtuem diktatin dhe për t'u përgjegjun pyetjeve.

2) *Hartim:* (përshkrim, kallzim ase nji letër të thjeshtë) tue i u dhanë nji kohë prej dy orësh.

3) *Mathematikë:* Zgjidhja e dy problemave. Koha e caktueme për këtë provë asht një orë e gjysmë.

4) *Kaligrafi:* Kjo provë gjykohet prej shkrimit të diktatit dhe prej hartimit, por notohet veçanërisht.

B. PROVA ME GOJË

1) Këndim me pyetje dhe analizim i njij fjalie.

2) Pyetje mbi Histori të Shqipnis.

3) Pyetje mbi Gjeografi të Shqipnis.

4) Pyetje mbi shkenca fizike e Histori natyre.

Art. 18. – Provimi për të hymun në klasët gatimore të Lyceve do të përfshijë landët e klasës së VI të shkollës fillore dhe do të bahet po me atë mënyrë që u tregue n' art. 17.

Art. 19. – Provimi, për të fituem bursën në shkollë teknike, e bulqësië tregëtare, do të përfshijë landët e klasës së V. të shkollës fillore tue u bamun pikërisht simbas rregullores së përmendun n' art. 17.

Art. 20. – Kandidati, që merr notën zero në njanën nga landët e provimit me shkrim ase t'atij me gojë, rrëzohet krejt nga provimi me të drejtë që mund të marrë pjesë përsëri në konkursin e vitit t'ardhëshëm.

Art. 21. – Mbasi marrin fund të dy provimet, Komisjoni provues pregatit listën e të gjithë kandidatëve të cilët i ka gjykuem të pranueshëm e bashkë me proces verbalin e mbajtun e të nënëshkruem prej të gjithë anëtarëve e me dokumentat e paraqituna prej kandidatëve, i a dërgon Drejtoris së P. t' Arsimit.

Art. 22. – Vendimi definitiv për akordimin e bursavet jepet prej Këshillit Qendruer të Drejtoris së P. t'Arsimit tue pasë para sysh të gjitha aktet e dokumentat relative të kandidatëvet.

Vendimi jepet tue ndjekë këtë proçedurë:

I. Mbi notat e fitueme

Lista e kandidatve bursistë që kanë fitue në konkurs ndahet në tre grupe të njinjishme:

a) Kandidatëvet qi gjinden të klasifikuem në grupin e parë u epet nota 6 ase 5;

b) Kandidatevet të grupit të dytë u jepet nota 4 ase 3;

c) Kadidatëvet të grupit të tretë u jepet nota 2 ase 1.

II. Mbi gjendjen familjare

a) Kandidatëvet qi janë prej nji familjeje me ma shumë se pesë fëmij ase atyne që janë me ma se katër fëmij bonjakë prej ati, ase ma se dy bonjakë prej nane e ati u nepet nota 5.

b) Kandidatëvet që janë prej nji familjeje me pesë fëmij ase me katër bonjakë prej ati ase dy bonjakë prej ati a nane u jepet nota 4.

c) Kandidatëve qe janë prej nji familjeje me katër fëmij ase me tre bonjakë prèj ati ase me nji bonjak prej ati a nane u jëpet nota 3.

ç) Kandidatëve prej nji familjeje me tre fëmij ase me dy bonjakë prej ati u jepet nota 2.

d) Kandidatëve prej nji familjeje me dy fëmij ase nji bonjak prej ati u jepet nota 1.

dh) Kandidatëve prej nji familjeje me nji fëmi u jepet nota 0.

III. Mbi gjendjen e veçantë familjare

a) Kandidatëve prej familjeve dëshmori ase veterani u jepet nota 3 pa marrë para sysh numrin e fëmijëve të familjes.

IV. Mbi gjindjen ekonomike

a) Kandidatëve prej nji familjeje me gjindje ekonomike tepër të nevojshme u jepet nota 3.

b) Kandidatëve prej nji familjeje me gjindje ekonomike të nevojëshme u jepet nota 2.

c) Kandidatëve prej nji familjeje me gjindje ekonomike mesatare u jepet nota 1.

V, Mbi largësin e vend-banimit

a) Kandidatëve prej familjeje emigranti të pa stabilizuem ase prej viseve malësore u jepet nota 3.

b) Kandidatëve nga vise jasht qarkut të Prefekturës ku gjindet instituti u jepet nota 2.

c) Kandidatëvet nga Nënprefekturat e Prefekturës ku gjindet instituti apo nga katundet e asaj Prefekturë u jepet nota 1.

ç) Kandidatëvet nga qyteti ku ndodhet instituti u jepet nota 0.

Art. 23. – Shuma e këtyne pesë kategorive ka me dhanë nji numër notash të ndryshme prej 1 – 20 i cili merret për bazë për akordimin e bursave.

Art. 24. – Ata kandidatë që fitojnë notën 11 – 20 marrin bursë të plotë ata që fitojnë notën 6 – 10 marrin dy të treta burse dhe ata që fitojnë notën 1 – 5 marrin gjysmë burse.

Art. 25. – Pagesa mujore ase vjetore e bursavet për institute ku ka internat si edhe për ata që nuk kanë internat caktohet nga Drejtorija e P. e Arsimit.

Art. 26. – Numri i bursistëvet që do të pranohen për se të cillën shkollë të mesme do të caktohet prej Drejtoris së P. t' Arsimit.

Art. 27. – Ata kandidatë që pas shkallës së notavet të fitueme mbeten jasht numrit të caktuem të bursavet t' ati vjeti shkolluer, në vjetin tjetër ruejnë të drejtën me u paraqitun përsëri në provim vetëm me gojë pa u detyrue me kalue nga provimi me shkrim.

Art. 28. – Për kandidatë tepër nevojtarë dhe pa prind a farefis mbrojtës që janë shque ndër mësime ndër shkollat fillore e plotore e që nuk mund të shigurojnë kursesi shpenzimet e udhëttmit për t' u paraqitun në konkurs, Këshilli Arësimuer i vendit tue u bazue në deshmin e Pleqësis së Lagjes a të katundit vendos me u dhanë një ndihmë nga fondi i posaçëm që kanë Bashkit për arsimin e vendit.

Art. 29. – Lutjet e paplotësueme simbas përshkrimevet të kësaj rregulloreje nuk merren para sysh.

Art. 30. – Kandidatët e pranuem si bursistë janë të detyruem me paraqitë mbrenda vjetit të parë shkolluer letër-detyrimet rregullisht simbas artikullit 17 të ligjës së posatshëme.

Ata qi mbrenda këti afati nuk kanë me i paraqitë, në vjetin e dytë nuk do të pranohen si bursistë.

II.

Bursa të përjashtëme

Art. 1. – Bursat e përjashtëme jepen në bazë të art. 25 të ligjës së posatshëme mbi bursat kombëtare dhe akordohen ve-

tëm për të gjitha degët universitare si edhe për shkolla të mesme e të nalta për Arte të Bukura.

Art. 2. — Nuk jepen bursa të përjashtëme për shkolla të mesme që gjinden mbrenda Shtetit si gjymnas, Normale, Teknike, Tregëtare e bulqësie.

Art. 3. — Bursat e përjashtëme akordohen në bazë të nji konkursi i cili ka për t' u ba me 15 Shtatuer të çdo viti në Drejtorin e Përgjithshme t' Arsimit.

Art. 4. — Kandidati asht i detyruem t'i drejtojë lutjen bashkë me dokumenta Drejtoris së shkollës së mesme ku ka krye mësimet dhe kjo në marëveshje me autoritetin arësimuer të vendit ka me veprue sipas art. 6 të kësaj rregulloreje për bursa të mbrendëshme tue dërgue të gjitha: lutjen, dokumentat dhe informatat në Drejtori të P. t' Arsimit si edhe një raport të Profesorit të veçantë mbi talentin që ka kandidati për atë degë Universiteti apo arti për të cilën ky kërkon bursën.

Art. 5. — Lutja bashkë me dokumentat duhet të paraqitet në Drejtorin e Arësimit deri me 31 Gusht. Çdo lutje e paraqitun pas kësaj date nuk merret para sysh dhe kandidati nuk mund të marrë pjesë në konkursin e ati vjeti shkolluer por i jepet e drejta me u paraqitun në vjetin tjetër.

Art. 6. — Komisjoni provues do të përbëhet prej Drejtorit të Përgjithshëm t' Arsimit si Kryetar tue pasë për antarë Shefin e Seksionit Teknik, nji nga Inspektorët e qendrës, nji Drejtor a Profesor shkolle të mesme e nji përfaqësues prej Ministris me të cilën do të ketë të përpjekun akordim i bursës.

Art. 7. — Provimet bahen vetëm me shkrim dhe ndahet në tre grupe: për degët klasike, degët reale dhe për Arte të Bukura dhe do të përfshijë landët më kryesore të shkollës së mesme tue i dhanë ma randësi degës që do të ndjekë kandidati. Përveç kësaj do të bahet edhe një hartim në gjuhë të dytë d. m. th. në gjuhën e atij Shteti ku kandidati do të ndjekë mësime.

Për ata kandidatë të grupit të tretë do të formohet një komisjon specialistësh i cili ka për të çmue talentin e tyne.

Art. 8. — Komisjoni sprovues i paraqet Këshillit Qendruer të Drejtoris së P. t' Arsimit raportin e vet mbi provimet e bame dhe Këshilli tue marë para sysh dispozitat e artikujvet 22, 23 24 mbi bursat e mbrendëshme të kësaj rregulloreje klasifikon

kandidatët bursierë dhe i paraqet listën Këshillit Ministruer për pëlqimin definitiv.

Art. 9. — Pagesa mujore ase vjetore e bursavet të përjashtëme caktohet nga Drejtorija e P. e Arsimit sipas shtrenjtësis së vendit ku kandidati do të shkojë me ba studimet.

Art. 10. — Numri i bursistëvet që do të pranohen në shkolla të përjashtëme caktohet nga Drejtorija e P. e Arësimit.

Art. 11. — Ata kandidatë që pas shkallës së notavet të fitueme mbeten jasht numrit të caktuem të bursavet t' ati vjeti shkolluer, preferohen në vjetin tjetër në qoftë se nuk do të ketë kandidatë me nota ma të mira se të tyne.

Art. 12. — Artikujt 29, 30 të rregullores mbi bursat e mbrendëshme zbatohen edhe për bursat e përjashtëme.

III.

Dispozita të përgjithëshme mbi bursistë të mbrendëshëm e të përjashtëm.

Art. 1. — Bursisti detyrohet t' u shtrohet pikërisht urdhnave e rregullave të shkollavet të vendit.

Art. 2. — Bursisti asht i detyruem të tregojë dashuri e nderim kundrejt profesorëve e bindje kundrejt urdhnave t' inspektoris së studentavet e përfaqësivet të Republikës.

Art. 3. — Ç'do bursist detyrohet të vazhdojë me rregull në shkollë, në nji mënyrë që mos të shkaktojë ankime nga ana e Drejtoris së Shkollës.

Art. 4. — Bursisti, pa autorizimin e inspektoris e të përfaqësuesve të Republikës e pa lejen e shkollës, nuk mund të largohet nga vendi ku mëson.

Në rasën e kundërt autoriteti merr masat për premjen e bursës së tij.

Art. 5. — Bursisti, që tregon pakujdesje në mësime e që sjellet keq mbrenda e jasht shkollës, dënohet për herë të parë me premjen e njij pjesë të bursës e në rasë përsëritje shrregjistrohet nga lista e bursistëvet të Shtetit.

Art. 6. — Bursisti asht i detyruem të ndjekë atë shkollë e atë fakultet që i ka caktuem Drejtorija e P. e Arësimit dhe të paraqesë me nji herë dëftesën e rregjistrimit në fakultet.

Art. 7. — Bursisti ndalohet rreptësisht që të bisedojë e të përzihet me çashtje politike e të shkruejë mbi to.

Art. 8. — Në kohën e pushimevet shkollore bursisti asht i lirë t'udhtojë ku të dojë, me kondîtë që të paralajmërojë autoritetet eprore e të gjindet në vendin ku mëson 5 dit para se të hapet shkolla.

Art. 9. — Bursisti asht i detyruem t'u paraqesë autoritetevet eprore në fund të ç'do semestri, e të konferencës, dëftesat shkollore, përkundrazi merren masa për shregjistrimin e tij nga lista e bursistëvet. Gjithashtu duhet të apë provimet mbrenda kohës së caktueme nga shkolla.

Art. 10. — Ai bursist që veperon jashtë urdhënavet të eprorevet e kundër artikujvet të kësaj rregulloreje, dënohet, sipas randësis së fajit, me qortim me pezmim e nji pjesë të bursës e me shregjistrimin e tij krejt nga lista e bursistëvet.

	Ministri i Financavet
Ministri i Drejtësis	*Zëv. Ministri i P. të Jashtme*
P. POGA	F. ALIZOTI
Min. i P. të Mbrendëshme	*Ministri i P. Botore e Bujqësis*
A. DIBRA	MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje e pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë me 20-V-1927. **A. ZOGU**

Nr. 72

LIGJË, 7 Qershuer 1927.

Mbi transferimin e nji kredije prej fr.ari 4000 për Drejt. e P. të P. T. Telegrafeve

(e botuem në Fletoren Zyrtare, 19 Qershuer 1927, Nr. 41)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e P. Botore e Bujqësis me

BKSH

mbartun nga Kap. Nr. 1 Art. 3 shkroje mbartje postash (dispozicion) fr.ari 4.000 (katërmij) të budgetit 1926-1927, të Drejtoris së P. të Post-telegrafavet.

Art. 2. — Prej shumës përmendun fr.ari 3.000 (trimij) i shtohen Kap. 2 Art. 9 shkroje Godi ndërtesash, e fr.ari 1.000 (njimij) Kap. 2 Art. 10 Godi linjesh të budgetit 1926-1927, të Drejtoris së P. të Post-telegrafavet.

Art. 3. — Kjo Dekret-ligjë hyn në fuqi qi nga dita e shpalljes.

Art. 4. — Ministrija e P. Botore e Bujqësis dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj Dekret-ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 109 datë 1-VI-1937 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet — F. ALIZOTI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës — MUSA JUKA

Nr. 73

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi transferimin e disa kredinave të K. P. Fuqis Armate

(e botueme në Fletoren Zyrtare 13 Qershuer 1927 Nr. 47)

Art. 1. — Për t'i bamë ballë disa nevojave tepër të ngutëshme mbarten prej budgetit 1926-1927, të Komandës P. të Fuqis Armate nga artikuj «blerje kafshë fr.ari 32.000, blerje arme e municjon» fr.ari 147.000 pastrim armësh fr.ari 10.000 vegla korespondence fr.ari 1.000 shuma fr.ari 20.000 dhe vishen Kap. «Operacjon po t' atij budgetit».

Art. 2. — Kjo Ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. — Trupi Ministruer ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 123 datë 1-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, më 6-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 74

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi krijimin e nji komiseri të Qeveris pranë Bankës Kombëtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, Nr. 47)

1) Krijohet në Ministrin e Financave nji Komiser i Qeveris për në Banken Kombëtare me nji rrogë të përmujshme prej 500 fr.ari.

2) Detyrat e Komiserit të Bankës janë ato të caktueme n' Art. 49 të ligjit organik të Bankës Kombëtare.

3) Shpenzimet e udhtimit e të djetevet të Komiserit të Qeveris pranë Bankës Kombëtare në rast t' udhtimit për sherbime, paguhen prej fondit të përkatshëm të Ministris së Financavet.

4) Zgjedhja dhe emnimi i Komiserit bahet në mënyrën e parapame në Konvencion.

5) Kjo ligjë hyn në fuqi qi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

6) Ministrija e Financavet autorizohet për zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 125 datë 1-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Nr. 75

LIGJË, 7 Qershuer 1927.

Mbi rregullimin e pagesës së të mbrapambetunavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, Nr. 47)

1) Ministrija e Financavet asht e autorizueme me rregullue pagesat e të mbetunavet të vjetvet 1925-1926 e 1926-1927, të cilat xanê shumën prej Fr.ari 461.388.

2) Përballimi i pagesavet të të mbrapambetuna bahet prej t' ardhunavet të mbrapambetuna të vërtetueme të pa nxjeruna në vjetet e kalueme e qi parashifet se do të nxirren në vjètin 1927-1928.

3) Rregullimet kontabel të pagesës së të mbrapambetunave bahet në bazë të nji rregullores të veçantë qi do të formohet nga Ministrija e financavet.

4) Kjo ligjë hyn në fuqi me ditën e shpalljes.

5) Ministrija e Financavet asht e ngarkueme me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 140 datë 3-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Përmbledhja e pengimeve të marruna e të pa paguerna për mungesë fondi

Dega	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma	[illegible]
Ministria e financavet	32.091	174.417	206.508	
» » Mbrendëshme	36.860	11.530	48.390	
» » Jashtme		17.400	17.400	
Drejt. P. e Shëndetsis	7.050	–	7.050	
Shuma	76.001	203.347	279.348	
Min. P. Botore e Bujqsis	13.100	162.500	175.600	
Min. e Drejtsis	810	5.030	5.840	
	90.511	370.877	461.388	

Nr. 76

LIGJE, 6 Qershor 1927.

Mbi shtojcen e nenit 4 të ligjës mbi disa ndrrime të ligjeve vepruese me d. 26-6-1923

(e botuem në Fletoren Zyrtare, 12 Qershor 1927, Nr. 41)

Kundërshtimet që përmenden në nenin 2 të ligjës mbi disa ndërrime të ligjëve vepruese d. 26-VI-1923, të juridiksonit të Gjyqit Shk. I-rë Dibër, shqyrtohet mbi akte prej Këshillit Shqyrtues të përbamë prej trupit gjykues të Gjyqit Shkallës I-rë Shkodër.

Kjo shtojcë ligje hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Ministrija e Drejtsis ngarkohet me zbatimin e kësaj shtojcë ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të zgjedhun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj shtojcë të nenit 4 të ligjës mbi disa ndërrime të ligjeve vepruese me datë 26-VI-1923 i

pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 105 datë 1-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 77

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi krijimin e nji nëpunësije për rregullimin e pasunive shtetnore në Sarandë dhe të nji zyre financiare në Zerqan

(e botuem në Fletoren Zyrtare, [illegible] Qershuer 1927, Nr. [illegible])

Art. 1. — E lidhun në Financën e Delvinës, krijohet nji nëpunës në qendër në Sarandë qi do të ketë e detyrimë me rregullimin e pasunive Shtetnore qi gjinden aty.

Art. 2. — Rroga mujore do të jetë Fr.ari 230.

Art. 3. — Gjith' ashtu krijohet nji zyrë financiare në Zerqan e mvarun nga Financa e Peshkopis me nji Kryenëpunës Finance me rrogë mujore Fr.ari 200.

Art. 4. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. — Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJME,

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 135 datë 3-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

BKSH

Nr. 78

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi shkëputjen e Drejtoris së Bujqësis e të pyjeve prej Ministris së P. Botore dhe të bamit në Ministri më vehte me titullin: Ministri e Bujqësis dhe e Pyjevet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, Nr. 47)

Art. 1. — Shkëputet nga Ministrija e P. Botore, Drejtorija e Bujqësis dhë e Pyjevet e bahet Ministri më vehte.

Art. 2. — Ministri e Bujqësis dhe e Pyjeve do të ketë dy Drejtori, Bujqësi edhe Pyje. Këto dy, do të kenë edhe dy degë Minjere-Lumenj, edhë veterinari.

Art. 3. — Detyrat dhe të drejtat e Organizatorit do të caktohen me nji rregullore të posaçme që do të vendohet prej Këshillit Ministruer.

Art. 4. — Kjo ligë hyn në fuqi që nga data e votimit të Budgetit.

Art. 5. — Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 139 datë 1-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 79

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi krijimin e një nëpunësije pranë komisionit të punimeve topografike kadastrore në tokën Shqiptare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, No. 47)

Art. 1. – Nën varësinë e Ministris së Financavet krijohet një nëpunës „Përfaqësuesi i Qeverisë pranë Komisjonit të punimeve topografike Kadastrore në tokën Shqiptare" me detyrat e caktueme n' art. 1 e 2, të kontratës së lidhun me 12-XII-1926, ndërmjet të Qeverisë Shqiptare e të Kryetarit misionit Italjan, të përfaqësim t' Institutit geografik ushtarak Ministrisë së Financës.

Art. 2. – Për me u emnue përfaqësues i Qeveris pranë komisjonit të përmendun n' art. 1, lypset të ketë njohtime të njëjta në topografi, geometrije e geografie, dhe të dijë njanën ngo gjuhët Italisht ose Frengjisht.

Emnimi bahet me provim.

Art. 3. – Rroga mujore do të jetë fr. ari 500 për posë të drejtën e shpenzimeve t' udhëtimit e dietë.

Art. 4. – Kjo ligjë hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M E

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës No. 134 datë 2-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, më 6-VI-1927

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 80

LIGJË, 6 Qershuer 1927.

Mbi shpërdarjen e misrit gratis të vobektëve të Dukagjinit e të Pukës

(E botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Qershor 1927, Nr. 41)

Neni 1. — Autorizohet Ministria e P. të Mbrendëshme me blemun në mënyrë pakimi me anë të Prefekturës Shkodrës, prej dhetarëve t'atij qarku, të sasi misri të mjaftueshme për t'i a shpërndarë gratis të vobekëvet të Dukagjinit e të Pukës.

Neni 2. — Për t'i bamë ballë shumës së nevojshme për blejtjen e misrit të permendun n' Art. 1, i akordohet budgetit 1926-27 të Ministris së Financavet, fr. ari 20.000 edhe taprizat e kreditavet prej fr. ari 40.000 e fr. ari 10.000 t' akorduemë me ligjen me datë 22-IV-1927, edhe me Dekret-Ligjen me datë 20-II-1927, e aprovueme prej Dhomavet Legjislative.

Neni 3. — Shumat e permendune n' Art. 2 të kësaj ligje do të përballohen prej fondi i të mbisparmbetunavet, qi shenohen në budgetin 1926-27 të Ministris së Financave.

Neni 4. — Kjo ligjë hyn në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 5. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptarë të nxeshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 128 datë 1-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 81

LIGJË, 6 Oershuer 1927.

Mbi tatimin e shtazëve të trasha

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, Nr. 47)

Art. 4. – Për veç atyne shtazavet të trasha që përdoren në pendë dhe atyne që nuk kanë kalue moshën motaka, gjith shtazat e trasha e tjera si femën e mashkull i shtrohen nji taksë të përvitëshëm si pason:

a) Çdo lopë. kalë, pelë, mushkë të mësueme e të pa mësueme fr. ari 2.

b) Buallicat fr. ari 4.

c) Mazat, mushkore, mëshqere, mëzat fr. ari 1.

d) Gomari fr. ari 0.50.

Art. 2. – Për regjistrimin e kontrollimin të shtazavet të trasha të përmenduna n' art. 1 të kësaj ligjë dhe për të mëshefunat e këtyne aplikohen dispozitat e ligjës së xhelepit.

Sa për këtë vjet, rregjistrimi i këtyne fillon me 1 Korrik.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi nga data e shpalles në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin ë kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit' me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 116-I datë 3-VI-1927 të Kryesis Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

AQSH

Nr. 82

LIGJE, 7 Qershuer 1927.

Mbi ndryshimin e nenit 12 të tarifës postare të Mbrëndëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Qershuer 1927, Nr. 41)

Neni 12 i Tarifës Postare të Mbrendeshme modifikohet në mënyrën vazhduese:

Art. 1. – Fletoret e dergueme prej editorit nder pagesa deri në 75 gram e për ç'do 75 gram frakcjon qindar 0,01.

Fletoret qi dergohen me copë kur asht vetëm nji fletore qindar 0,01.

Art. 2. – Ministrija e P. Botore e Bulqësis ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Art. 3. – Kjo ligje hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat mvetone të Shtetit

DEKRETOJMË

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 127 datë 1-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i P. Botore e Bulqësis
MUSA JUKA

Nr. 83

LIGJE, 6 Qershuer 1927.

Mbi pranimin e marrëveshtjes Tregtare me Austrin

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Qershuer 1927, Nr. 42)

1. – Pranohet marrëveshtja e përkohëshme nënshkrue me datë 14 Prill 1927 midis z. Fejzi Alizotti, Ministri i Financavet dhe zav. Ministri i P. të Jashtme i Republikës s'onë dhe të Imzot Seipel Kancelarit Federal t'Austris mbi eksportimin e mallnavet në të dy Shtetet në bazë të parimit të reciprocitetit dhe të trajtimentit të kombit më të favorizuem si pas kopjes këtu ngjitun.

2. — Kjo marrëveshtje mund të denoncohet kurdoherë prej secilës nga të dy anët kontraktuese me njı paralajmim tre muejsh.

3. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Gazetën Zyrtare.

4. — Ministsija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mas shkresës Nr. 111 datë 2-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

PËRKTHIM

Zotni Kanceljeri Federal

N' emën të Qeveris të Shtetit Shqiptar kam nderin t' i njoftoj Eksencës s' Uejë që Qeverija Shqiptare aprovon spitullat

1. — Regjimi i Kombit ma të favorizuem do t' aplikohet reciprokisht në marrëdhanjet tregtare midis Shqipëris dhe t' Austris.

2. — Kjo marëveshtje do të hyjë në fuqi 8 dit mbasi që aprovimi i Parllamentit Shqiptar do t' i njoftohet Qeveris Federale Austrtiake me udhë telegrafike ajo mund të denoncohet prej secilës nga të dy palët kontraktuese pas nji paralajmimi tre muej.

Duke ju lutur ekselencës s' Uej të ketë mirësinë të më dërgojë një komunikatë analloge, përfitojë nga ky rast për t' i përsëritur sigurimet e konsideratës s' ime të naltë.

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

KANCELJERI FEDERAL
Dep. i Punërave të Jashtme

Zotni Ministër,

N' emën të Qeveris Federale të Republikës t' Austris kam nderin t'i njoftoj Ekselencës s' Uejë se Qeverija Federale Austrijake aprovon stipullat vazhduëse:

1. — Regjimi i kombit ma të favorizuem do të aplikohet në marrëdhënjet tregtare midis Austris dhe të Shqipëris.

2. — Kjo marrëveshtje do të hyjë në fuqi tet dit mbasi që Parllamentit të Qeveris Federale Austrijake do t' i njoftohet Qeveris Shqiptare me udhë telegrafike ajo mund të denoncohet het prej secilës nga të dy palët kontraktuese pas një paralajmimi tre muajsh.

Duke ju lutur ekselencës s' uaj të ketë mirësinë të më dërgoni nji komunikatë analloge profitoj nga ky rast për t'i përsëritur sigurimet e konsideratës s' eme të naltë

Kanceljeri Federal
SEIPEL

Nr. 84

LIGJË. 6 Qershuer 1927.

Mbi ndryshimin e neneve 29 e 30 të ligjës shtojcës së Procedurës Civile dhe të nenit 38 të ligjës mbi disa ndrime të disa ligjeve vepruese

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Qershuer 1927 Nr. 48)

Neni 29 i shtojcës së procedurës civile përmirësohet si vijon:

Gjykatorja e diktimit padinë e shqyrton mbi akte.

Por në rastë qi ndonjeni nga ndërgjyqësit, në kërkesën, ose në parashtresën e tij, kërkon qi gjyqi të bahet botnisht dhe në pranin e të dy palvet, Gjykatorja tue respektue regullat procedurjale për komunikim thërret këto për me u paraqitë ditën e shenueme për Gjykim për me zhvillue vetëm pretendimet e bamuna në kërkesën, ose parashtresën diktimore.

Ditën e caktueme fillon gjykimi diktimisht në pranim e ndërgjyqësve ose në mungesën e njanit ose të dy palvet kur nuk janë çfaqun ose nuk asht kërkue thirja e tyne.

Gjykatorja e Diktimit mbrenda dy muajve që prej ditës së mbrritjes t'akteve n'ato gjyqe, bën shqyrtimet dhe vendim.

Kur padina asht nga ato ceshtje që i takon § 2. të nenit 28 të shtojcës së procedurës civile edhe njeni nga t'interesuemit ka kundërshtue vendimin dhe tjetri e ka diktue, Gjykatorja e diktimit e mvarë ceshtjen deri sa që padija që shqyrtohet kundërshtimisht, të sillet para diktimit ose vendimi i dhanun mbi kundërshtim të marrë formën e prerë.

Gjykatorja e Diktimit kur shqyrton padinë ka të drejtë t'urdhënojë prurjen e ç'do akti relativ të cilin e shef të nevojshme, ose t'atyne akteve të cilat, tue qenë të paregjituna, në gjyqin qi ka dhanë vendimin nuk kan shkue në vendimin tansisht ose në mënyrë t'eksplikueme.

Neni 30 i shtojcës së procedurës civile përmirësohet si vijon:

Regullat dhe dispozitat e nenit 22 të Shtojcës së Procedurës Civile për garancinë që epet për Diktim.

Akt-garancija duhet të përmbajë detyrimin për pagimin e demit dhe të shpenzimeve t'dhanuna apsolutisht dhe të shpenzimeve Diktimore dhe të jetë legalizue prej Noterit posi fuqija ekonomike e garantit të jetë vërtetue prej Dhomës Tregtore, ose Zyrës Kadastrijale me shenim sekuestrimi në regjistrat kadastrijale mbi pasuninë e pa lujtshme të garantit.

Kur që diktuesi e kërkon gjykatorja në të cilën asht paraqitun kërkesa diktimore caktan në cilën ose në cilën pjesë të pasurisë të garantit duhet të vihet shenimi sekuestrimi, ose shumën që duhet të depozitojë ky në kancelerinë e gjyqit e cila shumë nuk mund të kalojë në këtë rasë të fundit të një mij fr. ari.

Në rasë që akt garancija nuk asht e plotësueme, ose kërkesa Diktimore asht regjistrue, por shpenzimet nuk janë pague mbrenda afatit ligjuer, gjykatorja e Diktimit në ç'do gradë që të ndodhet ceshtja kur shef ato të mbetë, detyrohet me i akordue diktuesit nji afat prej 15 ditë c'prej ditës të komunikimit për me plotësue garancinë në mënyrë që i tregon gjykatorja ose për me dhanë shpenzimet. Në qoftë se diktuesi nuk konformohet në vendimin e Diktimit kërkesa Diktimore i refuzohet.

Në rast që mos plotësimi i garancisë, ose mos pagimi i shpenzimeve nuk provohet se ka rjedhë nga veprimet e diktuesit, Gjykatorja mund të vendose të premit tansisht ose pjesërisht të rrogës së noterit dhe të Kryesekretarit.

Neni 38 i ligjës mbi dies ndrime përmirësohet si vijon:

Kundra vendimeve të Diktimit nuk mund të bahet as kundështim as ndjekim gjyqit, vetëm mund të kërkohet prej secilit nga ndërgjyqësit mbrenda afatit qi tregohet ma poshtë, përmirësimi i vendimit për ndonjenin nga shkaket e poshtë shenueme:

1. — Kur n'akt-gjykimin e Diktimit nuk bahet fjalë mbi nji pretendim ose kundërshtim të shenueme në parashtresën e ndërgjyqësit dhe të bazuem në nji dispozitë të ligjes.

2. — Kur në ndonjenin nga aktet qi ishin paraqitë Diktimit ka kështhikim ose dredhje (dolt-sasia).

3. — Kur n'akt-gjykimin e Diktimit ndodhet nji vendim qi asht kundra nji dispozite të ligjes, ose asht dhanë vendim tue e marrun parasyshë nji e mbetë të cilën ana tjetër nuk e ka pretendue dhe e cila nuk asht nga ato qi mund të merren kryesisht.

4. — Kur po n'atë çashtje janë vendime qi kundërshtojnë njani tjetrin.

Shkaqet e tregueme në numrat 1 edhe 2 janë të pranueshme si shkaqe përmirësimi vetëm kur kan influencue gjykimin në themel (zabithyqën).

Përmirësimi i vendimit bahet me kërkesë qi ka me përmbajtë shkaqet për të cilat kërkohet përmirësimi. Kërkesa i drejtohet Gjykatores të Diktimit, ose Gjykatores ku kërkuesi ka banim të përhershëm, ose të përkohshëm.

Afati i përmirësimit asht 30 dit, dhe fillon nga e nesërmja e komunikimit t'akt-gjykimit të diktimit, por për shkaqet e tregueme në numrin 2 afati i përmirësimit fillon qi prej ditës qi provohen, ose konstatohen faktet e dëftueme n'atë.

Kërkuesi detyrohet mbrenda në afatin e sipërthanun të depozitojë në Sekretarin e Gjyqit, ose në Zyrën e Financës ballë dëftesës 100 fr.ari të cilat i kthehen në rastin qi të shihen të ligjshme pretendimet e tij, dhe në rastin qi të refuzohet kërkesa kanë me u regjistrue si t'ardhuna të Shtetit.

Kopja e vërtetueme e kërkesës i komunikohet prej Gjykatores ku asht dhanë ajo, anës tjetër e cila ka të drejtë mbrenda në shtat dit të paraqitë parashtresë gjegjëse.

Kur komunikimi asht ba nga Gjykatorja e banimit të kërkuesit kërkesa e përmirësimit tue përmbajtë edhe shënimin e kancelarit për depozitimin e shumës 100 fr.ari si dhe dëftesa e komunikimit dhe ajo e Financës në qoftë se depozitimi asht ba në Financë i dërgohet Gjykatores Diktimit.

Data e regjistrimit të kërkesës konsiderohet si datë e përmirësimit.

Kërkesat për përmirësim vendimi, shqyrtohen prej Këshillit të përgjithëshëm të Diktimit.

Këshilli i përgjithshëm, si në ketë rast ashtu dhe në gjithë rastet e tjerë formohet prej nandë vetë të dy Kryetarëvet të Diktimit ose Zavendësve të tyne, dhe shtatë anëtarëvet në konditën qi shumica të mos jetë nga ato qi kan dhanë vendimin e atakuem. Kryetari i Degës Civile asht dhe Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm.

Këshilli qi shqyrton kërkesën e përmirësimit nuk mund të kërkojë dhe këqyrë të tjera shkaqe jashtë atyne të caktueme në ketë ligjë për përmirësim.

Këshilli shqyrton çashtjen mbi akte dhe mbrenda nji muej ç' prej ditës së mbritjes së akteve n' atë gjyqë.

Në qoftë se Këshilli shkaqet e përmirësimit i shef t' arësyeshme vendosë përmirësimin e vendimit tanësisht, kur shkaqet kanë influencuem vetëm nji pjesë, përmirëson ketë pjesë.

Nuk mund të kërkohet ma tepër se nji herë përmirësim vendimi; gjithashtu nuk mund të kërkohet përmirësimi i vendimevet të Këshillit të Përgjithëshëm, por në rastë qi njena anë kërkon përmirësimin e nji vendimi të Diktimit, ana tjetër ka të drejtë si mbas rregullave të caktueme në nenin 220 të Procedurës Civile me kërkue edhe ajo përmirësimin.

Kërkesa për përmirësimin nuk ndalon eksekutimin e vendimit.

Për vendimet qi janë dhanë prej Degës Civile të Diktimit deri në ditën qi hynë në fuqi kjo ligjë, mund të kërkohet përmirësimi para Këshillit të Përgjithëshëm të Diktimit si mbas rregullave të tregueme në ketë ligjë, dhe për shkaqet e tregueme në nenin e abroguem 38 të ligjës mbi disa ndrime.

Dispozitat e këtij ligji aplikohen edhe për ato kërkesa Diktimore, ose përmirësimore qi nuk janë përfundue ende me vendim të Diktimit, deri në ditën qi hynë në fuqi kjo ligjë.

Ky ligjë hynë në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e këtij.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M E :

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 106 datë 2-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 6-VI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Nr. 85

INTERPRETIM, 1 Qershor 1927.

Mbi art. 5 të ligjës Moratoriumit

(e botuem në Fletoren Zyrtare, 15 Qershor 1927, Nr. 40)

Kryesija e Senatit, i ka dërgue së nderçhmes Kryesis së Këshillit Ministruer vendimin që vijon :

Kam nderin me i bam të njoftun asaj Së nderçhme Kryesi se, Dhomat Legjislative, pasi në bazim propozimin e qeveris për interpretimin e ligjes së Moratoriumit në fuqi, për sa i përket detyrimit të pagimeve të monedhës dhenimi në kartë, për të cilat disa vendime të Gjyqit Diktimit kishin shkaktue shumë hezitime në dy Dhomat në Sala, për këtë arsye për të e dakue e do mos kuptim, vendosnë interpretimin e art. 5 të ligjes së Moratoriumit me datë, 14-II-1922, në mënyrën e poshtë shenueme :

(Borxhet e shënueme në monedhën dhanimi kartë do të paguhen po në këtë monedhë tue mos u marrë parasysh cirkulacjoni me vleftë e saje kur i asht dhanë hua-marrësit).

Lutemi të kini mirësinë me i a komunikue Ministris së P. të Mbrendëshme interpretimin e naltpërmendun për me u vue në zbatim.

Me nderime të posaçhme

Tiranë, me 3-V-1927 *Kryetari i Senatit*
PANDELI EVANGJELI

KRYESIJA E REPUBLIKËS SHQIPTARE
Nr. 299/III

Ministria së P. të Mbrendshme

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e vendimeve të sipërme të Dhomave legjislative mbi interpretimin e nenit 5 të ligjit Moratoriumit me datë 14-II-1922 dhe urdhënojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 1-VI-1927. **A. ZOGU**

Nr. 86

LIGJE 7 Qershuer 1927.

Shtojcë nenit të Kodit të Procedurës Penale

(të botuame në Fletoren Zyrtare, 21 Qershor 1927, Nr. 44)

Art. 1. — Ç'do Gjykatë detyrohet me ndigjue dishmitarët dhe me plotësue letër-porosinat përkatëse të rekomandueme prej një gjykatoreje tjetër për ndigjimin e dishmitorëvet në ç'do çështje ndëshkimore.

Art. 2. — Kjo shtojcë neni hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. — Ministria e Drejtësis ngarkohet për zbatimin e kësaj Shtojce neni.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të Popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj shtojce nenit të Procedurës Penale i pranuem prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 88/III datë 1-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 7-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

BKSH

Nr. 87

DEKREL-LIGJË, 9 Qershuer 1927.

Mbi pranimin e konvencionit për koncesionin e minierave të bakrit etj. minerale qi gjinden në Pukë z. Marchese Gaetano di Sumi

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Qershor 1927, Nr. 50)

KONVENCJON

i bamë në mes të Qeveris Shqiptare e përfaqësueme prej Ministrit të P. Botore e Bulqësis që do të quhet tash e mbrapa «Qeverija» në njenën anë; e të z. Marchese Gaetano Di Sumi, ndenjës në Romë, i quejtun tash e mbrapa «Konçesjonar» në tjetrën anë;

Asht konvenue e vendue sa vashdon:

Objekti i këtij Konvencioni asht të dhanunit e koncesjonit të Minjereve të Remit (Bakrit) etj. minerale qi gjinden në Pukë Nën-prefekturën e Pukës (Prefektura e Shkodrës).

I.

Qeverija i jep Koncesjonarit Koncesjonin e Minjerës të Remit të Pukës për të nxjerrunit e shfrytëzimin e Remit etj. minerale. Koncesjoni ka me pasë nji afat 50 (pesdhetë) vjetësh si mbas art. 40 të ligjës në fuqi tue i dhanë koncesjonarit në mbarim të këtij afatit të drejtën e zgjatimit edhe për 30 (tredhet) vjet të tjera.

Zona e Koncesjonit shtrihet në nji sipërfaqe 9.000 (nandë mijë) hektarë si përshkruhet me planin e bashkangjitun në shkallë 1.25.000. Kufizimi i kësaj sypërfaqe asht si vazhdon:

Koncesjoni delimitohet mbas perimetrit poshtë shenuem:

Kisha e Kamanes të Drinit (Koto 80), në kotën 950, të kotës 950, në kotën 530, të kotës 530 në Pukë (Kota 820), të kotës 820 në Hadroj (kotës 622), të kotës 622, Maja e Arrsit (kotë 940), të kotës 940, në maja të Karmës (kota 1510), të kotës 1910 në të përshkruhem Mali i Krabit në Rosti përsypëri kotës (kotë 460) Cirok, të Rrojstit e me rrjedhjen e pronit Gomina e të Drinit, prej kësaj rrjedhje ulet për deri te Kisha e Komanes si rrëfen plani bashkalidhun në shkallën 1.25.000.

II.

Mbrenda pesë muejve që prej datës së ratifikimit të këtij

Konvencjoni, Konvencjonari detyrohet me formue nji kapital minimum 1,500.000 fr. ari.

Ky kapital ka më mujtë me u shtue po qe se e lypë nevoja e kësaj sipërmarrje.

Prej kapitalit n'akcione, 40 % kan me ju rezervën për dy muej rresht, nënshtetasve shqiptarë për nënshkrim.

Afati i këtyne dy muejve fillon që prëj datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare që koncesjonari do bajë ku do të njoftojë formimin e shoqënisë dhe hapjen për nënshkrimin e akcjoneve, Akcjonet e rezervueme për nënshkrim nënshtetasve shqiptarë, qi mbeten pa u nënshkrue mbrenda këtyne dy muejve kan për të mbetë në dispozicjon të Koncesjonarit i cili do t'i nënshkrujë.

III.

Koncesjonari detyrohet me fillue mbrenda tre muejve mbas formimit të Shoqënisë kërkimin e Remit (bakrit) e të tjera minerale. Mbas kësaj perjudhë kërkimit, nisë perjudha e shfrytzimit.

IV.

Koncesjonari detyrohet:

a) Mos me ba dame ndër tokat e përshieme në zonën e koncesjonit për pa pasë marrë përpara pëlqimin e pronarve, e veç kësaj mos me ba gërmime në nji reze 50 (pesëdhetë) metrash prej shpijavet të banimit, edhe me ba ç' të jetë e mundun për me ndalue ç' do dam që mund t' i rrjedhin bimëvet, nënshtetasvet ose pemve të frytshme.

b) Mos me ba kurfarë punimit në nji reze 64 (gjashtëdhet e kater) metrash prej pusavet t' ujit të piëshëm e me ba të gjitha mundimet për me ruejtë kronet, ujnat minerale e termale e vadat.

c) Mos me ba punime në qytete e katunde as në vende botnore si tregje kopshtije e lulishta në zotnim të nji ose ma shumë katundeve ashtu edhe ndër vorre, udhë hekuri e rruga botnore.

V.

Koncesjonari detyrohet me shpërblye ç'do dam qi mund t'i shkaktohet personave të treta në pronësiët e tyne nga ushtrimi i sipërmarrjes:

Në qoftë se koncesjonari nuk bjen në godi me personat e treta mbi çashtjen e shpërblimit për dam të shkaktuem, atëhere ka me u formue nji komisjon arbitrazhi i zgjedhun prej të dy

palvet. Në qoftë se këto nuk binë në marrëveshtje, do të zgjedhin bashkarisht nji sypër arbitër.

Vendimi i sipër-arbitërit ka me qenë definitiv. Në qoftë se komisjoni nuk bjen në godi mbi zgjedhjen e syper-arbitrit, atëherë ky ka me u emnue prej Gjykatores Kompetente Shqiptare.

Në rasë qi në kohën e veprimeve të shfrytëzimit ndonji tokë mund të damtohet aq sa mos me mujtë me u mjellë për nji vjetë, pronari i kësaj toke ka me pasë të drejtë me kërkue ekspropriacionin e sajë si mbas ligjeve në fuqi.

Në ç'do rasë për pagimin e ç' do damit ose të nji tokës s'eksproprijueme, do të merret para syshë vetëm vleftja ordinare e tokës tue mos vrejtun kurfarë konsideracjonet qi mund të rrjedhin nga ky konvencjon.

VI.

Koncesjonari detyrohet në mbarim të ç'do tre mujorit me i paraqitë Qeveris raporta ekzakte me hollësiëna mbi të gjitha punimet bashkë me të gjitha planet e përkatëshme. Veç kësaj Koncesjonari detyrohet me i paraqit Qeveris kryevjetit relacjonin e bilancin vjetuer të kësaj sipërmarrje.

VII.

Koncesjonari detyrohet me i pague Qeveris nji qira toke fikse vjetore fr. ari 2 (dy) për hektarë në vjetë, për të gjith zonën e marrun në konvencjon. Kjo taksë do të paguhet në fillim të ç'do vjetës përpara.

Për dy vjetët e para kjo qira do të paguhet përpara (en avance) e këtë mbrenda nji muejit çë prej ditës së ratifikimit të kësaj kontratë.

VIII.

Për landën minerale të bakrit e tjera qi nxirren nga minjera Koncesjonari detyrohet me i pague Qeveris në të holla nji redenvencë prej 5% (pesë për qind) mbi produktin, të larë, të spastruar, dhe të pregaditun në gjendje për t' u tretë tue zbritë vetëm shpënzimet e bartjes nga skela Shqiptare në vendin e shitjes. Kjo redevencë ka me u pague tri mujorisht dhe në bazë të çmimit të mesëm.

IX.

Koncesjonari detyrohet me ba të gjitha shka të jetë e mundur për shfrytzimin sa ma mirë të minjerës së bakrit, tue përdorur sasinë e puntorëve dhe specialistëve të nevojshmë për nji shfrytzim t' atillë.

Për sasin e mineralit qi ka me u nxjerrë prej minjerës në ditë ose në muaj, Konçesjonari detyrohet me ju shtrue të gjitha urdhnave të Këshillit të minjerave.

Konçesjonari nuk ka me muejtë kurë me kadalue ose me pezullue punimet përveç rastit të forcës majore e cila do të njihet juridikisht.

Në rasë qi Konçesjonari për nji kohë 4 (katër) muaj kadalon ose pezullon punimet si asht parapa mà naltë, ka për t' u gjobitë me 5,000 (pesë mijë) fr. ari. Në qoftë se mbrenda dy muejve mbas këtij afati konçesjonari nuk ka rishtifillue energjikisht punimet, Qeverija pa tjetër ka të drejtë me e prishë këtë konçesjon, përveç të rasteve së forcës majore.

X.

Qeverija detyrohet me i akordue konçesjonarit të gjitha lehtësinat qi janë në fuqi të sajë për me i sigurue përparimin e veprimeve të minjerës.

XI.

Konçesjonari detyrohet me depozitue nji shumë prej fr. ari **35.000** (tridhet e pesë mijë) si titull garancijet për mirëzbatimin e detyrimevet të marruna mbi vedi. Kjo shumë ka me u depozitue n' emën të Qeveris në Bankën Kombëtare mbrënda 15 (pesëmbëdhetë) ditëve çë prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare të këtij konvencjoni. Konvenohet bashkrisht se në kjoftë qi konçesjonari humbë konçesjonin nga shkaku se nuk i ka përmbushë detyrimet e marruna në këtë konvencjon, garancija e sipër përmendun bahet pranë Shtetit.

Qeverija detyrohet me lirue këtë garancië kur të konstatohet se minjera nuk mund të shfrytzohet tregtarisht. Kjo garancië mund të lirohet edhe kur se konçesjonari të ketë importue në Shqipni makina për nji vleftë dy fish sa shuma e marrun si garancië; d. m. th. nji vleftje prej 70.000 (shtatëdhet mij) fr. ari.

XII.

Në mbarimin e afatit të konçesjonit, konçesjonari detyrohet me i lëshue Qeveris Shqiptare, gratis e pa farë pretendimit të gjitha punimet e bame në Shqipni, si pusa, galerina, furra, ndërtime e instalacjonë, udhë hekurit me të gjithë materialin e lujtshëm (roulant) në nji fjalë të gjitha veprat e krijueme për këtë sipërmarrje.

XIII.

Konçesjonari me pëlqimin ma para të Qeveris mundet me

ndërtue e me ushtrue linjet telegrafike e telefonike, quais, rruge ura telegrafike, udhë të hekurta për transportimin e mineralit tue u nisë që prej zonës së minjerës edhe deri në skele eksportuese të Shën-Gjinit. Posë kësaj Konçesjonari ka të drejtë me ndërtue mbrenda zonës të konçesjonit, banime për puntorët e vet, zyra, depozita, magaze, e uzina, spitale e ç'do tjetër gja të nevojshme për mirëvajtjen e sipërmarrjes. Gjithë ashtu konçesjonari ka të drejtë me ngreh zyra, depozita, magaze, uzina, banim për puntorë e tjera ndërtesa të nevojshme për shfrytzimin e minjerës dhe jashta zonës së konçesjonit, d. m. th. në portën e Shën-Gjinit, në portën e Shkodrës e në të tjera vende qi konçesjonari t'a shofë të nevojshme. Tokat e nevojshme për këta qëllime në qofshin privatë kan me u eksproprijue me shpenzimet e konçesjonarit tue konsiderue si vepra për utilitet publik, në qofshin tokat Shtetnore kanë me ju lëshue prej Qeveris gratis e pa kurfarë ngarkimit. Konçesjonari detyrohet me lanë të lirë partitë e treta me kalue mbi këto zonat e tija, por me konditë qi të mos pengohen veprimet e shfrytzimit. Konçesjonari ka të drejtë me ba transportime me mjetet e tija edhe për persona e shoqënije private të tjera por për të tilla transportime tarifa ka me u caktue prej Konçesjonarit dhe e aprovueme prej Qeveris. Në bazë të kësaj tarife mbi t'ardhunat në to qi ka me pasë konçesjonari në transportimet e të tretavet, detyrohet me i pague Qeverija 10 % (dhet për qindë) për transportimin materjalesh Qeveritare kan me ju pague konçesjonarit vetëm gjysma e tarifës që ashtë caktuar për transportime private.

Funkcjonarët e nëpunsat e Qeveris kanë me pague vetëm gjysmën e tarifës.

XIV.

Qeverija i akordon konçesjonarit të drejtën me importue në Shqipni të lirë nga ç'do vergji taksë doganore, dhe tjera, taksa shtetnore ose municipale maritime ose teritorjale, sot në fuqi, edhe t'ardhme të gjitha maqinat, qerret, veglat, materjalet e hekur-udhës të nevojshme për transportimin e prodhimit të kësaj minjerë si edhe të gjitha gjanat e materjalet e nevojshme për ndreqjen, punimin, mirëmbajtjen edhe administratimin të shfrytëzimit qi ban objektin e këtij konçesjonit përveç gjanave të monopolizueme dhe të ndalueme për importim si dhe për veç gjanave t'ushqimit e të pijevet. Gjith ashtu konçesjonari përjashtohet edhe nga taksat mbi kapitalin e inventuem.

XV.

Konçesjonari përjashtohet nga taksa e eksportacjonit si edhe nga taksat e tjera të përmenduna n'art. e ma parëshmë të këtij konçesjoni për gjithë landët e para të nxjerruna prej minjerës dhe fabrikimet qi rrjedhin nga kjo landë.

XVI.

Nëpunësat e punëtorët e angazhuem prej konçesjonarit kanë me kenë nënështetas shqiptarë përveç teknikëve edhe specialistëve kur këta nuk gjinden në Shqipni. Konçesjonari detyrohet me u kujdesue për sigurimin e punëtorëve e të nëpunësave kundra rreziqeve të punës ashtu si ka për t'a vendue Qeverija, me ligjë të përgjithëshme. Konçesjonari detyrohet për sigurimin e mirëshëndetit të nëpunsave e të puntorëve shqiptarë, të mbaj mjekë të nevojshëm e të i apë barnat pa të holla.

XVII.

Konçesjonari detyrohet me i dhanë Qeveris në kjoftë se dëshiron deri në 10% (dhetë për qindë të prodhimeve qi nxjerrë nga minjëra landë të pa punueme ose të punueme me njçmim 10% (dhet për qindë) ma pakë se çmimi mesatar i tregjeí ve europjane.

XVIII.

Në rasë qi punimet e konçesjonarit pengohen nga shkaqet e forcës majore qi mund të ndodhin në zonën e konçesjonit periudha e afatit të parapame mbi ngjatjen e këtij konçesjoni ka me u zgjatue për aqë sa ngjatë rasa e forcës majeure. Në rastë të nji kundërshtimit mbi njohjen e racës së forçës majeure, çashtja ka me ju referue nji arbitrazhit si asht parapa n' Art 23 të këtij konvencjonit.

XIX.

Konçesjonari detyrohet me ju shtrue të gjitha ligjëve të tashme e t'ardhëshme të Shqipnis deri sa këta mos të jenë në kundrështim me dispozitat e përmbajtuna në këtë konvencjon.

XX.

Ç' farëdo informatit të parapamë prej këtij konvencjoni që Qeverija ka me i kërkue konçesjonarit ky do t' a japi me shkresë ose me kablogram tue ja adresuë Ministris së P. Botore e Bujqësis. Të gjitha informatat e dhanuna në shkresë, konsiderohen të marruna 3 (tri) ditë dhe ato me kablogram 48 (katërdhetetetë) orë mbas datës t' arritjes në destinacjon.

XXI.

Ç' do send artistik e antikitet gjetun prej konçesjonarit n'ushtrimin e punimeve të tija ka me ju dorëzue Qeveris Shqiptare gratis.

XXII.

Konçesjonari ka me i lëshue të gjitha të drejtat e detyrimet e fitueme e të marruna me këtë konvencjon. Shoqënis Anonime qi di do të formohet për këtë qëllim si u përmend n' Art. 2 të këtij konvencjoni. Shoqënija nuk ka me mujtë për kurfarë arësyet me ja lëshue këtë konçesjon nji personës ose Shoqënis së tretë pa pasë marrë përpara pëlqimin e Qeveris.

XXIII.

Në rasë' të nji mos marrëveshtjes ndërmjet të Qeveris e të konçesjonarit mbi interpretimin e të drejtave e të detyrimeve të dy palëvet kontraktuese qi rrjedhin prej dispozitave të këtij konvencjoni çashtja do t' i referohet kolegjit arbitral i formuem prej tre anëtarëvet prej të cilëve njeni ka me u emnue prej Qeveris, tjetri prej konçesjonarit e i treti ka me u zgjedhë në marrëveshtje të përbashkët prej dy arbitrave të parë.

Në qoftë se të dy arbitrat e par nuk bijnë në godi mbi emnimin e arbitrit të tretë ka me u formue nji arbitrazh prej 5 (pesë) arbitrash prëj të cillëve dy kanë me u emnue prej katër të parëve. Në qoftë se edhe këta katër arbitra nuk binë në godi mbi zgjedhjen e arbitrit të pestë, atëhere çashtja ka me ju shtru Gjyqit të Diktimit Shqiptar.

XXIV.

Në qoftë se vërtetohet se konçesjonari nuk ka përmbushun detyrimet qi ka marrë në kët konvencjon, Qeverija ka të drejtë me anullue konçesionin pa kurfarë detyrim shpërblimit.

XXV.

Ky konvencjon ashtë ba në dy origjinale: Shqip e Frengjisht. Në çdo rasë kundërshtimi mbi interpretimin e konditave teksti Frengjisht ka me pasë vleftë.

XXVI.

Ky konvencjon ka me u qujtun i vlefshëm mbasi t' aprovohet prej të dy Dhomave Legjislative edhe të shpallet në Fletoren Zyrtarë.

Tiranë, me . . . .

Ministri i P. Botore e Bulqësiës *Konçesjonari*

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e këtij konvencjoni dhe urdhnojmë zbatimin e tij.

Tiranë, me 9-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 88

RREGULLORE, 22 Qershuer 1927.

Mbi detyrat e inspektorave të Përgjithshëm

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 27 Qershuer 1927, Nr. 52)

Pjesa e I-rë

PARATHANJE:

Art. 1. — Inspektorët e përgjithëshëm si mbas ligjes, me dt. 7-VI-1927 ushtrojnë detyrën e kontrollimit dhe inspektimet mbi gjithë administratën e Shtetit në mënyrën e spjegueme në ketë rregullore.

Art. 2. — Gjithë autoritetet detyrohen me dhanun lehtësinat dhe informatat qi shifen të nevojshme nga inspektorët.

Pjesa e II-të.

Mënyra e të kryemit të detyrës s' inspektorëvet:

Art. 3. — Inspektorët për hetime ose inspektime marrin urdhën nga Kryesija e Republikës, por këto mund të korespondojnë me ç' do autoritet për sa i përket detyrës inspektimore dhe hetimore, të cilët detyrohen me dhanun shpjegimet e kërkueme sa ma shpejt.

Art. 4. — Inspektorët nuk kanë të drejtë të pranojnë lutje, për veç mbi ato lutje qi u përkasin çeshtjevet ose nëpunsavet mbi të cilat janë tue vazhdue inspektimet dhe hetimet.

Art. 5. — Kur në rezultat të hetimeve ankimet ose lajmerimet e bamuna kundra nji nëpunësit dalin të rrena e çpifje,

raporti i inspektorit i njohtohet Ministries kompetente e cila me anë të Prokurories i'a referon Gjyqit për ndjekjen ligjore kundra çpifsit.

Pjesa e III-të.

Detyrat e Inspektorëve në degën e administratës :

Art. 6. – Kontrollojnë gjithë veprimet e Këshillave administrative dhe të Bashkive dhe ushtrimin e kompetencavet tyne tue i studjue se këto deri në ç' gradë janë dhanë mbrenda në kompetencën e tyne dhe të bazueme në ligjat përkatëse.

Art. 7. – Inspektorët kanë me kontrollue gjendjet e emigrandave, mënyrën e ndarjes së ndihmave, instalimin e këtyne, veprimet e zyrës s' emigrandave, ankimet e bamuna për damjen e tokave shtetnore e gjendjen e shëndetsis bashkë me nevojat e tyne.

Art. 8. – Inspektojnë detyrat administrative të Gjendarmeris e të Policis, vonimet e shkaktueme me zbatimin e urdhënave qeveritare të veprimeve gjyqsore.

Art. 9. – Inspektorët ngarkohen dhe me kontrollimin e spitaleve, të komisioneve rekrutimit, të veprimeve të Shtetit Civil, t' instituteve të Kryqit të Kuq, të shoqnive bamirëse të krijueme me lejë qeveritare.

Pjesa e IV.

Detyrat inspektimore financjare :

Art. 10. – Inspektorët e përgjithëshëm kanë të drejtën e inspektimit në gjitha zyrat financjare, të mvaruna n' atë Ministrin dhe t' instituteve të monopolizimit. Kontrollojnë degat, tregojnë nji kujdesi të madhe mbi inspektimin e masavet ndaluese për kontrabandë; çfaqjen në këto zyra kur t' a shofin të nevojshme ose kur të marrin informata për veprime doganore të jashta ligjshme të ç' do llojë.

Ushtrojnë gjithë kompetencat e inspektorve të financës si për kontrollimin e arkës ashtu dhe për verifikimin e regjistrave dhe të mënyrës së pagimit bashkë me të drejtat shtetnore të rrjedhuna nga t' ardhuna të ndryshme.

Pjesa e V.

Detyrat inspektimore mbi detyrat botore e bujqësie:

Art. 11. – Inspektorët e përgjithëshëm në punët botore ushtrojnë gjithë ato kompetenca të shenueme në artikujt e ma sipërme tue u kujdesue veçanërisht për t' ardhuna përkatëse dhe mënyrën e zbatimit të ligjëve për punët botore, me kontrollue diftesat e dhanuna nga nëpunsat kompetente për zhgarkim detyre dhe mënyrën e t' ardhunave të zyrës botore; ka me pasë nji mbikqyrje në plotësimin e statuteve anonime të krijueme me dekretimin e Kryesis Republikës dhe në plotsimin e kushteve të konçesjoneve. Veçanërisht gjithë sipërmarrjet shtetnore dhe financjare, janë nën kontrollimin absolut të ktyne.

Pjesa e VI.

Detyrat inspektimore në degën e drejtësis:

Art. 12. – Inspektorët kanë me kontrollue gjendjen e burgjeve, atë të rreshtuemve të dënuemve, sjelljen e nëpunësit të burgut kundrejtë këtyne gjendjes shëndetsore dhe ushqimore.

Tue mos ndërhye në veprat gjyqsore, studjojnë aktet per të cilat drejtohen ankime, kërkon shpjegime mbi vonimet e shikimit të gjyqevet.

Pjesa e VII.

Detyrat inspektimore në degën e arësimit:

Art. 13. – Inspektorët ushtrojnë gjithë kompetencat e inspektorëve t' arësimit tue kontrollue ndër internatat gjendjen shëndetsore e ushqimore të nxanësve, sjelljet dhe moralin e këtyne tue u përkujdesun për zhvillimin e arësimit kombëtar, dhe sigurimin e mirë-aplikimit të ligjeve arësimore tue marrë shenime mbi nevojat e ç' do shkolle nga ç' do gradë të jenë.

Pjesa e VIII.

Dispozita të përbashkta:

Art. 14. – Inspektorat kanë me kontrollue sjelljet dhe moralin e nëpunsave të qendrës dhe të qarqeve, vazhdimin në detyrë si mbas orarit të Këshillit Ministruer, dhe hetojnë mbi zotësin

e këtyne nëpunsave të ç' do shkallë e degë e të gjyqtarvet, sjellen e këtyne kundrejt popullit; kujdesjen qi duhen me tregue në msheftësien e vendimeve të raporteve rezervat zyrtare, në shpejtimin e të kryemes së detyrës, si për nëpunësat e qendrës ashtu edhe të qarqeve, ç' do sjellje ose pakujdesi të ç' do nëpunës në respektin e të kryemit të përmbajtjes të ndonjanit nga këta. Dispozitat me nji herë kanë me ju raportue Kryesies Republikës, nga e cila jepen urdhënat e nevojshme për veprim.

Art. 15. – Inspektori në vazhdim t' inspektimit ose të hetimeve mbi nji nevoje të domosdoshme mund të vendosë pezullimin nga puna ose gjobitjen dishiplinore të ç' do nëpunësit, i cili vendim për nëpunësat me rrogë deri në 300 fr.ari tue bazue në raportin t' inspektorit zbatohet nga sypërjorët e tyne me nji herë; për ata qi janë me nji rrogë 300 fr.ari e lartë, raportohen Kryesis Republikës e cila urdhënon Ministrien kompetente për veprim.

Art. 16. – Në rast t' inspektimit, inspektorët mund të kërkojnë specjalistat prej Ministris përkatëse, e cila asht e detyrueme me dhanun akordimin e duhun pa as nji vonesë.

Art. 17. – Aktet hetimore dhe inspektimore t' inspektorëvet kanë fuqinë ligjore për deri sa të mos provohet e kundërta. Këta mbasi të shofin formalitetet e caktueme në ligjen mbi gjykimin e nëpunsavet, i referohen gjykatores kompetente.

Art. 18. – Për studim inspektorët mund të kërkojnë akthetimet të nëpunsavet të mbajnë nga Kryetarët e Zyrave ose nga Këshilli administrative ose Bashkive dhe të pa përfundueme për të cilat mund të bajnë gjithë vërejtjet e nevojshme për vonesat dhe për pa kujdesit e tregueme për përfundimin e këtyne veprimeve.

Art. 19. – Për gjith adjudikatat me shtim ose me paksim e shpallun në fletoren ose për ata adjudikatat, sipërmarrje të ç' do zyrë ose degë qi kanë nji barrë financiare për arkën Shtetnore ose të Bashkis, inspektorët mund të kërkojnë spjegime nga zyrat përkatëse, ose mund të ndodhen pranë në komisjonet e ngarkueme me ketë detyrë, dhe veçanërisht kanë të drejtën e kontrollimit mbi gjithë kontratat e lidhuna për ndonji nga qëllimet e shenueme në § I të këtij artikullit.

Art. 20. – As nji Ministër, as nji zyrtarë nuk mund të ndalojë Inspektorët në të kryem të detyrave të shenueme në ketë ligjë.

Art. 21. – Gjitha Ministriet e Drejtoriet e Përgjithëshme detyrohen me u a njoftue Inspektorëvet kopjet e qarkoreve të ç' do lloji.

Art 22. – Inspektorët ndeshkohen si mbas art. VIII-të të ligjës mbi krijimin e Inspektorvet. Kryesija e Republikës gëzon absolutisht dhe pa asnji rezervë të drejtën e ç' emnimit t' Inspektorëvet.

Art. 23. – Hetimet kundra inspektorëvet të përgjithëshëm për shpërdorim detyrë, bahen nga ana e nji Zyrtari të naltë qi shenohet në dekretin e Kryesis së Republikës dhe aktet hetimore mbasi të marrin vendimin e Këshillit Ministruer, i referohen gjyqit kompetent.

Art. 24. – Inspektorët mbajnë nji sjellje serjoze kundrejt nëpunsave qi kanë nën kontrollim; ata ndalohen me banue me ta, me lidhë interesa me ta dhe me korespondue privatisht për çeshtje të tilla e sa ma tepër zyrtare.

Art. 25. – Inspektorët në nji libër të posaçëm e personal ku shenon veprimet e përditëshme, kopjen e së cilët i a paraqet Kryesis Republikës në fund të ç' do mueji.

Art. 26. – Kjo rregullore hynë në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 27. – Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e këtaj rregullorje.

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje të pranueme edhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, me 22-VI-1926

A. ZOGU

Nr. 89

DEKRET-LIGJË, 24 Qershuer 1927.

Mbi përjashtimin e pemëve nga e dheta e mbi mënyrën e shitjes së dhetave ndër vise ku nuk ndodhen regjistrime kadastrore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Qershuer 1927, Nr. 53)

Na, Kryetari i Republikes Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer, me datë 16-VI-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1 — E dhetëta e pemëvet, për veç asaj t'ullinit, të qitrave e të bletavet, nuk do të merret ma tue nisun prej këtij vjeti.

Kjo dispozitë, do t'inserohet në letër-adjudikatat mbi shitje të së dhetavet.

Art. 2. — Dispozitat e art. 1 aplikohen pikërisht edhe për të tretën e pemëve të pasunis së Shtetit.

Art. 3. — N'ato vise ku nuk gjinden regjistrime kadastrore për shkak se janë shdukun në kohëna të trazimeve e të luftave të ndodhuna në Shqipni, të dhetat e bimës e të prodhimeve tjera të pa përjashtueme, do të shiten me adjudikatë e tue u bazue edhe në dishmina të pleqsive në mënyrë qi diftohet n'art. 4, 5 e 6.

Art. 4. — Klientat, për me mund me blemë të dheta në bazë t'art 3, duhet t'i paraqisin Këshillave Administrative të vendit nji dishmij të vërtetueme nga pleqësije e lagjes ose e katundit ku zotnojnë pasunin e pa tundëshme si: tokë të livrueshme, ullishta, vëneshta, livadhe, kullota e ndërtesa qirajet në të cilën do të deklarohet edhe se klientat janë dorëvuës efektive vetë ose me pjestarë në to.

Këto pasuni do të jenë nga ajo kategori qi japin provime të përvjetëshme.

Art. 5. — Dishmija e pleqësive do të përshij:

a) Sasiën e dynymëve të pasunis,

b) Pjesëtarët e sajë qi nuk do të jenë ma se dy,

c) Kufit e tashëm,

3) Vleftën me të cilën do mund të shitet pasunia në rastë qi nuk paguhet çmimi i të dhetës.

Art. 6. — Vlefta aproksimative e pasunis qi do të caktoj pleqësia në dëshmië, do të vërtetohet ose të ndryshohet nga ana e Këshillit Administrativ si mbas hetimeve të veçanta e në bazë të kësaj vlefte do të shitet e dhetëta pa bamë ndonji shtim krediti mbi te.

Art. 7. — Anëtarët e Këshillit Administrativ qi nuk përkujdesen me zbulue të vërteten mbi përmbajtjen të dëshmive e me sigurue Arkën e Shtetit janë përgjegjës solidarisht me damshpërblim.

Art. 8. — Pleqsiët e lagjeve ose të katundeve qi dishmojnë kundër të vërtetës në dam të thesarit Shtetnuer dhe këjo konstatohet ma vonë mbas shitjes të të dhetave, dënohen me burgim nga 6 deri 18 në muej.

Veç kësaj Financa e vendit, sekuestron edhe pasuniët e tundëshme e të pa tundëshme të pleqsive e kërkon të shiten për me mblue damin qi i asht shkaktue Arkës.

Art. 9. — Dishmijtë e pleqsive të plotësueme si ma sipër e të vërtetueme nga ana e Këshillave Administrative, do të jene dublikatë. Njana nga këto i referohet zyrës së kadastrës e cila do të marrë shenim në nji regjistër të posaçëm mbi objektin e saj e nuk do bajë ndonji veprim mbi pasuniët kësodore pa qenë paguem plotësisht të drejtat e Shtetit për të cilat janë nën sekuestrim.

Art. 10. — Dishmijt e përmenduna n' art. 9 janë të vleftëshme sa nji regjistrim kadastruer e të respektueshme ndër gjykata.

Art. 11. — Nëpunësit e Financave qi nuk bajnë ndjekje ligjore për nxjerrje të të dhetave e të tretave në mbarim t' afatit të ç' do kisti, tue sekuestrue ma parë pasuniët e tundëshme të blesit si: drithë, bagti e gjana të tjera të vleftëshme në bazë të ligjës së të dhetave, dhe këjo konstatohet prej inspektimi a kontrollimi të Ministris së Financavet, pushohen nga detyra e nuk pranohen ma në shërbim financiar.

Art. 12. — Këjo ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 13. – Ministrija e Financavet, e Drejtësis dhe ajo e P. të Mbrendëshme, janë të detyrueme me zbatimin e kësaj ligjë.

Tiranë, me 24-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 90

DEKRET-LIGJË, 22 Qershuer 1927.

Mbi pensionimin e z. Halim Gostivarit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Qershor 1927, Nr. 53)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin datë 16-VI-1927 të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

I. – Tue marrë para sysh shërbimet qi ka bamë z. Halim Gostivari si nëpunës dhe vjetërsinë e tij në këtë profesion si edhe gjendjen e vështirë financjare e shëndetsore të tij për deri t' aprovohet ligji mbi pensionet e nënpunsave civile e deri sa qi pension i tij të rregullohet si mbas dispozitave t' ati ligji të përmendunit i nepet nji pension prej fr. ari 200 në muaj.

II. – Ky Dekret-ligjë hynë në fuqi qysh prej ditës së shpalljes.

III. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e këtij Dekret-ligji.

Tiranë, me 22-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 91

RREGULLORE, 26 Qershuer 1927.

Mbi mënyrën e mbledhjes së ndihmavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 2 Korrik 1927, Nr. 54)

Kaptinë e I-rë

Dispozita e përgjithëshme

Art. 1. — Ç' do ndihmë mund të mblidhet vetëm me dëshirë të plotë dhe asht e ndalueme mbledhja e ndihmavet me shtrëngim e forcë në ç' do mënyrë qoftë.

Art. 2. — Në vende të përgjithëshme dhe mbrenda ndëpër mjet e komunikacionevet të ndryshme mund të mblidhen ndihma me kutie ose me mënyra të tjera me lejën e parapëlqimin të nëpunësit ma të naltë t' administratës vetëm për ata shoqnina dhe instituta bamirëse formimi i të cilavet asht pranue edhe prej anës së Qeveris.

Mbledhja e ndihmës në mënyrën e sipër-dëftueme lejohet në këto ditë të shenueme.

a) Me 28 Nanduer.
b) Me 24 Dhetuer.
c) Me 21 Kallnuer.
ç) Me 31 Kallnuer.
d) Ditën e mot-motit të ri e ditët e bajrameve e të pashkëvet.

Art. 3. — Kutijat ku do të mblidhen ndihmat, do të jenë të vulosuna me vulën e Prefekturës a të Nënprekturës para se mblidhet ndihma ndër 'to dhe mbas mbledhjes së ndimës derį me 24 orë kanë me u çelë në ndodhjen e Prefektit, Nënprefektit ose të nji nëpunsit të deleguem prej tyne duke u mbajtun edhe nji proces verbal ku do të shenohen sasija e lloja e ndihmës së mbledhun ndër 'to. Ky Proces Verbal do të ruhet në arshivën e Prefekturës bashkë me aktet relative të tjera të përmenduna. n' art. 2.

Art. 4. — Pa qenë e bazueme në ligjë për ç' do qëllim e dobië qoftë asht e ndalueme marrja e të hollavet e mbledhja e teshavet në formë ndihme tue vue taksa e tatime personavet të teshavet.

Ar. 5. – Në ç' do mënyrë dhe për ç' do qëllim qoftë si kurse edhe në konformitet me këtë rregullore asht e ndalueme mbledhja e marrja e ndihmavet nga ana e nëpunsavet prej atyne qi u drejtohen për punë zyrtare.

Art. 6. Në mbledhjen e ndihmavet marrja pjesë e Policisë, Gjendarmeriës dhe tragrambledhësvet asht e ndalueme.

Art. 7. – Nëpunsit e Shtetit janë të ndaluem me marrë nën mbrojtjen e tyne mbledhjen e ç' do ndihme sikurse edhe në qofshin për dobië t' Arësimit ose për punëra të tjera mirëbaëse.

Art. 8. – Pa u mbledh plotësisht ndihma e caktuemë nuk mund të fillohet në punë për të cilën asht lejue mbledhja e ndihmës.

Art. 9. – Ndihmat e mbledhuna ndëpër konçertet, ballot të pregatituna zakonisht dhe me qëllim bamirsije nën mbrojtjen të trupit diplomatik nuk i shtrohen dispozitavet të kësaj rregullorje.

Art. 10. – Ata qi shpenzojnë prishin zotënojnë për dobinë dhe emnin e tyne të hollat, teshat e mbledhuna ose pasunit e patundshme të dhurueme si ndihmë për shërbime të përgjithëshme, lokale e bashkijake, konsiderohen sikurse kanë vjedhë, prishë e zotënue pasuniën e Shtetit, dhe shofin gjith ata ndeshkime të caktumuna në Kodin Penal për faje kësodore.

Kaptinë e II-të

Autoriteti kompetent mbi caktimin e nevojës. sasiës dhe mënyrës së mbledhjes të ndihmave

Art. 11. – Kur popullsia e nji vendi çfaq dëshirë me shkrim mbi dhanien e ndihmave për me krye ose me lehtësue nji vepër qi asht nga shërbimet e përgjithëshme të Shtetit, pikë së pari çashtja vendoset prej Këshillit t' administratës së vendit. N' atë vendim caktohet shuma e shpenzimevet qi lypset të bahet dhe shuma e ndihmës qi ka me u mbledhë vendimi në fjalë i parashtrohet Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe kjo të pranuem ose të refuzuem, ia kthen Prefekturës dërguëse. Vendimet e dhanuna prej Këshillavet të Nënprefekturavet, para se t'i parashtrohen Ministris shqyrtohen edhe prej Këshillavet Administrative të Prefekturavet ku mvaren.

Art. 12. – Kur ndihma i takon nji sherbimit Bashkiak atëherë

ma parë duhet të vendosi Këshilla e Bashkis e mandej ata t' administratës. Para se të komunikohet pëlqimi i Ministris së P. të Mbrendëshme nuk mundet me fillue mbledhja e ndihmavet.

Art. 13. – Për mbledhjen e ndihmavet qi nuk do të shpenzohen për shërbime të përgjithëshme, lokale, bashkijake ose qi nuk kanë të bajnë me shërbimet e institutevet dhe shoqëninave mirëbaëse të cilat janë të formueme me nji statut të vërtetuem prej Qeveris dhe qi kanë për qëllim vetëm dobinë e përgjithëshme kërkohet leja tue i dhanë nji lutje nëpunësit ma të naltë t' aministratës të vendit ku do të mblidhet ndihma. Në lutjet duhet të shënohen këto pika:

a) Lloja e sasija e ndihmës qi ka me u mbledhë.

b) sa kohë ka me vazhdue ndihma;

c) ku e prej kuj ajo ka me u mbledhë.

ç) për ç' qëllime ka me u shpenzue.

d) shuma e shpenzimevet qi duhet për mbledhjen e ndihmës.

dh) Emni e mbi emni e vend-banimi i lutësvet.

Në qoftë se inisiativa e marrun për mbledhjen e ndihmës asht për nevojë shkollore e dobie të tyne, lutjes lypset t' i ngjitet edhe nji dëshmië e nënshkrueme prej Drejtorit të Shkollës ku të çfaqet nevaja e ndihmës dhe pëlqimi i veprës. Në qoftë se ndihma qi do të mblidhet nuk do të jetë në të holla por në plaçka, në lutjet duhet të jetë e shenueme lloja e sasija e tyne.

Art. 14. – Prefekti e Nënprefekti mbi lutjen e dhanun ep leje për mbledhjen e ndihmës në qoftë se ndihma asht e nevojshme të mblidhet e se për mbledhjen e sajë Policija e ku nuk ka Gjindarmerija nuk çfaqin ndonji pengim tue u bazue në hetime të bame.

Art. 15. – S' epet leje për mbledhjen e ndihmavet qi shpenzimet e mbledhjes kapërcejnë 20%-tën të shumave të përgjithëshme të tyne.

Art. 16. – Heqja e pjankos qi shpërblimin e ka në të holla mund të lejohet mbasi të kryhen veprimet e tregueme n' artikujt 11, 12, 13, 14 të kësaj rregulloreje, dhe si të vendoset prej Këshillit Ministruer me dekretin e Kryesis Republikës.

Art. 17. – Mbasi të nepet leja nga Ministrija e P. të Mbrendëshme për mbledhjen e ndihmës qi do të shpenzohet

për shërbime të përgjithëshme lokale e bashkijake zgjidhet nji komision i përbamun prej tre e deri në pesë vetë prej atyne qi kanë nënshkrue për mbledhjen e ndihmës, të cilët regjistrohen në nji libër të pasaçëm emnat e personave të ç' do lagjeje e katundi qi dëshirojnë me dhanë ndihmë, tue shenue kundrejt emnave të tyne llojën e sasiën e ndihmës qi dishron me dhanë se i cili. Mbasi të kryhet vepra e regjistrimit, komisjoni në fjalë e ka për barrë edhe me ju marrë nënshkrimet po n' atë regjistër dishiruesvet qi marrin për sipër dhurimin e ndihmës.

Art. 18. — Regjistrat e tregueme n' art. 17, i mbledh zyra qi ka me mbështjellë ndihmën, e cila pregatit nji regjistër të përgjithëshëm, tue shenue n' ato emnat e personat qi kanë marrë përsipër dhanjen e ndihmës bashkë me shumën e ndihmës. Ky regjistër vërtetohet në fund prej Këshillit t' administratës ose të Bashkies.

Art. 19. — Ndihmat e regjistrueme në regjistrin e treguem n' art. 18 dorzohen në kohën qi lypsen kundrejt nji dëftesës të vulosun me vulë zyrtare, dhe nji pjesë e sajë rrin në regjistrin e dëftesavet me brima qi asht pregatitë apostafat për ketë qëllim. Mbas dorëzimit të dëftesës i epet shenim edhe në rregjistrin e përgjithëshëm kundrejt emnit të përsonit qi ka dorëzue ndihmën e i asht dhanë dëftesa. Në qoftë se dísa nuk e plotësojnë premtimin e bamun, dhe kështu nuk plotësohet shuma e parapame e ndihmës, këjo bashkë me shkaqet shenohet në fund të rregjistrit prej Këshillit administrativ e Bashkijak, n' asht se ndihma mblidhet për nevojat e sajë.

Art. 20. — Ndihmat e mbledhuna si për nevoja të përgjithëshme e lokale, ashtu edhe për nevoja Bashkijake dorëzohen si depozita ndëpër arkat e Bashkievet dhe nuk munden me u prishë kursesi për qëllim tjetër për veç atij qi janë mbledhë e në bazë të dokumentavet justifikuese.

Art. 21. — Gazetat mund të mbledhin ndihma për vepra bamirësije e me lejen e nënpunsavet administrativ me shkallë ma të naltë ku botohet gazeta. Në nji rast të këtillë në gazetat shenohet emni i atij qi ka dhanë ndihmën e sasija e dhanun. Kur të marri fund mbledhja e ndihmës shuma e mbështjellun kundrejt nji dëftesë i dorëzohet personit reel ose personit moral për të cilin asht ba ndihma dhe kopja e sajë çpallet në gazét e tue ju rrëfye ma parë edhe nëpunësit administrativ lejues.

Në shkallë ma të naltë të vendit ku mblidhet ndihma si mbas randësis së veprës, ka të drejtë të çojë për kontrollim nji a ma shumë nëpunsa.

Art. 22. — Nëpunësit e sipër thanun në fund të kontrollimit të llogarivet mbajnë nji proces-verbal së bashku me inisiatorët dhe i a parashtrojnë tokë me aktet nëpunsit administrativ lejues. Me këto akte vërtetohet se ndihma asht marrë në dorëzim prej personit reel ose prej personit moral për të cilin asht mbledhë.

Art. 23. — Mbledhja e ndihmës prej institutevet bamirëse si për shembull prej atij të Kryqit të Kuq asht e lejueme absolutisht por gjithënji duhet me qenë me dëftesa të rregullta dhe me dëshirë të dhuruesavet.

Art. 24. — Personat reel, moral dhe institutet private bamirëse e fetare a të tjerë qi mund të mbledhin ndihma në bazë t' art. 13 të kësaj rregulloreje, duhet t' a kryejnë veprën e mbështjelljes së ndihmës, vetëm duke shpërnda bileta të shtypuna dublikatë me brima. Në rastin e mbledhjes së teshavet në naturë i dorëzohet dhuruesit dëftesë ku do të jetë shenue lloja e plaçkës si dhe çmim' i sajë i treguem prej dhuruesit. Biletat duhet të jenë baras me shumën e ndihmës qi do të mblidhet e do të jenë të ndamuna me klasa. Biletat do të kenë edhe çmimin e vërtetë si vetë ashtu edhe në pjesën dublikatë qi mbetet si dokumentë. Biletat para se të fillohen me u shpërnda numrohen prej Bashkis së vendit, o ku nuk ka Bashkië prej Këshillit administrativ e vulosun me vulën e kētyne Këshillave. Si për biletat dhe pjesa dublikate e tyne qi mbetet si dokumentë si të kryhet vepra e numrit e të mbarimit. mbahet nji proces-verbal ku shenohet sasija e biletavet dhe e çmimit të së cilit prej tyne. Mbasi të marri fund mbledhja e ndihmës shenohen në procesin e mbajtun ma parë biletat e shpenzueme e të pa shpenzueme e në fund të tij mbasi bahet edhe vërtetimi nga Këshilli i Bashkis a i Nënprefekturës, proces-verbali i dorëzohet nëpunësit administrativ qi ka dhanë lejën bashkë me dokumentat justifikuese ku dallohen edhe shpenzimet e bamuna për me i dhanë në vendin e caktuem për të cilin asht mbledhë ndihma.

Art. 25. — Asht e ndalueme marrja e të hollavet ma tepër se asht shenuem në biletat.

Art. 26. — Tue qenë se nëpunsi administrativ lejues asht përgjegjës për veprimet e numrueme n' artikujt 22, 24 të kësaj

rregullorje e për ç' do shpërdorim të ndodhun në mbledhjen e ndihmavet detyrohet me marrë ç' do masë për me i pre hovin këtyne.

Kaptinë e III-të.

Pjesa ndeshkimore

Art. 27. – Nëpunsit qi veprojnë kundra dispozitavet të kësaj rregulloreje ose caktojnë, lypin e mbledhin ndihma jasht metodevet e rregullavet të caktueme këtu, pushohen me nji herë nga puna dhe në qoftë se vepra e tyne si mbas ligjës formon faj, bahen edhe veçanërisht ndjekjet e duhuna ligjore kundra tyne.

Art. 28. – Ata qi fillojnë me mbledhë ndihma pa marrë leje zyrtare si mbas kësaj rregulloreje ose mbas marrjes së lejes zyrtare guxojnë me mbledhë ndihma pa dëshirë e jashtë premtimit të bamun, ndalohen me nji herë nga ana e Policis dhe ku s' ka policë prej Gjindarmeris e i dorëzohen Gjyqit.

Art. 29. – Kjo rregullore hyn në fuqië prej datës së shpalljes në gazetën zyrtare.

Art. 30. – Me zbatimin e kësaj rregulloreja ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendshme e Ministrija e Drejtësis.

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje të pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, me 26-VI-1927

A. ZOGU

Nr. 92

. . . .

Ligja e buxhetit 1927-1928

(e botueme në Fletoren Zyrtare 6 Korrik 1927 Nr. 56)

Art. 1. — T' ardhunat e përgjithshme qi parashifen se do të mblidhen n' arkë të Shtetit nga kompetenca e ushtrimit financjar prej 1 Prill 1927 deri me 31 Marc 1928, kapin shumën e fr. ari 30.879.800 (tridhetmiljon tetëqind e shtatëdhetë e nandëmij e tetëqind).

Art, 2. — Të dalunat (shpenzime të përgjithëshme të Shtetit) për kompetencën e ushtrimit 1927-28 parashifet se dc të kapin shumën e fr. ari 30.838.139 (tridhetmiljon tëtëqindetridhetetetëmij e njiqindetridhetenandë).

Art. 3. — T' ardhunat e vërtetueme të mbetuna pa u nxjerrë nga ushtrimet financjare të vjetve të kalueme deri me 31-III-1927 do të riservohen vetëm për përballimin e të mbetunave pasive të vjetve në fjalë. Mbasi të rregullohen të mbetunat pasive, teprica e t' ardhunave do të përdoret për shpenzimeve t' ushtrimit 1927-28. Pagesa e të mbetunave pasive rregullohet si mbas ligjëve në fuqi.

Art. 4. — Nxjerrjet e t' ardhunavet, të tatimevet e të tagrevet të shenjueme në budgetin e të hymevet t' ushtrimit financjar 1927 - 1928 si edhe të nxierrunit e të drejtavet shtetnore të mbrapambetuna të vjetve të kaluem bahen si mbas ligjëve në fuqi.

Art. 5. — Nuk mund të shtohet as mund te nxjerret ndonji e ardhun e Arkës së Shtetit pa qenë e bazueme në ligjë, gjith' ashtu nuk mund të bahet ndonji përjashtim në të drejtat e Arkës së Shtetit, pa qenë ky i bazuem në ligjë.

Art. 6. — Zyrat e ndryshme t' Administratavet Qeveritare nuk mund të përdorojnë asnjë t' ardhun prej çdo burimi qi të jetë, por do të ja dorëzojnë regullisht arkavet financjare.

Art. 7. — Veç rasavet të parapame në Statut (Art. 42 pikë e tretë), nuk mund të shtohen në kurrnji mënyrë kreditat e caktueme në këtë budget për shpenzimet e administratavet të ndryshme të Shtetit as nuk mund të çelen kredita të reja pa qenë të bazueme në ndonjë ligjë

Art. 8. — Kreditat e parapame për shpenximet e ushtrimit financjar 1927-28 kanë vleftë vetëm për pagesat e këtij ushtrimit.

Në qoftë se mbrenda vjetit financjar 1927-1928 (1-IV-1927-31-III-1928) kreditat e këtij budgeti nuk janë shpenxue e pengue, teprica e lirë e tyne nuk mund të përdoret për asnji qëllim por shkon n' ekonomi.

Art. 9. — Krediti i lejuem për shpenzime të nji degës admistratë Shtetnore nuk mund të mbartet në nji degë tjetër po nuk kje marrë për këtë nji autorizim ligjuer.

Mbartjet e kreditave nga nji artikull n' artikuj të tjerë, të nji kapitulli bahen prej Ministrit kompetent në marrveshtje me Ministrin e Financavet e me Këshilllin Kontrollues. Për pengime të marruna mbi kredita, bartjet mund të bahen mbrenda vjetit 1927-28. Për Dhomat Legjislative veprohet si mas ligjës me 15-XII-1926.

Art. 10. — Për posë mësuesve askush nnk mund të marrin dy rroga për dy nëpunësina të ndryshme. Rroga e zavendësis i paguhet zavendsave të ngarkuem rregullisht me këtë detyrë, nga fondi i rrogës së të zavendsuemit, në qoftë se nëpunësija asht e zbrazët (vakante).

Art. 11. — Ç' do degë admistratore asht e detyrueme të respektojë kuadrin e nëpunësive pa pasë të drejtë të shtoje sasinë e nëpunsave tue përfituem nga kreditat e parapame në budget.

Art. 12. — Fondi reservë po të përdoret vetëm për përballimin e atyne shpenzimeve të pa parapame në budget të ndryshme. Për shpenzimet qi do të bahet nga ky fond duhet të jetë marrë ma parë pëlqimi i Këshillit Ministruer. Shpenzimet këso dore i mveshen budgetit te degës së cilës i përkasin tue u hapun në këtë nji heri të kapi ullin fond reserve.

Art. 13. — Përvec ligjës me datë 15-XII-26, mbi mënyrën e transferimit të kreditavet në budgetet e Dhomave Legjislative, e të ligjes mbi rregullimin e pagesës të mbrapambetuna, ç' do ligjë tjetër në kundërshtim me këtë mbetet pa fuqi.

Art. 14. — Kjo ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes.

Art. 15. — Ministrija é Financavet asht e ngarkueme me zbatimin o kësajë ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare i mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DËKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësajë ligjë të votueme prej Dhomamave legjislative.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Përmbledhje e të parapamevet
për ushtrimin financjar 1927-1928

	Të hyme e shpenzime efektive	Shndrim kryegjanash	Shuma e përgjith. e të hymevet e shpenz. reale
Të hyme	30.879.800	– –	30.879.800
Shpenzime	25.201.289	+ 5.636.850	30.838.139
Diferenca	+ 5.678.511	– 5.636.850	+ 41.661

KRYESIJA E REPUBLIKËS SHQIPTARE
Nr. 82/37 Tiranë, me 16-VI-1927

Ministris së Financavet
Tiranë

Na Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin e budgetit t' ushtrimit financiar 1927-1928 të votuem prej Dhomave Legjislative me modifikimet e poshtëshënueme si mbas shkresës edhe të Kryesis së Senatit.

A.

Shuma e përgjithëshme e t' ardhunave si mbas ligjit të buxhetit të nalt-përmendun, të paraqitun prej Qeveris,

arrinte nji shumë prej fr. ari 26.000.000 (njizetegjashtë milion). Kësaj gjendjes të parapame e të hymeve për ushtrimin financjar prej 1-IV-1927 deri 31-III-1928, prej Dhomavet Legjislative d'akord me Qeverinë janë bërë këto ndryshime:

1) Në Kap. 5. t'ardhuna prej tokave të pajtueme për shfrytëzime minerale e të tjera, ishin parapa ma parë prej Qeverisë nji sasi prej fr. ari 400.000. Mbasi në vjetin e kaluem parashikohesh nji sasi prej 835.370 fr. ari, u kërkuan shpjegime prej Qeverisë, dhe si mbas përfundimit të llogarive të tregueme nga Ministrija kompetente u vërtetua se kjo diferencë nuk rrithte nga nji mos-përmbushje t'ardhuna por drejt për drejt nga nji matje llogarije jo aqë të drejtë. Kurse 400.000 fr. ari të kërkueme prej këtij artikulli në vënd qi të hynin n'Arkën e Financavet, u pa se ishin depozitue drejt për së drejti në Bankën Kombëtare nga Ministrija e P. Botore për llogaritë e sajë.

Me qenë se t'ardhunat në fjalë janë prej shfrytëzimevet të pyjeve dhe të minjereve, për këtë shkak duhesh me doemos të futeshin në buxhetin e Shtetit, dhe kësodoret Dhomat Legjislative bashkë me Ministrin e Financavet e shtuanë shumën e parapame e cila arrinë në fr. ari 800.000.

Gjith ashtu këtij kapitulli i janë shtuar edhe fr. ari 50.000 nga garancia e lanun prej Konçesjonarit të Minejerës së bakrit të Pukës, që tue u anullue kontrata me mos mbushjen e obligatave të marruna prej Koncesjonarit, garancija e përmendun u shtue si e ardhun Shteti.

Pra, kapitulli (5) arrinë deri në 850.000 fr. ari (tetëqindë e pesëdhetë mij) fr. ari.

2) Në Kap. (8) t'ardhunat prej të dhetës mbi drithna e pemë, duhan, ullinj, e zhuk, ishin parapa prej Qeverisë në nji sasi prej fr. ari 4.000.000, gja e cilla ishte ma pakë 740.800 fr. ari nga buxheti i vjetit të kaluem. Nga shpijegimet që u dhanë në rastin e bisedimit të buxhetit mbi diferencën në fjalë u kuptue se nga viti i kaluem shumë dhetarë, mbasi kanë pa larë bedelët e iltizamevet, dhë misrin e kanë të pa shitun, Ministrija e Financavet. ka parashikue se nuk kanë me dhanë shtesa për të dhetat e këtij vjeti, e kjo e metë mbas mendimit të Mintstris së Financavet kishte shkaktue zbritjen e paradiftueme.

Dhomat Legjislative, tue marrë para sysh se vjetin e kaluem të dhjetat përgjithësisht nuk janë shitur me çmim shumë të naltë dhe myltezimet me qëllim spekulacjoni kanë mbajtur

misrin për me e shitë me nji çmim shum të naltë nga shkalla që duhet të fitojnë nuk e gjetën të vendëshme arësyen e Ministris së Financavet, aq ma shumë për këtë vjet që të lashtat janë fare mirë e veçanërisht ullijtë edhe zhukat që janë mbrenda në këtë kaptinë, si mbas gjendjes së sotme, napin shpresa të sigurta për shtimin e t' ardhunavet.

Burime të cilat në vjetin e kaluem, si dihet fare mirë kanë qenë me nji gradë krejt të metash pra këto mendime dhe arësyena mbasi u gjetën të përshtatuna në gjendjen e parashikueme tue qenë bashkarisht në përfundimin e diskutimeve edhe Ministri kompetent, kapitullin në fjalë me nji shtesë 740.000 fr. ari u pranue katër milion e shtatëqind e dyzet mij e tetëqind (4.740.800) si në vjetin e kaluem.

3) Në Kap. 9. «Tatime xhelepi mbi berra e thi» ishte paraqitun ma parë prej Qeveris në nji sasi 1.950.500 por mbasi vërtetimet e numrimit përfunduan me nji shumë paksimi 85.500 fr. ari, u vendos tregimi i tij 1.865.000 fr. ari. Me qenë se si mbas ligjës së re e pranueme për xhelepin e gjasë së gjallë parashifet për këtë vjet nji shumë prej fr. ari 600.000. Për këto arësye kapitulli në fjalë ndahet në dy kapituj. Kap. i I, përmbanë shumën e nalt-përmendun, d. m. th. 1.865.000 dhe Kap. i II, shumën e nalt-përmendun prej fr. ari 600.000 qi kështu kapitulli në fjalë arrinë deri në 2.465.000 fr. ari.

4) Kap. (10) që ishte mbi tatimin progresiv mbi t' ardhunat e fitimet e tjera, ka qenë tregue ma parë prej Qeverisë në sasin e 150.000 fr. ari.

Mbasi detyrimet personale për punim rrugash në ligjën e re të votueme u caktue përgjithësisht për të mbledhun në të holla në bazë të llogarivet e të shpjegimevet që dha Ministri kompetent, u zbritnë 80.000 fr. ari dhe u lanë të parapame 70.000 fr. ari.

Sa për taksa personale rrugesh si mbas ligjit të ri të përmendun. dhe në numrin e nënshtetasve të detyruem sa do qi duhet me përfshi nji shumë 2.400.000 fr. ari por Dhomat Legjislative tue marrë para syshë se në disa vise munden të jenë krye pjesërisht dhe mundet të ngelin të prapambetuna preferoj parashikimin e nji fondi vetëm 1.500.000 fr. ari.

5) Kapitulli (14) taksa mbi akte të Shtetit qytetuer, e të gjykatave të rendshme sa do që parashifesh ma parë prej Qeverisë 374.500 fr. ari me nji të metë 41.000 (dyzetenjimij) fr.ari

nga vjeti i kaluem, por në bazë të shpjegimeve qi u muerën dhe llogarive qi u dhanë prej autoritetit kompetent, dhe tue marrë para sysh çeljen e disa gjykatave të reja, u vendos prej Dhomavet Legjislative qi shuma në fjalë të caktohet deri në 400.000 fr. ari.

6) Kap. (18) Bandrollim duhani ishte parapa prej Qeverisë 1.000.000 fr. ari.

Dhomat Legjislative tue marrë para sysh se ky tatim vjetin e kaluem ashtë vënë në veprim tepër vonë dhe për të parën herë në Shqipni, shumë veta qi pijnë duhanin para se vihesh kjo taksë nuk ka dyshim qi të kenë pasur në dispozicion privat nji sasi duhani e pakëta për nevojat në fjalë, të cilat këtë vit mbasi janë të detyrueme me blemun të taksuem, ky kapitull parashikohet prej nji shtese 300.000 fr. ari dhe kështu shuma e përgjithshme arrin deri në fr. ari 1.300.000.

7) Kapitulli (19) Tatime konsumi mbi kafe, sheqer, vojguri, benzinë ishin parashikue prej Qeverisë në 791.000 fr. ari, në bazë të vërtetimit të hymeve n'arkën e Shtetit në vitin e kaluem.

Në studimet që u banë ma vonë në rastin e bisedimit, dhe si mbas shpjegimeve që dhanë nëpunsit kompetentë se taksa ka qenë, benzin e vojguri, janë vënë mbasi kish fillue vjeti i kaluem financjar, dhe sheqeri 3 muej para se të mbaronte ky vjet.

Dhomat Legjislative tue u mbështetur në shifra të vërtetueme nër statistika dhe tue llogaritë pjesët që janë lanë mangut mbrenda nji viti bashkë me Qeverinë parashikojë nji shtesë 609.000 fr. ari që kësodore kapitulli në fjalë kapë shumën 1.400.000 fr. ari.

8) Kap. 24. t'ardhuna të ndryshme prej Legatave dhe Konsullatave parashikohesh nga ana e Qeverisë 100.000 fr. ari, me nji të metë 20.000 fr. ari nga vjeti i kaluem.

Mbasi këtë vjet tue u bamë pullat e nevojshme kanë me u rregullue këto veprime ma mirë dhe kanë me pasë nji shumë ma tepër, por për me qenë të sigurtë Dhomat Legjislative si mbas shpjegimeve të dhanuna nga autoritetet kompetente, vendosi të shtohet edhe 20.000 fr. ari kapitullit në fjalë, që kështu arrinë shumën prej 120.000 fr. ari.

9) Kapitulli (27) t'ardhuna «Post-telegrafi-telefoni» në bubuxhetin e paraqitun, shifesh 450.000 fr. ari.

Por në Dhomat Legjislative tue ndigjue shpjegimet justifikative qi dha Drejtori i P. i Post-telegrafevet e mbas llogarivet

të krahasueme me këto si treguan autoritetet kompetente dhe tue e marrë para sysh se vit për vit vjen tue u shfrytzue ky kapitull, e shtuan deri në 650.000 fr. ari.

10) Kapitulli (28), «Kthime gjithfarësh» të rrjedhuna nga shpenzime të rendëshme të pagueme jashtë kreditevet të caktueme në buxhet, ishte parashikue ma parë prej Qeverisë në 5.000 fr. ari.

Dhomat Legjislative, këtë kapitull e pa t'arsyeshme nga pikëpamja financjare që të ndahet në dy kaptina: Në kap. *a)* të përmbledhë shtime gjithfarësh tue ngelun si ka qenë 5.000 fr. ari dhe paragrafi *b)* kthime prej shpenzimevet të Krypës parashikohen 300.000 fr. ari të cilat në pjesën e të dalunavet mbassi janë shtyrur si shpenzime për punimin e krypës dhe në bazë të ligjës së monopolizimit, të kësaj, shuma e përmendun ka me ju kthye arkës nga sipërmarrësi, për këto arësye, ashtë nevoja të përfytyrojë në të hymet e këtij viti si mbas rregullavet financjare.

11) Mbassi kur u paraqit buxheti prej anës së Qeverisë nuk ishte votue ligja mbi taksin 2 % (dy për qind) për arësimin, për këto arësye Dhomat Legjislative, së bashku me Qeverinë e parashofin nji të hyme prej fr. ari 300.000, e cila formon nji kapitull të ri në titull «35 bis» t'ardhuna mbi taksa 2 % (dy për qind) për Arësim.

§

Si mbas ndryshimeve të bamuna, dhe si u shpjeguan ma naltë të hymet e përgjithshme të buxhetit t'ushtrimit financjar 1927-2928, janë si tregohen ma poshtë:

	Parapa në budget	Parapa në ndrysh.	Shuma
T'ardhuna të rendshme	23.145.000	4.879.000	28.024.800
T'ardhuna të pa rendshme	2.855.000	– –	2.855.000
	26.000.000	4.879.000	30.779.800

B.

Buxheti i gjendjes të përgjithëshme të shpenzimeve

1. Baxheti i Kryesis së Republikës

1. – Buxheti i paraqitun prej Qeveris për shpenzimet e vitit financjar 1927-1928, të Kryesis së Republikës u pranua plotësisht, vetëm me këto shtime;

A) (7.000) fr. ari ashtë vue në kap. 5, n'art 3, për «përmbajtjen e dy automobilave për Ministrat».

Dhomat Legjislative e panë t'arësyeshme që automobilat e Ministrave të lihen në dispozicjonin e Kryesis së Republikës tue i shtue dhe fondin e duhun për mbajtjen e tyre prej fr.ari 7.000. Dy automobilat në fjalë do të përdoren prej zotrijve Ministrave vetëm për punë Shtetnore kur të jetë nevoja me dalë jashtë. Automobilat e tjerë janë për t'u shitun n'adjudikatë.

B) Kapitullit 11, si mbas ligjit të votuem për krijimin e katër Inspektorëve, i ashtë shtuar rishtazi fr. ari 14.400, për «rrogat e dy Inspektorëve».

2. *Senati*

Në buxhetín e Senatit në Kap. 17, «rrogë personali» nga 37.560 fr. ari, qi ishte paraqitë prej Qeverisë, bahet 38.160 fr. ari. Kjo shtesë prej 600 fr. ari vjen nga shtimi i rrogës të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilit nga 450 fr. ari i bahet rroga fr. ari 500.

3. *Dhoma e Deputetve*

Kap. 21, «rrogë personali» nga 46.320 fr. ari, bahet 47.520 fr. ari, kjo shtesë prej fr. ari 1.200 (njimij e dyqind) vjen nga shtimi i rrogës të Sekretarit të Përgjithëshëm të cilit nga 450 fr. ari i bahet 500 fr. ari, gjith ashtu edhe Stenografít të I. nga 350 fr. ari i bahet 400 fr. ari në muej.

4. *Këshilli Ministruer*

Kap. 25, «rrogë personali» nga 21.240 fr. ari, që ashtë paraqit bahet 21.840 fr. ari. Kjo shtesë prej 600 fr. ari vjen nga shtimi i rrogës të Sekretarit të Përgjithëshëm të cilit nga 450 fr. ari i bahet fr. ari 500.

5. *Këshilli Kontrollues*

Kap. 30, «shpenzime zyre e të tjera» të ndame në tetë artikujt ishin paraqitë 6.400 fr. ari, artikujve 1 e 2, «shkresina e shtypshkrime» mbasi i hiqen 500 fr. ari dhe nga art. 5, «mobilje» i hiqen 500 fr. ari. Kapitulli në fjalë me nji paksim 1.000 fr. ari, bahet 5.400 fr. ari.

Kap. 31. «shpenzime udhtimi e djetë» ka qenë paraqit 5.000 fr. ari, i hiqen 2.000 fr. ari, e ngelin fr. ari 3.000.

6. *Ministrija e Financavet*

Kap. 34, «rrogë personali etj.» të paraqitun prej Qeverisë 1.131.720 fr. ari. Kësaj shumë i shtohen 147.960 (njiqind e ka-

tërdhet e shtatë mijë e nandëqindë e gjashtëdhetë) fr. ari, e kështu Kap. në fjalë bahet 1.279.680 fr. ari shtimet në fjalë përmbahen nga artikujt e ndryshmë që tregohen si mbas listës bashkanjitun.

Kap. 36, shpenzime zyre dhe shkresina, shtypshkrime, e të tjera të Buxhetit të Ministris së Financavet, ishte paraqit në fr. ari 81.740 i cili ndodhet i ndamun ndër 11 artikuj; prej këtyne artikulli 1, 2, 3, 4. 5, 6, 7 dhe 9 ngelin si janë, Art. 8, «shërbim automobili» prej fr. ari 3.840, ngrihet krejt Art. 10, «Mobilje» nga fr. ari 13.000, i hiqen 3.000 fr. ari dhe mbeten 10.000 fr. ari. Art. 11, «mirëmbajtje zyre» nga 10.000 fr. ari i hiqen 2.000 fr. ari dhe mbeten 8.000 fr. ari.

Për arësyen e naltpërmendun Kap. në fjalë mbetet 72.900 fr.ari.

Kap. 38, «vërtetim tatimesh e taksash» ka qenë paraqit 30.000 fr. ari Dhomat Legjislative tue parapamun si të tepër, e zbritnë deri në 22.000 fr. ari.

Kap. 47. — «Fond rezervë për shpenzime të pa parapame a të pa caktueme në buxhet për gjith degat», ishte paraqitë 200.000 fr. ari. Por mbasi në shpjegimet që dha Qeverija u kuptue se fondi duhet të parashikohet si reservë për çdo të papandehun që mund të ngjasi. Për këto arsye u shtue dhe 100.000 fr. ari që kështu Kap. në fjalë përbahet prej fr. ari 300.000.

Kap. 48. — «Ndërtime e miratime në pasuni Shtetit» ishte parapa prej Qeveris nji sasi fr. ari 145.000. Por Dhomat Legjislative së bashku me Qeverin në rjedhjen e bisedimeve e panë t' arësyeshme qi t' i zbritet 45.000 fr. ari, që kështu shuma në fjalë arrinë në 100.000 fr. ari.

Kap. 50. — «Regjistrim i Pasunis së Shtetit» ishte paraqit prej fr. ari 29.000. Por mbasi pritet ma parë të kryemit e dokumentavet Kadastrore, ky fond ngrihet sa për këtë vjet krejt.

Kap. 53. — «Komision për të nxjerrë rrëgjistrat kadastrore në Stamboll «Ky shpenxim suprimohet krejt me qenë se Qeverija Turke nuk dha konsentimentin e vetë për nji të tillë Komision.

Kap. 56. — Kiste gjashtëmujore të këthimit të huas për punë botore për huan e etj. Mbasi i përket llogarivet të veprimevet të shoqënis për Zhvillimin Ekonomik, ngeli i pa shqyrtumun dhe i mvarun për studime të ma pastajshme.

Me ndryshimin e kapitujve qi u treguen ma naltë, Buxheti i Ministris së Financavet tue përmbledhë dhe atë të Kryesis së Republikës, të Dhomavet Legjislative të Këshillit Ministruer e të Këshillit Kontrollues, përgjithësisht përbahet prej 9.393.172 fr.ari (nëndë milion e treqind e nandëdhetetremij e njiqind e shtatëdhetedy).

7. Ministrija e Drejtësis

Kap. 1, «rrogë personali» ishte parapa, 713.760 fr. ari, kësaj shumë i shtohen edhe 10.800 fr. ari që kështu shuma në fjalë bahet 724.560. Kjo shtesë rrjedh nga 30 fr. ari që i u shtue dy Kryesekretarëve të Gjyqit të Diktimit, të dy degave (Civile e Penale) të cilëve prej 250 fr. ari, ju bahet 280 fr. ari. Veç këtyne shtohen në kuadër, 14 shërbëtorë ndër zyra Gjyqsore të ndryshme të cilët deri tash nuk i kanë pasun, seicili nga 60 fr. ari qi kështu shuma e përgjithëshme arrinë 10.800 fr. ari.

Fondi për «Shkollën e Drejtësis» që ishte paracaktue prej 25.000 fr. ari hiqet nga ky buxhet dhe i mvishet buxhetit të Ministris së Arësimit.

Në përfundimin e ndryshimeve të bamuna, shuma e përgjithëshme e shpenzimeve të Ministris së Drejtësisë, arrinë deri në 995.130 fr. ari.

8. Ministrija e P. të Mbrendëshme

Kap. 1, «rrogë e shpenzime përfaqësimi personale e të tjera» parashifëshin 889.780 fr. ari. Në përfundimet e shqyrtimeve në Dhomat Legjislative u pa e arësyeshme qi të shtohet edhe 4.600 fr. ari, qi kështu kap. në fjalë arrinë shumën 894.440 fr. ari. Shtimet e paksimet në fjalë janë bamë si vijon:

Art. parë «rrogë»: Rroga e të dy Inspektorëve ju rëzohen nga 50 fr. ari në muej. Shtohet nji Llogaritar me 300 fr. ari në muej.

Shtimi vjetuer 3.600 fr. ari.

Në Prefekturën e Beratit, shtohet Sekretari i Shtetit Civil, me rrogë mujore 140 fr. ari. Shtim vjetuer fr. ari 1.680 Prefektit të Durrësit i zbriten 100 fr. ari. Zbritja vjetore 1.200 fr. ari, dhe Sekretarit të kësaj Prefekturë i zbritet 10 fr. ari në muej, shuma vjetore fr. ari 120. Nënprefektura e Kurveleshit bahet klasa e I-rë, tue ju shtue 50 fr. ari në muej për rrogë për Nënprefektin shtimi vjetuer 600 fr. ari dhe Sekretarit t'asaj Nënprekturë i shiohen 20 fr. ari shtimi i këtij bahet 240 fr. ari.

Prefektit të Korçës i zbriten 100 fr. ari në muej, paksimi

vjetuer kap shumën 1.200 fr. ari, Kryesekretarit të kësaj Prefekturë i zbriten 10 fr. ari në muej, zbritja vjetore 120 fr. ari.

Sekretarit të Shtetit Civil të kësaj Prefekturë i zbriten 10 fr. arı në muej. Zbritja vjetore fr. ari 120.

Prefektit të Shkodrës t zbriten 100 fr. ari në muej. Zbritja vjetore kapet në 1.200 fr. ari. Kryesekretarit të kësaj Prefekturë, dhe Sekretarit të Shtetit Civil, u zbritën secilit nga 10 fr.ari në muej. Zbritja vjetore për të dy këta kapen 240 fr. ari.

Në Prefekturat Tiranë, Vlonë, Sekretarëve të Shtetit Civil u zbriten nga 10 fr. ari në muej. Zbritja vjetore për të dy këta kapet 240 fr. ari.

Në Prefekturën e Gjinokastrës shtohet nji Sekretar i Shtetit Civil me 140 fr. ari në muej, shtesa vjetore kapet fr.ari 1.680.

Shtohet nga nji Sekretar i Shtetit Civil, në Prefekturat Durrës, Elbasan, Dibër nga 140 fr. ari në muej. Shtesa vjetore për këta të tre kapë shumën fr. ari 5.040.

Si mbas ndryshimeve të bame prej Dhomave Legjislative, në kuadrin e Ministris së P. të Mbrendëshme, si u referue sipri, rrjedh nji shtesë vjetore prej fr. ari 7.200, por tue qenë se në shumën e parapame prej Qeverisë nën kët kapitull kishin vue nji shumë prej fr. ari 3.340, ma shumë se përmbante kuadri i personalit, kjo shumë u zbrit, e shtesa e thjeshtë kapë shumën e fr. ari 3.860, kështu qi kapitulli I. Art. 1, «rrogë personali» arrinë shumën e fr, ari 881.640. Art. 3, të këtij kapitulli i shtohen 2.500 fr. ari për përfaqësime, kështu qi ky artikull kapë shumën e fr. ari 12.500.

Shuma e përgjithëshme e këtij kapitulli me këto shtesa kapë shumën e fr. ari 896.140.

Kap. 2, «Rrogë për Këshillat dhe sekretar të krahinave» parashifshin 39.000 fr. ari por mbasi Ministri kompetent tregojë nevojë të domosdoshme për shtimin edhe nga nji Sekretar ndër disa krahina të Malsive ku Krahinarët nuk dinë me shkrue u vendue shtimi i nji shumës 13.000 fr. ari, që kësisoj Kap. në fjalë parashikohet 52.000 fr. ari. Kapitulli 4, ka qenë paraqit nga Qeverija prej fr. ari 41.200; Dhomat Legjislative n' Art. 7 po të këtij kapitulli rrëzuen 9.000 fr. ari që ishin për blemje e mbajtje automobilash. N' art. 10, «mirëmbajtje zyre» u shtuen 1.000 fr. ari mbasi nuk figuronte ndonji shumë e tillë; Kështu që ky kapitull bahet 33.200 fr. ari.

Kapitulli 7, mbetet si asht, por me konditë qi shuma e cak-

tueme në këtë kapitull të shpenzohet vetëm për Fletoren Zyrtare, e korespondencë të jashtme.

Kapitulli 8, «Subvencjon klerit të tre besimeve» qi ishte paraqitun 60.000 fr.ari, i zbriten 10.000 fr.ari, dhe ngelë 50.000 fr.ari.

Kapitulli 9, «Subvencjon Kishës Autoqefale» ashtë paraqit prej Qeverisë «promemoria» nga Dhomat Legjislative ju vue këtij kapitulli fr. ari 20.000.

Kap. 12, «Shpenzime të mshefta» ashtë paraqitë 110.000 fr. ari. Mbi shpjegimet e dhanuna nga z. Ministri, Dhomat Legjislative i shtuan këtij kapitulli dhe 45.000 fr. ari, që keshtu shuma e përgjithëshme kapet në 155.000 fr. ari.

9. Shëndetësija Botore

Kapitulli 13, «Rrogë personali, mjekë të posaçëm, e lishartuesa» ka qenë paraqitë nji shumë prej fr. ari 113.360. Këtij kapitulli ju shtuan 4.800 fr. ari. Shuma e përgjithëshme bahet fr. ari 118.160.

Kapitulli 15, «Shpenzime zyre, ashtë paraqitë 3.160 fr. ari, këtij kapitulli i shtohen 1.000 fr. ari për blemje botimesh» dhe keshtu shuma e përgjithëshme kapet fr. ari 4.160.

Kapitulli 21, «Laboratori i bakteriologjis» ashtë parapa 6.000 fr.ari por mbasi u pa se kjo shumë nuk mjafton për sigurimin e veglave të nevojshme u shtuan dhe 4.000 fr. ari, e kështu shuma e këtij kapitulli kapet fr. ari 10.000.

Kapitulli 22, «bursë specializimi» ashte paraqitë fr.ari 11.000, ndër shqyrtimet që u banë në Dhomat Legjislative, u pa se kjo shumë nuk mjaftonte, dhe u shtue 3.000 fr. ari, kështu shuma e përgjithëshme e këtij kapitulli kapet fr. ari 18.000.

Kapitulli 23, «Subvencjon i Spitalit të Shkodrës» ishte paraqitë fr. ari 15.000; por mbasi u zbritën 1.000 fr. ari ky kapitull ngelë 14.000 fr. ari.

Në perfundim të shqyrtimeve shuma e përgjithëshme parashifet prej 1.999.980 fr. ari (nji milion e nëndëqindenëndëdhetenëndëmij e nëndëqindë e tetëdhetë).

10. Ministrija e P. të Jashtëme

Kapitulli 1, «Rrogë personali e tjera» ishte paraqitun prej Qeverisë fr. ari 378.000. Në përfundimin e bisedimevet Dhomat Legjislative së bashku me Qeverinë e panë t'arësyeshme që këtij kapitulli t'i shtohet edhe nji shumë prej fr. ari 32.160 që kështu shuma në fjalë arrinë fr. ari 410.160. Ndryshimet e naltëpërmenduna janë bamë për arësyet e poshtë shënueme:

Për krijimin e nji Chargé d'Affaires në Londër. Për këtë qëllim i shtohen edhe fr. ari 12.000, të cillat transferohen nga Legata e Parisit e cila deri tash këqyrte edhe Londrën. Krijimi i Chargé d' Affaires në Londër rrodhi mbi proponimin e Qeverisë dhe me pëlqim të dy Dhomave Legjislative.

Ministri Fuqiplotë, Roma, Bukuresht e Budapest, i shtohet nji alokasjon 200 fr. ari në muej. Shuma vjetore 2.400 fr. ari. Sekretarit të kësaj Legatë i shtohen 50 fr. ari alokasjon, kështu që shuma vjetore i bëhet 600 fr. ari.

Ministrit Fuqiplotë te Beligradit i shtohen 100 fr.ari në muej alokasjon, shuma vjetore arrinë në fr. ari 1.200.

Në Legatën Angora-Sofie Sekretarit të parë që rri në Sofie, i shtohen 200 fr.ari alokajson në muej, shuma vjetore 2.200 fr.ari.

Kryekonsullit të nderit në Bukuresht, i jepet nji alokasjon 150 fr. ari në muej, shuma vjetore 1.800 fr. ari.

Dy shërbëtorëvet ju zbriten nga 10 fr. ari në muej që kështu shuma e përgjithëshme kapet 240 fr. ari në vit.

Kap. 2, «Udhtim e djetë» ishte paraqitun prej Qeverisë, 46.000 fr. ari. Prej kësaj shumë janë zbritun 9.000 fr. ari që kështu shuma në fjalë ngelë 37.000 fr. ari.

Kap. 3, «Shpenzime zyre e tjera» ishte paraqitun në projekt-ligjën e Buxhetit, 31.220 fr. ari, tue u ndamë në 11 artikuj. Dhomat Legjislative mbassi ju pakësuan art. 6. «Veshje mathje shërbëtorësh» fr. ari 400, dhe art. 7, «blemje e mbajtje automobili» u ngritë, ky kapitull parashifet prej fr. ari 23.400.

Kap. 4, «Shpenzime të ndryshme për përfaqësina» ishte parashikue ma parë prej Qeverisë, 218.600 fr. ari me qenë se ashtë ndrue shtëpija ku banon Ministri i Beligradit, për të cilën u shtue për qira edhe 6.000 fr. ari; kështu që ky kapitull bahet 224.600 fr. ari.

Ministri Fuqiplotë që figuron në kuadrin e qendrës u vendos prej Dhomavet Legjislative që përveç rrogës së disponibilitetit për sa kohë që të ndodhet në qendër nuk ka me marrë nji rrogë.

Gjendja e parapame e shpenzimeve të Ministris P. të Jashtëme për ushtrimin financjar 1927-1928, arrinë 840.060 fr. ari (tetëqindekatërdhetmij e gjashtëdhetë).

11. Ministrija e P. Botore

Kap. 1, «rrogë personali» në buxhetin e paraqitun ishte parashikue 180.000 fr. ari. Por mbasi u vendos të ndamit e dega-

vet të Bulqësiës e të Pyjevet nga kjo shumë u zbritnë 35.880 fr. ari. Në zbritjen në fjalë përmbahet dhe zbritja prej 20 fr. ari në muej të Sekretarit të parë, si dhe rroga e shoferit. Shuma në fjalë mbetet 144.120 fr. ari.

Kap. 2, «Rrogë personali me kontratë» ne buxhet ishte paraqitun 89.400 fr. ari si mbas organizimit të ri, tue u suprimue ingjineri i hekur-udhës, tue u rrëxue dhe fr. ari 1.200 në vit, Ingjinerit për molo, kapitulli në fjalë mbetet 78.480 fr. ari.

Shenim i veçantë: Si mbas vendimit qi u muar prej Dhomavet Legjislative bashkë me Ministrin e P. Botore nga Ingjinerët që fytyrojnë në kuadrin e qendrës, katër veta do të jenë shqiptarë.

Kap. 3,· «Shpenzime udhëtimi e djetë e ushqim kualsh» Ky kapitull nga Qeverija ishte paraqit 35.500 fr. ari, mbas organizimit të ri ju shtuan prej Dhomavet Legjislative 5.000 fr. ari që kështu shuma në fjalë kap 40.000 fr. ari.

Kap. 4, «Shpenzime zyre e të tjera» ishte paraqit 16.900 fr. ari. Nga Dhomat Legjislative janë rëxue 2.900 fr. ari dhe ngelë 14.000 fr. ari; rëximi bahet n'art. 1 e 2, «shkresina e shtypshkrime» fr.ari 1.400, art. 4 i zbriten 500 fr.ari, art. 5 i zbriten 1.000 fr.ari.

Kap. 6, «blemje vegla teknike dhe materiale ravizimi» ishte paraqitë 91.000 fr. ari, prej kësaj shumë janë rrëxue 51.000 fr. ari, e kështu ngelin 40.000 fr. ari.

Kap. 7. Titullohet në këtë mënyrë «Mbajtje udhash», ka qenë paraqitë me gjith mbajtje e blemje kamjonesh, fr.ari 600.000. Por prej këtij fondi 560.000 kanë qenë për mbajtje udhash. Në Dhomat Legjislative mbassi u shtuan 440.000 fr. ari, shuma e kapitullit në fjalë bahet 1.000.000 fr. ari.

Kap. 8, «Ndërtime e mbajtje urash». Në buxhetin e paraqitun nuk ka qenë parapa ky fond në mënyrën e ndame. Për këtë arësye u vendos bashkërisht me Ministrin e P. Botore, u krijua ky fond i posaçëm prej 300.000 fr. ari.

Kap. 9, «mbajtje e blemje kamjonesh» prej 40.000 fr. ari që ishte paraqitun u zbritnë 15.000 fr.ari, e kështu ngelë 25.000 fr.ari.

Shpenzime për Administrimin e Postave e Telegrafave

Kap. 10, «Rrogë personali e tjerë» ka qenë paraqit 610.380 fr. ari. Në Dhomat Legjislative si mbas nevojave të diftueme e të domosdoshme për përparimin e kësaj degë që vit për vit, vijnë tue u shtue t'ardhunat, u pranue kërkimi i Drejtorit

të Pëgjithëshëm të Post-Telegrafavet së bashku me ministrin kompetent, për akordimin e nji shtese 10.800 fr. ari me të cilën kapitulli në fjalë tue i u ndrue edhe numuri në shifrën 10, ngelë 621.180 fr. ari.

Mënyra e shtimeve e shkoqitërisht tregohet si mbas kuadrit të bashkanjitun.

Kap. 13, «Shpenzime zyre» që ka qenë paraqit 58.000 fr.ari janë shtuemun edhe 1.200 fr. ari qi kështu shuma në fjalë bahet 59.200 (pësëdhetë e nandëmij e dyqind). Tue u ndryshue shifri i këtij kap. në numur 13. Ky kapitull ka qenë i ndamë në tetë artikuj. I shtohet edhe nji artikull «rroje pullash» që përmbanë fondin 1.200 fr. ari.

Kap. 17, «ngrehje e mbajtje e linjeve telegrafike» ka qenë paraqitë 30.000 fr. ari, që kështu kapitulli në fjalë arrinë shumën prej fr. ari 40.000.

Në përfundim të ndryshimeve gjithsejt për Ministrin e P. Botore por përmbledhë dhe shpenzimet e Administrimit të Drejtorisë P. të Postë-Telegrafevet arrinë shumën e fr. ari 2.536.600 (dy miljon e pesëqind e tridhet e gjashtëmij e gjashtëqind).

12. Ministri e Bujqësis dhe e Pyjeve

Kap. 1. — «Rrogë personali» ishte paraqitun ma parë prej Ministris së P. Botore e Bujqësis, 190.560 fr. ari. Por mbasi Ministrija e P. Botore ndahet nga administrimi i Bujqësis dhe i Pyjevet, dhe kjo krijohet si Ministri, kapitullit në fjalë i shtohen edhe nji sasi prej 50.440 fr. ari.

Kap. 2. — «Rrogë personali me kontratë» ishte paraqitë 36.000 fr. ari në Dhomat Legjislative ashtë rëzuemun 24.000 fr. ari që kështu shuma në fjalë ngelë 12.000 fr. ari.

Kap. 3. — «Shpenzime udhëtimi e djete» ishte paraqitë 21.300 fr. ari por në bazë t'organizimit të ri mbasi u zbritnë 4.360 fr. ari ky kapitull mbetet 17.000 fr. ari.

Kap. 4. — «Shpenzime zyre e të tjera» janë paraqit prej Qeverisë 10.700 fr. ari por janë rëzue 1.000 fr. ari që kështu kapitulli në fjalë mbetet 9.700 fr. ari.

Kap. 5. — «Qira» ka qenë paraqit 4.000 fr. ari në bazë t'organizimit të ri ju shtuan fr. ari 1.200 dhe kështu u ba 5.200 fr. ari.

Kap. 6. — «Shpenzime shërbimi e të ndryshme» ka qenë paraqit prej fr. ari 64.000 fr. ari në bazë t'organizimit të ri si

mbas listës shpijeguëse i janë shtue fr. ari 57.540, që kështu kapitulli në fjalë bahet 121.340 fr. ari.

Kap. 7. — «Shpenzime për botime karta geologjike e analizime» ngeli si ishte paraqitun prej Qeverisë në 5.000 fr. ari.

Me qenë se Ministrija e Pyjeve dhe e Bujqësis, u krijue rishtazi për këtë arsye, bashkanjitur ju dërgohet dhe kuadri komplet i kësaj Ministrije.

Në përfundimet e ndryshimeve që janë ba, për ushtrimin financjar 1927-1928, arrinë 411.240 (katërqind e njimbëdhetëmij e dyqind e katërdhetë) fr. ari.

13. Ministrija e Arësimit

Kap. 1. — «Rrogë personali indemnitet e të tjera» ka qenë paraqit 1.444.970 fr. ari, kësaj shumë shtohen fr. ari 4.920, shuma e përgjithëshme e këtij kapitulli arrinë 1.649.890 fr. ari.

Kap. 5. — «Shpenzime për mbajtje konviktesh etj.» ka qenë paraqit 264.715 fr. ari, me qenë se për internatin e Mirditës, mbasi u vendos shtuarja e 35 nxanësve, u shtua edhe 20.000 fr. ari. Gjith' ashtu dhe 165.000, për përmirësimin e mirëmbajtjen e internatave dhe për plotësimin e nevojave të shkollave të mesme, që kështu kapitulli në fjalë bahet 449.715.

Kap. 6. — «Ndihmë e subvensjon instituteve të ndryshme t'edukatave» ka qenë paraqit 16.000 fr. ari, si mbas artikujve të ndame ashtë shtuemun edhe 36 000 fr. ari që kështu shuma e përgjithëshme arrinë në 52.000 fr. ari.

Kap. 7. — «Bursa studentësh të mbrendëshme e të jashtme e harte të bukura» ka qenë paraqit 358.715 fr. ari, kësaj shumë i shtohen edhe 85.000 fr. ari, që kështu shuma e përgjithëshme bahet 443.715 fr. ari.

Prej kësaj shumë 40.000 fr. ari janë për bursat e mbrendëshme të 50 vetave që do të kenë ekslusivisht karierën e ushtëris. Kjo shumë u zbritë nga Buxheti i Fuqis Armate dhe ju shtua kapitullit të naltpërmendun.

Kap. 9. — «Ndërtime» shtohen 70.000 fr. ari tu prishun si mbas artikujve të ndame.

Kap. 10. — «Shpenzime për Shkollën e Drejtësis» 30.000 fr. ari i shtohen.

Shuma e përgjithëshme e parapame e shpenzimeve për ushtrimin financjar 1927-1928, të Ministris s' Arësimit, kapet prej fr. ari 2.810.920 (dy miljon e tetëqind e dhetëmijë e nandëqind e njizetë).

14. Komandat e P. të Fuqive Armate

a) Shpenzime për ushtri

Kap. 2. – «Rrogë graduatësh e ushtari» ka qenë paraqit 3.074.280 fr. ari nga kjo shumë ashtë zbritun 20.000 fr. ari, dhe mbetet 3.054.280 fr. ari.

Kap. 4. – «Shpërblime» ka qenë paraqit 64.283 fr. ari, që kështu shuma në fjalë ngelë 40.000 fr. ari.

Kap. 12. – «Hesë kali» ka qenë paraqitun 709.160 fr. ari nga kjo shumë ashtë zbritë fr. ari 20.000, që kështu shuma e përgjithëshme mbetet fr. ari 689.160.

Kap. 20. – «Shpenzime për ushtrimin e anijeve e vaglavet detare» ka qenë paraqitur fr. ari 250.000. Nga kjo shumë me qenë se ashtë rrëzue automobili që përfituronte në këtë fond prej fr. ari 3.000 shuma në fjalë ngeli në 247.000 fr. ari.

SHËNIM: Paksimi që ashtë ba prej 40.000 fr. ari, nga kapitulli 2 e 12 të naltëpërmendun i ashtë shtuemun buxhetit të Ministris s'Arësimit për 50 bursista të mbrendëshme që do të destinohen eksklusivisht për ushtri.

b) Shpenzime për Gjendarmeri

Kap. 22. – «Rrogë oficeri» ka qenë paraqit 371.760 fr. ari, si mbas kuadrit të ri u paksuen 46.800 fr. ari që kështu shuma mbetet 324.960 fr. ari.

Kap. 23. – «Rrogë aspiranti e gjendarmi» ashtë paraqitë 1.948.440 fr. ari. Si mbas kuadrit të ri ashtë shtue edhe 109.560 fr. ari që kështu ky kapitull arrinë në 2.058.000 fr. ari.

Kap. 24. – «Shpenzime udhëtimi e djete» ka qenë paraqit 24.700 fr. ari këtij kapitulli i shtohen 7.300 fr. ari, që kështu bahet 32.000 fr. ari.

Kap. 25. – «Shpenzime transporti për gjendarmë e material» ka qenë paraqitë 15.000 fr. ari, kësaj shumë u zbritnë 4.160 fr. ari, që shuma në fjalë mbetet 10.840 fr. ari.

Kap. 26. – «Shpenzime zyre etj.» Ka qenë paraqit 98.740 fr. ari, tue i rëzue në bazë t'organizimit të ri 18.740 fr. ari që kështu kapitulli në fjalë ngelë 80.000 fr. ari.

Kap. 28. – «Ndërtime e meremetime» në bazë të listës së re që paraqiti Komandanti i P. i Gjendarmeriës, sa do qi nuk ishte paraqitur nji sasi e këtillë në buxhet, u pranue shtimi i nji fondi prej 7.000 fr. ari. Kështu kapitulli në fjalë krijohet me shumën e sipër përmendun.

Kap. 29. – «Veshje e mbajtje gjendarmësh» ka qenë paraqit 294.000 fr. ari mbasi mbas organizimit të ri janë zbritë 44.000 fr. ari, që kështu ngelin 250.000 fr. ari.

Kap. 31. – «Ushqim kafshësh, blemje kafshësh dhe pajimi i tyne» ka qenë paraqitë 76.360 fr. ari nga ky kapitull zbriten 9.160 fr. ari që ngelë shuma e përgjithëshme fr. ari 67.200.

Kap. 32. – «Indemnitet e shpërblim për aksidenta e dhurata» ka qenë paraqit 5.000 fr. ari nga kjo shumë zbritën 2.000 fr. ari dhe mbetet 3.000 fr. ari.

Kap. 33. – «Shëndetësi» ka qenë parashikue 12.000 fr. ari, janë shtue edhe 1.000 fr.ari që kështu shuma bahet 13.000 fr. ari.

Krijohen edhe dy kapituj të tjerë:

Kap. 36. – «Fuqija e mbetur jashtë kuadrës» e cila nuk ishte parashikue ma parë, por ma pastaj në radhën e bisedimeve në Dhomat Legjislative asht paraqitur prej Qeverisë nji sasi prej fr. ari 180.820.

Kap. 37. – «Për plotësimin e të mbetunave t'arkës» për aspirant, graduat e gjendarm, ashtë caktue nji fond prej 17.500 f.a.

Shuma e përgjithëshme e parapame e shpenzimevet të Komandavet të Përgjthëshme të Fuqive Armate, për ushtrimin financjar 1927-1928, kapë shumën 11.851.037, (njimbëdhetëmiljon e tetëqindëpesëdhetënjimij e tridhetështatë) fr.ari.

Si mbas ndryshimeve të bamuna prej Dhomave Legjislative tue qenë d'akord dhe me Qeverin, të dalunat e përgjithëshme për vitin financjar 1927-1928, parashikohen si vijon:

Shpenzime të rendëshme e të pa rendëshme.

Paraqitun prej Qeveris	Shpenz. Shndrrim kryegjan.	Shuma
23.677.121	5.636.850	29.314.042

Shtim prej Dhomave Legjislative d'akord me Qeverin
për shpenzimet e rendëshme të pa rendëshme. . 1.524.097

Shuma 30.838.139

Shuma e përgjithëshme e shpenzimevet për ushtrimin financjar 1927-1928, (tridhetë milion e tetëqind e tridhetëtetëmij e njiqind e tridhetë e nand) fr. ari.

SHKURTIM:

T' ardhunat e përgji. në vitin financjar 1927-1928, fr.ari 30.879.800
Të dalunat e përgjith. të vitit financjar 1927-1928, fr.ari 30.838.139
Mbeten exedent fr.ari 41.661

Shenime të posaçme :

Dhomat Legjislative, tue biseduar kreditin prej 1.850.000 fr.ari në buxhetin e t' ardhunavet, dhe prej 5.636.850 fr.ari n' atë të së prishunave, të dya të rrjedhuna prej huas 50.000.000 fr.ari, vendosnë dhe deklaruan :

a) Nuk ka as nji dijeni për disa akorde eksekutive dhe marrëveshje të tjera qi janë ba prej Qeverive, mbi huan e nalt-përmendun, dhe nuk aprovon as nji . vepër të deritashme për këtë hua ;

b) Kërkon prej Qeverisë qi gjith veprimet mbi huan të ryjnë në rrugën legale ;

c) Ç' do interesë Shteti, në konflikte sot me «Shoqërin e zhvillimit ekonomik të Shqipnis» Qeverija t' a mbrojë me gjithë mjetet e duhuna ;

ç) Tue digjuar Qeverinë se pa u votuar kreditet e nalt-përmendun, Shtetit i shkaktohen dame nga humbja e ngarkesës së kamatës, pranon kreditin palegalizuar kurfarë vepër tjetër mbi huan, deri në sesionin vjeshtuar, kur çashtjen e huas ka për t' a shqyrtue hollësisht dhe ka marrë nji direksjon tue legalizuar gjith veprat, ose tue i refuzuar. Në rastin e fundit ka për të marrë gjithë masat e duhuna për t' i dhanë çashtjes zgjedhjen qi i përshtatet.

Kopja e buxhetit në fjalë po ju dërgohet këtu ngjit.

A. ZOGU

Pasqyrëz shkoqitëse mbi ndryshimet e bame në kuadrin e personalit të Ministris së Financavet :

BERAT	Nji llogaritar i II-të me 150 Fr.ari Nji tragrambledhës kalorës me 150 fr.ari Nji kontrollor tragrambldhës me 240 fr.arı (tue mos pasun të drejtë udhëtimi e djetesh) Nji Sekret-Vergjije me 130 fr.ari
SKRAPAR	Nji tagrambldhës me 150 fr.ari
FJERI	Nji tagrambledhës me 150 fr.arı Nji Llogaritar me 160 fr.ari
MALLAKASTËR	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari

LUSHNJË	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
VLONË	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji Sekret-Vergjije me 130 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji arkëtar Dogane 180 fr.ari Nji Kontroll tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete).
TIRANË	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete). Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari
PESHKOPI	Kryenëpunsit i shtohet 30 fr.ari dhe i bahet rroga nga 220 në 250 fr.ari Nji Sekretar Vergji-Kadaster me 140 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete Peshkopi Kukës, Mat).
MAT	Nji Llogaritar me 160 fr.ari
ELBASAN	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djetë). Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari
KORÇË	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete).
ERSEKË	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
BILISHTË	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 15C fr.ari Nji Sekretar Vergji-Kadastre me 140 fr.ari Nji arkëtar dogane me 180 fr.ari
POGRADES	Nji Lllogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Sekretar Vergji-Kadastër me 140 fr.ari

GJINOKASTËR	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhës me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete). Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
TEPELENË	Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
PËRMET	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Sektrar Vergji-Kastrë me 140 fr.ari
DELVINË	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji Rojtar i Pas. Shtetit me 100 fr.ari
DURRËS	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari Nji arkëtar dogane me 180 fr.ari
KRUE	Nji Llogaritar me 160 fr.ari
KAVAJË	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
KUKS	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji Sekretar Vergji-Kadastrë me 140 fr.ari
SARANDË	Nji arkëtar dogane me 180 fr.ari
SHKODËR	Nji Llogaritar i II-të me 150 fr.ari Nji Sekretar Vergjije me 130 fr.ari Dy tagrambledhsa a 150 fr.ari Nji Kontrollor tagrambledhes me 240 fr.ari (pa të drejtë shpenz. udhtimi e djete). Nji arkëtar i doganës me 180 fr.ari
LESH	Nji Llogaritar me 160 fr.ari Nji tagrambledhës me 150 fr.ari
KURVELESH	Nji axhent finance me 180 fr.ari
ZERQAN	Nji azhent finance me 180 fr.ari

Nënpunsit të Doganës së Patokut i shtohen 30 fr.ari dhe i bahet rroga nga 150 qi e ka pasun, me 180 fr.ari.

Shtohen në kuadrin e qendrës nji Kontrollor me rrogë muejore 330 fr.ari dhe nji Llogaritar me 300 fr.ari.

Nëpunsi rezervë qi figuron në kuadrin e Ministris së Financavet me 250 fr.ari rrogë pranohet për Sekretar në degën e të ardhunavet.

Përmbledhje e Budgetit

të parapamevet për të Hymet e të Dalunat

e ushtrimit financjar prej 1-IV-1927 deri me 31-III-1928

	Kompetenca si mbas ligjës qi aprovon ushtrimin provizor të Budgetit 1926-1927 1	Ndryshime qi propozohen 2	Kompetenca rrjedhëse për ushtrimin financjar 1627-28 (shtylla 1+2) 3
KATHEGORI E I.			
Të hyme e shpenzime efektive			
Pjesa e rendëshme			
Shpenzime:			
Ministri e Financavet . . .	3 730.856	- 70.534	3 660.322
Ministri e Drejtësis . , . .	872 290	+ 51.420	923.710
Ministri e P. të Mbrendshme	2 025 040	– 200.220	1.824.820
Ministri e P. të Jashtme . .	730.060	+ 110 000	840 060
Ministri e P. Botore. . . .	2 256 240	+ 280.360	2.536.600
Ministri e Bujqsis e e Pyjeve	392 680	+ 18 560	411 240
Ministri e Arsimit	2.451.880	+ 359 040	2 810.920
Koman. e P. e Fuqive Armate	9 524 954	+2.102.763	11.627.717
	21.984.000	+2.651.389	24.635.389
Të hyme. . . . , ...	22.943 360	+5.081.440	28.024 800
Diferenca	+ 959 360	+2.430.051	+3.389.411
KATHEGORI E I.			
Të hyme e shpenzime efektive			
Pjesa e pa rendëshme			
Shpenzime:			
Ministri e Financavet . . .	295.000	– 199.000	96 000
Ministri e Drejtësis	48 200	+ 23 220	71 420
Ministri e P. të Mbrendshme	465.600	– 290 440	175.160
Ministri e P. të Jashtme . .	139 727	– 139.727	–
Ministri e P. Botore. . . .	105 600	– 105 600	–
Ministri e Bujqsis e e Pyjeve	27.480	– 27.480	–
Ministri e Arsimit . . , .	7 000	– 7.000	–
Koman. e P. e Fuqive Armate	2 019 157	- 1.795.837	223.320
	3 107.764	– 2.541.864	565.900
Të hyme. . , ...	66.000	+2 789 000	2.855.000
Diferenca	- 3.041.764	+5 330 864	+2.289.100

Gjendja e parapame e të hymeve
për ushtrimin financjar 1927-1928

Nr. i ushtrimit 1926 1927	Nr. i ushtrimit 1927 1928	KAPITUJ EMERTIM	Kompetenca si mbas ligjës qi aprovon ushtrimin provizor të Budgetit 1926-1927	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhëse për ushtrimin financjar 1627-1928 (shtylla 4+5)
1	2	3	4	5	6
		Titull i I. Të hyme të rendshme			
		Kath. e I. - Të hyme efektive			
		T'ardhuna prej pasunis së Shtetit			
1	1	Qera tokësh e ndërtesash Shteti .	99.240	+ 101.860	201.100
2	2	Të tretëta	295.000	– 20.800	274.200
13	3	T'ardhuna nga peshku i gjuejtun	378.800	+ 21.200	400.000
3	4	T'ardhuna prej pyjevet të Shtetit	92.500	– 8.400	84.100
5	5	T'ardhuna prej tokëvevet të pajtueme për shfrytzime minerale, si edhe prej koncesjonevet për të nxjerrun drue, gurë e metale dhe të ndryshme pasunije Shtetit . .	835.370	+ 14.630	850.000
		Totale e t'ardh. prej pasunis Shtetit	1.700.910	+ 108.490	1.809.400
		Tatime e taksa të drejta			
		Tatime, (vergji)			
8	6	Tatim mbi ndërtesa , ...	1 159.500	+ 36.800	1.196.300
7	7	Tatim mbi prodhime pyjesh e gurorësh, në pronë private , . .	74.200	+ 51.900	126.100
11	8	Të dhetëta mbi drithna e pemë, duhan, ullij e zhukë	4.740.800	– –	4.740.800
6	9 a	Tatim xhelepi mbi berre e thij .	2.010.000	– 145.000	1.865.000
–	9 b	« « « shtazë të trasha	– –	+ 600.000	600.000
10	10 a	Tatim progresif mbi t'ardh. e fitime	215.000	– 145.000	70.000
–	10 b	Taksë personale për punim rrugash	–	+1.500.000	1.500.000
		Për t' u bartë	8.199.500	+1.898.700	10.098.200

Nr. i ushtrimit 1926-1927 (1)	Nr. i ushtrimit 1927-1928 (2)	KAPITUJ — EMERTIM (3)	Kompetenca si mbas ligjës qi aprovon ushtrimin provizor të budgetit 1926-1927 (4)	Ndryshime qi propozohen (5)	Kompetenca rrjedhëse për ushtrimin financjar 1927-1928 (shtylla 4+5) (6)
		bartun	8.199.500	+1.898.700	10.098.2C0
9	11	Tatim mbi patentë tregtare . . .	224.250	+ 41.250	265.500
		Totale të tatimevet të drejta	8.423.750	+1.939.950	10.363.700
		Taksa (Resem)			
16, 17	12	T'ardhuna nga regjistrimet kadastrore . . . . , ...	208.500	+ 71.100	279.600
14	13	Taksë pullash	216.000	+ 34.000	250.000
18	14	Taksë mbi akte të shtetit qytetuer e të gjykatavet të rendshme . .	415.500	— 15.500	400.000
37	15	Taksë limani, fenerësh, karantinash e të ndryshme . . . . . . , . .	85.000	+ 62.000	147.000
		Totale të taksavet të drejta	925.000	+ 151.600	1.076.600
		Tatime e taksa të shdrejta			
		Të hyme doganore			
		Shuma e përgjithëshme e Kathegoris së I. (të rendshme)	9.524.954	+2.102.763	11.627.717
		Tit. i II. Shpenzime të pa rend.			
		Kath. e I. - Shpenzime efektive			
		Shpenzime për Ushtri . , .	2.019.157	– 1.994.157	25.000
		Shpenzime për Gjindarmeri . .	– –	+ 198.320	198.320
		Shuma e përgjithëshme e Kathegoris së I. (të pa rendshme)	2.019.157	– 1.795.837	223.320
		PËRMBLËDHJE E KRTHEGORIVE			
		Kathegori e I. - Shpenzime efektive (të rendshme e të pa-rend.)	11.544.111	+ 306.926	11.851.037
		Shuma e shpenzimeve reale	11.544.111	+ 306.926	11.851.037

Pasqyrëz shkoqitse e shpenzimeve për artikull

USHTRI

a) Kap. 7. – Shpenzime zyre

Art. 1. – Shkresinë	Fr. ar	13.108
Art. 2. – Shtypshkrime / Art. 3. – Blemje botimesh	»	15.000
Art. 4. – Zjarm e dritë (për zyrë)	»	34.100
Art. 5. – Mobilje	»	20.000
Art. 6. – Të vogla	»	14.196
Art. 7. – Kremtime	»	1.466
	Fr. ar	97.870

GJINDARMERI

b) Kap. 26. – Shpenzime zyre

Art. 1. – Shkresinë	Fr. ar	10.000
Art. 2. – Shtypshkrime	»	1.000
Art. 3. – Blemje botimesh	»	10.000
Art. 4. – Maqina shkrimi	»	4.000
Art. 5. – Telefon e materjal	»	22.000
Art. 6. – Mobilje	»	6.000
Art. 7. – Të vogla	»	8.000
Art. 8. – Zjarm e dritë	»	19.000
	Fr. ar	80.000

BKSH

Nr. 93

LIGJË, 16 Qershuer 1927.

Për mbi organizimin e shërbimeve të shëndetësis publike

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Korrik 1927, Nr. 56)

Art. 1. — Mbrojtja e shëndetësiës publike dhe zbatimi i ligjevet që i përkasin asaj, për veç atyne qi bajnë me epizootie (sëmundje bagtish) për të cilën ashtë kompetent Ministrija e Bujqësisë, mvaren në Ministriën e P. të Mbrendshme dhe ushtrohen nën drejtimin e sajë m'anë t'autoriteteve civile, bashkijake dhe komunale, si dhe nën kujdesin të nji personeli shëndetsuer të posaçëm.

Personeli Shëndetsuer i Shtetit, Dispozita të Përgjithëshme

Art. 2. — Asnji mjek nuk mund të pranohet si nëpunës i Shtetit ose nëpunës komunal pa kjenë shtetas shqiptar, pa patur diplomë mjeksije, pa gëzuar të drejtat civile e politike dhe pa ditun me folë me këndue e me shkrue gjuhën amtare.

Përjashtohen nga konditat e fundshme mjeksit specialiste të huej që thëriten nga ana e Qeverisë.

Mjeksit në shërbim të Shtetit, të Bashkiës ose të Komunes qofshin përveç nëpunsisë q'u ngarkohet prej ligjës nuk mund të pranojnë asnji tjetër nëpunsi mjeksore, as me rrogë, jashta qendrës ku këta banojnë dhe ushtrojnë profesionin e tyne.

Klasifikimi dhe kategorizimi i mjeksëvet të Shtetit, të Bashkive ose të Komunevet qofshin bahen me ligjë të posaçëm.

Pensjoni i mjekësve do të rregullohet në bazë të ligjës përmbi pensjonin e nëpunsave civil.

Art. 3. — Personali shëndetsuer i Shtetit përbahet:

a) Në Kryeqytet prej Drejtorit të Përgjithëshëm të Shëndetësisë dhe prej Inspektorit të Shëndetësisë;

b) Në Prefekturat e Nënprefekturat Zyrtarve shëndetsuer, prej Lishenuesve (vaksinatorëve), ku ndodhen të tillë, prej mjekësvet shetitës dhe prej Inspektorvet të posaçëm të shëndetsisë;

c) Në Portot (limanet), në stacjonet kufizore dhe në lazaretat (karantinat) prej nëpunsash shëndetsuer të posaçëm.

Kaptinë e I-rë

Për mbi Drejtorinë e Përgjithëshme të Shëndetësisë

Art. 4. — Drejtorija e Përgjithëshme e shëndetësisë asht nji administratë e formueme prej nji personali të posaçëm si mbas

Art. 5, të kësaj ligje, e kryesuem prej nji Kryetari i cili ka titullin Drejtor' i Përgjithëshëm i Shëndetësisë.

Drejtori së bashku me misat'e tjerë të Drejtorisë përmbajnë Këshillin e Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë asht trup këshillues i Ministris së P. të Mbrendëshme përmbi çeshtjet q' i përkasin shëndetësisë publike dhe mjeksis përgjithësisht, por me gjithë qi mvaret prej kësaj Ministrije administrativisht për çeshtjet që përgjithësisht i përkasin Shëndetësisë dhe mjekësisë ka të drejtë të bajë letër-këmbime drejtë për së drejti me ç'do Ministri, zyrë shtetnore dhe shoqërina private.

Art. 5. – Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë përbahet prej misash të rregullshëm dhe të jashtëzakonshëm.

Misa të rregullshëm janë:

1) Drejtori i Përgjithëshëm i Shëndetësisë;

2) Inspektori i Shëndetësisë;

3) Drejtori i Laboratoriumit të Bakteriologjisë së Shtetit;

4) Një mjek prej atyne që kanë në Kryeqytet nëpunësi shtetnore, shëndetësore ose mjekësore nga më të naltët dhe qi kanë zotësi të provueme;

5) Mjeku ma i naltë i ushtrisë;

6) Dy prej mjekve privat të Kryqytetit prej atyne qi u asht provuar zotësija me dokumenta.

Misa të jashtëzakonshëm janë:

1) Nji farmacist-qimimist prej nëpunësve shtetnore, dhe në mungesë të këtillit nji prej farmacistëvet qi ushtrojnë kët profesion në Kryeqytet:

2) Nji prej dentistvet qi ushtrojnë profesionin e vet në Tiranë, prej atyne qi do të kenë edhe diplomë mjekësie;

3) Veterinari ma i naltë ushtarake ose i Ministris së Bujqësisë dhe në mungesë të këtillësh nji i tillë civil;

4) Nji përfaqësuës i Ministris P. të Mbrendëshme;

5) Drejtori i Përgjithëshëm i Ministris së P. Botore;

6) Shef' i seksionit të Doganavet në Ministrin e Financavet ose nji përfaqësues i asaj Ministrije;

7) Kryeprokurori i Diktimit.

Për veç misave të rregullshëm e të jashtëzakonshëm Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë ka të drejtë të grishi në mbledhjet e Këshillit, pa të drejtë vote, cilin do që mundet si mbas dijenisë së tij speciale, të këshillojë trupin shëndetësuer për veprimet e veta.

Për të tilla qëllime atyne qi banojnë në Kryeqytet nuk do t'i epet kurfar ndonji shpërblim, por atyne qi banojnë nëpër vise larg Kryeqytetit do u jepen shpenzime udhëtimi dhe djete të caktueme në bazë të vendimit qi ka me ba Këshilli i Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, dhe i tilli shpërblim nuk mund të kalojë gradën e të drejtave të Prefektit.

Ata prej misave të rregullshëm ose të jashtëzakonshëm qi nuk kanë ndonji nëpunësi shtetnore, qi të munden vetë drejtësisht të bahen misa të Këshillit emnohen në këtë detyrë mbas proponimit të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësiës e me Dekret të Republikës. Mjeku, Farmacisti e Veterinari civil duhet të kenë për së paku 5 vjet ushtrim në profesionin e vet.

Do të mbeten në këtë shërbim dy vjet dhe në mbarim të këtyne mundet m'u zgjedhë rishtas. Këta pushohen nga detyra për shkake të justifikueme në bazë të ligjës mbas nji raporti me arësyetime të plota të Këshillit të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Ky vendim për t'u dekretue do t'i paraqitet Kryesisë së Republikës me anë të Ministris së Punëve të Mbrendëshme.

Art. 6. – Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë ka këto detyra:

1) Kërkon prej zyrave shëndetësore shpjegime përmbi gjendjen shëndetësore të Shtetit dhe tregon mënyrën e veprimit mbi masat qi duhen marrë për përmirësimin e sajë;

Jep instruksjonet e duhuna për mbi çeshtjet qi i përkasin mjekësisë dhe shëndetësisë e përgjithësisht kurse i kërkohet mendimi prej zyrave shtetnore të ndryshme; jep mendimin për çeshtje qi parashikohen prej kësaj ligje ose prej ligjeve të tjera të Shëndetësisë; tregon masat e sistemet qi duhen marrë e ndjek prej zyrave përkatëse për mbi çeshtjet qi kanë të bajnë me hygjenën publike, si me thanë; mirësim tokash (bonifikim), tharje moçalesh e kënetash etj.

2) Proponon Ministriës, qoftë mbas kërkimit prej anës së asaj qoftë prej vetiut, tërë masat qi quhen të nevojshme për mirësimin e gjendjes shëndetësore të Shtetit;

3) Parashtron Ministriës proponime për mbi përpillimin e Projekt-Ligjeve dhe t'urdhënave shëndetësore ose për mbi modifikimin, interpretimin si edhe abrogimin e këtyne përgjithësisht ose pjesërisht;

4) Vëzhgon (këqyrë) në se ushtrohet rregullisht mjeksia dhe profesionet ose mjeshtëritë qi kanë lidhje me këtë;

5) Mejtimi i Drejtorisë duhet me u kërkue për mbi kundërshtimet (apelet) qi bahen kundra vendimeve të Këshillit shëndetësuer të Prefekturave si dhe përmbi kundërshtimet e parashtrueme dhe kundërshtimet të cilat po janë vendue nga ana e Prefekturave për çeshtje qi janë krijue ndërmjet Bashkisë dhe mjeksve të tyne, si dhe përmbi kundërshtimet qi bajnë komunet, qytetsit dhe personat morale kundra shërbimit shëndetësuer të spitaleve ose të klinikave private;

6) Kontrollon ç'do Institut nga ata qi u treguan ma sipër në paragrafin 5, (spitale, klinika), dhe ata qi tregohen në paragrafin 12 (ujra metalike), qoftë se të tillat do të jenë dhe do të përbajnë persona morale qoftë se janë sipërmarrje, dhe parashtrohen raportat e Ministris së P. të Mbrendëshme si dhe proponime për nji rregullim ma t'arsyeshëm për mbi veprimet e këtyne Institutave të cilat imponohen si të detyrshme prej autoritetëve kompetente;

7) Shfaq mejtim të prem mbi çeshtje kontestuese qi kanë të bajnë me mjekësinë ligjore;

8) Proponon si mbas ligjevet në fuqi krijimin (çeljen), këthimin e tjetër kujt ose mbylljen e farmacivet, përpillon çmesën (tarifën) e barnave dhe tregon ç'do gjë qi ka të bajë me përdorimin e barnave dhe të helmeve;

9) Aprovon mostrat e kininës qi do të vihen për të shitun prej Shtetit si dhe ç'do lloji kinine qi do të hyjë në Shtet;

10) Jep mendimin e vet për mbi caktimin e përgatitjeve të kininës, qi do të tretet ose përgatitet prej Shtetit për t'u përdorun prej popullit si dhe për mbi formën e mënyrën e të shpërndamit të këtillave përgatitjeve;

11) Shenon të sëmurët e vaksinat qi duhen të kontrollohen në se janë të thjeshta ase të pa përzieme dhe cakton rregullat për përmbajtjen e tyne;

12) Kujdesohet për mbi burimet e ujnave metalike sheruese;

13) Ven në provim ata prej praktikanve farmacista, dentist, mami dhe rrethpresës (synetçi) qi kërkojnë leje për me ushtrue profesionin e tyne si mbas ligjës;

14) Rëfen mejtimin e vet për mbi dënimet disiplinore qi do t'u vihen mjekve, farmacistëve, dentistëve, mamive, si dhe për mbi shpërblimin ose pagesën të kqyrjes (vizitës) mjeksore qi munden t'u jepen për çeshtje qi u përkasin ushtrimit të profesionit ose të shërbimit të tyne si mbas rregullave të përkatëshme;

15) Proponon emnimin, gradimin, transferimin ose pushimin

si dhe ç'do shpagim ose dënim të personalit të shëndetësisë shtetnore, mbas ligjeve në veprim,

16) Pregatit buxhetin e shëndetësiës të cillin e paraqit me anë të Ministris së P. të Mbrendshme për shqyrtim dhe pëlqim;

17) Ushtron detyrat qi i ngarkohen prej ligjeve dhe rregulloreve që do të votohen pas kësaj ligje.

Art. 7. – Drejtori i Përgjithëshëm i Shëndetësiës për veç detyrave qi ka së bashku me misat e tjerë të Këshillit, për të cillat bëhet fjalë n'art. 5 të kësaj ligje ka veçanërisht dhe detyrat qi ndjekin:

1) Drejton të gjitha çeshtjet qi i përkasin shëndetësis publike;

2) Shqyrton raportat e shkresat e ndryshme të dërgueme prej mjekve nëpunsa të Shtetit ase të komunave, ase mjekësve privat, si edhe shkresat e dërgueme prej Ministrive, prej zyrave shtetnore të ndryshme dhe i jep përgjegje atyne shkresave për të cilat nuk ashtë nevojë të kërkohet mendimi i Këshillit të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë si mbas art. 6 të kësaj ligje;

3) Pregatit landën për mbi të cilën duhet marrë mendimi i Këshillit dhe i a parashtron këtij;

4) Kujdesohet për mbi përfundimin e votimeve të Këshillit;

5) Parashtron Ministriës P. të Mbrendëshme masat e marruna e t'urdhënueme prej Këshillit në konformitet t' art. 6 të kësaj ligje; dhe

6) Mbishikon për mbi përmbarimin e paramasave të marruna dhe t'urdhënueme prej Këshillit të Drejtoriës.

Art. 8. – Këshilli i Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë për me zbatue shërbimet e veprimet e veta mblidhet për së paku nji herë në javë rregullisht ndër ditët që do të caktojë ky trup dhe jashtëzakonisht kurdoherë që të paraqitet ndonji çashtje e ngutshme ose me randësi.

Art. 9. – Këshillin e Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë në mbledhjet e veta e Kryeson Drejtori, dhe në mungesë të tij, tue mos qenë gati ose tue qenë i penguem, e kryeson misi i rregullshëm nga mjeksit ay qi do të jetë më plaku nga të tjerët, dhe këtë të fundit në e lyptë nevoja e zëvëndëson misi tjetër i rregullshëm nga mosha ma i ri nga i pari.

Në rasë qi Drejtori ndodhet me leje dhe pengohet përkohësisht, për me krye detyrën e këtij për përmbarimin e punëvet të Drejtoriës ky vetë e cakton zëvëndësin e përkohëshëm të tij.

Inspektori merr pjesë në Këshillë vetëm kur gjindet në Kryeqytet.

Mbledhja ndodhet në shumicë, tue ndodhë gati për së pakti gjysma e misëvet të vetë mjekës, veç Drejtorit. Në mungesë ose tue qenë të penguem disa prej misavet të rregullshëm mjekës, Drejtori për të formuar shumicën mundet të thërrasë numrin e lypun për atë shumicë prej misëvet të jashtëzakonshëm: Farmacistin, Dentistin ose Veterinarin, të cilët përveç të këtillës rasje munden me u thir dhe kurdoherë që Drejtori ndin të nevojshëme ndodhjen e tyne. Misat e zakonshëm thirren kurdoherë që i kërkon nevoja.

Të drejtë vote kanë vetëm misat e rregullshëm ose ata prej misavet të jashtëzakonshëm që duhet të zëvëndësojnë këta, si edhe ata që u përket çashtja për të cilën thërriten të japin mendimin e vetë; për mbi çashtjet qi i përkasin mjeksiës vetëm misat mjekës kanë të drejtë vote. Në njesi votash rëndon ana që ka votue Drejtori ose zëvëndësi i tij.

Art. 10. – Drejtori i Përgjithëshëm i Shëndetësiës dhe misat qi janë nëpunës nuk marrin shpërblim të veçantë për mbledhjet për veç mjekësvet privat nga misat e rregullshmë të cillët për ç'do mbledhje marrin fr. ari 10 tue mos kalue fr. ari 40 për muej.

Art. 11. – Drejtori i Përgjithëshëm i Shëndetësisë propozohet prej Ministris së P. të Mbrendëshme në bazë dokumentash dhe titujsh (tituj shërbimi dhe shkencore) midis mjekve të Shtetit dhe emnohet me vendimin e Këshillit Ministruer e me Dekretin e Kryesis së Republikës me rrogën e caktueme në budget.

Art. 12. – Drejtorija e Shëndetësiës në e kërkoftë nevoja mundet të bajë inspektime shëndetësore jo vetëm me anë t'Inspektorit të Shëndetësisë por dhe me anë të misëve të vetë të rregullshëm ose të jashtëzakonshëm tue u ngarkue këtyne këto barrë me vendimin e Këshillit të vetë.

Art. 13. – Për me zbatue shërbimin e përmbrendëshëm të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shendetësisë emnohen pranë kësaj nji Kryesekretar me rrogë të caktueme në budget, nji Sekretar qi ban detyrën e Llogaritarit, nji Protokolist Arshivist e Kopist me rrogë qi do të caktohet në budget, dhe nji Shërbëtuer-Ftues me rrogë mujore si mbas budgetit.

Në rasë nevoje mundet me u emnue dhe nji Ndihmës Sekretar me rrogë qi caktohet në budget.

Kryesekretari do të jetë mjek e zgjidhet prej Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësisë mbas nji konkursi në bazë të dokumentave shkencore; preferohen specialistat në degën e Bakteriologjisë. Kryesekretari duhet të ketë krye me sukses profesjonin mjeksuer jo më pak se tre vjet rishtazi, gjithashtu duhet të dijë frengjishten ose gjermanishten, ose italishten ose inglishten. Kushtet e konkursit do të caktohen në rregulloren e mbrendëshme të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Sekretarë emnohen ata qi me anë dokumentash që do t' i paraqesin Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë do të vërtetohet se kanë mbarue Gjimnazin ose ndonji shkollë tjetër të kësaj grade dhe që kanë shërbyer jo ma pak se tre vjet si Sekretar në ndonji zyrë qeveritare ose bashkije.

Art. 14. — Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë ka nji Bibliothekë për begatimin e plotësimin e të cilës jepet nji kredi e përmotshme sasija e të cilës do të caktohet me budget. Librat që do të sillen do të caktohen prej Këshillit të Drejtorisë.

Gjithashtu kjo Drejtorië boton nji revistë në të cilën pasqyrohen veprat e misave të sajë, urdhënat e rregullat e shëndetësisë dhe ç' do landë qi i përket kësaj; kushtet e kësaj reviste caktohen me rregulloren e mbrendëshme të Drejtorisë.

Drejtorija ka Vulë Zyrtare të vetën e cila mban emnin e këtij grupi.

Art. 15. — Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë autorizohet të përpillojë rregulloren e mbrendëshme të vetë, që duhet t' aprovohet prej Këshillit Ministruer, me anë të së cilës caktohet mënyra mbas të cilës kjo Drejtorië do kryej detyrat e veta në konformitet të kësaj ligje.

Kaptinë e II-të

Për mbi Inspektorët e Shëndetësisë

1. Inspektori i Shëndetësisë

Art. 16. — Pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë emnohet nji Inspektor i Shëndetësisë me rrogë të caktueme në budget.

Inspektori i Shëndetësisë emnohet mbas propozimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë dhe emnimi i tij bahet me vendimin e Këshillit Ministruer dhe me Dekret të Kryesis së Republikës. I propozuemi do të ketë pasë ushtrue për 5 vjet

reshtazi me sukses profesionin mjeksuer dhe prej atyne mjekësvet që do të jenë marrë me mikrobiologjinë e me shëndetësinë publike.

Pushimi i Inspektorve të Shëndetësisë bahet me vendimin të Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Detyrat e Inspektorit të Shëndetësisë do të caktohen me anë të nji rregulloreje të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë që duhet t' aprovohet prej Këshillit Ministruer.

2. Inspektorë të posaçëm të Shëndetësisë

Art. 17. — Në periudë të nji epidemie kolere, murtajë, tifus exanthematique dhe të çdo tjatër lëngate ngjitëse të randë mbrenda Shtetit, ose për me evitue rrezikun e të këtillash lëngatave mundet t' emnohen Inspektorë të posaçëm të Shëndetësisë prej mjekve privat, tue u preferue specialistët në degën e Bakteriologjisë.

Gjithashtu mund t' emnohen si Inspektora të Posaçëm të Shëndetësisë edhe mjeksit specjalistë të sëmundjeve venerjane (syphylografes) për me organizue nji luftim të dobishëm kundra këtyne sëmundjeve dhe posaçërisht kundra syphilisit. Këta emnohen mbas propozimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë me Dekret të Kryesis së Rëpublikës. Emnimi i tyne asht vetëm për kohën qi vazhdojnë sëmundjet në fjalë. Rroga e këtyne caktohet prej Drejtoris së Përgjithëshme te Shëndetësisë dhe u paguhet nga kredia e posaçme që caktohet në budget të kësaj Drejtorije për këtë qëllim.

Inspektorëve të posaçëm të Shëndetësisë u merr fund nëpunësia mbas proponimit që ka me ba Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë. Pushimi i këtyne bahet në mënyrën e sipertregueme për emnimin e tyne.

Detyrat e Inspektorëve të posaçëm të Shëndetësisë për sa u përket sëmundjeve që bahet fjalë në këtë Artikull, do të caktohen me anën e nji rregulloreje të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë që duhet t'aprovohet prej Këshillit Ministruer.

Kaptinë e III-të

Për mbi Këshillat Shëndetësore të Prefekturave

Art. 18. — Në qendër të ç'do Prefekture formohet nji Këshill Shëndëtësuer i Prefekturës.

Këtë Këshillë e kryeson Prefektî ose zëvëndësi i tij ligjuer. Kjo Këshillë përbahet prej Zyrtarit Shëndetësuer, si Nënkryetar,

prej Ingjinjerit të Prefekturës ose të Bashkisë, prej Veterinarıt të Prefekturës ose atij të Bashkisë, në ndodhen të tillë dhe prëj Kryetarit të Syndikatit Mjekësuer ose të Shoqërisë Mjeksore në asht se ndodhen të tilla.

Përveç kētyne Prefékti ka të dretë të grishi në mbledhjet e vet pa të drejtë vote e shpërblimi ç'do tjetër person të vendít që e quan të arsyeshme për të plotësuar qëllimin që ndjek Këshilli, nëpunës ose privat qoftë ky.

Kjo Këshillë mblidhet pa kur farë shpërblimi, por atyne që banojnë lark qendrës së Prefekturës u jepen shpenzime udhëtimi e djete në bazë të vendimit që do të merret prej këtıj Këshilli.

Detyrat e Sekretarit të Këshillit i plotëson Sekretari i Prefekturës pa të drejtë vote.

Detyrat e të drejtat e Këshillit Shëndetësuer të Prefekturës janë këto që vijojnë:

1) Të ketë dijeni për ç'do send që i përket gjindjes shëndetësore të qarkut të Prefekturës përgjithësisht dhe veçanërisht të ç'do Nënprefekturë, krahinë dhe të katundeve që përfshin Prefektura. dhe të rëfejë ç'do masë që mund të miret për të mirësue gjendjen shëndetësore të tyne,

2) Të jaqë mejtime për çdo çashtje shëndetësore që i paraqitet nga ana e zyrave kompetente dhe përveç kësaj t'i parashtrojë ajo vetvetiut Prefektit proponime 'për mbi marrje masash shëndetësore;

3) Të çfaqë mendimin për mbi masat shëndetësore që merren prej krahinave dhe katundevet dhe të mbishikojë me kujdesi përmbi zbatimin përgjithërisht të shërbimit shëndetësuer për krahinat e katundet;

4) Të përmbarojë ç'do tjetër shërbim që ka të bajë me shëndetësinë publike dhe që i ngarkohet prej kësaj ligje ose prej ligjevet të tjera si dhe ç'do shërbim që i ngarkohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë nga ata që përfshihen në paragrafin 4 t'art. 6.

Vendimet e Këshillit Shëndetësuer të Prefekturës u shtrohen shqyrtimit dhe pëlqimit të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Autorizohet Drejtorija e Përgjithëshme e Shëëdetësisë të përpillojë një rregullore me anën e së cilës të caktohen hollësinat e urdhënavet (dispozitavet) për mbi këshillat shëndetësore të Prefekturavet në konformitet të kësaj ligjë.

Rregullorja në fjalë duhet t'aprovohet prej Këshillit Ministruer.

Kaptinë e IV-të

Për mbi ndihmën shëndetësore mjek-qirurgjikore, mamisore dhe farmaqetike ndër komunet

1. Për mbi Qarket Shëndetësore të Shtetit

Art. 20. – Ç'do Prefekturë ndahet në Qarke Shëndetësore.

Ç'do Qark Shëndetësor përbahet ose prej komunes të nji qyteti që ka nji popullsi prej 10 mijë banorësh, ose prej nji komunes të nji qyteti të vogël të bashkuem shoqënisht me banorët e katundevet të qarkut ose më së fundi prej komunevet të ndryshme të bashkueme në Shoqëninë.

Art. 21. – Për mbrojtjen e Shëndetësisë të Qarqeve Shëndetësore të ndryshme dhe për ndihmat mjeksore dhe mamisore pa të holla të vobektëvet, si për ata mbrenda si dhe për ata jashtë banesës, dhe për të përndamunit nëpër të vobektve barna pa të holla, kujdesin do t'a kenë komunet qoftë veçanërisht qoftë të bashkueme në shoqëninë, kur të jetë se as mjekësit, as mamıt, as barnat nuk do të jenë të siguruеme me ndonji mënyrë tjetër.

Art. 22. – Komunet të cilat nga shkaku i gjendjes së tyne ekonomike, si dhe të gjendjes së tyne topografike të posaçme, gjith' ashtu dhe nga shkaku i popullsisë të paktë të tyne nuk ndodhen në gradë që të pajtojnë një mjek ose nji mami, për të pajtuar dhe për të mbajtur të tillë janë të detyruem të bashkohen me shoqnin tue u marrë vesh me shoqi-shojnë, e tillë marrëveshje duhet t' aprovohet prej Prefektit mbasi të digjohet dhe mendimi i Këshillit Shëndetësuer të Prefekturës.

Art. 23. – Kurse gjendja ekonomike e nji qarkut shëndetësuer, qoftë komunal qoftë i bashkuem në Shoqëninë asht e tillë që nuk ndodhet në gradë të përkujdeset vetiu për ndihma mjeko-kirurgjike dhe mamisore për të vobekët si edhe për kujdesimin shëndetësor t' atyne komuneve, atehere Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë duhët të paguej nga fondi i posaçëm i buxhetit të sajë të gjithë rrogën ajo vetë ose së bashku me komunet, personalit mjek-shëndetësuer, edhe të përkujdeset për barnat që lypen për të vobekët; gjith' ashtu duhet të kujdeset edhe për masat shëndetesore për të cillat ka nevojë qarku.

Art. 24. – Me nji rregullore të posaçme të Drejtorisë së

Përgjithëshme të Shëndetësisë do të caktohen Qarqet Shëndetësore të ndryshme të ç'do Prefekture të Shtetit.

2. Për mbi Zyrtarin Shëndetësuer

Art. 25. – Ç'do Qark Shëndetësuer i formuem në mënyrat e paratregueme n'art. 20 drejtohet prej nji mjeku i cili sjell titullin: Zyrtari Shëndetësuer (Officier de Santé).

Art. 26. – Zyrtari Shëndetësuer, rroga e të cilit do të paguhet prej komunës ose prej komuneve të ndryshme të bashkueme në shoqnim, do t' emnohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë e cila do të marrë për bazë proponimin e Këshillit të Bashkisë ose të përfaqësuesit të shoqnimit, dhe me vendim të Këshillit Ministruer e me Dekretin e Kryesisë së Republikës.

Emnimi i tij do të bahet mbas nji konkursi për tituj, të shpallun prej komunes ose shoqnimit si mbas rregullave që do të vendosen me një rregullore të posaçme të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Për të tillë detyrë do të preferohen mjekësit që janë të specializuem në degën e Shëndetësisë dhe të Bakteriologjisë.

Në rastë që do të mungojnë të tillë do të para preferohen ata që kanë sidomos tre vjet shërbim mjeksuer dhe në mungesë të këtillëve vjen radha e ma të rinjve në marrjen e lejes t'ushtrimit të profesjonit në Shqipëri.

Emnimi i mjekvet që fitojnë në konkurs do të bahet vetëm për dy vjet dhe për me u pranue definitivisht mbas kalimit të këtyne dy vjetëvet, Kryetar' i Bashkisë ose i Shoqnimit do të bajë hapat e lypuna pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë për emnimin e tij të përherëshëm ose për pushimin e tij.

Art. 27. – Pushimi i Zyrtarit Shëndetësuer në kohën që po vazhdon prova e tij, si mbas art. 26 të kësaj ligje, duhet biseduar dhe vendosur të paktën tre muaj para kalimit të dy vjetëvet nga ana e Këshillit të Bashkisë ose të Përfaqësuesit të Shoqnimit vendimi i të cilëve merr formën e preme mbasi të pëlqehet edhe prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Pushimi i tij bahet me vendim të Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 28. – Zyrtari Shëndetësuer i pezulluem nga detyra në vazhdim të periudhës të provës e mandej marrun rishtazi në shërbim po n'atë komune ose shoqënim me ose pa shkë-

putje prej shërbimit, vazhdon rishtazi shërbimin e ma parëshëm për me plotësue periudhën e provës.

Art. 29. — Pushimi i Zyrtarit Shëndetësuer pas kalimit të periodit të provës dhe të emërimit të tij definitiv bahet me vendim të Këshillit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë.

Art. 30. — Rroga e Zyrtarit Shëndetësuer duhet të jetë e caktueme nga an' e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësise tue u marrë parasyshë konditat e ndryshme të vendit dhe gjerësija e ç' do komunes dhe tue u dëgjuar edhe mendimi i Këshillit Shëndetësuer të Prefekturës.

Rroga do të paguhet në këste mujore:

1) Prej komunës ose Shoqnimit për ato që ndodhen në gradë për me e pague tërësisht;

2) Prej Komunës ose Shoqënimit së bashku me Drejtorinë e Përgjithëshme të Shëndetësisë për ato Komune ose shoqënime që janë në gradë t' i disponojnë gjysmën e rrogës;

3) Prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, kur qi konditat financjare të komuneve ose të Shoqnimit të ndryshme nuk ndodhen në gradë t' i bëjnë ballë vet-vetiu të tillë pagimi.

Për të tri keto kategori do të merren parasyshë dispozitat të reshtueme n' art. 21, 22, 23, 33 e 34 të kësaj ligje.

Art. 31. — Zyrtarët Shëndetësuer konsiderohen si nëpunësa qeveritarë (shtetnuer) dhe si të këtillë, varen drejt për së drejti jo vetëm prej Bashkisë ose prej Shoqnimit, por edhe prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë me të cilën bëjnë letër shkëmbime dhe të cilës urdhënat ekzekutojnë (përmbarojnë).

Kanë të drejtë pensioni si edhe nëpunësat e tjerë të Shtetit në konformitet të ligjës së pensionit të nëpunësave civilë, tue u shtrue pikërisht konditavet e detyrimevet që ay përmban.

Art. 32. — Detyrat e Zyrtarit Shëndetësuer janë këto që vijojnë:

1) T'u japë ndihmë mjekësore pa të holla të vobektëvet të komunës ose të shoqënimit të komuneve të ndryshme;

2) Të mbikujdeset për mbi konditat shëndetësore të komunës ose të komuneve të bashkueme në Shoqnim dhe për mbi shikimin për me u përmbarue pikë shërbimi shëndetësuer, si mbas dispozitavet të përkatëshme për mbi atë shërbim dhe të mbajë pa rreshtun në dijeni të plotë Drejtorinë e Përgjithëshme të Shëndetësisë me të cilën asht i detyruem të ndodhet me letër këmbim;

3) Të kujdeset për me luftue lëngatat e randa ngjitëse tue tregue masat e duhuna për me i prapsue dhe për me i kufizue, gjithashtu të mbikujdeset dhe për të marrë vetë drejtësisht të këtilla masa në rasa të ngutëshme, kurse parashifet se vonimi i të marrunit të këtillëvet rezikon përhapjen e ç' do lëngatës ngjitëse të rrezikëshme;

4) Të mbikqyrë zbatimin e dispozitavet të përkatëshme për mbi ushtrimin e mjeksisë dhe të profesjonevet që kanë të bajnë me të dhe të zbatojnë propozimet e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë dhe ndëshkimet disiplinore kundra atyne që ushtrojnë këtë profesjon jashtë ligjës tue u bazue në ligjën për mbi ushtrimin e profesioneve mjeksore;

5) T'inspektojë farmacistët, apoteket barnash, edhondojatrit, disifektorët, llizhet (banjat) dhe burimet metalike mjekuese;

6) Të kërkojë prej autoritetevet kompetente përmirësimin e gjëravet shëndetësore që nuk ndodhen në gjendje normale tue marrë gjithashtu masa për përmirësimin e shëndetësisë dhe për të marrë anën me pre hovin e ç do shkakut qi mund të cenosjë;

7) Të rëfej mejtimin e vet kur t'i kërkohet prej autoritetevet kompetente për mbi çështjet shëndetësore;

8) Të përpillojë në ç'do krye muaji raportat për mbi gjendjen shendetësore të komunes ose të shoqnimit të komunevet të cilat ja dërgon Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Në mbarim të vjetit të përpillojë raportin vjetor të përgjithëshëm për mbi gjendjen shëndetësore që ja dërgon gjith ashtu asaj Drejtorije.

Për veç sa u përmend ma sipër Zyrtarit Shëndetësuer i ngarkohen pa ndonji shpërblim të veçantë dhe sa vazhdojnë;

1) Të bëjë lishenimin (vaksinacion) dhe rilishenim të banorve të komunes ose të shoqnimit të komuneve, për veç rasave qi parashikohen n' art 39 të kësaj ligje;

2) Të drejtojë Zyrën e Shëndetësisë atje ku ndodhet e tillë;

3) Të drejtojë Laboratorjumin e Shëndetësisë të Bashkivet atje ku impozohet krijimi i të këtillit si mbas Art. 38 të kësaj ligje;

4) Të mbikqyrë shëndetësinë e shkollave atje ku nuk ndodhet ndonji mjek shkolluer i posaçëm;

5) Të mbikëqyrë shëndetësinë publike për sa i përket sëmundjeve venerjane (Blenorragie, Chancro mou, Syphilis) tue vizitue dhe shtëpitë publike (kurvore);

6) Të marrë përsipër shërbimin shëndetësuer të burgjevet;

7) Të bajë ekspertimet në mjekësiën ligjore tue marrë vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe djetet, si mbas ligjës së nëpunësavet, nga Ministrija e Drejtësisë;

8) Të mjekojë në qendër ku ushtron profesjonin e vet gjendarët e stacionevet të ndryshme. Por atje ku ndodhen Qendra Ushtarake ose Shkolla Gjendarmerije e Ushtarake mjekimi i ushtarëve ose i gjindarmëvet i ngarkohet mjekve ushtarakë;

9) Të marrë pjesë në komisjonin për me shqyrtue rekrutat e ushtarët;

10) Të shqyrtojë sendet hejore dhë barnat, si dhe ç'do tjetër send qi del në doganë dhe ka të bajë me mbrojtjen e shëndetësisë publike;

11) Të bajë shërbimin mjekësor të zyravet shëndetësore të portovet (limanevet) për veç rasave për të cilat flitet n'art. 43 të kësaj ligje.

3. Për mbi shërbimin farmaqetik dhe për mbi të përndamit në për të vobektët barna pa të holla

Art. 33. - Ndër komunet ose shoqënimet të formuëme në mënyrën e parashkrueme n'art. 20 ku mungon nji farmacië dhe kurse ata qi ndodhen në komune fqinjore dhe në qendër janë shumë të largme dhe të vajturit asht i zorshëm, për me sigurue nji shërbim të shpejtë dhe të rregullshëm për nji ndihmë mjeksore, Prefekti ose Nënprefekti tue pasun dhe mejtimin e Këshillit Shëndetësuer të Prefekturës dhe mbasi të marrë parasyshë gjendjen financjare të komunes ose t'atyneve të bashkueme në shoqnim si edhe randësinë e veprës së kërkueme prej mjekut, mundet me urdhënue qi të formohet detyrisht nji armar (dollap) farmaqeftik (armadio farmaceutico) i cilii do të jetë nën kujdesin dhe përdorimin e mjekut të Qarkut Shëndetësuer.

Art. 34. — Pajimi i armarit farmaqeftik kufizohet vetëm në barnat ma të domosdoshme dhe atë të nevojës së parë lloja dhe sasija e barnave do të caktohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Shpenzimet për krijimin e Armarit dhe furnitura e barnave i përkasin komunes ose shoqnimevet që për shkak të gjendjes ekonomike të vështirë nuk ndodhen në gradë të përkujdesen vetë për barnat për të vobektit shpenzimet i përkasin Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Barnat do t'u jepen të vobektëve pa të holla dhe të pasurve do t'ju nepen me nji çmim

ma të math nga ay i tarifës së cakueme e të pregatitun prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Vlefta e barnavet që do t'u nepen të pasunve, edhe sikur të jetë qi kjo t'i jetë pague mjekut, do të paguhet prej këtij ose prej së cilit nga klientat n'arkën e komunes ose të shoqnimit për llogari të këtyne ose për llogari të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë kur të jetë se kjo e fundit i ka fornizue barnat.

Me nji rregullore të posaçme të Drejtorisë së Përgjithëshëm të Shëndetësisë do të caktohen rregullat e përkatëshme për mbi krijimin e Armarit Farmaqeftik, për mbi caktimin e llojit të barnave dhe për mbi funkcjonin e tij teknik dhe administrator; gjith'ashtu do të caktohen edhe rregullat e kufizimit e të përndamunit pa të holla të barnáve nëpër të vobektët.

4. Për mbi Mamitë Komunale

Art. 35. — Në ç'do Komune ku nuk ushtrojnë mami me leje të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë emnohet prej kësaj Drejtorije ose prej Komunes dhe me aprovimin e Drejtorisë, nji Mami Komunale e çila detyrohet të japë grave të vobekta ndihmën mamisore pa të holla. Mënyra e pagimit të rrogës do të bahet në konformitet të Art. 30 të kësaj ligje.

Ndër komunet ku ndodhen Mami të cilat ushtrojnë lirisht mamisinë ndihma mamisore e të vobekve i ngarkohet njerës prej këtyne tue i paguar nji rrogë për këtë qëllim.

Art. 36. — Ç'do Mami Komunale detyrohet të mbajë nji rregjistër të pjelljeve në të cilat ajo ashtë gjindun gati, tue bërë në këtë shënimet e duhuna për ç'do pjellje.

Mamit Komunale në ç'do fund të muajit detyrohen t'i napin Zyrtarit Shëndetësuer të Komunes nji raport për mbi veprimet e veta,

Detyrat e tjera të Mamive Komunale do të caktohen me anë të nji rregulloreje të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

5. Për mbi Zyrën e Shëndetësisë të Bashkivet

Art. 37. — Ndër qytetet me nji popullatë prej 5.000 e lart banorësh dhe që formojnë nji qark shëndetësuer do të formohet me emnin Zyrë e Shëndetësisë nji shërbim bashkijak nën autoritetin e Kryetarit të Bashkisë e nën drejtimin e mjekut të

kësaj i cilli do të jetë edhe kryetari i kësaj zyre e cila asht kurdoherë nën kontrollimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Kjo zyrë do të ketë barrën e përmbarimit të masave shëndetësore të parashikueme prej kësaj ligje.

Autorizohet Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetësisë të bajë rregulloren me anë të cilës kjo zyrë do të kryej detyrat e veta në konformitet të kësaj ligje.

6. Për mbi Laboratoriumin e Bashkisë për mbishikimin higjenik e Shëndetësuer

Art. 38. – Ndër Zyrat e Shëndetësisë të qyteteve me nji popullsië prej 5.000 e lart banorësh mundet me u krijue nji Laboratorium i Shëndetësisë së Bashkisë nënë drejtimin e Zyrtarit Shëndetësuer me nji personal teknik t' aftshëm. Zyrtari Shëndetësuer, qi ashtë edhe Drejtori i Laboratoriumit duhet të jetë specialist në degën e Bakteriologjisë dhe emnimi i tij bahet me konkurs mbi tituj, si mbas rregullave që do të vendosën me nji rregullore të posaçme të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë t' aprovueme prej Këshillit Ministruer.

Kaptinë e V-te

Për mbi Lishenuesit (Vaksinatorët)

Art. 39. – Lishenimi edhe rilishenimi i banorëve të Shtetit, ndër vendet ku ndodhen Zyrtarë Shëndetësuer u barohet këtyne pa kur farë shpërblimi të veçantë. Në rasë epidemie lije në qoftë se Zyrtarët Shëndetësuer nuk mjaftojnë për të lishënuar popullin ose kur në disa vende mungojnë të tillë mjekë atëhere Prefekti ose Nënprefekti pasi të kërkojë mejtimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, bashkë dhe me këtë marrin dhe shpenzimet e udhëtimit.

Po të jetë se në disa vende nuk ndodhen as Zyrtarë Shëndetësuer, as mjekë privat, atëhere për të kryemit e lishënimit emnohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë nji Lishënuës i posaçëm i cili për kohën qi ka krye lishënimin merr rrogë qi do të caktohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë gjith' ashtu merr edhe shpenzimet e udhëtimit.

Lishënuësit e posaçëm transferohen ose pushohen mbas proponimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Detyrat e Lishënuësvet do të caktohen me anën e nji rre-

gulloreje të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, t' aprovueme prej Këshillit Ministruer.

Kaptinë e VI-të

Për mbi Mjeksit Shetitës

Art. 40. — Në zonat malarike të Shtetit, të caktuëme me rregullore të posaçme dhe ndër vise ku siphilisi asht tepër i përhapun, kur sasija e personalit shëndetësuer i Shtetit ose i komuneve nuk asht i mjaftë ose mungon krejt, për mbrojtjen botore prej këtyne sëmundjeve, në këto vënde munden t' emnohen Mjek Shetitës prej mjeksve privat.

Mjeksit Shetitës emnohen mbas proponimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë dhe me Dekret të Kryesisë së Republikës. Preferohen veçanërisht për këto detyra ata mjek qi me anë dokumentash u provohet se janë marrë me mikrobologji dhe në mungesë të këtillësh emnohen ata që kanë ushtrue për tre vjet mjekësinë me sukses.

Rroga e këtyne caktohet Prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë tue marrë parasyshë për caktimin e kësaj konditat e ndryshme dhe gjerësija e vendit ku këto do ushtrojnë.

Mjekësit Shetitës për veç rrogës dhe shpenzimeve t' udhëtimit qi caktohen së bashku për nji herësh (an blok) nuk marrin djetë të veçantë, si mbas ligjës të nëpunësve civil.

Mjeksit Shetitës pushohen nga puna me vendim të Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 41. — Për me sigurue nji shërbim të shpejtë e të rregullëshëm për ndihmën mjeksore autorizohet Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë me ju dhanë Mjekësve Shetitës në bazë të budgetit barna, materjal shëndetësuer dhe ç' do mjet për shetitje dhe për instalimin e tyne e të personalit të vet si edhe për të sëmurët, tue sigurue me këtë mënyrë krijimin Ambulancash Shetitëse dhe Dispenserësh.

Me nji rregullore të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë do të caktohet mënyra e formimit t' Ambulancavet dhe të Dispenserivet të drejtuëme prej Mjekësve Shetitës.

Kaptinë e VII-të

Për mbi personalin e Zyrave të Shëndetësisë Detare e Kufizore dhe atë të Lazaretevet (Karantinavet)

Art. 42. — Në ç'do porto (liman) të Shtetit ushtrojnë (fon-

ksionojnë) Zyra të Shëndetësisë Detare, Stasjone e Rrojë Shëndetësie; gjith' ashtu në vënde të posaçme krijohen edhe Lazareta d. m. th. stasjone shëndetësore për karantina. Qëllimi i këtyne ashtë qi të mbrojnë Shtetin nga të hymit e të përhapunit në këtë të lëngatave ngjitëse të rënda (kolerë, murtajë (peste), tyfos exanthimatique, edhe e verdhë) të cilat munden të vijnë me anën e komunikasjoneve; si edhe të mbikqyrin e të kujdesen për mbi gjendjen shëndetësore të porteve, t' anijevet dhe t' udhëtarëvet.

Shërbimi i Zyravet të Shëndetësisë Detare si edhe ay i Stasjoneve dhe Rrojeve shëndetësore kryhet prej autoritetevet të portos, ku ndodhen të tilla, dhe atje ku nuk ndodhen të tillë, shërbimi kryhet prej autoriteteve doganore, të cillat në të këtilla rasje për çështje që i përkasin shëndetësisë marrin urdhënat e duhuna prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Shërbimin mjeksor të Zyrave të Shëndetësisë Detare e kryen Zyrtari Shëndetësuer i vëndit pa ndonji shpërblim të veçantë, por në rasë që nuk ndodhen të tillë si edhe në rasë që Zyrtarët Shëndetësuer ndalohen ose pengohen për të kryem këtë detyrë atëherë Kapiteni i Portos ose autoritetet civil të vendit mund t'u a ngarkojnë detyrën e shërbimit mjeksuer të zakonshëm mjekve privatë me nji shpërblim që do të caktohet prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 43. — Në rasë që nevoja e kërkon që, ndër anijet që vijnë prej vëndesh jashtë Shtetit, për veç masave të vizitimit mjeksor të thjeshtë, të miren masa shëndetësore të rënda; atëherë mundet me u emnue nji personal shëndetësuer i posaçëm prej nji mjeku i cilli merr titullin: Mjeku i Shëndetësisë (Medecin de la Santé), prej nji Sekretari dhe prej nji sasie Rojtarësh të mjaftuëshme për të plotësuar nevojën e shërbimit, për gjithë kohën që do të jenë në veprim të këtilla masa. Të marrunit e masave të rënda duhet t'i proponohen Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë prej Mjekut të Shëndetësisë, në qoftë se do të jetë i tillë, ose prej Zyrtarit Shëndetësuer me anë të nji shkresë me të cillën do të vërtetojnë e do të justifikojnë nevojën për marrjen e të tilla masavet.

Si mjek i shëndetësisë për të tillë rasë preferohen prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetesisë ata që janë specializuar në degën e higjienës dhe te mikrobiologjisë. Këta do të marrin nji rrogë që do të caktohet nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Për Sekretarë preferohen ata që me anë dokumentash vërtetohet se janë marrë me punëra të financës dhe të llogarivet.

Si Rojtarë Shëndetësuer të portove emnohen rrojtësit doganash, tue u preferue ata që janë dhe detare; në mungesë të këtyne emnohen punëtorë deti.

Art. 44. — Personali i Lazaretit përbahet prej nji Mjeku të Shëndetësisë, prej nji Sekretari, i cili plotëson edhe detyrën e llogaritarit dhe të magazinerit, të Llazeretit, prej nji ose dy shoferësh (zjar ndezës), prej nji sasije infermieresh (kujdestar i të sëmurëve) dhë prej nji sasie rojtarësh të cilët kryejnë edhe shërbimin e disenfekcionit.

Mjekët, Sekretarët e Rojtarët e Lazaretëve emnohen në mënyrën qi parashikohet n'artikullin e ma parshëm.

Në rast nevoje drejtimi i Lazaretëvet mund t'i ngarkohet përkohësisht Zyrtarit Shëndetësuer të qarkut ku gjindet Lazareti. Në të tilla raste për kohën që Zyrtori Shëndetësuer do të shërbejë në Lazaretin detyrën e këtij duhet t'u a barosin mjekve të tjerë.

Lazaretet vihen në veprim ose pushojnë kurdoherë mbas proponimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 45. — Rroga e zjar ndezësit (shoferit) të Lazaretit dhe ajo e infermjereve caktohen prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë me këste mujore. Infermieret dhe rojtarët e Lazaretit i kanë kujdesimin e atyne që lëngojnë prej kolerës, murtajës, tyfos, exanthematique, ose ethes së verdhë, për veç rrogës mujore të rregullshme do të marrin për gjithë kohën që vazhdon mjekimi i të sëmurëvet me të tilla lëngata nji shpërblim tri fr. ari në ditë.

Art. 46. — Mjeksit e Shëndetësisë të Lazaretëvet ndalohen t'ushtrojnë profesionin mjeksor ndër popull për deri sa vazhdon shërbimi i tyne në kët detyrë; gjith' ashtu ndalohet edhe e të marrunit përsipër ç'do tjarër ofiqi ose nëpunësie shtetnore, bashkijake ose private.

Stacjoni i Lazaretit do të caktohet prej Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë. Në rasë nevoje mundet të krijohen edhe Lazareta të tjera mbas proponimit të Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Detyrat e Mjekësve të Lazaretit, detyrat e personalit tjetër, dënimet disiplinore e aplikimit të tyne, si edhe ç'do tjetër që i përket këtyne do të caktohet me anë të nji rregullores të

Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, sa herë që asht në rrezik shëndetësija e Shtetit prej kolerës, murtajës, dhe ethes së verdhë.

Art. 47. — Ndër shtetet principale të vijës kufizore ushtrojnë zyra, stacjone e roja shëndetësije, shërbimin e të cilve e kryejnë autoritetet doganore, të cilët për çështje që i përkasin shëndetësisë marrin urdhëna prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Shërbimi mjeksuer kryhet si mbas dispozitavet t' art. 43 të kësaj ligjë. Në rasë që nevoja e kërkon që të merren masa shëndetësore të rënda atëherë veprohet anallogjisht me dispozitat e art. 44, 45, 46, të kësaj ligje.

Kaptinë e VIII-të

Dënime dhe ndëshkime disiplinore

Art. 48. — Për dënimin e ndëshkimin e mjeksvet nëpunës të Shtetit ose të Komunevet, veprohet si mbas ligjëve të nëpunësvet dhe si mbas Kodit Penal.

Dispozita të posaçme

Art. 49. — Për mjeksit qi kanë bamun studimet e veta me bursa të Shtetit veprohet si mbas ligjës së posaçme mbi bursat kombëtare.

Gjith' ashtu gjith mjeksit qi kanë bamun studime me të hollat e tyne, do të përdoren prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë si përdoren mjekësit e Shtetit ose komunevet, por përdorimi i kētyne ndër ata vise ku do të shifet e nevojshme nuk do kalojë më tepër se nji vjet.

Në raste që këta nuk i shtrohen këtij detyrimi u merret prap leja e ushtrimit për në Shqipni, deri sa që të venë në detyrën e ngarkueme prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Dispozita të ndryshme

Art. 50. — Ligjët qi janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj ligjë mbeten pa fuqi.

Art. 51. — Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 52. — Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të populli, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 138/I dt. 14-VI-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 16-VI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 94

LIGJË, 16 Qershuer 1927.

Për mbi ushtrimin e profesjoneve mjeksore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Korrik 1927, Nr. 56

Kaptinë e I-rë

Kushte për ushtrimin e mjekësisë

Art. 1. — Për me ushtrue profesjonin e mjeksisë në Shqipni duhet:

1) Me pasë diplomë nga nji fakultet i mjeksis ose prej Universitetit;

2) Me marrun leje ushtrimi të mjeksisë prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë;

3) Mos me qenë dënuem me ndonji delikt qi ka për qëllim pezullimin e profesjonit, ose me delikte që sjellin një ndëshkim kundër lirisë personale ma tepër se tre vjet.

Art. 2. — Çdo mjekës shqiptar për me marrë lejen e ushtrimit të profesjonit të vet duhet t'i paraqitë vetë ose t'i dërgojë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë kopjen e diplomës së tij të përkëthyeme shqip dhe të rregjistrueme në një Zyrë Noteriale të Shtetit, bashkë me dëftesën përkatëse t'arkës shtetnore për pagimin e taksës prej fr. ari 100 (nji qind) si të drejtë leje.

Në rastë dyshimi t'indentitetit vetuer Drejtorija e përmendun mund të provojë t'interesuemin me një coloqium që do të bahet përpara Këshillit të kësaj Drejtorije. Në rastë rëzimi në provim nuk i këthehen të hollat e taksës.

Art. 3. — Çdo mjeksi nënshtetas i huej do t' i jepet leja e ushtrimit profesjonit mjeksuer në Shqipni vetëm në rastë që ky asht specialist në ndonji nga degat e mjeksisë dhe mbassi t' i paraqitë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë bashkë me diplomën edhe çertifikatën e specializimit të rregjistrueme në Zyrën Noteriale të Shtetit dhe mbassi të provohet zotsija e tij me nji coloqium të mbajtun para Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Mjeksit nënshtetas të huej për me marrë lejen e ushtrimit të profesjonit të vet detyrohen para se të prezantohen në coloqium, si ma sipër, të paguejnë n' Arkën e Shtetit nji taksë prej fr. ari 300 (treqind) të cilat nuk u kthehen në rastë që rëzohen në provim.

Art. 4. — Përjashtohen nga përmbushja e kushtevet të parapame n' art. 3:

1) Mjeksit nënshtetas të huej prej Shtetesh me të cilët në bazë traktatesh ose konvencjonesh mjekësvet shqiptarë u lejohet ushtrimi i profesjonit mjeksuer, tue aplikuar për të tillët dispozitat e parapame n' art. 2 të kësaj ligje në bazë të reciprocitetit;

2) Mjeksit e huej që thërriten nga ana e Qeverisë për shërbim të Qeverisë;

3) Mjeksit specialistë me famë prej vendesh të huej që thërriten për pakë kohë, por jo ma tepër se nji muej, nga ana e gjinis të sëmurit për me e vizitue ose me e mjekue.

Kaptinë e II-të

Kushtet për ushtrimin e profesionit farmaqeftik

Art. 5. — Kërkush nuk mundet me krijue ose me drejtue Farmacië po të mos jetë nënshtetas shqiptar, po të mos ketë diplomë të një shkolle farmaqeftike dhe pa pasë marrë lejen e posaçme të ushtrimit të profesjonit të tij prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë në konformitet të dispozitave t'art. 2 të kësaj ligje.

Art. 6. — Në rastë që në vëndin ku mjeksit ushtrojnë profesjonin e tyne nuk gjendet farmacië, si mbas ligjës, atëhere këta munden me përdorue e me drejtue me lejen e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë nji farmacie shtëpijake për klientat e tyne, për deri sa n' at vend të krijohet nji farmacië e rregulltë si mbas ligjës.

Art. 7. — Për farmacistët e huej prej Shtetesh me të cilët

Shteti Shqiptar ka lidhur traktate o konvencjone të posaçme për ushtrimin e profesjonevet reciprokisht aplikohen anallogjisht dispozitat e parapame n' art. 2 të kësaj ligje.

Farmacistët e huej të sjellun prej Qeveris për nevoja të Shëndetësisë publike, përsa kohë qè këta ndodhen në shërbim të Qeveris përjashtohen prej çdo kushti dhe formaliteti nga ato që përmenden në art. 2 e 3 të kësaj ligje.

Kaptinë e III-të

Kusht për ushtrimin e Odhondejaterisë (Profesjonit të Dentistit)

Art. 8. – Kërkush nuk mundet me ushtrue profesjonin e dentistıt në Shqipni pa mos qënë nënshtetas shqiptar, pa mos pasë diplomë të Shkollës së Odhondojatris dhe pa marrë leje praktikimi të posaçme prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, në konformitet t' art. 2 të kësai ligje.

Për dentistët e huajë prej Shtetesh me të cilat Shteti Shqiptar ka lidhur traktate ose konvencjone të posaçme për ushtrimin e profesioneve reciprokisht aplikohen anallogjisht dispozitat e parapame n' art. 2 të kësaj ligje

Kaptinë e IV-të

Kushte për ushtrimin e profesjonit të Mamisë

Art. 9. – Kërkush nuk mundet me ushtrue mjeshtrin e mamisë për pa patur diplomë dhe pa marrun leje nga Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë, e cila leje jepet mbas nji provimi para Këshillit të kësaj Drejtorije pa pagesë takse.

Përjashtohen nga kjo dispozitë, ato mami që ushtrojnë pratikisht mjeshtërinë e tyne, dhe janë të detyrueme me marrë leje prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë me anë të mjekut të Bashkisë të qarkut ose të rrethit të tyne. Këto mami do vazhdojnë me ushtrue mjeshtërinë e tyne deri sa ay vend të mos ketë nji mami me diplomë.

Art. 10. – Mamitë janë të ndalueme të përdorin në pjellje e sipër vegla (instrumenta) kirurgjike për me qitë foshnjen. Në rasë që foshnja nuk vjen mbarë, mamitë detyrohen të grishin nji mjek për me përmbarue të pjellmit. Gjith' ashtu janë të ndaluem të bëjnë mjekime gjinekologjike dhe të japin barna ose të shkruajnë receta, përveç në rastë që do të caktohen me nji rregullore të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Kaptinë e V-të

Detyrat e mjekësvet, farmacistëvet, dentistëvet e mamivet

Art. 11. — Mjeksit, farmacistët, dentistët e mamitë posa të stabilizohen në një qytet ose katund, detyrohen t'i njoftojnë autoritetit të vendit cilsinë e tyre, dhe të rregjistrojnë jetëshkrimin e tyre në nji rregjistër të posaçmë ku do të shkruhet emni dhe vëndi i banimit të tyre, Universiteti nga i cili ka marrë diplomën, numri e data e kësaj si dhe numri e data e lejes.

Të rregjistruemit në këtë mënyrë është e domosdoshme për ushtrimin e profesjonit të tyne mbrenda Shtetit.

Në krye të ç'do vjeti në ç'do Prefekturë me kujdesi të Prefektit ose të Kryetarit të Bashkisë përpillohen radhoj (lista) në të cilat shënohen emni mbi emni, vendi i banimit, Universiteti prej të cilit ka marrun diplomën, data e diplomës e numri i lejes të mjekësvet, farmacistëvet, dentistëvet e mamivet që ushtrojnë në atë Prefekturë profesjonin e tyre në ato kohë. Një kopje e këtij radhoj i dërgohet Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 12. — Gjithë mjeksit në ç'do rast vdekjeje detyrohen t'i njoftojnë Zyrës së Shëndetësisë së Bashkisë llojën e sëmundjes ose shkakun që shkaktoj vdekjen.

Kaptinë e VI-të

Përmbi ekspertimet mjekoligjore dhe përmbi pagesën e vizitës mjeksore

Art. 13. — *a)* Kur Zyrtarët Shëndetësuer kryejnë shërbimet që i përkasin mjeksis ligjore të cilat u porositen prej Gjykatësvet të Prefekturavet e të Nënprefekturavet etj. nuk marrin pagë të veçantë përveç asaj të djetevet dhe të shpenzimevet t'udhëtimit në bazë të ligjës së nënpunsavet, si edhe në rasë autosije për të cilën paguhen veçanërisht si mbas ligjës përkatëse për mjeksit privatë.

b) Shërbimin e pericisë mjekoligjore përpara gjykatave e kryejnë edhe mjek ligjistët të posaçëm tue preferue si të tillë ata që kanë dokumenta (dishmira) ushtrimi të posaçëm në mjekësinë ligjore të ndonji Universiteti, prej të cilavet dëshmohet se ata munden me ushtrue me mbarim të mirë (sukses) vepra

që i përkasin mjeksisë ligjore. Të këtillë mjekës emnohen me Dekret Presidencjal mbas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe pëlqimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

c) Në rastë që mungon ose ndalohet Zyrtari Shëndetësuer, si dhe mjek-ligjisti i qosaçëm, në qoftë se ndodhet diku i këtillë, për me krye detyrat e mjekut ligjist, të kryemit të pericis mjeko ligjore përpara Gjykatoreve u ngarkohet mjeksavet privatë me nji pagesë në bazë të ligjës për të cilën bahet fjalë më poshtë në paragrafin c) të këtij artikulli.

ç) Me nji ligjë të posaçme do të caktohen shumat e pagesës qi do t' u paguhen mjekësvet privatë për vepra perisije mjeko-ligjore si edhe për djetet e shpenzimeve t' udhëtimit të vajtjes e të ardhjes.

Gjith' ashtu me nji vendim rregullues të këshillit Ministruer mbas propozimit të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësisë do të caktohet tarifa e përgjithëshme për mbi pagesën e vizitës për mjekime që duhet t' ju paguhet mjekësvet nga ana e privatëvet.

Kaptinë e VII-të

Dispozita ndëshkimore

Art. 14. — Ushtron mjeksinë jashtë ligjës:

a) Kushdo që tue mos patur lejen e posaçme për me ushtrue mjeksinë në Shqipëri, merr përsipër të mjekojë sëmundje pathollogjike e kirurgjike, ose ushtron profesjonin e farmacistit, të dentistit ose të mamisë, pa patur lejen e duhur, ndëshkohet si mbas art. 16 të kësaj ligjë.

Dispozita e më sipërme mbi formalitetet e ligjës nuk aplikohen për studentat e mjeksisë të cilët ushtrojnë vepra ndihmëse të mjekësvet ose kur vendosen prej këtyne të fuudit pranë ndonji të sëmurit.

b) Po me ato ndeshkime dënohet dhe çdo mami qi kalon kufit e uëhtrimit të mjeshtrisë së saj, kufi që caktohen prej art. 10 të kësaj ligje.

Art. 15. — Ndalohet ushtrimi së bashku i profesjonit të mjeksis e farmacis prej nji personi qi ka të dyja cilësitë e sipër përmenduna, përveç rasave në të cilat në nji vënd nuk gjindet farmacië e rregullëshme, Në ç'do tjeter rastë këta duhet të zgjedhin njerën prej të dy profesjonevet për me ushtrue, e të mjekut ose të farmacistit.

Art. 16. — *a)* Kushdo që ushtron mjeksime jashtë ligjës ose i jep vehtes abuzimisht titullin e mjekut, ndëshkohet si mbas Kodit Penal;

b) Kushdo që mban farmaçië pa lejen e posaçme të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësisë për veç rasteve që përshkruhen n' art. 6 dhe 15, ndeshkohet si mbas Kodit Penal.

c) Ushtrimi i profesjonit të dentistit me diplomë ose pratikant qoftë i tillë ndeshkohet si mbas Kodit Penal.

ç) Ushtrimi i profesjonit të mamisë jashtë ligjës ndëshkohet si mbas Kodit Penal.

Art. 17. — Mjekët që në çdo rast vdekje nuk i njoftojnë Zyrës së Shëndetësisë së Bashkisë llojin e sëmundjes qi shkaktoj vdekjen, si mbas art. 12 të kësaj ligje ndëshkohen si mbas Kodit Penal.

Kaptinë e VIII-të

Dispozi të posaçme

Art. 18. — *a)* Kanë të drejtë të vazhdojnë me ushtrue profosjonin e tyne, gjith ata farmacistët praktikanë dhe pa diploma, shqiptarë qofshin ose të huej, të cilët e kanë ushtrue deri sot profesjonin e tyne me lejen e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë, në konformitet me ligjën respektive më datë 11-X-1921.

b) Kanë të drejtë me vazhdue t' ushtrojnë profesjonin e dentistit gjith ata dentista, shqiptarë ose të huej, që kanë pasë ushtrue atë profesjon deri më sot, edhe që kanë lejen e posaçme prej Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Art. 19. — Gjith ato ligjet që janë në kundërshtim me dispozitat të kësaj ligje mbeten pa fuqi.

Art. 20. — Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Art. 21. — Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej

Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 94/I 14-VI-1927 të Kryesisë së Senatit.

Tiranë, 16-VI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 95

LIGJË, 16 Qershuer 1927.

Për mbi marrjen e mjeksvet në shërbim etj. për luftimin e lëngatave ngjitëse të randa (maladies transmisosibles

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Korrik 1927, Nr. 56)

Art. 1. — Gjithë mjeksit që ushtrojnë profesionin e tyne në një qytet ose në një katund të Shtetit ku u çfaq ose është rezik që të çfaqet murtaja, kolera, tifus eksantimatik, ose ç do tjetër lëngatë prej atyne që rëfehen nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë si lëngata ngjitëse të randa, detyrohen të vihen në dispozicjon të autoriteteve me pagesë që do të caktohet prej asaj Drejtorije posa që këta do fillojnë në detyrë.

Të marrunit në shërbim të këtyne mjekësvet bahet me vendimin e Këshillit të Drejtorisë së P. të Shëndetësisë i cili ka me çaktuem hollësisht detyrat e këtyne mjekësvet me anë urdhënash të veçanta ose të përgjithëshme.

Art. 2. — Në rasë epidemije të ndonji nga lëngatat që përmenden ma sipër, kur nuk mjafton personali shëndetësuer i Shtetit, Këshilli i Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësise ka të drejtë të marrij në shërbim për ndalimin ose luftimin të kësaj epidemije ç' do mjek higjinollogë ose ç' do tjetër mjek me nji pagesë që do të caktohet nga ana e sajë dhe që fillon posa që këta të fillojnë në detyrë.

Art. 3. — Mjekësit e përmendun n' artikullin e sipërm detyrohen me pranue shërbimin që u ngarkohet mbrenda afatit të caktuem prej Këshillit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetesisë.

Lirimi i këtyne prej këtij detyrimi bahet prej Këshillit të Drejtorisë së Përgjithësme të Shëndetësisë.

Art. 4. — Në rast që mjekësit të detyruem si ma sipër re-

fuzojnë barën që u asht ngarkuar, ose nuk kujdesohen me krye detyrën, ndiqen dhe ndeshkohen si mbas Kodit Penal.

Art. 5. — Në rasë epidemije të ndonji nga lëngatat ngjitëse të sipër-përmenduna, mjekësvet që shërbejnë për spitale, ku mjekohen të sëmurët të goditun prej këtyne lëngatave, mundet me u shtue rrogat që kur fillon e për gjithë kohën që vazhdon shërbimi i tyne në të këtilla spitale. Gjith' ashtu infirmjeret dhe infermjerat veç rrogës mujore të rregullshme do të marrin edhe një shpërblim prej fr. ari 3 në ditë për gjithë kohën të mjekimit të këtillave lëngatash.

Art. 6. — Kurdoherë që, për ndalimin e përhapjes ose çfarimit të nji lëngate nga ato që parashikohen n' art. 1 ma sipër ashtë nevojë që disa sende të dikujt të shkatrahen ose të shduken, pronarët e sendevet të palujtëshme ose të lujtëshme kanë të drejtë dam-shpërblimi për sendet e tyne të shfarueme.

I tiili dam-shpërblim rregullohet nga ana e një komisjonit të përbërë prej Drejtorit të Përgjithëshmë të Shëndetësisë ose zavendësit të tij, prej nji eksperti t' emruem prej Ministris së P. të Mbrendëshme, dhe prej nji përfaqësuesit t' interesuemit. Në rasë që i interesuemi nuk do të pranojë vendimin e komisjoni atëhere dam-shpërblimi caktohet me anë të Gjyqit.

Art. 7. — Kurdoherë që, për ndalimin ose çfarimin e një epidemije të lëngatavet ngjitëse të randa të përshkrueme n'art. 1 të kësaj ligje, shifet nevojë e domosdoshme dhe e impozueme që të pushtohet prona vetjake të lujtëshme ose të pa lujtëshme për të ngrehur spitale, shëronjëtore, ose vënde për me veçue (izolue) të sëmunët, ose vorrezë ose Lazareta dhe të tjera kësilloj godinash, ose ashtë nevoja të u ndihmojnë fonksionit të tyne, atëherë me vendim të Ministrisë së P. të Mbrendëshme mund të pushtohen këto përdhunisht për nji kohë të caktueme ose të shpronësohen (eksproprijohën) si mbas ligjës tue ç' damtue të zotnit e tyre ose ata që i kanë marrë për të i shfrytëzuar.

Art. 8. — Ministrija e P. të Mbrendeshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Art. 9. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na. Kryetari i Repeblikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligje të pranueme dhe prej Dhomavet Legjislative si mbas shkresës Nr. 93/I datë 14-VI-1927 të Kryesisë së Senatit.

Tiranë, me 16-VI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 96

LIGJË, 16 Qershuer 1927.

Mbi shitjen e barnave e të helmevet dhe mbi inspektimin e farmacivet, t' apotekëvet barnash etj.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Korrik 1927, Nr. 56)

Art. 1. — Për mbrojtjen e shëndetësisë publike autorizohet Drejtoria e Përgjithëshme e Shëndetësisë të përpillojë herë pas herë nji rregullore me anë të se secilës do të caktohet ç' do gjë që i përket përdorimit, caktimit të vleftës së shitjes (tarifë) etj. të barnavet prej farmacivet, apotekavet barnash dhe instituteve që merren me shitjen e të tilla sendesh, si edhe ç' do lloj sendi helmues që përdoren prej sjencavet, mjeshtërive, industrive, bujqësisë etj.

Me anë rregullore do të caktohet edhe shitja e bojravet helmuese të përdorueme prej bojëshitësvet.

Art. 2. — Gjith' ashtu me anë rregulloreje të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë do caktohen rregullat për sa i përket inspektimit të farmacivet, t' apotekavet barnash, t' institutevet që kanë të bajnë me fornizimin, pregatitjen dhe shitjen të ç' do sendi farmaqeftik, mikrobiollogjik, organotherapeftik, dhjetitik. si dhe ç' do sendi tjetër të përdoruem prej mjeksis dhe shëndetësisë.

Art. 3. — Kundravajtësit ose ata që nuk konformohen me dispozitat e rregulloreve për të cilat bëhet fjalë në këtë ligjë, ndeshkohen si mbas dispozitave të Kadit Penal.

Art. 4. — Ç' do ligjë që vjen në kundërshtim me dispozitat e kësaj ligjë mbetet pa fuqi.

Art. 5. — Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6. – Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e këtij ligji të pranuem prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 92/I datë 13-VI-1927 të Kryesisë së Senatit.

Tiranë, me 16-VI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 97

DEKRET-LIGJË, 4 Korrik 1927.

Mbi 2.000 kuintal misër për të vobektët e Dukagjinit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Korrik 1927, Nr. 58)

Na Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme; mbasi asht ndigjuem e pëlqyem vendimi me datë 1-VII-1927 i Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Për me u shpërnda popullsis të vobektë të Dukagjinit, autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme me ble në mënyrë paksimi me anën e Prefekturës së Shkodrës nji sasie misri për kuintal 2.000 (dymijë).

Art. 2. – Për blemjen e këtij misri i shtohet budgetit të Ministrisë së Financavet në nji kapitull të posaçmë nji fond prej fr. ari 40.000 i cili do të përballohet nga teprica e budgetit udhtuer.

Art. 3. – Kjo dekret-ligjë hyn në fuqië me botimin e sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Finan-

cavet ngarkohen me zbatimin e sajë, dhe detyrohen me i paraqit në sesionin e afërmë Trupit legjislativ.

Tiranë, me 4-VII-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i P. Botore Zav.
Ministri i Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 98

DEKRET-LIGJË, 6 Korrik 1927.

Mbi rregullimin e pagesave të prapambetura bashkë me listën çkoqitse

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M Ë :

zbatimin e gjashtë copë pasqyrza qi tregojnë shkoqitërisht shumat e pengimevet të mbrruna e të pa pagueme për mungesë fondi të dikastereve të ndryshmë, për të pague si mbas Ligjit relativë mbi rregullimin e pagesave të mbrapambetuna, i aprovuem dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 140/I datë 4-VII-1927 të Kryesis Senatit.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Pasqyrza e pengimeve të marruna e të pa pagueme për mungesë fondi të Ministris së Financavet

Lloj' i shpenximit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Mobilje (Kryesi e Republ.) .	— —	80.000	80.000
Mobilje (Finance) . . .	500	3.200	3.700
Rroge	3.809	200	4.009
Shkresine	180	1.415	1.595
Zjarm e dritë	600	— —	600
Të vogla	70	230	300
Dërgesë të hollash . . .	370	635	1.005
Qira . . . , , .	1.500	2.500	4.000
Shpenzime gjyqi . , .	1.106	1.445	2.551
Udhtim djetë	879	10.032	10.911
Meremetime e ndertime . .	2.000	15.000	17.000
Regjistrim ndertesash. , .	1.500	2.200	3.700
Vërtetim taksash . . ,	160	— —	160
Skonto pullash . . , .	142	1.500	1.642
Kom. Pas. Shtetit Sarandë. .	— —	15.000	15.000
Nëpunsa të përkohshëm . .	— —	500	500
Festime	275	— —	275
Shtypshkrime	18.000	28.000	46.000
Banderol	— —	10.000	10.000
Automobil	— —	560	560
Dam Arke	1.000	— —	1.000
Shuma Fr. ari	32.901	174.417	206.508

Pasqyrëz e pengimeve të marruna e të pa pagueme për mungesë fondi të Ministriës së Drejtësiës

Lloj' i shpenzimit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Shpenzime hetimesh . . .	160	- —	160
Udhtim e djete	170	2.200	2.370
Qira . , ...	110	220	330
Shkresinë	200	60	260
Gjyqi Politik	— —	2.550	2.550
Zjarm e dritë	70	— —	70
Sherije	100	— —	100
Shuma Fr. ari	810	5.030	5.840

Pasqyrëz e pengimeve të marruna e të pa pagueme për mungesë fondi të Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetsisë

Lloj' i shpenzimit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Udhtim e djete	1.150	– –	1.150
Lishartuesa	500	– –	500
Të ndryshme	1.200	– –	1.200
Ushqim Spitali . , . .	900	– –	900
Zjarm e dritë , . . .	1.300	– –	1.300
Qira	2.000	– –	2.000
Rrogë	600	– –	600
Shuma Fr. ari	7.650	– –	7.650

Pasqyrzë e pengimeve të marruna e të pagueme për mungesë fondi të Ministris së P. të Mbrendëshme

Lloj' i shpenzimit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Rrogë	– –	1.920	1.920
Udhtim e djete	7.000	1.750	8.750
Të vogla	810	400	1.210
Meremetime	3.400	2.000	5.400
Shpenzime burgu . . .	18.500	2.000	20.500
Mobilje	3.000	300	3.300
Shkresinë	990	400	1.390
Zjarm e dritë	– –	360	360
Shpenzime internimesh . .	700	400	1.100
Ushqim t'internuemve , .	2.460	1.000	3.460
Shtypshkrime e shpenz. shtypi.	– –	1.000	1.000
Shuma Fr. ari	36.860	11.530	48.390

Pasqyrzë e pengimeve të marruna e të pa pagueme për mungesë fondi të Ministris së P. Botore e Bujqësisë

Lloj' i shpenzimit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Udhtim e djete , . . .	– –	3.000	3.000
Mbajtje udhash e urash , .	13.100	155.000	168.100
Shkresinë . , ...	– –	3.500	3.500
Të vogla , . , . .	– –	1.000	1.000
Shuma Fr. arı	13.100	162.500	175.600

Pasayrëz e pengimeve të marruna e të pa pagueme për mungesë fondi të të Ministris së P. të Jashtme

Lloj' i shpenzimit	Vjeti 1925-26	Vjeti 1926-27	Shuma
Shtypshkrime	— —	3.400	3.400
Dam-shpërblim shoferave të huej	— —	3.000	3.000
Komisjoni i kufive . . .	— —	11.000	11.000
Shuma Fr. ari	— —	17.400	17.400

Nr. 99

DEKRET-LIGJË, 16 Qershuer 1927.

(1) Mbi mënyrën e shpenzimit të huas për punë botore

(e botneme në Fletoren Zyrtare, 14 Korrik 1926, Nr. 58)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin Nr. . . . . datë. . . . . . . të Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Autorizohet Ministrija e Financavet me shpenzue prej huas për punë botore e për vjetin financjar 1927-1928 shumën e fr. ari 26.315.000.

Art. 2. — Shuma e përmendun n'artikullin 1 do të përdoret për:

a) Ndërtime rrugash;
b) Ndërtime urash të mëdha;
c) Ndërtime urash të vogla;
ç) Ndërtime limanesh;
d) Ndërtime, tharje e kanalizime;
dh) Ndërtim ndërtesh;
e) Ndërtim i hekur-udhës Tiranë-Durrës;
ë) Vepra bujqësore;
f) Studime për të gjithë punimet e shenueme në ndarjet *a-ë*.

Ndarjet e sipërthanuna kanë me u konsiderue si kapituj e mund të ndahen n'artikuj si mbas punimevet të ndryshme.

Art. 3. — Shuma e huas që do të merret e të shpenzohet në vjetin 1927-1928 do të fytyrojë në budget të veçantë, jo i

trazuem me budgetin e Shtetit për shpenzime të përgjithëshme. Në mbarim të vjetit financjar 1927-1928 Ministrija e Financavet bashkë me konsuntivin e vjetit financjar 1927-1928 asht e detyrueme të paraqesi llogari në vedi për sa asht autorizue të marrë e të shpenzojë nga huaja.

Art. 4. – Shpenzimet e bame për pune botore me anën e Shoqënisë huadhanëse «SVEA» prej kohës 1-I-1927 do te njehsohen në shumën e lejueme për prishje nga huaja.

Art. 5. – Ministrija e Financavet dhe ajo e Punëve Botore janë t'autorizueme për zbatimin e kësaj ligjë.

Tiranë, me 16-VI-1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

(Shih listën shpjeguese në faqen 322)

([1]) *Lista shpjeguese mbi mënyrën e shpenzimit të huas për punë botore*

Nr. rend.	Ndërtim rrugash	Fr. ari	Ura të mdhaja	Gjatësija m.	Fr. ari	Ndërtim definitiv i urave provizor qi janë ndër rrugat qi eksistojnë	Fr. ari
1	Elbasan-Korçë.	225.000	Ura Topojanit	21	25.000	Durrës	300.000
2	Rogozhinë-Lushnje-Fieri .	175.000	Ura Kukësit	145	150.000	Vlonë	300.000
3	Lushnje-Berat-Klisyrë . .	80.000	Ura Elbasanit	45	30.000	Korçë	175.000
4	Puka-Ura Vezirit . . .	450.000	Ura Drashovical	150	150.000	Gjinokas	150.000
5	Milot-Mat-Kukës. . . .	2.000.000	Ura Kotës	40	40.000	Berat	200.000
6	Lesh - Ungrej - Oroshi - Ura Vezirit	900.000	Ura Buenës	103	210.000	Elbasan	200.000
7	Rruga Dukagjin	750.000	Ura Kardiqi	40	80.000	Shkodër	300.000
8	Berat-Fieri-Semani-Karapunar-Fieri-Semani. . . .	50.000	Ura Mati	480.5	80.000		
9	Fieri-Patos-Ballsh	20.000	Ura Librazhd	90	200.000		
10	Tiranë - Qafa Krabës-Elbasan-Tiranë-Elbasan. . .	50.000	Ura Kumara	70	170.000		
11	Tiranë-Ura Beshirit-Kavajë	50 000	Ura Papri	110	200.000		
12	Tiranë-Murrizi	75.000	Ura Lezhës	116	250.000		
13	Shkreli-Thethi	75.000	Ura Gjoles	50	100.00		
14	Berat-Cerevodë-Korçë . .	200.000	— —	—	— —		
	Shuma	5.100.000			1685 000		1625 000

Ndërtime limanesh	Ndërtesa Qeveritare	Tharje e kanalizime	Studime gjithfar.	Përmbl. e buxhetit «Svea» 1927-1928
Durrës 3.000.000	Pallati Presid. 500.000	Vlona 300.000	250.000	Ndërt. rrug. 5.100.000
Vlonë 500.000	Parlamenti 125.000	Muzak. 300.000		Ura të mdha 1.685.000
Sarandë 500.000	3 Ministrina 400.000			Ura të vog. 1.625.000
Shen-Gjin 500.000	Kom. F. Arm. 60.000			Limane 4.500.000
	Kom. Gjind. 80.000			Tharje kanal. 600.000
	Spitale 300.000			Ndërtesa 2.115.000
	Post-Komand. 500.000			Studime 250.000
	Shkolla 150.000			Rr. hek. udh. 1.800.000
				Bulqësis 1.000.000
Shuma fr. ari 4.500.000	2.115.000	600.000	250.000	18.675.000

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 81

DEKRET-LIGJË, 5 Korrik 1927.

Mbi caktimin e kohës së shërbimit të rezervistëve' në katër muej

(e botueme në Fletoren Zyrtare, '4 Korrik 1927, Nr. 58)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit.

Mbi proponimin e Komandës së P. të Fuqis Armate;

Mbassi në ligjën Rekrutimit në fuqi nuk asht parapa shërbimi normal i rezervistëve;

Mbassi asht ndigjue e pëlqye mendimi i Këshillit Mtnistruer;

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Koha e shërbimit normal i rezervistëvet asht katër muejsh.

Art. 2. — Rezervistët thirren në shërbim me klasë.

Kur lypset pjesa e nji klasi, qitet me shortë përjashtimi i rezervistëvet qi i teprojnë numrit të duhun.

Art. 3. — Rezervistëvet të marrun në shërbim para kësaj datë nëpër Baonet kufizore u njehet shërbimi ç'nga data e paraqitjes në zyrat e rekrutimit.

Art. 4. — Ky Dekret hyn në fuqi c'nga data e shpalljes.

Art. 5. — Ministrija e P. të Mbrendëshm, e Komanda e P. e Fuqis Armate ngarkohen me zbatimin e këtij Dekreti dhe me paraqitjen e tij në Trupin Legjislativ në sesjonin e afërmë.

Tiranë, me 5 Korrik 1927.

A. ZOGU

Nr. 101

LIGJË, 3 Qershuer 1927.

Mbi transferim kredijet të Komandës së Përgjithshme të Fuqis Armate

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 18 Korrik 1927, Nr. 59)

1. — Për t'i bamë ballë nevojave të trupave të riformuem transferohet nji shumë prej fr. ari 107.611 nga artikulli «Blemje armësh» të budgetit 1926-1927, të Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate, tue i a mvesh artikujve rrogë graduatësh fr. ari 22.155, rrogë ushtari fr. ari 3.486, zjarm e dritë fr. ari 2.000, blemje kafshësh fr. ari 80.000.

2. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes.

3. — Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të inveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj ligjë të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 107 datë 30-V-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 3-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

(Shih pasqyrën faqe 325)

Projekt shtojcë në kuadrën e Komandës së P. të Fuqis Armate

për ushtrimin financjar 1926-1927

TRUPI	Oficera: Major	Kap. kl. I.	Kap. kl. II.	Toger	N. Toger	Aspirant	Të huej e civ.	Shuma	Grad. usht. me rrogë: Kapter	Reshtar	Tetar	Ushtarë	Shuma	Graduat ushtarë rrekrut: Kapter	Reshtar	Tetar	Ushtar	Shuma	Katshë: Hypje	Barrë	Shuma	
Baoni Vijosa . . .			— —			—	—	—	6	26	62	—	94	—	—	40	433	473	8	83	91	Formue me 1-XI-1926
Baoni Erzeni . . .			— —			—	—	—	6	26	62	—	94	—	--	40	443	473	8	83	91	» » 1-III-1927
Shtesë për 2 Baterit mas nevojës së parapame			3/5			—	1	9	7	14	12	—	32	—	—	10	217	227	2	159	161	Shtue me 1-XI-1927 nji civil me fr.ari 200 në muejë
Shtesë për 4 qendra instruksionit, mitraliozit e mitr. Sulmues e ata të Vijosës. .			— --			—	—	—	—	14	11	—	28	—	—	10	76	86	114	114	114	» » » 1-II-927
Kompania e Xhenjos			— —			—	2	2	2	4	8	—	14	—	—	10	216	226	—	—	—	» » » 1-II-927 dy të huej
Aspirant të Shkollës .			— —			45	—	45	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	fr. ari (1) 560 në muejë (1) 400 në muejë
Shuma			3/5			45	3	56	21	84	154	—	262	—	—	110	1375	1485	18	439	457	
5 Batalion Kufizorë .			— —			—	—	—	—	—	—	—	—	20	35	65	1630	1750	20	90	110	Gradue më 21-I-1927 Formue më 15-III-1927
Shuma e Përgjith.			3/5			45	3	56	21	84	154	—	262	20	35	175	3005	3235	38	529	567	

Tiranë, më 28-II-1927.

Nr. 102

DEKRET-LIGJË, 9 Korrik 1927.

Mbi anulimin e taksavet të shenueme n'art. 4 e alinjatet a) e b) t'art. 22 të ligjës mbi Financat e Bashkive me datë 7-VI-1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Korrik 1927, Nr. 61)

Na. Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me Fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

Mbasi asht ndigjue e pëlqye vendimi me datë 3-VII-1927 i Këshillit Ministrue;

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Taksi i dy ureve të Shkodrës i shenuemë n'art. 4 të ligjës mbi Financat e Bashkivet me datë 7-VI-1926 ngrihet.

Art. 2. — Taks' i caktuemë n'alinjatet *a)* e *b)* t'art. 22 po të ligjës së tregueme n'art. 1 të kësaj ligjë për barkat me vel e motor, anulohet.

Art. 3. — Art. 4 e 22 të ligjës mbi Financat e Bashkiëvet me datë 7-VI-1926 për sa i përkasin taksavet qi merr Bashkia e Shkodrës prej Urës së Buenës e të Bahçallekut, dhe taksat qi marrin bashkit breg-deti, liqenë e lumejsh prej barkave me vel e motor, mbeten pa fuqië.

Art. 4. — Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi që me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. — Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Tiranë, me 9-VII-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 103

DEKRET-LIGJË, 24 Korrik 1927.

Mbi shtimin e tre policëve në Prefekturën e Korçës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Korrik 1927, Nr. 61)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit.

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme:

Mbassi u ndigjue e u pëlqye vendimi me 7-VII-1927 i Këshillit Ministruer:

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Kuadros së Policis së Prefekturës së Korçës të caktuemun në budgetin e vitit 1927-1928 i shtohen edhe tre policë të tjerë me nga një rrogë mujore 150 fr. ari.

Art. 2. — Rroga e policve të shenuem n'art. 1 e qi kapet në shumën fr. ari 5.400 në vjet, do të përballet me kursimet e bamuna në kap. 1 (rrogë qendër e qarqe) të budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme të vjetit 1927-1928.

Art. 3. — Ky dekret-ligjë hyn në fuqi ditën qi do të shpallet në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij dekret-ligji, dhe me paraqitjen e tij në Trupin Legjislativ në sesjonin e afërmë.

Tiranë, me 24-VII-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 104

DEKRET-LIGJË, 24 Korrik 1927.

Mbi pranimin e Konvencionit me shoqnin S. V. E. A. për ngrehje ndërtimesh me interesë botore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Korrik 1927 Nr. 62)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vulnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit;

Mbi proponimin e Ministrit të P. Botore;

Mbasi asht kënduem konvencjoni i bamë ndërmjet z. Musa Juka Ministër i P. Botore dhe z. Ing. Luigj Sottili, Përfaqësues për këtë çështje të Shoqëris S. V. E. A. i cili konvencjon e bashkanjitet këtij Dekreti;

Mbasi asht kënduem e pëlqyem vendimi i Këshillit Ministruer, datë 24-VI-1927 Nr. 186, me të cilin pranohet konvencjoni i nalt-përmendun dhe paraqitet nevoja qi të ngrehen sa ma parë ndërtesat e nevojshme për zyrat qeveritare për me kursye qira dhe për me pasë ndërtesa qi t'u përshtaten cillsivet të zyravet:

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Ndërmjet vepravet botore të përmenduna në artikullin e parë të ligjës së Konvencjonit 29 Maj 1925 të huas e qi do të bahen me mjetet e saj përshihen edhe ndërtesat e nevojshme për zyrat qeveritare.

Art. 2. – Ky Dekret hyn në fuqi ç' nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Ministrija e P. Botore dhe të Financavet ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji, dhe detyrohen me i a paraqitë Trupit Legjislativ në sesjonin e afërmë.

Në Tiranë, me 24 të Korrikut 1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

KONVENCJON

Për të vuemit në veprim e për zgjanimin e ndërtesave botore me fonde të huas.

Në lidhje me konvencjonet e bame ndërmjet të Qeveris të Republikës Shqiptare me njenën anë, të grupit financjar Italjan e të Shoqëniës për zhvillimin ekonomik të Shqipniës në tjetrën anë, me datë 15 Mars e 29 Maj 1925 të dyja të ratifikueme prej Parlamentit Shqiptar e të botuemë në fletoren zyrtare Nr. 36 me 13 Korrik 1925, me të cilat ndër tjera ishte vendue se S. V. E. A. do të kishte nxjerrë nji uha për punë Botore të Shqipniës.

Tue paravue:

Se në artikullin 1 të Konvencjonit të sipërthanun me 29 Maj 1925 asht kenë caktue ndër sa të tjera se nxjerrja e kësaj uha qi u tha do të vijnë vetëm për ndërtim limanesh, urash e rrugash, për punime tharje kënetash, brakash e tjera punime qi janë n' interesë të zhvillimit buiqësuer të vendit, për ndërtime hekurudhash, për vepra idroelektrike, ngrehje telefonash e telegrafash, shfrytzime pyjesh.

Që S. V. E. A. me 12 Nanduer 1925 asht përkujdesë për të nxjerrunit e huas qi u tha sipër tue e vue pranë nji Sindikati Bankash e Bankjerësh.

Që Qeverija Shqiptare ka kërkue mandej qi ndër punë botore qi janë për t' u ba me huan e ndëpër mjet të Ministris të P. Botore të jenë e shtime edhe ndërtimi i disa ndërtesave botore.

Tue mendue se Shoqënija për zhvillimin ekonomik të Shqipniës në marrëveshtje me Sindikatin e Bankavet e të Bankjervet, Asuntorët e huas, mendon se mund të pranojë kërkesat e sipër përmenduna të Qeverisë Shqiptare ndërmjet të Qeverisë së Republikës Shqiptare, përfaqësue prej z. Ministër i P. Botore z. Musa Juka, i autorizuem veçanërisht për të bamit e këtij Konvencjoni me veudim të Këshillit Ministruer Nr. . . . me. . . . . dhe të Shoqëriës për zhvillimin ekonomik të Shqipnisë (SVEA) e përfaqësueme prej Ingjinierit z. Luigj Sottili, asht ujdisë e vendue çë ka vijon:

Art. 1. — Artikullit të I-rë në rreshtin e 2-të të Konvencjonit me 29 Maj 1925 me të rreshtuemit e kategorisë veprash për t' u bae me huan, i shtohet tekstualisht, ndërtim ndërtesash qi ka interesë botore.

Për të vuemit e këtyne veprave në veprim mbesin në fuqië përshkrimet e konditat e caktueme në Konvencjonin për hua e mëndyrnat e procedurës të bamë për të vuemit në veprim të vepravet me anën e Ministris së P. Botore gjith' ashtu dhe rregjistrimet e urdhën-pagesavet pranë Këshillit Kontrollues.

Art. 2. – Çë do kundërshtim qi mund të dali ndërmjet të Qeverisë të Republikës Shqiptare e të Shoqënis për zhvillimin ekonomik të Shqipniës në Lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin të kësaj marrëveshtje do të zgjidhet prej nji gjyqi arbitral sikuerse asht caktue n'art. 12 të Konvencjonit të nalt përmendun.

E bame në kopje dyfishë, njena për Qeverinë e Republikës Shqiptare, dhe tjetra për S. V. E. A.

Tiranë, me 5 Korrik 1927.

Për Qeverinë Shqiptare
Minisri i P. Boore
MUSA JUKA

Për S. V. E. A.:

Nr. 105

DEKRET-LIGJË, 24 Korrik 1927.

Mbi blemjen e 1.000 kuintal misër për të vobektët e Nikaj Mertuer e për Malsin e Jakovës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Korrik 1927, Nr. 62)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme:

Mbasi u ndigjue e pëlqye vendimi me 7-VII-1927 i Këshillit Ministruer,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Ministrija e P. të Mbrendëshme autorizohet me ble në mënyrë paksimi me anë të Prefekturës Shkodrës nga dhetarët e atij qarku nji mij kuintal misër për t'i a nda gratis popullsis së vobektë të Nikaj-Merturit e Malsis Gjakovës në këtë përpjesiim: për Nikaj - Mertuer 700 kuital Malsis Gjakovës 300 kuintal.

Art. 2. – Për blemjen e këtij misri i shtohet buxhetit të Ministris së Financavet të vjetit 1927-1928 me nji kap. të veçantë nji fond prej Fr. ari 20.000.

Art. 3. – Kjo dekret-ligjë hyn në fuqië me botimin e sajë në fletoren zyrtare.

Art. 4. – Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje, dhe me paraqitjen e saj në Trupin Legjislativ në sesjonin e afërmë,

Tiranë, me 24-VII-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore Zav.
Ministri i Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 106

RREGULLORE, 22 Korrik 1927.

E Kryqit të Kuq Shqiptar

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Gusht 1927, Nr. 63)

Art. 1. – Sikurse bahet fjalë në statutin relativ, administrata e Kryqit të Kuq ndahet në dy dega:

a) Administrimi Qendruer;
b) Administrimi Qarkuer.

Të dyja këto dega drejtohen prej Drejtoris së Përgjithëshme të Kryqit të Kuq qi formohet prej personalit Administrativ të treguem në kuadron përkatse e lidhun budgetit të ç' do viti. Personeli i Kryqit të Kuq i sipër-përmendun ndihmohet dhe për sjelljen moralin e vazhdimin e rregullit në detyrën e tij asht nën kontrollin e përhershëm të nji komisionit përmanent i përbamun prej katër vetash. Ky komision do të zgjidhet e do të dekretohet nga Kryesija e nderit ku ka me u pëlqye e dekretue nga ajo e Nalta Kryesi. Atributat e nënkryesiës së nderit caktohen po nga ajo e naltë Kryesis.

Art. 2. – Administrata e Kryqit të Kuq do të ketë nji budget të përvjetëshëm e me burime t' ardhunash gjithfarësh e me fonde të parashikueme për nevojat e saja. Budgeti më një Mars të ç' do vjeti lypset të përpilohet prej Drejtorisë së Për-

gjithëshme të Kryqit të Kuq tue i a paraqit komisjonit i cili mbrenda në dy javë e shqyrton dhe e vërteton.

Art. 3. – Buxheti nuk mundet me u aplikue (zbatue pa pas autorizimin e Kryesis e pa qenë i shpallun në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ç' do burim t'ardhunash e ç'do shpenzim qi bahet nga Drejtorijarija e Përgjithëshme i shtrohet kontrollimit të komisionit. Komisioni e ban kontrollin e vet mbi pikat e sipër-shënueme rregullisht në mbarim të ç' do mueji dhe ato qi i gjenë konform me buxhetin e të mbështetun me urdhnin e kësaj rregulloreje i vërteton. Veprimet e bamuna kundra buxhetit të kësaj rregulloreje i rrefuzon dhe qi për këta ashtu dhe për të mbeta të tjera qi mund të shofin nga pikpamja financjare e administrative lajmëron me raport Kryesin e Nderit. Komisioni e ka për detyrë të lajmërojë Kryesin e Nderit në fund të ç' do mueji edhe mbi gjendjen e përgjithshme të Kryqit të Kuq. Kopja e ktyne rraportave do të mbahet në nji libër të posaçëm e në rregull.

Pregatitja e këtyne raportave bahet prej komisjonit dhe përshkruhet e rregjistrohet në librin e posaçëm prej nji nëpunsi të Kryqit të Kuq.

Art. 5. – Komisioni kuer të shofë nevojë ka të drejtë edhe kontrollime e hetime në ç' do degë qi i mvaret Kryqit të Kuq tue studjue librat, rregjistrat e tyre si dhe me kontrollue a po epet ushqimi si mbas ligjës qi flet art. 14 e veshjen e mbathjen e nxansavet, atelerijët e Strehës, gjendjen e nxansavet, mënyrën e distribusionit të qumshtit e të tjera. Në raste të këso dore nëpunsit e ç'do dege janë të detyruem të japin shpjegimet e nevojshme mbi pikat qi ay ka me pas nevojë me hetue e të parashtrojnë ç'do akt, libër a dokument qi atij kanë me ju dashtë për me krye veprën e vet.

Art. 6. – Nga pika e qumshtit mund t' u epet zakonisht ndihmë vetëm atyne të vorfënve qi vorfnija e vobeksija e tyne asht e vërtetueme me dishmi.

Art. 7. – Ç' do emnim i personalit t' Administratës të Kryqit të Kuq bahet mbi proponimin e Drejtorit të Përgjithëshëm të Kryqit të Kuq ose me vendim të komisionit, por merret pëlqim'i Kryesis Nderit në qoftë se rroga e nëpunsit kapërcen 100 fr. ari.

Art. 8. – Ç' do e hyme ose e dalun qi ndodhi në arkën e Kryqit të Kuq do të përfytyrojë në rregjistrat përkatse t' Ad-

ministratës e do të jetë e bazueme në rregulla të zbatueme ndëpër Financat e Shtetit.

Rregjistrat janë këta:

1) Libri i Arkës;
2) Libri i t' Ardhunavet;
3) Libri i të prishunavet;
4) Urdhën marrje;
5) Urdhën prishje.
6) Duer Arke e rregjistra të tjera ndihmësa.

Art. 9. – Për veç rregjistrave të shënuemun në art. 8. Për barnatoren Drejtorija e Kryqit të Kuq do të mbajë këto rregjistra:

1) Rregjistri i përgjithshëm i përditshëm;
2) Rregjistri i konsumasionit të barnavet;
3) Bilanci i të ardhunavet e i të dalunavet.

Art. 10. – Barnatori asht i detyruem të dorzojë dit për dit llogarinë e përditëshme ke llogaritari. Barnatori e ka për detyrë në ç' do shishe e paqetë të ngjisë nji etiqetë qi përmban vleftën e barit, numrin rradhuer të rregjistrit të përditshëm emnin e doktorit e të sëmundit dhe formulin e barit. Barnatori nuk ka të drejtë të shpërndajë barna gratis, qoftë edhe për personalin e Kryqit të Kuq, barna pa të holla mund të jepen vetëm duke u bazue në recetën e nji mjekut.

Art. 11. – Edhe në dispenserin do të gjinden këto libra:

1) Rregjistri ku do të jetë shënuemun emni e mbiemni vend banimi e mjeshtrija e atyne që janë vizitue.

2) Rregjistri ku do të jetë shënuemun lloja sasija e barnavet të përdoruemun.

Art. 12. – Vizitat në dispenseri do të bahen prej nji mjekut ose mjekses me diplomë, në qoftë se këta nuk gjinden ose nuk përfytyrojnë në buxhet këtë detyrë e ban Drejtori i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq. Në dispenserinë do të ndodhet nji zonjë a zojushë si infermiere dhe kjo do të ketë mbarue mësimet në shkollën e posaçme të infermieravet. Këjo infermiere ka me shërbye edhe në revirin e Strehës Vorfënore që bahet fjalë n' art. 15.

Art. 13. – Për pikën e qumështit Drejtorija e Kryqit të Kuq do të mbajë këta rregjistra:

1) Regjistër i konsumasionit të qumështit, i cili do të ketë në vrejtjen me ç sasi, kujt i asht dhanë dhe me ç' çëmim.

2) Rregjistri i observasionit të fëmive. Kjo degë do të mashtrohet prej Drejtoreshës së shkollës së infermieravet, prej nji nëpunses e nji shërbtores. Nëpunsija qi do të shërbejë në këtë degë do të zgjidhet prej nxansavet të Strehës Vorfnore.

Drejtoresha nuk paguhet për këtë shërbim me qenë se paguhet prej shkollës së infermiere-vet. Edhe nëpunsija nuk merr ndonji shpërblim mbasi ushqehet prej Strehës. Shërbëtorja paguhet si mbas budgetit.

Art. 14. — Nxansave të Strehës do të jepet ushqimi në lloje e sasi normale e në gjelltoren e Strehës për ç' do ditë do të jetë e mvarun tabela që modeli i sajë ndodhet i lidhun në këtë rregullore me germën (B).

Art. 15. — Në Strehën Vorfnore do të ketë dhe nji revir ku do të bahet vizitë e përditëshme n' orën 8 p. m. d. prej trupit mjekues të rrëfyem në art. 12. Në revirin e Strehës do të ketë gjithmonë gati 5 shtretën për me shtrue nxanësit e sëmurë. Në këtë revir shtrohen ata të sëmurë që kanë nevojë për nji javë mjekim. Ata të sëmundë që kanë nevojë për nji shërim ma të gjatë ose kanë sëmundje të randë dërgohen për mjekim në Spitalin e Shtetit. Në revirin do të mbahet nji rregjistër qi përmban emnin e të sëmundit, diagnostikën, datën e të hymes e të dalunit të sëmundit e barnat e dhanuna.

Art. 16. — Gjanat e ushqimit e të tjera që duhen për Strehën Vorfënore pikën e qumshtit, kolonjale, robe për mveshje e mbathje, mish, bukë, qumësht do të blehen në mënyrë paksimi në ankandë. Kushtet e adjudikatës caktohen prej komisionit ku merr pjesë edhe Arkëtari i P. i Kryqit të Kuq si kuer se shpjegohet në art. 29. Komisioni ka të drejtë edhe disa prej gjanavet të sipër-tregueme kuer të jetë i bindun se Kryqi i Kuq do të ketë ma dobi të vendosi të sillen nga jasht në nji rast këso-dore komisjoni vendos llojën e plaçkës që ka me u sjellë sasinë e sajë e autorizon Drejtorin e P. të Kryqit të Kuq për me krye gjith veprimet që lypen për sjelljen e marrjen në dorëzim të tyne.

Art. 17. -- Gjanat ushqimore të përditëshme si ve, barishta e të tjera që nuk kalojnë shumën e fr. ari 150 blehen me shumicë për nji javë me anë të ekonomatit që do të jetë i garantuemë si mbas sistemit të përdorun për nëpunsat financjarë që marrin e japin të holla.

Art. 18. — Pasunija e tundëshme dhe e pa tundëshme e

Kryqit të Kuq do të jetë e përshkrueme në nji inventar. Pasunija e pa tundëshme jepet me qira ose qeveriset nga ana e Komisionit.

Art. 19. – Për barnat që porositen e importohen prej së jashtëmi veprohet si mbas art. 18 dhe veçanërisht do të mbahen shënime të veçanta në arshivë dhe në barnatoren për të pas njoftim mbi xhiron, ndihmat dhe fitimet që duhet të ketë administrata e Kryqit të Kuq.

Art. 20. – Ç' do marrëdhanje që ushtrojnë Streha, pika e qumshtit barnatori, dispenserija e shkolla e infermierevet do të jetë e shënueme në librat përkatse të shtypun nga Drejtorija si mbas modelevet të pregatitun nga komisjoni. Këto libra do të jenë në gjëndje me tregue sasinat e të hymevet, të përdorimevet të përditëshme dhe të përgjithëshme dhe sasinat që mbeten pa u përdoruem në fund të ç' do vjeti.

Art. 21. –. Për ruejtjen dhe përdorimin e pasunivet të tundëshme dhe të sendevet ushqimore krijohet nji magazi e rregulltë me nji ekonomat i cili para se të emnohet mbasi të kryhen veprimet e tregueme n' art. 7 do t' i shtrohet edhe garanciës si mbas art. 17.

Art. 22. – Për pullat e Kryqit të Kuq të krijueme me ligjë qi janë shtypun e do të shtypen mbahet nji llogari e veçantë ndër libra të përputhëshëm mbi sasiët e shtypuna e të përndamuna ndër qarqe.

Art. 23. – Caktimi i formës dhe i sasiës së dekorasionevet bahen me urdhën dhe me pëlqimin e Kryesiës së Nderit, e cila ka edhe të drejtë e distribusionit. Në këtë mënyrë veprohet edhe për pullat që hynë në kategorinë e pullave të shënueme në art. 22 e qi krijohen e shtypen për koleksion, të shtypunit e së cilave mund të mbahet në shtetet e huaja me anë të ndonji legatës Shqiptare.

Art. 24. – Për ndihmat e mbrendëshme e të jashtëme qi i vinë Administratës të Kryqit të Kuq do të mirren shënime ndër libra të shtypuna për këtë qëllim. Në këtë libër shënohet ndihma mbi lloje të monedhës e kuer të shkëmbehet me të holla të tjera rregjistrohet e ardhun në librin përkatës. Ku do të ç' quhet me ç' monedhë asht shkëmbyem e me ç' kurse.

Art. 25. – Në rast të nevojës për ndonji transferim kredije nga njani artikull të budgetit me nji tjetër, ose kapitull merret vendimi i komisionit e mandej bahet pagesa.

Art. 26. — Për shpenzime të jashtzakonshme qi nuk figurojnë në budget komisioni nuk mundet me bisedue e me dhanë vendim pa qenë i urdhnuem mbi qëllimin e dobinë për se kërkohet të bahet ky shpenzim nga Kryesija e Nderit. Vendimet e Komisionit që kanë me u dhanë në bazë t' urdhnit t'asaj Kryesije nuk vehen në veprim pa i pëlqye e urdhnue veçanërisht e vuemja e tyne në zbatim po me urdhnin e asaj Kryesije.

Art. 27. — Ç' do organizim për me mbledh ndihma për Kryqin e Kuq do të jetë përshtat rregullores për mbledhjen e ndihmavet me 1925 e nuk mund të bahet pa vendimin e komisionit.

Art. 28. — Drejtorija e Përgjithëshme e Kryqit të Kuq nuk mundet të pranojë fëmijë të tjerë në Strehën vorfënore përveç numrit të parapamun në budgetin e ushtrimit përkatës.

Art. 29. — Komisioni për ankand të ndryshmë shitje blerje e për porosina sendesh që shpjegohen n' art. 16 e 19 formohet komisioni përmanent me këta antarë:

1) Drejtori i Përgjithëshëm i Kryqit të Kuq,

2) Antarët e Komisionit permanent.

Art. 30. — Për ankandet e ndryshme do të veprohet në dy mënyra: me sistemin me zarfa të mbyllura dhe me atë që bahet haptazi. Për dy mënyrat bahet shpallja me mjetet e nevojshme. Në rast paracaktohet vetëm një afat ditën e fundit e në orën e caktueme çilen zarfat prej komisionit që flet art. 29 e ju njoftohet prej klientavet fituesi si sipërmarrës. Në rast të dytë caktohet afati i adjudikatës provizore prej 20 dhe ay i adjudikatës definitive prej 10 ditësh dhe vazhdohet rregullisht.

Art. 31. — Trupi administrativ qarkuer i shtrohet dispozitave të parapapuna në këtë rregullore me sa të jetë e mundun. Për pikat të cilat nuk mund t' aplikohen ndër dega të qarkut duhet ba e dijtun Drejtorija e Përgjithëshme e Kryqit të Kuq dhe kjo do të napi urdhnat e duhuna si mbas vendimit të komisjonit.

Art. 32. — Drejtoria e Përgjithëshme e Kryqit të Kuq asht përgjegjës për ç' do vepër që nuk pajtohet me këtë rregullore dhe ka këto detyra:

a) Administron institutin me personalin e caktuem në kua dron q' i lidhet budgetit;

b) Ushtron detyrat mjeksore të dispenseriës, të revirit e të Strehës Vorfnore;

c) Qorton çdo nëpunës të Kryqit të Kuq e të degave të mvaruna prej tij, kur nuk sjellen mirë ose nuk vazhdojnë n'orarin e caktuem për nëpunsat e Shtetit me vendimin e Këshillit Ministruer, dhe në rast të përsëritjes mer masa për prerjen e rrogës pjesërisht ose plotësisht me anën e Komisionit;

ç) Të shikojë e të rregullojë të hymunit e të dalunit e sendeve ushqimore, të veshjes, mbathjes e të materjalit të Strehës, të dispenseris, të pikës qumshtit e të shkollës së infimieravet, të barnatores e tue kontrollue librat, rregjistrat e tabelat të numrumuna n' art. 8, 9, 11, 13, 14 e tue i nënshkruem vetë Drejtori i Përgjithëshëm asht drejt për drejt përgjegjës mbi mirë-administrimin e pikavet të caktuemuna në këtë artikull.

d) Ushtron buxhetin tue ba pagesa si mbas shenimevet financjare të tregumuna n' art. 2, 3, 8, 16, 17, 19, 25, 26 të kësaj rregulloreje.

Art. 33. — Drejtori i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq detyrohet edhe me vue në zbatim me nji herë vendimet qi ka me dhanë komisioni për pikat e shenumuna në këtë rregullore. Drejtor' i sipër-thanun po me këtë mënyrë ka me veprue edhe për vendimet qi kanë me dhanë nga komisioni për çeshtje qi nuk përmenden në këtë rregullore e qi janë n' interesë e në dobiën e për-mirëvajtjen e Kryqit të Kuq. Por, në rasë qi asht kundra vendimit, ka të drejtë t'apelojë çashtjen në Kryesië.

Art. 34. — Kuadroja e personalit caktohet në buxhet dhe detyrat e sejcilit do prej tyre kanë me u shpjegue në nji program të hartuem e të pregatitun nga Komisjoni.

Art. 35. — Me zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtorija e P. e Kryqit të Kuq ç' prej ditës së pranimit prej së Naltës Kryesi.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, mbasi u pa neni 3 i Statutit të Kryqit të Kuq Shqiptar.

Mbi proponimin e Ministriës së P. të Mbrendëshme:

DEKRETOJMË:

zbatimin e rregullores së Kryqit të Kuq këtu nalt të përshkrueme.

Në Durrës, me 22 të Korrikut 1927.

A. ZOGU

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 107

DEKRET-LIGJË, 2 Gusht 1927.

Mbi zbritje e caktim të tagrit doganuer të disa gjanave të tarifës doganore të vjetit 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 6 Gusht 1927, Nr. 64)

Na, Kryetari i Republikëst Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

Mbasi asht ndigjue e pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 26-7-1927;

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Tagri Doganuer i gjanave qi përshihen në listen e bashkalidhun do të merret si mbas shenimeve rispektive që përmbanë lista në fjalë.

Art. 2. – Kjo Dekret-Ligjë, hyn në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje dhe me paraqitjen e saj në Trupin Legjislativ në sesjonin e afërm.

Në Durrës, me 2-8-1927

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore Zav.
Ministri i Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

BKSH

Lista e tarifës doganore e vjetës 1926

Nr. rend.	Nr. Tarifës		EMNI I GJASË	Tagri si mas tarifës	Bahet për kuintal
1	25 d		Bakala e Aringa	–	–
	»	1	të krypuna a në shëllin . . .	25	25
	»	2	i thatë	50	50
2	46		Galeta peksimet ejt.	–	–
	»	a	galeta e peksimet	80	80
	»	b	Ekmek-kadaif (buke kadaif . .	20%/0	90%/0
	»	c	Petë Gjylaxhi	20%/0	100
3	66		Konserva pembësh e barishtnash e turshina gjithfarësh	120	120
4	73		Anason	–	–
	»	a	Koker	20	20
	»	b	Pluhun	20%/0	30
5	89	c	Faqoll (Glukosja) për sheqerxhi. .	20%/0	10
6	92	a	Pemë sheqeri të kristalizueme . .	100	100
	»	b	Sheqerna, konfeta e bombona . .	20%/0	120
7	117		Voj e undyra të ndryshme . .	–	–
	»	f 1	Voj Margarine	30	30
	»	f 2	Tëlynë e undyrë pemesh e Margarine	20%/0	200
		gj	Voj Soja	20%/0	150
8	139 f		Këpucë me shullë druni . . .	20%/0	250
9	142 d		Kollçi (gambali) lëkuret . . .	20%/0	250
10	168 i	4	Gjana drunit tjera të pa përmenduna.	20%/0	100
11	184 ç		Letra transparent me vojë . . .	20%/0	30
12	197		Libra gjithfarësh a. b. 1 e2 . .	60-15	tagri i fal.
13	206 c		Tire gjithfarësh për çarapë qylyma etj.	–	–
		1	Natyrel	40	40
		2	I zbardhun	50	50
		3	Me ngjyrë	60	60
14	211		Mbas fjalëve me nji shlesë tagrı 40%/0 t'i shtohen edhe frazat: Kur janë teper se 15%/0 e deri 49%/0 kanë me u randue me 60%/0 shtesë mbi tager kur kanë mo se 49%/0 klasifikohen: (me mëndafsh natyrel Nr. 254 b) me artificial Nr. 254 ç)	–	–

Nr. rend.	Nr. Tarifës	EMNI I GJASË	Tagri si mas tarifës	Bahet për kuintal
15	243 g 4	Dollak dhe goti	20	300
16	254 ç	Pelhurë artificiale e përzime me pamuk	$20^0/_0$	700
17	265	Kapela, fesa, qylaha, takije etj (tag. mbetet si mas tarif.)		
18	286 a 1	Linoleum për shtroje me ngjyrë a me lule, kur trashmenija të jetë deri 3 milim	45	45
„	a 2	Kuer të jetë ma tepër se 3 milimetër	45	35
19	276 b	Për mbloje e veshje mobiljeshe e perde dritoresh (tela cerata . .	60	60
20	100 c	Krem gjithfarësh për pastrim gjana metali	$20^0/_0$	30
21	324	Lampa me trumë qi ndezen me spirto gaz ose karbit:		
	a	Hekurit	400	100
	b	Metali tjetër	800	200
22	326	Hekur e çelik i shkrimë		
	a	Qylçe i pa punuem	1	0.50
	b	Grimca e pluhun	2	0.80
	c	I vjetër qi nuk hynë në punë për qëllim qi asht bamun . . .	5	2
23	327 a 1	Putrela, trena gjithëfarësh. . .	5	2
	» a 1	Hekura e vagona për dekovil e pjesët e tyne	5	2
24	345 c	Kakia, çerep, saça, tagar hekuri ose gize :	$20^0/_0$	10
25	351	Enë hekuri e gisë kuxhinet e shpijet:		
	» a	Të pa galvanizueme . . .	$20^0/_0$	20
	» b	Të galvanizueme	30	30
26	357	Sumlla, pulla metali, vathë, unaza me gurë falso etj. hekurit e çelikut .	85	85
27	360	Cilindra me daze ose oksixhen .	5	5
28	423 A	Makina telegrafi e telefoni e veglat e tyne përveç telave . . .	200	100
	» B	Makina e aparata radio-telegraf radiofon e kalamit (Rrëfe pritse) .	20	100

Nr. rend.	Nr. Tarifës	EMNI I GJASË	Tagri si mas tarifës	Bahet për kuintal
29	453	Zyjt, sere, bllak	10	10
30	465 C	Dyllë të kuq (cera lacca) . .	20°/₀	50
31	480 a	Ballkot (bare me mbytë peshk) .	I ndaluem	
	» b	Specialitete lang e pluhun për me mbytë miza e tjera insekte . .	20°/₀	10
32	483 c 1	Serum, Vaksina, Neosalvarsan e ekstret e tyne	tagri i falun	
»	» 2	Bare për gëlbaz të gjas së gjallë si fugermal, distol etj.	20°/₀	tag. fal.

Nr. 108

DEKRET-LIGJË, 28 Qershuer 1927.

Mbi zgjanimin e afatit për pagesat e qiravet të pasunis Shtetnore të Sarandës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Gusht 1927, Nr. 65)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit;

Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

Mbasi asht ndigjuem e pëlqyem vendimi me d. 23-VI-1927 i Këshillit Ministruer.

DEKRETOJMË:

Art. 1 — Afati i caktuem me paragrafin e I. të Dekret-ligjës me 25-II-1926 për pagimin e kistevet të detyravet zgjatet për nji kohë katër vjetësh tue fillue ç' nga dita qi ësht komunikue vendimi i Komisionit të formuemë me ligjën 28-VII-1925 për rregullimin e pasunis së Shtetit në Sarandë.

Art. 2. — T'interesuemvet si mbas § 2 të nenit 3 të Dekret-Ligjës me datë 29-3-1925 i u drejtuen Gjyqit mbrenda në 15 ditë nga data e komunikimit të vendimit të Komisjonit, qysh nga data e këtij Dekret-Ligji e deri në 6 muj. Financa nuk do t'u kërkojë kestin e caktuem prej saj për të drejtat Shtetnore të vendosuna nga Komisjoni. Në mbarim të gjashtë muejve do të veprohet si për të gjith të tjerët ose mas vendimit të Gjyqit në se i interesuemi doli fitues.

Art. 3. – Shuma e qiranave të vjetve të kaluem të caktuemë me vendimet e komisionit, u bahet nji zbritje prej 15 %₀ përgjithësisht.

Art. 4. – Ky Dekret-Ligjë hyn në fuqi ç' nga data e shpalljes.

Art. 5. – Ministrija e Drejtësisë, e Financavet dhe ato të P. Botore e Bujqësis ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji dhe detyrohen me i a paraqit në sesjonin e afërmë Trupit Legjislativ.

Tiranë, me 28 Qershuer 1927.

A. ZOGU

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav. Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 109

RREGULLORE, 5 Gusht 1927.

Mbi detyrat e kompetencat e Inspektorëve t'Administratës pranë Ministriës së P. të Mbrendëshme

(e botneme në Fletoren Zyrtare 9 Gusht 1927, Nr. 65)

Arr. 1. – Për me kontrollue veprat e sjelljet të nëpunsave të degës s' administratës civile, pranë Ministris së P. Mbrendëshme ndodhen dy Inspektora me rrogën e caktueme në buxhet.

Art. 2. – Inspektorët zgjidhen dhe emnohen si mbas dispozitave të ligjës organike të Ministris.

Art. 3. – Inspektorët kanë për qendër Kryeqytetin; në rasë t' inspektimit jashta qendrës, marrin shpenzime udhtimi e djete si mbas dispozitave në fuqi.

Art. 4. - Inspektorët në vëndet ku shkojnë për inspektim kontrollojnë dhe hetojnë këto pika;

a) Gjëndjen të qetësis publike dhe veprimet e sjelljet të nëpunsave t' administratës, të gjindarmeriës e të policis mbi sigurimin dhe ruejtjen të qetësis së vëndit.

b) Vendimet e Këshillave Administrative, veprimet e Zyrave të Shtetit Civil, dhe të Bashkivet ;

c) Veprimet mbi instalimin e emigrandëvet ;

ç) Gjendjen dhe administratën e burgjeve ;

d) Gjendjen e shëndetësis publike dhe administrata e Spitaleve dhe t' instituteve shëndetësore, si edhe gjithë veprimet e tjera të nëpunsave t' Administratës.

Art. 5. — Përveç pikave të nalt-shënueme, Inspektorët si mdas urdhnit qi kanë me marrë nga ana e Ministris P. të Mbrendëshme, hetojnë edhe ankimet e drejtueme kundra nëpunsavet dhe abuzimet e pretendueme dhe t' informueme t' atyneve.

Art. 6. — Inspektorët kuer ndodhen n' inspektim e sipër, pa pasë nevojë për urdhnin e ministris, mund të bajnë hetime mbi ç'do shpërdorim e abuzim qi kanë m' u informue ; edhe ç' do ankim qi ka me i u drejtue atyne ; gjith' ashtu janë të detyruem me hetue edhe çeshtjet e referueme nga ana e Prefektave mbi abuzimet e nëpunsave ku ata ndodhen për inspektim.

Art. 7. — Në fund të ç' do inspektimi bashkë me aktet relative dhe mbassi merren shpjegimet dhe përgjegjet e nëpunsavet t' interesuem, bashkë me aktet relative, i paraqiten raportat e nevojshme Ministris së P. të Mbrendëshme e cila mbi këta ban veprimet e duhuna. Aktet hetimore të kompozueme si mbas procedurës penale, ndjekin procedurën e caktueme me ligjën e posaçme. Këta u referohen Prefekturave ose Nënprefekturave për me u referue këshillave kompetente për sqyrtim e vendim; nji kopje të përmbledhjes së hetimeve i paraqitet Ministris.

Art. 8. — Inspektorët kanë me raportue gjëndjen e përgjithëshme të nëpunsavet t' atyne vëndeve qi shetisin d. m. th. mbi moralin, sjelljen e kapacitetin e tyne, si dhe mbi kujdesin qi tregojnë në plotsimin e detyrës, dhe përparimin dhe lulzimin të vendit. Këto shenime inserohen në biografinë e nëpunsavet.

Art. 9. — Inspektorët për plotsimin e inspektimit ose të hetimeve, kërkojnë dhe kqyrin gjithe aktet e nevojshme. Gjith' ashtu kanë të drejtë të kërkojnë ç' do informacjon prej ç' do Zyre të Shtetit, dhe këta detyrohen me u a dhanë.

Art. 10. — Nga an' e Ministris inspektorëve u jepet nji letër identiteti, të cilën u a tregojnë zyrave ose nëpunsave në ç' do rasë nevoje.

Art. 11. — Inspektorët detyrohen me mbajtë nji libër të posaçëm, ku kanë me i shënue veprimet e përditshme të tyne. Nji kopje e këtyne shënimeve, në fund të ç' do muejit i jepet Ministris.

Art. 12. — Inspektorët pa marrë urdhën nga Ministrija, nuk mund të largohen nga vendi ku bajnë inspektime ose hetime; këta në mbarim të detyrës lajmërojnë Ministriën prej së cilës marrin urdhënat e fundit.

Art. 13. — Inspektorët janë të detyruem me i mbarue inspektimet ose hetimet në nji kohë ma të shkurtën; në rasa qi kuptohet se pa pasun nevojë janë zgjat inspektimet, Ministrija i a zbret dijetet e ditëve qi i konsiderohen të tepërta.

Art. 14. — Inspektorët pa pasë lejen e Ministris, nuk mund të pranojnë as nji detyrë tjetër si zëvëndës, gjith' ashtu n' asnji mënyrë nuk mund të lanë zëvëndës për detyrat e veta.

Art. 15. — Mbasi Inspektorët kanë për detyrë vetëm inspektim e kontrollim, këta nuk mund të ndërhyjnë as në detyrat e nëpunsavet, as nuk mund t' u apin urdhna atyne.

Art. 16. — Inspektorët janë të detyruem me kompletue ç'do inspektim dhe hetim qi kanë fillue, tue analizue çështjen me gjithë detajet dhe hollësinat; në rasë qi për ç' do shkak qoftë, do të shtërngohen me i pushue hetimet ose inspektimet, n' atë çasë lajmërojnë Ministriën, prej së cilës marrin urdhën për vazhdim ose ndalim.

Art. 17. — Inspektorët në mbarim të ç' do inspektimi, përveç raportit të treguem n' art. 7, i paraqisin Ministris edhe nji raport të veçantë mbi gjëndjen e përgjithëshme d. m. th. mbi situatën administrative, ekonomike, sociale dhe mbi nevojat e përgjithëshme të vëndit ku kanë bamun inspektime.

Art. 18. — Në vazhdim të hetimeve, nëpunsat për të cilët çfaqet nevoja qi të pyeten prej anës s' inspektorit, janë të detyruem me ardhë para tij; vetëm Prefektat dhe Nënprefektat pyeten me letër të posaçme. Të gjitha zyrat janë të detyrueme me i a tregue inspektorit ç' do akt e korespondencë qi ka me i kërkue ay.

Art. 19. — Inspektorët kanë me hetue edhe sjelljet e organeve të gjindarmeris ndaj popullin, dhe kapacitetin e tyne në pikpamjen e të kryemit të detyrës administrative; mbi këtë pikë veçanërisht paraqesin raportat e nevojshme Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 20. — Inspektorët e kanë për detyrë me inspektue edhe administratat e instituteve mirë-bërëse, si ajo e Kryqit të Kuq ashtu edhe shoqëninat private këso dore; përfundimi i inspektimit i njoftohet Ministris me nji raport të posaçëm.

Art. 21. — Në vazhdim e sipër t'inspektimit ose të hetimeve kur inspektori shef se vazhdimi në detyrë i nji nëpunsi me të vërtetë asht damtuës ose sjell pengime n'inspektim ose ne hetim, në qoftë se ay ka nji rrogë deri në 200 fr. ari, pa autorizim dhe n'asht se ka nji rrogë ma shumë se 200 fr. ari me autorizimin e Ministris, e pëzullon nga puna dhe lajmëron si Ministrin ashtu dhe superiorin e tij.

Art. 22. — Inspektorët janë të ndaluem m'e përhapë para se të nisen, vendin se ku kan me shkue për inspektim.

Art. 23. — Inspektorët janë të detyruem me mbajtë nji seriozitet kundrejt nëpunsave qi ndodhen nën inspektimin e tyne; ata janë të ndaluem:

a) Me banue pranë nëpunsavet;

b) Me pranue rekomandimet dhe shënimet e tyne;

c) Me pasë korespondencë private me ta.

Art. 24. — Inspektorët, të cilët nuk nxjerrin në shesh shpërdorimin dhe abuzimet e atyne nëpunsave qi i kan nën kontrollim:

a) Kjo në rrjedhje prej pazotsije, transferohen në nji detyrë tjetër;

b) Në qoftë se rrjedh prej neglizhence ose ka qëllim favorizimi dhe çështjes i epet nji formë tjetër, inspektori përveç qi pushohet nga puna, por edhe bahen ndjekje ligjore kundra tij.

Art. 25. — Dënimet disiplinore kundra Inspektorëve janë këto:

a) Vërrejtje;

b) Qortim me gojë ose me shkresë;

c) Premje rroge;

ç) Pushim.

Tri të parat zbatohen direkt prej Ministriës dhe ajo e fundit ekzekutohet me pëlqimin e Kryesiës së Republikës, bazuem në propozimin e Ministriës. Dënimet e shënueme në paragrafet *b), c)* e *ç)* shënohen edhe në biografinë e Inspektorit.

Art. 26. — Ata Inspektorë qi, mbrenda motit shofin dy herë dënime, n'asht se do shifet nevojë qi të dënohen për të tretën herë mbrënda n'at mot, ky dënim do të jetë ay qi asht nji gradë më e naltë se ato dënimet e kalueme.

Art. 27. – Inspektorët për shpenzimet e udhëtimit e dijetet, marrin paradhanje prej Arkës së Qendrës; këta gjithmonë në fund të ç'do muejit, detyrohen me i liquidue paradhanjet e marruna mbrenda n'atë muej.

Art. 28. – Rregullorja mbi detyrat e inspektorëve të Ministris së P. të Mbrendëshme me datë 19-VII-1922 mbetet pa fuqi.

Art. 29. – Kjo rregullore hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 30. – Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M Ë :

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje, të pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, 5-VIII-1927. **A. ZOGU**

Nr. 110

RREGULLORE, 5 Gusht 1927.

Mbi kursin e II. të Gjindarmeriës në Shkodër për gjindarmë qytetas dhe për gjindarmë semple

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Gusht 1927, Nr. 65)

I. – Kurs' i II. i Shkollës Gjindarmeriës në Shkodër do të përmbajë dy rende: nga të cilat i pari do të ketë nji periodë studimi prej 10 muejësh, qi nis nga data 1-IX-1927 dhe merr fund me 28-VI-1928, tue pasun për qëllim të krijuemit e nji gjindarmerije qytetse prej 60 vetash të cilët do të stërviten në

bazë të detyravet të Policiës dhe të Gjindarmeriës, dhe rendi i II. do të ketë nji periodë prej gjashtë muejësh qi nis me 1-IX-1927 deri me 28-II-1928 për stërvitjen e 100 gjindarmëve qi nuk kanë parë ndonji kurs.

II. — Rendi i parë i kursit ka për burime:

a) Ata graduat (Kapter e Reshtar) qi janë në moshën 30 vjeç dhe kanë nji kapacitet të praktikueshëm në shkrim e këndim, me prova kanë rrëfye nji zotsië në detyrat e gjindarmeriës, kanë nji moral të pastër dhe bashkë me gjith konditat fizike e trupore të paktën kanë 1.63 m. naltësie;

b) Ata djelmosha qi me gjithë konditat fizike e trupore janë në moshën 22, 27, të paktën kanë mbarue nji shkollë plotore me 6 rende, ose me provim rrëfejnë zotsië dhe kanë nji intelizhencë të natyrshme, janë nga nji familje e mirë, d. m. th. e pa cenueme me imoralitet dhe nuk kanë ndonji dënim, dhe pranojnë me shërbye në degën e gjindarmeriës qytetse të paktën 5 vjet.

III. — Frekuentat qi vijnë nga dega e gjindarmeriës sa të vazhdojë kursi marrin rrogë si mbas gradës qi kanë dhe ata qi pranohen nga dega civile marrin rrogën e gjindarmit sempël.

IV. — Ata qi dalin nga ky kurs me sukses të plotë, nën titullin «Qytetsore i Gjindarmerisë», emnohen në vëndet, caktohen nga Qeverija si mbas nevojës. Ky titull vjen baras me atë të Aspirantit tue pasun ende të dreitën e rrogës së këtij.

V. — Ata frekuenta qi nuk mundin me mbarue kursin me sukses në qoftë se kanë ardhë nga dega e gjindarmerisë këthehen prap në degën e tyne, dhe në kjoftë se janë pranue nga kategorija civile këta si gjindarmë sempël detyrohen me ba dy vjet shërbim në qarqet e Gjindarmerisë.

VI. — Ata frekuenta qi në periodhën e studimeve për arsye morali ose disipline kuptohet se nuk mund të mbahen në shkollë, në qoftë se kanë ardhë nga gjindarmerija bashkë me dënimin ligjuer çrregjistrohen nga dega e gjindarmeriës, në qofshin nga kategorija e dytë këto i dorzohen ushtriës qi detyrohen me ba dy vjet shërbim aktiv.

VII. — Rendi i II. i Shkollës do të përbahet nga Tetarët e gjindarmët qi janë në moshën maximum 28 vjeç dhe nuk kanë pa ndonji kurs në Shkollën e Gjindarmeriës, këta do të stërviten në bazë të rregullores qi ka vue në zbatim Shkolla në kursin e I.

VIII. — Personali i Shkollës formohet nga ay i sotshmi tue u kompletue me njerës qi ndodhen në Shkodër dhe kanë kompetencë në degën e Drejtësisë, për veç nji oficeri qi me gradën Kapiten ose Toger dhe me titullin instruktor i Gjindarmeriës Qytetse do të sillet nga përjashta.

IX. — Personali i sotshëm i Shkollës deri sa të çilet kursi do të merret me përkthimin e pregatitjen e librezavet të nevojshme për Gjindarmërinë Qytetse.

X. — Programi i mësimevet të kursit do të bahet nga Komanda e Përgjithëshme e Gjindarmeriës, tuj u marrë ende mejtimi i Drejtoriës së Shkollës e Inspektorisë së Përgjithëshme të Gjindarmeriës.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje të pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, me 5-VIII-1927.

A. ZOGU

Nr. 111

DEKRET-LIGJË, 9 Gusht 1927.

Mbi ndrimin e fjalëve t' eksistueme ndër kapijt 20 e 30 të budgetit 1927-28 të Drejtoris së Përgjithshme të Shëndetsis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Gusht 1927, Nr. 69)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministries së P. të Mbrendëshme;

Mbassi u ndigjue e u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 2-VIII-1927,

DEKRETOJMË:

Neni 1. – Kapitulli 20 i pranuem me emertimet Çmendinë: shpenzime për mbajtje e sherimin e të sëmundeve shtresa mbulesa e tjera, personeli sherbyes e qira Fr.ari 35,000 ndrohet e bahet kështu; Çmendina: Ushqim, rrogë personeli, rrogë e specialistit qi do të sjellet s' jashtmi, shperblim mjekut shikues (vizitues) për deri qi të mërrintë specialisti, shtresa e mbulesa, përmbajtje godine, e të jera si mbas nevojavet Fr.ari 35.000.

Neni 2. – Kapitulli 30 i pranuem me emertimet: Shpenzime për luftimin e epidemive vegla dizinkfeksioni, lazereti e tjera, Fr.ari 5160 ndrohet e bahet kështu:

Shpenzime për vegla të spitaleve, Dispenserive e Laboratorit të Bakteriologjis Shtetit Fr.ari 5160.

Neni 3. – Në bazë të ktij Dekret-Ligji ushtrohen veprimet Financjare të ktyne kapitujve për sa kohë ka fuqie budgeti Financjare 1927-28.

Neni 4. – Kjo dekret-ligjë hynë në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 5. – Për zbatimin e ksaj Dekret-ligjë ngarkohet Ministria e P. të Mbrendëshme dhe Ministra e Financavet, dhe detyrohen me i a paraqit në Sesionin e afërme Trupit Legjislativ.

Tiranë, me 9-8-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 112

DEKRET-LIGJË, 9 Gusht 1927.

Mbi shtesën e një kredije prej fr.ari 8.900 në budgetin e Ministris s' Arsimit për muze e bibliothekë

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris s' Arsimit;

Mbassi asht ndigjuem e pëlqyem vendimi i Këshillit Ministruer me datë 31-VI-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Budgetit të Ministris s' Arësimit i shtohet nji shumë prej fr.ari 8.900 e cila ka me i u ngarkue kapitujvet nji e tre, të parit fr.ari 2.400 e të dytit fr.ari 6.500

Art. 2. – Shuma fr.ari 6.500 ka me u përdorë për mobilimin, qiran e instalimin e Muzeut e të bibliothekës si edhe për pajisjen e këtyne me libra etj.

Art. 3. – Shuma fr.ari 2.400 ka me u përdorë për rrogen e nji Drejtori me fr.ari 300 në muej, nëpunsija e të cilit krijohet qysh prej datës nji Gusht.

Art. 4. – Kjo Dekret-ligjë hyn në fuqi prej ditës së shpalljes.

Art. 5. – Ministrija e Arësimit dhe ajo e Financavet janë të ngarkueme me zbatimin e saj.

Tiranë, me 9-VIII-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

AQSH

Nr. 113

DEKRET-LIGJË, 13 Gusht 1927.

Mbi krijimin e nji Legate në Pragë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Gusht 1927, Nr. 69)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së P. të Jashtme;

Tue pëlqye vendimin e Këshillit Ministruer me d. 5-VIII-1927:

DEKRETOJMË:

1. — Krijohet nji Legatë në Pragë.

2. — Punët e kësaj Legate do të drejtohen prej titullarit të Legatës s'onë në Belgrad.

3. — Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes.

4. — Ministria e P. të Jashtme ngarkohet me zbatimin dhe me paraqitjen e kësaj Dekret-Ligjë Trupit Legjislativ në Sesionin e afërmë.

Tiranë, me 13-VIII-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri P. të Jashtme
I. VRIONI

Zev. Ministri P. Botore e Zev. Ministri Bulqësis e Pyjeve
A. DIBRA

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 114

DEKRET-LIGJË, 25 Qershuer 1927.

Mbi përjashtimin nga tagri doganuer të sendeve qi importojnë oficjerët britanikë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Gusht 1927, Nr. 71)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi propozimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

Mbasi asht ndigjuem e pëlqyem vendimi i Këshillit Ministruer me datë 16-VI-1927,

DEKRETOJMË:

Neni 1. — Oficerët Britanikë në shërbim si Inspektorë pranë Gjindarmerisë së Republikës përjeshtohen nga tagri doganuer për sendet ushqimore e orendiët shtëpijake qi importojnë në Shqipni për nevojët e veta.

Neni 2. — Sasia e sendevet ushqimore për ç'do oficjer me familje u mbetet e caktueme mbas listës qi vijon për sasin ma të madhe qi mund të lypet në nji vjet.

Lista e seudevet të kërkueme prej Inspektoravet të Gjindarmeriës për shtëpiat e tyne këtu, me lirimin e tyne nga tagri doganuer vetëm për nji herë

1) Mobilje shtëpiet, 2) Tesha buket, 3) Tesha fjetjet, 4) Vegla kualsh, 5) Petka veshjet e mathjet etj., 6) Materjal për bartjen e teshavet, 7) Barna, 8) Gjana të toiletit, 9) Vegla për gjujtësi, 10) Vegla sportive (lojnash), 11) Vegla për lojna të fëmijve, 12) Pëlhura për nevojë shtëpijet etj., 13) Shtypshkrime, 14) Shkresina dhe veglat e sajë, 15) Llulla, 16) Vegla qepjet, 17) Të ngrëna ndër kutina (Konserva), 18) Gjana kollonjale (bakallëke), 19) Alkohol dhe të pira alkoholike, 20) Duhan cigareta dhe cigar, 21) Farë kopshtit, 22) Parafinë, 23) Sende fotografike etj., 24) Instrumente muzikale, 25) Bojna kundrash e lëkurash, 26) Xhela për metale, 27) Qirinj.

EMËRTIM	Sasi	Lloji
Bajama	30	kuti
Ançovie (peshk i krypun i kutiës)	50	kuti
Ararut . . . . . ,	50	kuti
Proshutë (Xhambon) . . .	120	killo
Pluhun për gjevrekë (baking powder)	24	kuti
Groshë	50	kuti
Mish kau konservë bear . .	100	kuti
Çaj prej gjakut të kaut (beef tea)	20	kuti
Konserva prej mishit pule ose peshk	150	« ose shishe
Piskota	50	kuti
Bimna të godituna, (për me hangër në mëngjes)	75	paketa

E M Ë R T I M	Sasi	Lloji
Tëlynë pa krypë	200	kuti
Gjevrek (ambëlsina të thata) .	50	kuti
Sirop për gjevrekë . . .	12	kuti
Havjarë . . . . , .	50	kuti
Kapri (Turshi)	5	kuti
Djathë	100	killo
Çikori (zarzavatë). . . .	12	kuti
Çokollatë . . . . . ,	200	kuti
Kakao . . . . . . ,	48	kuti
Kafe . . . . . . ,	75	kuti
Miell misri (niseshte) . ,	10	kuti
Pluhun për qumshtore (Custart powder)	50	kuti
Dhjamra për gatim . . ,	250	killo
Esansa	20	shishe
Miell	200	killo
Xhellatine	10	kuti
Xhexhefil	20	kuti
Glasere	5	kuti
Barniste (Ereba) . . . ,	5	kuti
Marmallade, Xheme, Siropë, Mjaltë	200	killo
Xhelli (Shorop për amëlsina) .	5	kuti
Pluhun xhunket për amëlsina .	3	kuti
Mullë djathi	2	kuti
Kristal për lemonadhë . . .	2	kuti
Their	5	kuti
Makarona	50	killo
Margarinë (Të lym të dytë) .	50	killo
Qumësht me kutië. . , .	300	killo
Mish për byrek . . , .	6	kuti
Mustarde	20	kuti
Trahano (oat meal) , . .	20	kuti
Voj Ullini	50	shishe
Ullinj . , ...	70	shishe
Mylci pate (pate de foi) . .	10	shishe
Miellë prej bizelash . . .	12	shishe
Piper	12	shishe
Turshi	36	shishe
Putinga . , , , , .	24	kuti

BKSH

EMËRTIM	Sasi	Lloji
Oris	48	kuti
Sago (Bimë) . , . . .	12	kuti
Krypë . . . , . .	40	kuti
Salca	50	shishe
Shelqer	200	killo
Supa	100	kuti
Amëlsina , . , . .	100	kuti
Caj.	60	kuti
Zarzavate konserve . . .	50	kuti
Uthull . '	24	shishe
Brumë , , , , , ,	12	kuti

TË PIRA

Wiskee	12 arka	(12 shishe)
Xhin	6 arka	«
Vermouth	12 arka	«
Konjak	6 arka	«
Venë	18 arka	(12 shishe)
Birra	18 arka	(48 shishe)
Liqeure	6 arka	(12 shishe)
Biters	(pije të hidhura	(3 shishe)

Neni 3. – Orendit shpijake përjashtohen nga tagri doganuer me llojin e në sasin qi shifen t' arsyeshme për nevojët shtëpijake t' oficjerit por vetëm për nji herë.

Neni 4. – Kur oficjeri nuk ka familje përjashtimi nga tagri doganuer pasohet në proporcjon të nevojëvet qi aj mundet me pasë.

Neni 5. – Autorizimi zyravet doganore për lirimin e sendevet të përjashtueme nga tagri doganuer do të jetë i nënshkruem rasë mbas rasës nënlistën e sendevet nga Komanda e Përgjithëshme e Gjindarmeriës dhe nga Ministrija e Financavet.

Neni 6. – Ky dekret hyn në fuqi që nga dita e shpalljes.

Neni 7. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin

e këtij Dekreti dhe me paraqitjen në Trupin Legjislativ në Sesjonin e afërmë.

Tiranë, me 25-VI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
Zav. Ministri i P. të Jashtme
F. ALIZOTI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Bulqësiës
MUSA JUKA

Nr. 115

DEKRET-LIGJË, 5 Shtatuer 1927,

Mbi ndryshimin e nenit 11 të Dekret-Ligjës me datë 20-I-1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927, Nr. 74)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armatë,

Mbasi ashtë ndigjue e pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 16-VIII-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Korrigjimi i moshavet si të rekrutave ashtu dhe të ndihmsave të tyne asht vetem në kompetencën e Këshillave Administrative.

Korrigjimet në fjalë nuk ndryshojnë gjendjen ushtarake të nji rekrutit vetëm kuer bahen së paku dy vjet para fillimit të kontrollimit. Ata rekruta të cilëve u korrigjohet mosha jashta konditës së naltë-përmendun, por gjithëmonë para kontrollimit, mbasi të mbarojnë detyrën aktive si ata me të cilët së bashku kanë pamun kontrollim, transferohen në klasën rezervë si mbas moshës së korrigjueme.

Sa për shpërnguljet, ndarjet dhe martesat, këta për me ndryshue gjëndjen ushtarake të nji rekrutit duhet me qënë të egji struem para fillimit të kontrollimit në regjistrat e Shtetit Civil ose formalitetet e regjistrimit të jenë në mbarim e sipër; ve-

çanërisht ngjarjet në fjalë duhet me qënë të vërtetuëme edhe me hetimet e posaçme t'autoritevet kompetente.

Art. 2. – Neni 11 i Dekret-Ligjës me datë 20-I-1926 mbetet pa fuqi.

Art. 3. – Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministria e P. të Mbrendëshme dhe Komanda e Përgjithëshme e Fuqis Armate detyrohen me zbatimin dhe me paraqitjen e kësaj Dekret-Ligjë para Trupit Legjislativ në Sesjonin e afërmë.

Tiranë, me 5-IX-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Zev. Ministri P. Botore e Zev. Ministri i Bujqësis e Pyjeve
A. DIBRA

Nr. 116

DEKRET-LIGJË, 5 Shtatuer 1927.

Mbi nji kredi prej 6.000 fr. ari

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927 Nr. 74)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së Financavet,

Mbasi u ndigjue e u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 8-VIII-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Për me i bamë ballë rrogës së Komiserit të Kontrollimit të veprimeve bankare, Ministria e Financave asht e autorizueme me bartë mbrenda budgetit të sajë prej Kap. 40. Nxjerrje (punim) e bartje krype shumën prej fr. ari 6.000 (gjashtëmij) në kap. 32 «Rrogë personale» qendruer e qarkuer e ushqim kualsh.

Art. 2. – Kjo dekret-ligjë vehet në zbatim ditën e shpalljes e ka fuqi për vjetën financjare 1927-1928.

Art. 3. - Ministrija e Financavet asht e ngarkueme për zbatimin e kësaj dekret-ligjë, dhe me paraqitjen në Trupat Legjislativë në Sesjonin e afërmë.

Tiranë, me 5-IX-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Zev. Ministri P. Botore e Zev. Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
A. DIBRA

Nr. 117

DEKRET-LIGJË, 5 Shtatuer 1927.

Mbi shtimin e nji krediti prej 40.000 fr. ari Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927, Nr. 74)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së Financavet,

Mbasi u ndigjue dhe pëlqyem vendimin e Këshillit Ministruer me datë 16-VIII-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Autorizohet Ministrija e Financavet me shtue në budgetin e sajë t'ushtrimit 1927-1928 nën Kap. 49 «Rrogë për nëpunësa të mbetun jashta kuadrit» nji fond prej fr. ari 40.000 (dyzetmij).

Art. 2. – Shtim i këtij fondi përballohet nga t'ardhunat e Kap. 9 b) «Tatim xhelepi mbi shtazë të trasha» mbasi në këtë kapitull parashifet nji e ardhun prej fr. ari 40.000 (dyzetmij) ma tepër se asht shenjue në budgetin e ushtrimit 1927-1928.

Art. 3. – Kjo dekret-ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Me zbatimin e kësaj dekret-ligjë e me paraqit-

jen e sajë pranë Trupit Legjislativ ngarkohet Ministrija e Financavet.

Tiranë, me 5-IX-1927.

A. ZOGU

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Zav. Ministri i P. të Jashtme
P. POGA

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Zev. Ministri P. Botore e Zev. Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
A. DIBRA

Nr. 118

DEKRET-LIGJË, 5 Shtatuer 1927.

Mbi krijimin e Drejtoris së Shtypit në Ministrin e P. të Jashtëme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927, Nr. 74)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së P. të Jashtme,

Mbasi u ndigjue e u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 8-VIII-1827,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Krijohet Drejtorija e Shtypit pranë Ministris së P. të Jashtme.

Art. 2. – Për drejtimin e kësaj përveç Sekretarit të shënuem në kuadro do të ketë nji Drejtuer me nji rrogë mujore 400 fr. ari e 50 fr. ari mujuer si allokasjon.

Art. 3. – Shumat e nevojshme për t'i bamë ballë personelit të përmëndun n'art. 2 do të paguhen nga fondi i kapitullit 10 të budgetit 1927-1928 të Ministris së P. të Jashtme.

Art. 4. – Rrogat e personelit do të paguhen që nga data e dorëzimit të dekretit ose emnimit përkatës.

Art. 5. – Kjo dekret-ligjë ka fuqi që nga data që ësht pranuem budgeti 2927-1928.

Art. 6. — Me zbatimin e kësaj dekret-ligjë ngarkohet Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet, të cilat detyrohen me i a paraqitë Trupit Legjislativ në Sesionin e afërmë.

Tiranë, 5-IX-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Arsimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Zev. Ministri P. Botore e Zev. Ministri Bulqësis e Pyjeve
A. DIBRA

Nr. 119

RREGULLORE, 2 Shtatuer 1927.

Mbi disa ndryshime në rregulloren e Lyceut të Korçës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927, Nr. 74)

Art. 10 i rregullores së Lyceut të Korçës ndryshohet në këtë mëndyrë:

Art. 10. — Detyrët e Drejtorit Administratuer.

A.

1) Ka për sipër Administratën e Përgjithëshme tëLyceut;

2) Përkujdeset për disiplinën e mbrendëshme të Lyceut dhe t'internatit të Lyceut;

3) Mbas korrispondencës me Ministriën e Arësimit mbi të gjitha çashtjet administrative, financjare e teknike;

4) Kryeson Këshillin disiplinuer dhe ven në zbatim vendimet e këtij që nuk lypin autorizimin epruer e të veçantë;

5) Aplikon masat disiplinore mbi personalin e Lyceut dhe mbi nxanësit e Lyceut n'Internat në marrëveshtje me Drejtoriën e Internatit për këta të fundit;

6) Përpiqet që personali i Lyceut të kryejë plotësisht detyrën e vet; gjith'ashtu përkujdeset për përparimin, disiplinën e rregullimin e mirë të Shkollës;

7) Kontrollon të gjitha veprimet e Drejtorit t' Internatit;

8) Për çashtje të jashtëzakonshme, tue marrë përsipër ç' do përgjegjësi, mund t' a pezullojë një nëpunës ase nji profesuer tue lajmue Ministrin e Arësimit;

9) Në mbarim të vitit shkolluer pregatıt raportin e posaçëm mbi nëpunsit e trupit mësimuer dhe ban vërejtjet e duhuna për se të cilin tue i a drejtue Ministrisë së Arsimit;

10) Mbikëqyrë zbatimin e programit të mësimeve të pjesës shqipe dhe për të kontrollue profesorët shqiptarë hynë mbrenda në klasë;

11) Që mund të bahet njëjësija në çeshtje teknike të mësimit në ç'do mungesë a përmirësim të nevojshëm vepron në marrëveshtje me Drejtorin e pjesës teknike;

12) Mban të gjitha regjistrat e nevojshme qi i përkasin shkollës mbas rregulloreve në fuqi;

13) Kontrollon e vërteton bordrot ase dëftesat e personelit të Lyceut;

14) Në rasë që bahen ndalime rrogash per shkak ndeshkimi i cakton këto dhe i shënon në bordro;

15) Asht përgjegjës për zbatimin e mirë të budgetit të Lyceut dhe çdo shpenzim do të kontrollohet e të vërtetohet prej këtij.

B.

Art. 1. — Drejtori i Internatit të Lyceut ka përsipër administrimin, rregullimin e mbrendshëm si edhe gestionin financjar t' Internatit.

Art. 2. — Vepron për sa i përket ushqimit, pastrimit e disiplinës s' Internatistëvet në bazë të rregullores s' Internatevet të Shtetit.

Art. 3. — Asht përgjegjës në mbajtjen e të gjitha shpenzimevet t' Internatit.

Art. 4. — Asht i detyruem të japë nji kuacjon e të përmbushë të gjitha detyrat që lypen prej rregullores s' Internatevet për ekonomin.

Art. 5. — Korrispondon me Ministrinë e Arësimit me anë të Drejtorit Administratuer të Lyceut;

Art. 6. — Drejtueri Administratuer i Lyceut i përcjellë Mi-

nistrisë s' Arësimit shkresat e Drejtorit t' Internatit tue shfaqun edhe mendimin në rasë nevoje.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arësimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësajë rregulloreje të pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, më 2-IX-1927.

A. ZOGU

Nr. 120

RREGULLORE, 2 Shtatuer 1927.

Mbi detyrat e Inspektorit të Shëndetësisë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Shtatuer 1927, Nr. 74)

Tue patur para sysh artikullin 16 të ligjës për mbi organizimin të shërbimevet të shëndetësisë publike shtypun në Fletoren Zyrtare Nr. 56 datë 8 Korrik 1927 përpillohet rregullorja mbi detyrat e Inspektorit të Shëndetësisë si vijon:

Art. 1. — Me anën e Inspektorit Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësisë ka mbi kqyrjen mbi personat e degës të Shëndetësiës Botore.

Art. 2. — Detyrat e Inspektorit të Shëndetësis janë këta qi pasojnë:

a) Inspektor' i Shëndetësisë drejton gjith shërbimet Mikrobiologjike dhe shëndetësore të ngarkueme trupit shëndetësuer të Shtetit tue veprue si mbas instruksioneve të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësiës;

b) Mbikëqyrë gjithë trupin shëndetësuer të Shtetit mbi kryemjen e veprimeve të ngarkueme këtyne me inspektime të rregullshme dhe të jashtë-zakonëshme.

Art. 3. – Inspektori i Shëndetësisë, inspekton mjekët zyrtarë (mjekët e bashkive dhe të Qeverisë) tue kontrollue:

a) Veprimet e tyne në detyrat dhe në Laboratoare të drejtuemun prej tyne;

b) Veprimet shëndetësore dhe masat të marruna prej tyne në qarkun në rasë të ngutëshme.

c) Kontrollon nga pikëpamjet shëndetësore gjëndjen e spitaleve të Shtetit e instituteve bamirse botore, bashkijake ose private mjeksore ose jo të qarkut, si dhe masat e marruna dhe të tregueme prej mjekut zyrtar si dhe zbatimin e tyne prej anës së Instituteve të nalt-përmenduna;

ç) Mbrenda qarkut Administrativ zbatimin e ligjëve në veprimin e kryemjes së mjeksiës si dhe zejeve (profesion) qi kan lidhje me mjeksiën tue pasë posaçërisht kujdesiën e vet mbi kujdesimin e mjekut zyrtar ndër barnatore, drogerit atolijet e dentistave, në godinat dizenfektuese si dhe banjat artificjale dhe natyrale të cilat në rasë nevoje i kontrollon personalisht;

d) Kontrollimi mbi kryemjen e shenimit kundra liës si mbas urdhnave të zyrtarve eprorë;

dh) Veprimet e tyne ndaj autoriteteve kompetent mbi përmirësimin e shëndetësiës së Përgjithëshme dhe për parandalimin e cenimit të shëndetësiës botore.

Art. 4. – Inspektori i Shëndetësiës, inspekton lië shënjuesit mbi kryemjen si mbas shkresës detyrën e ngarkueme atyne për shënim dhe rishënimin në kohnat e duhuna.

Art. 5. – Inspektori i Shëndetësiës, inspekton mjeksit e portave dhe lazereteve të Shtetit si dhe ç' do autoritet qi asht i ngarkuem me shërbimin shëndetësuer.

Këtyre i u kontrollon:

a) Shërbimin e mbrendëshëm dhe

b) Zbatimin e plotë të ligjëve qi flasin mbi mjeksiët e portave të lazereteve si dhe zbatimin shkencor të plotë t' urdhnave të dhanuna nga Drejtorija e Përgjithëshme e Shëndetësiës;

c) Aftësiën dhe zotësiën të mjekve të portave dhe të lazereteve si dhe të personelit inferior të tyne.

Art. 6. – Inspektori i Shëndetësiës kryen ç' do tjetër ins-

pektim qi ka të bajë me shëndetësiën e përgjithëshme qi asht ngarkue prej Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësiës.

Art. 7. – Mjekët e Bashkivet të Qeveris të portave dhe të lazereteve si dhe personeli inferior i këtyne detyrohen të konformohen mbas instruksioneve të Inspektorit i cilli asht tërësisht përgjegjës për instruksionet e dhanuna prej tija.

Art. 8. – Inspektori i Shëndetësiës n' inspektimin e Spitaleve të Shtetit e nëpunësave shëndetësuer, Barnatorëve, Drogrive, të banjave artificjale dhe natyrale dhe përgjithësisht t' institutеve botore, bashkijake ose private ka të drejtë të marrë njoftim mbi gjithë aktet e korrespondencës si dhe regjistrat të këtyre instituteve.

Art. 9. – Inspektori në rasë që sheh ndonji të mbetë në personat e shëndetësiës të kontrolluem prej tij; detyrohet të kërkojë me shkresë përmbushjen e të mbetave dhe çdo gja tjetër të ligjëshme për mirëvajtjen e shëndetësiës së përgjithëshme, në këtë rasë Inspektori okupon vëndin e superiorit të të kontrolluemit d. m. th. urdhënon këta si superjorë.

Art. 10. – Inspektori i Shëndetësisë me urdhënin të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë ose dhe prej nisiativës vetiake ban hetime të betueshme ose jo për përmbarimin e hetimeve janë të detyruem autoritetet policor, administrativ dhe bashkijak t' i ndihmojnë Inspektorit të Shëndetësiës; gjith' ashtu privatët të vijnë e të dëshmojnë para tij. Të ftuemit zyrtar dhe privat betohen si mbas dispozitave të ligjëve në veprim.

Art. 11. – Inspektori i Shëndetësiës detyrohet të pranojë justifikimet e nëpunësavet të kontrolluem prej tij mbi vrejtimet qi ju njoftohen atyne.

Art. 12. – Në rasë çfaqje ose në rasë të rrezikut çfaqje të ndonji epidemije, kolere, murtaje, ethe verdhi, tifo eksantimatik dhe çdo lëngatë ngjitëse të rrezikshme me ndonji vënd të Shtetit, Inspektori i Shëndetësis vete në vënd tue marrë me vehte veglat e nevojshme për caktimin e sëmundjes të çfaqun, kontrollon masat e marruna dhe kërkimin mikropiologjike dhe klinike të bamuna deri në vajtjen e tij, dhe në rast nevoje vepron personalisht kërkimet me veglat e shpënuna me vehte. Mbas caktimit të shpejt të sëmundjes dhe në marrëveshtje me autoritetet ma të naltë administrative shëndetësuer dhe bashkijak t' atij qarku cakton në mbështetje të porosinave të këshillit mjeksuer mënyrën e ruejtjes dhe të luftimit të sëmundjes tue

i' a ngarkue zbatimin masave të autoriteteve shëndetësore të qarkut.

I njofton Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë masat q' i përkasin bashkivet, dhe komunave krijimin e vendeve të izolimit dhe nevojën e dërgimit të mjekve të tjerë, dhe në marëveshje me autoritetin ma te naltë administrativ fton Kryetarin e Bashkiës ose Kryeplakun tue i urdhnue marrjen me nji herë të masave të caktuëme.

Art. 13. — Inspektorit të Shëndetësisë në rasë t'inspektimeve mbi kërkesën e tij për nevoja të jasht-zakonshme i nepet nji paradhanje si mbas nevojës qi shifet tue qënë i detyruem me të kthyer në qendër të liquidoje paradhanjen.

Art. 14. — Inspektori i Shëndetësiës përmbaron gjith porosinat e Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësiës dhe Këshillit të Naltë mjeksuer.

Art. 15. — Inspektori i Shëndetësiës paraqet raporta në përfundimin e ç' do inspektimi Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetësiës tue treguem në të sjelljen dhe zotsiën të personelit të inspektuemun dhe ban për këta propozime të justifikueme.

Art. 16. — Inspektor' i Shëndetësiës detyrohet prej nisjatives së vet t' informojë Drejtorin' e Përgjithëshme të Shëndetësis rezultatin e zbatimeve të ligjëve, të dekret-ligjëve, dhe të rregulloreve dhe t' urdhnave të Drejtoriës së Përgjithëshme të Shëndetësiës, tue tregue mendimin e vet mbi nevojat dhe mënyrat e ndrimit të tyre.

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arësimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore Zav.
Ministri Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

aprovimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje të pranueme dhe prej Këshillit Ministruer.

Tiranë, me 2-IX-1927.

A. ZOGU

Nr. 121

DEKRET-LIGJË, 6 Shtatuer 1927.

Mbi mbartjen e kursimeve të kredinave të Ministris së Drejtësis në budgetin e vjetit 1926-1927 e 1927-1928 në kapitullin 5 qira t'ushtrimit financjar të vjetit vazhdues

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Shtatuer 1927, Nr. 75)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së Drejtësiës:

Mbassi u ndigjue e u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 3-IX-1927.

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Fr. ari 4.722 (katërmijështatëqindenjizetedy) rrogë personeli e fr. ari 4.000 (katërmij) shpërblim i Komisjonit Ligjgatitës të kursyeme në budgetin e vjetit 1926-1927 barten në kap. 5 qira të budgetit 1927-1928.

Art. 2. — Fr. ari 1.900 (njimijënandëqindë) rrogë personali të Gjyqit Paqtues Vlonë për dy muej e gjysëm, fr. ari 2.880 (dymijëtetëqidëtetëdhetë) rrogë personali të Gjyqit Paqtues të Bunjaj e Mirëdite për dy muej e gjysëm, fr. ari 3.000 (trimij) rrogë e Kryetarit vakant të Gjyqit Diktimit (D. Nd.) për pesë muej, fr. ari 600 rrogë e Protokolist-Kopistit vakant të Gjyqit Shk. I. Dibër për pesë muej, fr.ari 500 kursim nga rroga e gjyqtarit paqtues të Tepelenës për 5 muaj, fr.ari 750 (shtatëqindepesdhetë) rrogë e antarit vakant të Gjyqit Shk. I. Dibër për dy muej e gjysëm, kursime në budgetin e vjetit vazhdues barten në kap. 5 qira të këtij budgeti.

Art. 3. — Kjo dekret-ligjë hyn në fuqi qysh ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e Drejtësiës dhe ajo e Financavet ngar-

kohen me zbatimin e kësaj dekret-gjë, dhe me paraqitjen e saj para Trupit Legjislativ në sesionin e afërmë.

Tiranë, me 6-IX-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Arësimit
Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Ministri Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 122

DEKRET-LIGJË, 13 Shtatuer 1927.

Mbi bartje kredije

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 20 Shtatuer 1927, Nr. 77)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris s' Arësimit;

Mbassi u ndigjue e u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 2-IX-1927,

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Kredija për Shkollën e Drejtësiës fr. ari 30.000 i votuem nga Dhoma Legjislative në kap. 10 të buxhetit t'Arësimit transferohet po për atë qëllim në Buxhetin e Ministrisë së Drejtësiës.

Art. 2. – Kapitulli 10 i Buxhetit t' Arësimit anulohet e për transferimin e këtij fondi çilet në Buxhetin e Ministriës së Drejtësiës kap. II. «Shpenzime për Shkollën e Drejtësiës.

Art. 3. – Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi qysh me ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministrija e Financavet e Arësimit dhe e Drej-

tësiës ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë dhe me paraqitjen para Trupit Legjislativ në sesionin e afërmë.

Tiranë, me 13-IX-1927.

A. ZOGU

Ministri i Arësimit
Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Ministri Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 123

DEKRET-LIGJË, 13 Shtatuer 1927.

Mbi ndrrimin e art. 1 të dekret-ligjës me dt. 5-VII-1927

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 20 Shtatuer 1927, Nr. 77)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të inveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate ;

Mbassi asht ndigjue e pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 11-IX-1927.

DEKRETOJMË :

Art. 1. – Koha e shërbimit normal të rezervistëvet asht gjashtë muejsh.

Art. 2. – Artikulli 1 i dekret-ligjës me datë 5-VII-1927 mbetet pa fuqi.

Art. 3. – Ministria e P. të Mbrendëshme e Komanda e Përgjithëshme e Fuqis Armate ngarkohen me zbatimin e kësaj

deket-ligjë, tue u detyrue edhe me i' a paraqitë Trupit Legjislativ në sesionin e afërmë.

Tiranë, me 13-IX-1927.

A. ZOGU

Ministri i Arësimit
Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Ministri Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 124

DEKRET-LIGJË, 13 Shtatuer 1927.

Mbi shpërblime të përmuejshme në ligjë me disa grada n' ushtri

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Tetuer 1927, Nr. 82)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate:

Mbasi u ndigjue dhe u pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 3-IX-1927.

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Personat që okupojnë ose kanë me okupue postat e poshteshenjueme kanë me gëzue të drejtën e nji shpërblimi të përmuejshëm si ma poshtë vijon:

a) Komandanti i Përgjithëshëm i Fuqis Armate fr. ari 300;

b) Kryetar' i Shtatit Madhuer fr. ari 600;

c) Adjutanti i Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate fr. ari 80;

d) Komandanti i Gardës Presidencjale fr.ari 150;

e) Kapidanat e Gardës Presidencjale fr. ari 120;

f) Togerat e Gardës Presidencjale fr. ari 100;

g) Nëntogerat e Gardës Presidencjale fr. ari 60;

h) Aspirantat e Gardës Presidencjale fr. ari 40.

Art. 2. — Ky shpërblim ka m'u pague në ngarkim të fondit të caktuem me budget të sejcillës vjetë pa u marrë parasyesh grada e personavet që okupojnë ato posta.

Art. 3. — Kjo Dekret-Ligjë vehet në zbatim me fuqi parapavepruese qysh me 1 Prill 1927.

Art. 4. — Ministrija e Finanacavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjie dhe me paraqitjen e saj para Trupit Legjislativ.

Tiranë, me 13-IX-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Arësimit
Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Ministri Bujqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 125

RREGULLORE, 12 Tetuer 1927.

E uniformës s' ushtriës e gjindarmeriës shqiptare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Tetuer 1927, Nr. 85)

A. OFICERA E ASPIRANTA

1. Uniforma fushore

Vesha e oficerave (Aspiranta)

1. — Oficerat e Aspirantat për veshë kanë:

Xhaket

Pantolla { kilot / të gjata }

Kapot edhe pelerinë

Ksulë.

2. — Ngjyra e stofës për të gjitha pjesët e robeve të cilat janë njoftue në pikën 1, asht khaki, vetëm për pelerinë asht boja qiellit.

Xhaqeta

3. — Xhaqeta asht e gjatë deri në krye të dorës me pesë sumlla të mshefta me katër xhepa të qepuna përsipri.

Mangët me kapak 10 cm. gjatë, pa sumlla e në formë të mangve të kapotës, me qafetë nji fish (3-5 cm. nalt mbas qafës) me supsa prej stofit të vet. Supsa n'anë të poshtme do ketë nji gjuhëse të gjatë sa asht supsa dhe përmbi sup të xhaketës dy uresa prej të cilavet kalon gjuhësa. Në majë nji sumull të vogël arit ose sërmi [1]). Xhaketa e çame për mrapa në midis, si mbas gjatësis së trupit, xhepat e epër të xhaketës do të jenë rrafsh me sumllën e dytë të xhaketës, gjanësija e tyne në grykë 13 cm. fundi 14 cm. dhe gjatsija me gjith kapak 15 cm. Xhepat e poshtër janë me grykë 17 cm. e fundi 18.5 cm. gjanë xhepi vetë 24 cm. gjatë, kapaku i këtij xhepi asht prap në formë të sipërmit e 7 cm. gjanë.

Xhepat si të poshtmit ashtu edhe të naltit, mërthehen me nga nji sumull (sustë) përmbrenda e në kapak nuk ka sumull. Të dy xhepet kanë nga nji rudhë midis të sipërmit 3 cm. gjanë e të poshtmit 4 cm. Xhaketa kurkund nuk ka zeh. Nën qafetë, rreth qafës përdoret qaforja e bardhë në formë koleti ose kravate.

Pantallonat

4. — Pantallonat janë dy llojesh:

Kilot

Të gjata

të dyja pa zeh edhe pa rrudhë e të mërthyeme përpara.

Për kilot: Të çamit e pulpave nuk do të kalojnë përsiprit gambalavet, ose çismavet.

Për pantallona të gjata: Të premit në pjesën e sipërme pak ma i gjanë, në pjesën e poshtme pak ma i ngushtë. Ndër pantallona të gjata në fund të kambëve vehen rrypa. Prandaj edhe fundi i pantallonave nuk duhet të jetë i kthyem. Xhepat çilen në të dy anët përmbi vijë të qëpunit të përjashtëm.

Në daljet në shërbim me trupat do të baren gjithëherë

---

1) VREJTJE: Oficerat Trupash Komandash etj. kanë shenjë arit si: sumlla hyjt, portope etj. Intandancat, Mjekët, Barnatorët, Veteterinarët, sermit.

pantallona qillot me çizme të zeza o këpucë të zeza me lidhsa me gambale lëkurat të zeza, në manevra operacione edhe në luftë me dollakë (khaki).

Ndër shërbime te tjera, në shesh ushtrimit kuerse trupat janë pa strajcë shpine, mandej jashta shërbimit baren pantallonat e gjata me këpucë të zeza me lidhsa.

Ksula

5. — Ksula asht e gjanë si mbas kres përpara 10-14 cm. nalt, mrapa 1 cm. ma pak. Skei i fishit të dytë do të jetë nji $^1/_2$ cm. nën skejin e sipërm të fisit mbrendëshëm.

Pjesa e nalt e ksulës duhet të jetë proporcionalisht, por në ç' do rasë nuk duhet të jetë ma e gjanë se pjesa e poshtme.

Skeji i epër i fishit të dytë do të ketë nji zeh njyre simbas parollës.

Streha e ksulës e përbame prej lëkurës së zezë lustrafin fillon të veshet e asht pak e ulun përpara.

Gjansija ma e madhe në mes 4 cm. Mbi streh vehet nji nëngojës prej lëkurës së zezë lustrafin në mes e mbyllun me nji togës metali, ndër skcjet sumlla si asht njoftuë për supsa.

Ksulës deri në gjysë të naltësis mund t'i vehet nji astarë i koluem, për me e mbajtë formën ma mirë. Ksulat do të bahen vetëm prej stofit të lëmuet (jo me formën e stofës terthuras).

Elmi

6. — Oficerat (Aspiranta) qi dalin në shërbim me trupat barin elmin si ushtarët, po kje se trupa del në shërbim me elm.

Kapota

7. — Kapota asht e gjatë deri në midis të pulpit të kambës, me dy kapakë do me thanë me dy reshte sumbullash, me qafeta të gjana 7 cm. me supsa edhe me nji rryp mbrapa ngjitun me dy sumlla, përmbrapa dy fish e palosun (sistem austriak).

Sumllat e kapotës janë metalit të cilat do të jenë me ngjyrë qi i ngjet stofës.

Astari i kapotës për generalat i kuq, për të tjerët, i blerët mbyllët, i zi, ose khaki, përveç kësajë në dimën mund t'i vehet astare me qyrk.

Kapota barret gjithëherë e mbyllun.

Pelerina

8. – Ngjyra bojë qiellit, me qafetë të njiajishme, gjatsija deri në gjujë, pa astar – vetëm Generalat barin ndër dy kindat e mbrenshëm (ja posht) nji sherit astarit të kuq 5 cm. gjanë,

9. – Kapota baret në shërbim e në daljet n' ushtrime me trupë, n' asht se kjo del në shërbim me kapotë.

Pelerina baret në shërbim, vetëm atëhere kurse asht leja me veshë pantallona të gjata, mandej për uniformë parade e salonit, si edhe jashta shërbimit.

Bartja e mushamas (Impermeabel) në formën e nji kapotës ose pelerinës por pa parullë, asht e lejueme.

Pajë e Armë

10. – Oficerat (Aspiranta) për pajë kanë rrypin me nji shtojcë krah e qafë, kah krahi i djathtë, strajcë kartash, matare ujit, tejqyrse Oficeri (Aspirant) bashkë me kët rryp bar si armë revolverin (sistem nagant). Ky rryp baret vetëm ndër manevra, në operacion e në luftë.

Për ndryshe Oficeri (Aspirant) asht i armatosun me (shpatë) qi baret nën xhaqetë, nji model për armët kalorse e nji tjetër për armët e degat e tjera.

Rrypi bartës i shpatës asht mbas modelit italian d. m. th. përgjithësisht prej lëkurës së zezë, për uniforma parade zbukurue me sherita arit (sermit).

Portopee (tuf e mbyllun) për oficera arit ose argjentit për Aspiranta lëkuret të zezë, sheriti i portopesë (arit ose argjentit) zbukurue ndërmjet me pej kuq e zi.

Bashkë me shpatë mund të baret nën xhaketë (tuej u vue nga xhepi i pantallonave për mbrapa) edhe revolveri ose nji pistole ma e vogël. Oficerat e rezervës të fuqis civile barin në të gjithë rasat vetëm rrypin e nalt diftuem, nuk mund të barin kurrnjiherë shpatën.

Kordonat

11. – Kordonin (arit), d. m. th. n' anë të djathtë, kanë të drejtë me e bart:

Generalat	}	t' arit
Adjutantat e Shkëlqesis Tij (të vërtet e nderit) .	}	
Oficerat e Gardës Nëntoger e përpjetë . . .	}	

Adjutanti i Komandës së P. të Fuqis Armate .	sermit
Adjutanti i Komandës së P. të Gjındarmeriës .	sermit
Kryetari i Shtatit Madhnor	sermit

Parollat

12. – Parollë i thonë copës së stofit të ngjyem qi difton armën.

Parolla vihet në të dy anët e qafetës së xhaketës, kapotës, e pelerinës.

Parolla në xhaket asht 9 cm. gjatë e sa qafeta gjanë. Parolla e kapotës e pelerinës asht siç tregohet në fytyrë të kapotës. Ngjyrat e parollës për ç' do armë e degë të ndryshme janë si ma posht:

Kambsorija . . .	të blert të kjart	
Garda. . . .	kuq të hapët	të tre rreth krejet qafës
Adjutantat e Kryesis .	kuq të hapët	të tre rreth krejet qafës
Artilerija . . .	bojë qielli i mbyllët	të tre rreth krejet qafës
Xjenjo. . . .	vjolet të haptë	
Shtat Madhnor . .	bojë qershijet	
Kalorija . . .	bojë qiellit	
Gjeneralat . . .	të kuqe	
Gjindarmerija . .	të kuqe	
Intendanca. . .	të verdhë	
Shëndetësija . .	kadife të zezë	
Veterinaria. . .	kadife të zezë	
Armatarët si mbas armës ku mvaren		
Oficerat e nderit .	të bardhë	
Mitraljozi . . .	si Kambsorija	
Muzika . . .	si Kambsorija	

Grada

13. – Gradat rrëfehen:

në kësulë
në parollë
në supa
eventualisht edhe në mangë.
(Në kapotë, pelerinë gradat nuk rrëfehen).

Në kësulë

14. – Aspiranti në kësulë nuk ka shejë gradet.

Oficerat n'anë të majtë të kësulës kan sherita qi rrëfejnë gradën d. m. th. mbi krejt naltësinë e kësulës (prej skajit të naltë deri në skaj të fundit) në mëndyrën qi vijon:

Nëntoger 1	gajtan $^1/_2$ cm. gjanë		
Toger . 2			
Kapiten . 3			
Major . 1	nji sherit 2 cm. gjanë	gajtan $^1/_2$ cm. gjanë	
Nënkolonel 2			
Kolonel . 3			

Sheriti larg njeni prej tjetrit 1 cm.

Kapiteni Kl. I. ka nji gajtan thik përmbi tre gajtanat e gjanë

General Brigade .	1 sherit.	1 gajtan $^1/_2$ cm. gjanë
« Divizjoni .	4 cm. gjanë .	2 « $^1/_2$ « «
« Korp Armate.	4 « me .	3 « $^1/_2$ « «
Generalissimus . .	4 « me .	1 gjeth lisi ari përsipër

Për Generala shenjat e gradës nën tê të kuqe.

Komandanti i Përgjithëshëm i Fuqis Armate dhe Komandanti i Përgjithëshëm i Gjindarmeriës në qoftë se nuk kanë gradë Generali, ven gjithnji shenjat e gradës së kuqe nën te.

Në parollë

15. -- Grada në parollë rrëfehet me hyj edhe sherita:

Aspiranti nji hyllë mëndafshi i zië.

Nëntoger . . 1	hyj arit (argjenti)
Toger . . 2	
Kapiten . . 3	

Kapiten i Kl. I. parolla kufizohet në fund me nji sherit arit ose argjentit, 5 cm. e gjanë e vueme pingul.

Major . mbi paroll 1	(sheritat do të jenë si ata qi bajnë Gjeneralat)
Nënkolonel « « 2	
Kolonel . « « 3	
General Brigade 1	(sheritat do të jenë si ata qi bajnë Gjeneralat)
« Divizjoni 2	
« Korp-Armates	(sherita si ato të Shkëlqesiës së Tij Presidentit me nji gjeth lisit për siprit).
Generalissimus . .	

Hyjt vehen prej midis të parollës në nji radhë njani me tjetrin me 2 cm. largësi prej mesi në mes. Ndër Oficerat Madhnorë hyjt vehen $^{1}/_{2}$ mbi parollë.

Forma e hyjve: Oficerat (Aspiranta) e Komandave të trupave etj. 5 skepa, Intendancat, mjekët etj. 6 skepa.

Në Supsa

16. — General Brigade . . nji hyll
« Divizjoni . . dy hyj
« Korp d'Armee . tre «
Generalissimus . . . nji gjeth lisi

Ndër mangë

17. — Oficerat e rezervës vullnetare (fuqi civile) në parollë nuk kanë kurrnji shenjë grade. Në vend të kësaj ndër mangë mbi vëndin ku kthehet manga vënë:

Aspirant	1	sherit argjentit		
Nëntoger	1	sherita të ngushtë arit		
Toger	2			
Kapiten	3			
Major		1 sherit të gjanë	1	sherita të ngushtë arit
Nënkolonel			2	
Kolonel			3	

18. — *Shenjat e përgjithshme për ç'do degë:*

Mbi kësulë përpara: elmi i Skënderbeut qindisë n'arë (argjent) me ngjyrën e parollës nën tê.

19. — *Shenjat e posaçme për degat e ndryshme:*

Adjutant i Regjimentit . 1) sherit 1 cm. gjanë vue ter-
« i Baonit ose Grup. Art. 2) thuer mbi supsa të xhaketës

Në mangën e sipërme të majtë nën te me ngjyrën e parollës:

Mitraljozat: nji mitraljoz profil 4 cm. gjanë 3 cm. nalt.

Xhenjo . .) nji kazmë e nji lopatë
« trupash.) të vueme në formën kryq (X)

Armatarët: nji pushkë e nji çekiç prej 4 cm. gjate e gjanë.

(Telefon, signal etj. .) shkeptima (vetimë) në formën kryq (X)
Korrespondencë. .)

Diktuesat: 1 hyllë

Goniometristat (Artileri) nji trikambësh

Shenjuesa (Artileri) nji top
« (Kambsor) nji pushkë
Largsi-matsa . . nji telemetër
Nallban . . . nji patkue
Samarxhi . . . nji S.
Borizan . . . nji bori
Shëndetsi . . nji lidhse t'bardh me nji kryq të kuq përsipri
Muzikant . . . nji lurë 5 cm. gjatë e 4 cm. gjanë
Kalori . .)
Artileri . . } shif parollat
Garda . .)

Për veç kësaj Kalorija e Artilerija e kanë nji zeh rreth supsave në ngjyrën e armës së tyne.

2. Uniforma e verës

20. – Si Oficerat (Aspiranta) ashtu edhe nën-oficerat e ushtarët mund të veshin në verë nji uniformë veret. Kjo e ka të premin e njinjishmë si uniforma fushore por asht punuemë prej stofës së lehtë e qi mund të lahet.

Ngjyra e stofës asht për oficera (Aspiranta) khaki, (kuerse shkojnë me trupat) ose e bardhë, për ushtarë khaki. Uniforma e verës përgjithësisht baret në kohën që prej datës 1 Maj deri në fund të Shtatorit.

Edhe në këtë uniformë Oficerat (Aspiranta) barin këpucë të zeza.

Me pantallonat e uniformës fushore (kilot ose të gjata) mund të baret edhe xhaketa e verës (e bardhë ose khaki).

3. Uniforma e Paradës

21. – Uniforma e Paradës e systemueme deri tash (rregullorja e vjetit 1925 faqe 12-15) me të vetëm për:

a) Shkëlqesinë e Tij Zoti Presidentit;

b) Adjutantat e Tij me gradë Oficeri (jo Adjutantat e nderit);

c) Oficerat e Gardës;

Në vënd të kallpakut merret elmi: ky përbahet prej çelikut me nikel, ka përpara nji shqipe të zezë me dy krena e si zbukurim elmit kryet e kaprollit arit mbas formës historike t' elmit të Skënderbeut (qi gjendet në Muzen e Wienës).

Për Oficerat (Aspiranta) tjerë vlen uniforma fushore por

gjith herë me shpatë e çizme të zeza (lustrafin) edhe si uniformë e Paradës, në të cilën rasë hyen edhe shënjat e posaçme qi vijon :

a) Mbi xhaketë për Oficera deri Kapiten i Kl. I. barën supsat arit argjent) pa tufa, për Oficera eprorë prej Majorit e përpjetë me tufa ;

b) Si shënjë shërbimit baret nji kordelë (bandoljerë) kjo asht 8 cm. e gjanë e kuqe në midis nji sherit i. zi 2 cm. e gjanë nga fundi tufat të gjata e të kuqe.

Kordela (bandoljera) baret :

Prej trupave kalorëse (kaloriё, artileri) e prej Adjutantave të komandave eprore (ma e naltë se Komanda Regjimenti) pre supit të majtë në kërllokëll të djathtë.

Prej Oficerave të tjerë prej supit të djathtë në kërdhokëll të majtë.

Kordela shtihet nën rrypin e diftuem në pikën C.

Nuk barin kordela të gjith Aspirantat mandej Intendantat, Mjekët, Barnatorët, Veterinarët, Armatarët.

c) Nji rryp mesit arit (argjentit) bartun mbi xhaketë si asht caktue për shpatën e uniformës së vjetër të Paradës. Me gjith kët shpata nuk duhet mërthye në këtë rryp, por baret si n' uniformën fushore nën xhaketë ;

d) Shënja të posaçme për kalori artileri : Vezme me rryp arit (modeli italjan). Baret prej supit të djathtë në kërdhokëll të majtë ;

e) Dorza të bardha ;

f) Ndër daljet në Parada me trup Oficerat (Aspirantat) e dam për trupë barin elmin, si asht caktue për ushtarë. Të tjerët kësulë.

V ë r e j t j e : Oficerat e rezervës të fuqivet civile nuk kanë të drejië me bartë uniformën e Parades.

22. – Uniforma e Paradës baret :

a) Ndër dit festash Kombtare (28-XI, 21-I, 31-I) ;

b) Ndër audienca te Shkëlqesija e Tij ;

c) Në gjyq, kuerse shpallet vendimi i fundit si dhe dishmitarët qi thirren para Gjyqit.

d) Në vorrimin e Oficerave.

Uniforma e Salonit

Ndër festa zyrtare, kuerse autoritetet e tjera paraqiten në gala (me frak) baret uniforma e Paradës si uniform saloni me të gjitha shënjat por pa kordele (banderole) e me pantallona të gjata.

Për ndryshe vlen si uniformë salonit, për shoqnina, shëtina e tjera rasa jashtë shërbimit uniforma fushore me pantallona të gjata (me nënkambse) këpucë të zeza lustrafin, shpatë e doreza të bardha.

Dekoracjonet

24. – Kto barën në radhën e në mëndyrën e bartjes së caktueme (ma parë të mbrendëshmit) vetëm për uniformë Parade e ndër festa zyrtare për uniformë saloni.

Për ndryshej baren vetëm shënjat e urdhnave (mostrine).

Mahmuzet

25. – Mahmuz barin gjith trupat kalorës (Kambësorija Artilerija edhe ata qi kanë të drejtë me pasë kalë.

Uniformat e Shkollave Ushtarake

26. – Për Akademin Ushtarake do të sistemohet nji uniformë e posaçme parade e shetije.

Në të premë kjo asht nji me uniformën fushore por me gjith kët krejt prej stofit të zi.

Qafa e xhaketës përpara e posht rreth me nji sherit të ngusht në ngjyrën e armës e në vënd të shenjit të gradës vehet nji shqipe (arit).

Pantallonat të gjata me rude në ngjyrën e armës.

Forma e kësulës si për Oficera për sipër përpara me nji rozet.

Bajoneta me rryp mesi lustrafinit e portopee të verdhë mëndafshit.

(Nxansat e Kaloris e Artileris me shpata me portopee të njinjishëm).

Këpucë të zeza.

Dorza të bardha.

Për ndryshej nxansat e akademiës barin uniformën fushore.

Ashtu edhe nxansat e shkollave tjera ushtarake barin vetëm kët uniformë me gjith kët krejt qafa në ngjyrën e armës.

Bajoneta me portopee të zezë lëkuret. Si shënja të posaçme

nxansat barin n' uniformën fushore shenjin e përgjithshëm të shkollës e sheja grad të posaçme. Dy shënjat e fundit do të caktohen në Rregulloren e Shkollës.

Uniforma e Kryetarit të Republikës

27. – Për kët mesin' dispozitat e rregullores së vjetër të vjetit 1925 (faqe 15, P. 30) me përjashtim të dispozitave për kallpak i cili plotësohet me elm. (shif P. 21).

V e s h a e U s h t a r v e t

28. – Xhaketa e ushtarvet asht e gjatë deri në kyç të dorës, me qafetë nji fishit, me supsa me nji rrolet në sup të djathtë (për me qindrue pushka), me katër xhepa dy në gjoks edhe dy poshtë. Xhepat janë të çilun për mbrenda me grykë përjashta e me kapakë. Me mangë të çamë 10 cm. në rrafshinë të brylit me nji sumull rezervë qi në kohna të ftofta të ngushtohet manga tue u mërthye me sumllën rezervë.

Pantallonat janë gjysmë kilot në gjue e poshtë të ngushta e 15 cm. të çamë përmbrenda pulpit e në fund kanë nji llapë sa me mbulue grykën e këpucëve, skej i poshtëm i llapës qi përket në kundër duhet me kenë i tegeluem me nji sherit qi mos të shtyhet. Llapa do të jetë e mbërthyeme prap mbrenda pulpit me dy sumlla e me dollak përsipër.

Kapota asht khaki, me supsa me nji rrolet në sup të djathtë.

Trupat e Artileriës kanë nji pelerinë (khaki) e gjatë deri në gjue.

Si kapota ashtu edhe xhaketa dhe pantallonat do të jenë në formë të veshës s' Oficerave, por ma sempël.

Kësula e ushtarve e graduatve asht si ajo e Oficerave por ma sempël, pa elmin e Skënderbeut, por sipër me nji rozetë.

Mandej për uniformën e trupavet duhet:

Elmi çelikut baret:

a) Në shërbim inspekcionit;

b) Në shërbim roje;

c) Në daljet në shërbim me krejt pajimin fushor;

d) Përgjithësisht në luftë.

Ndër rasat *c)* e *d)* ushtari ka edhe kësulën me vedi.

Ndrrimin me elmin e çelikut (i cili mandej mërthehet në strajcë shpine) bëhet për lehtësime marshit (edhe në fushat etj.).

Ngjyra e elmit çelikut me shkronja e shenjë të posaçme asht e ndalueme. Graduatët e ushtarët dalin jashta kazermës gjithëherë me uniformën e urdhënueme, por gjithmonë me bajonetë mbi xhaketë. Vetëm në marrjen e ushqimit ose materialit e në detyrat e posaçme nuk baret bajoneta, ashtu edhe ordinancat mbrenda Garnizonit nuk barin bajonetë.

Shenjat e trupave

29. – Nënoficerat e ushtarët kanë parollat e njinjishme si oficerat (me gjith kët vetëm 7 cm. gjatë) në xhaketë, kapotë e pelerinë.

Numrin e Baonit (ose shkronjën fillore t' emnit të Baonit (mbi kësulë nën rozetë.

Numrin e Kompaniës (Bateriës) mbi supsa (në të dyja anët) mbi xhaketë e kapotë.

Shënjat e posaçme të njoftuem në pikën 19 kanë fuqi edhe për nënoficera e ushtarë, por këto në vënd t' arit janë të qindisuna me lesh të verdhë.

Shenjat e Gradës

30. – Graduatët kanë mbi parolla këto shënja:

Tetari . . 1)
Reshtari . 2) sherita mëndafshit të verdhë pingul gja-
Kapteri . . 3) nësisë së patrollës e 5 mm. gjanë.
« Kl. I. 4)

Njani sherit prej tjetrit 1-2 cm. larg.

Graduatët me rrogë për veç kësajë:

Tetari . . 1)
Reshtari . 2) Po ksi sheritash rreth mangës. Sheriti ma i
Kapteri . . 3) poshtmi 7 cm. larg prej mbarimit të mangës.
« Kl. I. 4)

Mbi kësulë, sipër përpara, ushtarët e graduatët do të kenë nji rozetë në ngjyrën e trupës.

Mandej Nënoficerat nji bylbyl tetshe (në xhepin e naltë të xhaketës n' anë të majtë, lidhë me nji kordon në ngjyrën e armës.

Ky kordon sipër mërthehet me sumllën ma të naltë të xhaketës.

31. — *Nuk ka uniformë Parade për Graduat e Ushtarë.*

Ndër të tilla rasa do të dilet në shërbim me uniformat (e pajim) ma të mira. Në paradë nënoficerat e ushtarët barin dorëzat e bardha pamukut.

Kalorija e Artilerija merr nji shënjë arme të posaçëm metalit i cili mërthehet mbi supa.

Dorëzat e sipërnjoftueme i barin edhe:

Patrollat .) në qytet
Rojet pritse)

32. — *Uniformë e Verës.* (Shif pikën 20).

33. — *Ndryshim për Uniformë fushore në kohë luftë.*

Në kohë lufte të gjitha pjesët shndritse metali do të ngjyhen me bojë khaki ose do të mveshen me nji stofë të tillë.

Shënjat e ndritshme (kordona distinkcioni etj.) do të plotësohen me nji ngjyrë e cilla nuk bje në syë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate;

Mbasi asht ndigjue e pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 6-X-1927.

DEKRETOJMË:

zbatimin e Rregullores t' Uniformës s' Ushtriës e Gjindarmeriës.

Tiranë, me 12-X-1927.

A. ZOGU

Ministri i Arësimit
Zav. Ministri i P. të Jashtme
XH. YPI

Ministri i Drejtësis
P. POGA

Ministri i Financavet
F. ALIZOTTI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i P. Botore e Zav.
Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
MUSA JUKA

Nr. 126

LIGJË, 12 Tetuer 1927.

Mbi shtimin e nji kredije prej 200 000 fr. ari

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Tetuer 1927, Nr. 86)

Art. 1. – Për të likuidue pagesat e muejve Kallnduer, Fruer, Mars 1927, të fuqis civile të Kosovës, të cilat kanë mbetë pa u pague, autorizohet Ministria e Financavet, me hapë në buxhetin 1928-1929 të Komandës së Përgjithëshme të Fuqis Armate Kap. 39 nën emën «të pa pagueme» për mungesë fondi.

Art. 2. – Ky fond i përmendun n' art. 1 caktohet prej fr. ari 200.000.

Art. 3. – Përballimi i kësaj pagese bahet prej nxjerrjes së të mbrapambetunavet.

Art. 4. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes në gazetën zyrtare.

Art. 5. – Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

zbatimin e kësaj Ligjë e pranueme prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 174 datë 10-X-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 12-X-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
F. ALIZOTI

Nr. 127

LIGJË, 25 Tetuer 1927.

Mbi lidhjen e nji pensioni z. Nuçi Naçit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Tetuer 1927, Nr. 90)

Art. 1. – Tue marrë parasysh shërbimet patriotike e ato të bame në degat e ndryshme t' Administratës Shtetnore, si edhe gjendjen e vështirë financjare e shëndetësore të z. Nuçi Naçit, nga Korça, autorizohet Qeveria me i pague nji shpërblim të

përmuejshëm prej fr. ari 180, deri sa të hyjë në fuqi ligja e pensioneve për nëpunsat civil.

Art. 2. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej datës së shpalljes.

Art. 3. – Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

D E K R E T O J M Ë :

zbatimin e kësaj ligjë, të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 185 datë 15-X-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 25-X-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 128

LIGJË, 25 Tetuer 1927.

Mbi dhanjen e nji shpërblimi z. Dervish Himës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Tetuer 1927, Nr. 90)

Art. 1. – Tue marrë parasyesh shërbimet patriotike të tij dhe me qëllim qi t' i bajë ballë mjekimeve të sëmundjes prej së cillës ësht tue vuejt, Qeverija autorizohet me i pague z. Dervish Himës, nji shpërblim të njihershëm prej fr. ari 3.000 (tremij).

Art. 2. – Shuma në fjalë paguhet nga budgeti i Ministris së Financavet nga Kap. 33 (art. 4) në të cillin do të bartet fondi i nevojshëm prej kursimeve qi kanë m' u vërtetue në mbarim të vjetit në Kap. 34 «Rrogë» të degës së Financës.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministria e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

DEKRETOJMË:

zbatimin e kësaj ligjë, të pranueme dhe prej Dhomave Legjislative si mbas shkresës Nr. 191 datë 15-X-1927 të Kryesis së Senatit.

Tiranë, me 25-X-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 129

LIGJË, 28 Tetuer 1927.

E pensioneve civile

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Nanduer 1927, Nr. 91)

Kaptinë e I-rë

Depozita të Përgjithëshme

Art 1. – Nëpunsat civil të Republikës Shqiptare, të cillët marrin rrogë të përmuejshme si mbas buxhetit, dhe lenë përqindjet n' Arkën e Përgjithshme të Pensionit, kanë të drejtë me marrë pension, si mbas dispozitave të kësaj ligjë, mbas një lutje të tyne ose mbas propozimit t' autoritetit qi mvaren nëpunsat, me vendim të Këshillës Administruese t' Arkës së Pensioneve, e me Dekret të Kryesis së Republikës.

Art. 2. – Nëpunsat civil për me përfitue si mbas dispozitave të kësaj ligjë, të drejtat e pensionit për kohën e shërbimit, duhen të kenë shërbyer dhjet vjet të mbushur dhe mbasi të kenë lënë përqindjet për pension.

Art. 3. – Pensioni asht dy llojesh:

a) Fakulltativ;

b) I detyrueshëm.

Art. 4. – Pensionohen detyrisht gjith ata nëpunsa civil që kanë shërbyer rregullisht (35) tridhjet e pesë vjet, ose kanë arrirë moshën (60) gjashtëdhjet vjeç.

Vihen në pension si mbas dëshirës e kërkesës së tyne vetëm ata nëpunsa qi kanë plotësuar (25) njizetepesë vjet shërbim.

Art. 5. – Nëpunsat civil pensionohen në mënyrë të detyrueshme:

a) Kur pashëndetësija e tyre i ndalon të vazhdojnë në shërbim;

b) Kur mbeten sakat (infirme) sa të mos mundin të kryejnë detyrën;

c) Kur me vendimin e gjyqeve kompetente dënohen me ma tepër se nji vjet burg.

Art. 6. – Shkaket e nalt-tregueme qi provokojnë të vuemit në pension të detyrueshëm justifikohen kështu:

a) Arsyenat shëndetësore mbi sëmundje mendore e fizike qi tregohen si shkak pazotësie të nëpunsit për vazhdim në detyrë, vërtetohen me nji raport të dhanun nga dy mjekë qeveritarë, të cillët i shënon autoriteti ku mvarret nëpunsi, në marrëveshtje me Drejtorin e Shëndetësis.

Në vënde ku s'ka mjekë qeveritarë shënohen mjekës privatë.

b) Arësyenat e plotësimit të shërbimit dhe të kalimit të moshës (60) gjashtëdhetë vjeç vërtetohen me dokumenta relative të nëpunsit dhe me shënimet e zyrave të Shtetit civil të vërtetueme rregullisht;

c) Arësyenat e tregueme për dënimin e nëpunsit me ma shumë se nji vjet vërtetohen me vendimin e premë të gjyqit respektiv.

Kaptinë e II-të

E drejta e mënyra e pensjonit

Art. 7. – E drejta e pensjonit për të gjith nëpunsat civil të Republikës Shqiptare fillon mbas datës 28 Nandor 1912.

Art. 8. – Kohët e kryengritjeve të mbrendëshme e të okupasioneve t'ushtrive të huaja të ndodhuna mbas 28 Nandor 1912, njifen si vazhdim nëpunsije e llogariten në vjetët e shërbimit t'atyre nëpunsave.

Përjashtohen nga kjo e drejtë ata nëpunsa qi pranuen nëpunësina ndër shtete të huaja jashtë Shqipnis.

Art. 9. – Ata nëpunsa civil qi zgjidhen Deputet, Senator, Kryetar Bashkie ose dërgohen me mision jashtë Shqipnis ose emnohen Ministra, periudha e këtij shërbimi të tyre njifet si vazhdim nëpunsije në qoftë se këta mbas periudhës së parë parlamentare, ose misjonare marrin prapë nëpunsi.

Gjith' ashtu mjekësve e inxhinerave qi merren nga shërbimi i Shtetit e shkojnë në shërbim të Bashkive, u njifet si vazh-

dim nëpunsije koha e shërbimit për Bashkit, në qoftë se merren përsëri në shërbim të Shtetit.

Nëpunsave, qi japin dorëheqje ose pushohen nga puna apo mbeten jashta kadros dhe qi merren përsëri në shërbim të Shtetit, u llogariten në vjetët e shërbimit dhe kohët e para të nëpunësis.

Art. 10. – Pensioni i nëpunsave civil qi kanë të drejtë të marrin në bazë t' art. 2 dhe 4, caktohet tue mbledhun sumat e rrogave të pagueme në 5 vjetët e fundit dhe tue shumëzue këtë me kohën e shërbimit dhe tue pjesëtue rezulltatin e këtij shumëzimi me numërimin fiks 2.100.

Formuli asht ky: $\frac{X \times Y}{2.100}$

X = Rroga e pagueme në 5 vjetët e fundit.
Y = Koha e shërbimit.
2.100 = Numuri fiks.

Fraksionet e frangut 0,48 qind. e poshtë i ngelen arkës së pensioneve. Fraksionet qi kalojnë 0,50 qind. pagohen për nji frangë.

Vjetët e shërbimit i-u llogariten nepunsave prej moshës 20 (njizet) vjet.

Art. 11. – Kur ndodhë që një pjesë e kohës së disponibilitetit pa rrogë por të pranueshme, i takon nëpunësit në pesë vjetët e fundit, për me plotësue rrogën e pesë vjetëve, merret për bazë rroga e nëpunësis së fuundit nga e cila kje pushue nëpunësi dhe n' atë mënyrë kalkulohet pensioni.

Art. 12. – Ma e vogla shkallë e pensionit për 25 vjet shërbim asht fr. ari 50 (pesëdhjetë) e për 35 vjet fr. ari 70 (shtatëdhetë).

Art. 13. – Ata nëpunsa që vihen në pension të detyrueshëm për shkaket e tregueme në paragrafet *a)* e *b)* t' art. 5, dhe qi kanë kalue 10 vjet shërbimi, kanë te drejtë të marrin nji pension me 10% ma tepër se pensioni qi caktohet në bazë t' art. 10.

Art. 14. – Ata nëpunsa civil që bëhen sakat (invalid) sa të mos mundin të kryejnë nji detyrë zyrtare ose punë private, dhe kjo pazotësi shkaktohet në të kryem e sipër të detyrës ose nga të kryemit e detyrës, në bazë t' akt-zhustifikimeve, pa u marrun para sysh koha për 10 vjetë shërbim, pensinohen me rrogën e plotë të muajit të fundit te shërbimit.

Mjekët privatë qi merren në detyrë jashtëzakonisht ose në rast epidemije, kolerë, murtajë, li, tyfis, ekzanthımatique kurse në detyrë e sipër pësojnë prej këtyne sëmundjeve, fitojnë të drejtën e pensionit i cilli caktohet në bazë të rrogës qi marrin mjekët në shërbim të Shtetit.

Art. 15. — Pa-zotësija e nëpunësave për vazhdim në shërbim për shkaket e nalt-tregueme, vërtetohet prej nji konsullti mjeksuer.

Për veç çertifikatës t'autoritetit prej të cilit mvaret nëpunësi si mas art. 6 paragraf *a)* ku do të tregohet se, përse, ku, kuer e në ç'vend ka ngjarë shkaku qi provokoj pazotësin e nëpunësit në shërbim, nëpunësi detyrohet të paraqesi dhe nji raport të dhanun prej tre mjekësve qeveritarë të zgjedhun nga Ministrija përkatëse.

Art. 16. — Nëpunsat civil qi pensionohen në raste të tregueme n'artikullat 13 e 14 munden me u përdorue si nëpunsa të përkohëshmë të Shtetit mbas nji shpërblimi që do t'u caktohet. Ky shpërblim nuk cenon të drejtën e pensionit.

Art. 17. — Familjet e atyne nëpunsave që vdesin për shkake të tregueme n'art. 14, kanë të drejtë të marrin nji pension sa katër të pestat e pensionit qi i pështetet dispozitave t'art. 14.

Pensioni i ç'do pjesëtari të familjes së nëpunsave të vdekun nuk do të jetë ma i ulte se fr. ari 10 (dhjet) dhe në qoftë se llogarisht i takon me marrë ma pak.

Pjesët e pensionit caktohen tue u konsiderue si nji jetim ç'do bir e bijë, mëmë e at, ashtu dhe grua e dy gjyshe, motra dhe vllaj të nëpunsit të vdekun.

Art. 18. — Familja e atyne nëpunsave qi vdesin mbasi këta të jenë pensionuem, marrin $^2/_3$ (dy të tretat) e pensionit të caktumun për të vdekunin kur ishte vue në pension.

Familjet e atyne nëpunsave qi vdesin para se të jenë pensionumun dhe qi kanë mbushur 10 (dhjet) vjet shërbim, merrë $^2/_3$ (dy të tretat) e pensionit të caktumun si mas art. 10.

Art. 19. — Familjet e të vdekunit qi kanë të drejtë pensioni janë këto:

a) Gruaja ose burri deri sa të martohen;

b) Bijtë deri në moshën 20 vjeç ose deri në mbarim të mësimeve pa shpenzime të Shtetit, dhe gjith jetën në qofshin invalid fizikisht ose mentalisht.

c) Bijat në martesë edhe kur të mbeten të veja e në qofshin invalid fizikisht ose mentalisht për gjith jetën;

e) Ama e pa martueme me burrë tjetër;

d) Motrat deri në martesë edhe kur të mbeten të veja;

dh) Vllazërit deri në moshën 20 vjeç ose deri në mbarim të mësimeve pa shpenzime të Shtetit dhe gjith jetën në qofshin invalid fizikisht ose mentalisht;

ë) Ati;

f) Gjyshet.

Art. 20. — Në raste kur në gjinin familjare humbasin ma shumë se nji nëpunës të pensjonumun ose me të drejtë pensioni, gjinija familjare merr vetëm pensionin ma të math të nëpunësit të vdekun.

Art. 21. — Gruaja që është e ndame nga burri i vet për ç'do shkak, si dhe bijt në shpirt dhe thjeshtrit e nëpunsit, nuk kanë të drejtë pensioni.

Kur nji nëpunës ose nëpunëse ka dalë në pension fakultativisht dhe martohet e shoqja ose i shoqi humbasin të drejtat e pensionit.

Art. 22. — Nga pensioni që marrin gratë e veja, jetimet, prindët, gjyshet, vllaznit, motrat, nuk kërkohet pagesa e borxhit qi kanë lënë nëpunsit e vdekun, por për borxhet që vënë vetë të përmendunit mund të kërkohet pagesa vetëm nga $^{1}/_{4}$ (një e katërta) e pensionit.

Art. 23. — Kryetarve të Republikës qi mbas shpalljes së kësaj ligjë mbushin periudhën e caktueme për atë ofiq, Ministrave qi rëxohen për arsye mos besimi e gjith nëpunsave civil që pushohen nga detyra për arësye politike e administrative, në bazë të vendimit të Këshillit Ministruer, u jepet nga fondi rezervë depozitumun për këtë qëllim, kjo rrogë:

a) Kryetarvë të Republikës deri sa të ri-zgjedhen $^{1}/_{5}$ (një e pesta e rrogës;

b) Ministrave qi kanë shërbye ma shumë se dhjet vjet si nëpunsa ose si Ministra, deri sa t'emnohen Ministra po në do nji nëpunsi tjetër, u jepet nji rrogë në bazë t'art. 10;

c) Gjith nëpunsave të tjerë qi kanë shërbye ma shumë se dhjet vjet, deri sa t'emnohen në ndonji nëpunsi tjetër, u jepet nji rrogë në bazë t'art. 10.

Art. 24. — Rroga e caktueme n'art. 23, vazhdon aqë kohë

sa të merret në shërbim shtetnor dhe pritet n'atë minut qi nëpunsit të pushuemun ose Ministrit të rëxuemun i propozohet nji nëpunësi e pajtueshme me dinjitetin e shkallës së nëpunësis qi ka pasur ma para se të pushohet.

Ari. 25. – Në qoftë se nëpunsi, i mbetun jashta kadros ose i pushumun qi ka mbushur dhjet vjet shërbim, vdes para se të merret përsëri në shërbim, familja e tij ka të drejtë me marrë pension në bazë t'art. 10 të kësaj ligjë.

Gjith' ashtu dhe familjet e nëpunsave qi japin dorëhekjen dhe që kanë mbushur dhjetë vjet shërbim, vdesin para se të hyjnë përsëri në ndonji shërbim tjetër të Shtetit kanë të drejtë pensioni në bazë t'art. 10 të kësaj ligjë.

Kaptinë e III-të

Ndihma

Art. 26. – Nëpunësat qi nuk kanë mbushur dhjet vjet shërbim dhe qi kanë lënë përqindjet, kur hiqen nga nëpunësija nga shkaku i nji sëmundjeje marrun në kohë të nëpunësis por jo nga shkaku i shërbimit, dhe në qoftë se kjo sëmundje e bën nëpunsin që të mos mundi të kryejë ndonji shërbim publik dhe në qoftë se nëpunsi nuk ka t'ardhuna për jetesë, në këto kondita ay nëpunës ka të drejtë të marrë njëherësh prej arkës së pensionit nji ndihmë prej nji muaji e gjysmë rrogë shumëzuar me vitet e shërbimit.

Për bazë t' asaj rroge merret rroga e muejit të fundit.

Në rast kur sëmundja çduket dhe nëpunësi merret përsëri në shërbim koha e shërbimit qi do të bëjë mandej i shtohet kohës kur nëpunësi ka qenë i sëmurë dhe për t' u njoftur ajo kohë si kohë shërbimi, nëpunsi ësht i detyruar me lenë përqindjen.

Konstatimi i sëmundjes së nëpunsit do bëhet si mbas dispozitave të kësaj ligjë.

Art. 27. – Familja e nëpunsavet civil qi vdesin vetiu dhe jo nga shkaku i shërbimit, para se të mbushin dhjet vjet shërbim dhe në qoftë se kanë lënë përqindjet dhe në qoftë se familja nuk ka mjete jetese, në këto kondita ajo familje ka të drejtë me marrë prej arkës së pensionit të gjitha përqindjet e depozitueme prej nëpunësit të vdekun.

Kaptinë e IV-të

Mënyra e shkaket e humbjes së Pensionit

Art. 28. – Nëpunësat civil humbasin të drejtat e pensionit dhe i fitumun qoftë:

a) Kur dënohen me gjykim të gjyqeve për shkak trathtije ndaj Atdheut;

b) Mbas nji dënimi për çfar do krim, keq shpërdorim të hollash, korupsion (dobidashësi) dhe keq shpërdorim besimi;

c) Mbas nji dënimi me humbjen gjithnji të drejtave civile;

ç) Kuer pushohen me vendim të Këshillit ministruer mbas raportit të nji komisjoni i formuem prej Diktimit e dy fonksionarë t' administratës e qi arësyenat të jenë aq të forta sa me justifikue humbjen e të drejtës së pensionit, dhe në këtë rast, në Dekretin e pushimit të përmendet fjala: «me humbjen e së drejtës së pensionit».

d) Kur japin dorëhekjen nga nëpunësija para se të mbushin dhetë vjet shërbim.

Art. 29. – Nëpunësit civil të pensionumun humbasin të drejtën e pensionit:

a) Kur dënohen në mënyrë qi tregohet në artikullin 28 në paragrafin *a, b, c*;

b) Kur marrin nënshtetësin e huaj ose kur pa lejen e Qeveris, hyjnë në shërbim të nji shtetit tjetër.

Art. 30. – Familjet e nëpunsave civil humbasin pensionin:

a) Gruaja (e veja) ose buri kur martohet ose kur dënohen si mbas paràgrafit *a, b, c,* t' art. 28;

b) Fëmija femna dhe motrat kur martohen ose kur dënohen si mbas paragrafit *a, b, c,* t' art. 28;

c) Fëmija meshkuj dhe vllaj kur bëhen 20 vjeç, dhe nuk janë në studim, ose kur dënohen si mbas paragrafit *a, b, c,* t' art. 28;

ç) Prindrit kur vdesin ose kur dënohen si mbas paragrafit *a, b, c,* t' art. 28.

Kaptinë e V-të

Themelimi i Arkës së Përgjithëshme të pensioneve për nëpunsat civil dhe burimet e saj

Art. 31. – Për sigurimin e pensionit të nëpunsave civil dhe mbas vdekjes së tyne për sigurimin e familjes krijohet nji

Arkë e posaçme me emnin: « Arka e Përgjithëshme e pensioneve për nëpunsat civil ».

Kjo arkë formon nji institut të veçantë dhe funksionon pranë Ministris se Financavet, nënë autoritetin e Ministris së Financave dhe lehet nën drejtimin e administrimin e nji këshille administruese, e përbame prej, nji Senatori, nji Deputeti, nji antari të Diktimit, nji antari të Këshillit Kontrollues, dhe prej nga nji funksionarit të naltë të ç'do Ministrije.

Art. 32. – Pensioni paguhet nga fondi i pensjonit të paguem me kët ligjë.

Kur fondi i pensioneve ose i rezervave nuk munden veçanërisht seicili t'i bëj ballë pagesavet respektive, mungesat plotësohen nga Arka e Përgjithëshme e Shtetit.

Për këto mungesa Ministrija Financavet detyrohet me shënue në budgetin e Shtetit nji fond të posaçëm për ketë qëllim.

Art. 33. – Burimet e Arkës së Pensionit janë këto:

a) $6\,^0/_0$ (gjashtë për qind) nga rroga organike e gjith nëpunësave dhe t'atyne që vihen në pension si mbas kësaj ligjë;

b) $^1/_4$ (nji e katërta) e rrogës të muajit të parë dhe $^1/_4$ (nji e katërta) e rrogës të muajit të dytë të nëpunsave që emnohen për herën e parë;

c) Sasija e shtesës të nji muaji rrogë në rast të gradimit të nëpunësit;

ç) Gjobat që merren nga rrogat për ndeshkim disiplinuer të nëpunsavet;

d) $2\,^0/_0$ (dy për qind), si fond rezervë për nëpunësat e pushuemun, e të mbetun jashta kadros;

dh) Dhurata dhe të lanuna me testament për këtë qëllim;

e) $5\,^0/_0$ (pesë për qind) e djetave e indemniteteve e përfaqësimeve;

f) $4\,^0/_0$ (katër për qind) të rrogave organike t'atyne nëpunësave të cilët në kohën e okupacjoneve të përmendun n' art. 8 tue qenë jashta detyrës ose në shërbim nuk kanë lanë përqindjen e pensionit.

Mbajtja e $4\,^0/_0$ (katër për qind) të rrogave vazhdon deri sa të plotësohet si mbas kësaj ligjë gjith sasia e përqindjes së pensionit të rrogës për ato kohna; në rast të mos plotësimit të sasisë, përqindjet mbahen nga pensioni i nëpunsit të pensionumun;

g) $1\,^0/_0$ (nji për qind), nga t'ardhunat e buxhetit të Bashkive;

h) 5 % (pesë për qind) të rrogave organike të atyne nëpunësave që kanë qenë pushue ose nxjerrun jashta kuadros, për arësye Administrative, ose që kanë dhanë dorëhekjen dhe që merren prap në shërbim të Shtetit.

Kjo 5 % (pesë për qind) vazhdon të merret deri sa të plotësohet si mbas kësaj ligjë gjith sasija e përqindjes së pensionit për rrogën e asaj kohë që nëpunësi ka qenë jashta detyrës. Na rast të mos plotësimit të sasis përqindjet mbahen nga pensioni i nëpunsit të pensionumun.

Kaptinë e VI-të

Formimi dhe fonksionimi i Këshillës Administruese

Art. 34. — Antarët e Këshillës Administruese s'Arkës së Pensioneve, të përmendun n'art. 31, emnohen me vendimin e Këshillit Ministruer mbas propozimit të Ministris së Financavet, dhe dekretohen me dekret Presidencial.

Art. 35. — Këshilla Administruese ka nji Kryetar dhe nji Nënkryetar, të cilët zgjidhen prej gjirit të Këshillit.

Art. 36. — Drejtori i Përgjithëshëm i Arkës së Pensioneve emnohet mbas propozimit të Këshillës Administruese me pëlqim të Ministris së Financavet, me vendim të Këshillit Ministruer dhe me Dekret të Kryesis së Republikës.

Gjith'ashtu veprohet dhe për pushimin e tij.

Detyrat e Drejtorit të Përgjithëshëm do të caktohen prej Këshillës Administruese me nji rregullore të veçantë.

Art. 37. — Këshilla Administruese mblidhet të pakën dy herë në muej prej Kryetarit ose Nënkryetarit ose n'emën të këtyne prej Drejtorit të Përgjithëshëm, i cili merr pjesë në mbledhje me votë konsultative.

Ministri i Financavet mundet me marrë pjesë në mbledhje dhe në këtë rast merr Kryesin e Këshillës.

Art. 38. — Detyrat e Këshillës Administruese janë:

a) Të mbikëqyri e të kontrolloj administrimin dhe mirëvajtjen e Arkës;

b) Aprovon buxhetin e Arkës mbas propozimit të Drejtorit;

c) Jep mendimin mbi çdo kërkesë krediti të nevojshme për Arkën, dhe mbi përdorimin e fondeve;

ç) Jep mendimin mbi ndonji propozim që bëhet për modi-

fikimin e ligjës së pensionit, ashtu dhe të rregullores mbi ligjën e pensionit;

d) Vendos mbi masat që janë për t'u marrë për të ndihmuar pensionistët dhe eventualisht nëpunësit.

Vendimet e Këshillit Administrues për buxhetin dhe për përdorimin e fondeve do t'i shtrohen për aprovim Dhomave Legjislative.

Rregullorja e ligjës s'Arkës do të përmbaje hollësisht organizimin dhe fonksionimin administrativ t'Arkës, si dhe çeshtjet e përgjithëshme të cilat i shtrohen për aprovim Këshillit Ministruer.

Art. 39. – Arka e Përgjithëshme e pensioneve për nëpunësa formon person juridik dhe përfaqësohet në gjyq prej Drejtorit të Përgjithëshëm t'Arkës, ose zëvëndësit e tij.

Art. 40. – Arka e Përgjithëshme e pensioneve administron me nji buxhet të veçantë t'ardhunat e të dalunat e saja.

Ky buxhet i shtrohet për çdo vit aprovimit të Dhomavet Legjislative me anë të Ministris së Financavet.

Art. 41. – Në fund të çdo viti Arka detyrohet të parashtronjë gjendjen e sajë financjare me nji bilanco i cili me nji raport i parashtrohet për aprovim Dhomave Legjislative prej Ministrit të Financavet.

Art. 42. – Kapitali rezervë dhe eksedentet buxhetare ashtu dhe çdo e ardhun që mbetet pa u shpenzue në buxhet depozitohen ç'do vit n'emën t'arkës së pensioneve në banka depozitimi.

Art. 43. – Nëpunësit me rrogë t'arkës së përgjithshme të pensioneve gëzojnë si dhe nëpunësat e tjerë të Shtetit të gjitha të drejtat që u japin ligjët.

Emërimi dhe pushimi i nëpunësave t'arkës së pensioneve bahet prej Këshillës Administruese.

Kaptina e VII-të

Dispozita të ndryshme

Art. 44. – Nëpunsat civil fitojnë të drejtën e pensionit prej ditës së fillimit në detyrë.

Nëpunsat janë të detyruemun t'i parashtrojnë Kryesis së Këshillit Administrues lutjen dhe dokumentat e duhuna për kërkimin e pensionit.

Pensioni llogaritet në të nesërmen e ditës që nëpunësi largohet nga detyra ose vdes. Në këtë mënyrë veprohet edhe për pensionin e familieve të nëpunsave që vdesin.

Art. 45. — Arka e pensionit civil paguan vetëm pensionet e nëpunsave civil edhe të familjeve të tyne si mbas dispozitave të kësaj ligjë.

Art. 46. — Gjith Ministrat e Shtetit dhe delegatët e çdo kategorije dhe të çdo shkalle konsiderohen si nëpunësat e tjerë dhe për sa i përket mbajtjés së përqindjes për pension veprohet si për nëpunësat e tjerë.

Në qoftë se Ministri ose Delegati në kohën e emnimit si Ministër apo si Delegat ësht ndodhë Ministër pa portofol në pension ose në dorëhekje, në këtë rastë përqindjet për pension u ndalet po n' atë mënyrë që u ndalet nëpunsave të tjerë.

Art. 47. — Depozitimet qi hyjnë n' arkën e pensioneve si mbas kësaj ligjë n' asnjë mënyrë dhe në as një rastë nuk munden as të kërkohen, as të konfiskohen, as të jepen si hua, për veç rasteve të parapame n' art 27 të kësaj ligjë.

Art. 48. — Nëpunësat e pensionumun mbajnë titullin e nëpunësit qi kanë pasun në kohë kur u pensionuan.

Art. 49. — Nëpunësit e pensionumun munden të merren me punë e me veprime private të cillat nuk cenojnë nderin e nëpunësis.

Art. 50. — Nëpunësat e pesionuem marrin pension edhe kur shpërngulen me banim jashta Shqipnis.

Art. 51. — Si lutjet për pension ashtu edhe shqyrtimet e shtimet mbi dokumentat qi paraqiten për justifikim, merren, shqyrtohen, hetohen dhe vendosen prej Këshillës Administruese, e cilla i a u komunikon të interesuemve. Në raste ankimi ose kundërshtimi, t'interesumunit adresohen Këshillit Ministruer.

Art. 52. — Veç lutjeve të gjitha dokumentat që merren nga autoritetet Shtetnore e private ose komunale si nga zyrat e Shtetit Civil, Zyrat Kadastriale, Zyrat e Bashkive, rregjistra, kishëtare, raporta mjeksore etj. për kalifikimin e të drejtës së pensionit nuk paguajnë taksa e janë të përjashtueme nga timbrat.

Art. 53. — Gjith nëpunësat civil të ç'do dege e kategorie që të jenë nuk mund të vihen në pension kundra dëshirës e pëlqimit të tyre veç se kur të kenë plotësue 35 vjet shërbim

ose të kenë arrijt moshën 60 vjeç apo në rastet qi tregohen në paragraf *a*, *b*, *ç* t' art. 5.

Art. 54. — Senatorët, Deputetët, Kryetarët e Bashkive qi nuk marrin rroga por shpërblim dhe gjith ata nëpunësa të përkohëshmë që nuk përfytyrojnë në kuadron e buxhetit, nuk janë nëpunës, e prandej nuk u ndalohet gja për fond pensioni dhe këta nuk përfitojnë prej të drejtës së pensionit.

Përjashtohen nga dispozitat e sipërme ata Senatorë, Deputet e Kryetarë Bashkie, si edhe ata mjekë e Inxhinjera të Bashkive që janë nëpunësa para këtyne shërbimeve e qi marrin pjesë përsëri në shërbimet e Shtetit si nëpunësa. Këta për me përfitue nga të drejtat e pensionit janë të detyruemun me lanë përqindjen e pensionit për gjithë kohën që mbajnë ato detyra në bazë të shpërblimit ose të rrogës qi marrin.

Art. 55. — Gjith pensionet e caktueme në ç' do mënyrë e kuj-do qi të jenë para shpalljes së kësaj ligjë do të rregullohen e do të paguhen si mbas dispozitave të kësaj ligjë.

Art. 56. — Përqindjet për pension të caktueme dhe të depozitueme ose të pa depozitueme përpara shpalljes së kësaj ligjë, kanë me u plotësue ose me u pague në bazë të sasis së përqindjeve që tregohet n' art. 33 prej rrogës së nëpunsit ose prej pensionit të pensionumunit.

Art. 57. — Shumat e derdhuna n' arkën Shtetnore si fond pensioni prej nëpunsave civil deri në shpalljen e kësaj ligjë, llogariten si depozitë dhe dorëzohen Arkës së Përgjithshme të Pensionit.

Art. 58. — Dispozitat e ligjëve të pensioneve civile qi janë në kundërshtim me këtë ligjë janë të anullueme.

Art. 59. — Këjo ligjë hyn në fuqi ç' prej datës së shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Art. 60. — Gjith Ministrat detyrohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit;

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Këshillit Ministruer;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës së pensioneve të nëpunësve qi na asht parashtrue prej Kryesis së Senatit me datë 17-X-1927 e Nr. 99/I.

Tiranë, me 28-X-1927.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
Zav. Ministri Drejtësis
I. VRIONI

Zev. Ministri i Arësimit
I. VRIONI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri Bujqësis e Pyjeve
Minisri i P. Boore
FERID VOKOPOLA

Nr. 130

LIGJË, 26 Tetuer 1927.

Mbi shtojcën e art. 3 të konvencjonit të vajgurit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 9 Nanduer 1927, Nr. 93)

Shtojcë e art. 3 të konvencjonit të vaj-gurit bamë në mes të Qeveris Shqiptare e të Hekurudhavet të Shtetit Mbretnuer t'Italis me 12 Mars 1925.

Art. 1. – Konvencjonit të voj-gurit bamë në mes të Qeveris Shqiptare e të Hekurudhavet të Shtetit Mbretnuer t'Italis, n'art. 3 i shtohet kjo dispozitë:

Afati i trië vjetve caktuem n'art. 3 të Konvencjonit të parë si perjudë kërkimesh t'arta e thellimesh, ka me vazhdue për kohën deri me 31 Dhetuer 1930 (njimijë e nandëqind e tridhet).

Art. 2. – Ministrija e Bulqësis e Pyjevet, ngarkohet me zbatimin e kësajë ligjë.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit;

Mbi proponimin e Ministris së Bulqësis e Pyjevet;

Mbasi Parlamenti e Senati e kan pranuem;

DEKRETOJMË:

zbatimin e shtojcës së nenit 3 të Konvencjonit për vojin e gurit të bamë në mes të Qeveris Shqiptare dhe të Hekurudhavet të Shtetit Italjan.

A. ZOGU

Ministri i Bujqësis e Pyjeve
FERID VOKOPOLA

Nr. 131

LIGJË, 9 Nanduer 1927.

Mbi kompletimin e trupit të Oficeravet e të Aspirantavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Nanduer 1927, Nr. 94)

KOMPLETIMI I TRUPIT T' OFICERAVET

Trupi i Oficerave aktiv

Neni 1. — Kompletimi i Trupit t' Oficerëve aktiv, bahet me ata studenta që mbarojnë me sukses shkollat ushtarake të vendit dhe emnohen Aspiranta n' Ushtri.

Në qoftë se këto shkolla nuk do të kompletojnë kadron e oficerave në këtë rast graduatët (kapterat) gradohen Aspiranta, mbasi të kenë mbushë 4 (katër) vjet rrjesht shërbimi, dhe mbasi të fitojnë në provimin e dhanun, përpara nji komisionit ushtarak.

Neni 2. — Në shkollat ushtarake të vendit, pranohen ata që kanë mbarue 6 (gjashtë) rende të shkollave fillore. dhe qi kanë moshën 18 deri 25 vjeç, dhe qi janë të pëlqyeshme nga pikëpamja fizike e morale.

Neni 3. — Aspirantat, Nëntogerat e Togerat, qi duan me hye në shërbim, t' Intendancës; do të kryejnë n' Intendancën e Përgjithshme nji shërbim prove 6 muejsh, dhe mbas provimit, në qoftë se dalin me sukses të mirë emnohen definitivisht Intendancjerë; për ndryshe këthehen në degat e tyne.

Neni 4. — Për Oficerët që dëshirojnë të transferohen në degë të Rekrutimit, veprohet pikërisht si për ata t' Intendancës.

Neni 5. — Në detyra të Shtat-Madhnoris, mund t' emnohen vetëm ata oficerë që kanë krye nji shkollë të naltë ushtarake të huaj (shkolle shtatmadhnorije) ku të ketë marrë pjesë

aktivisht në mësime dhe të ketë dhanë provim si studentat e atij Shteti që ndodhet shkolla.

Dërgohen në shkollat e Shtat-Madhnoris, në shtete të huaja ata oficerë që kanë mbarue me sukses Akademin Ushtarake, dhe që kanë krye me sukses dy vjet shërbim si oficera të trupave dhe mbas nji provimi zotsije dhanun përpara nji komisioni, të posaçëm i kryesuem prej Komandantit të P. të Fuqis Armate në të cilin komision për veç antarve të tjerë, merr pjesë dhe Kryetari i Shtatit Madhnor.

Neni 6. – Në detyrat e mjeksis, Veterinaris e Barnatoris, për shërbim aktiv mirren njata persona qi kanë diploma profesionit të tyne.

Në rast që nuk gjinden Barnatorë me diplomë, mund të meren dhe prej praktikanvet barnatorë që kanë marë lejen si mbas ligjës në veprim të Shëndetësis.

Neni 7. – Në degë t' Armëtaris mirren në shërbim aktiv njata persona qi të jenë të diplomuem për këtë profesjon ose të njohin punimin e Farkes e të jenë të praktikuem në ndreqjen (reparacjon) e armëvet.

Neni 8. – Transferimi i Oficerve nga dega e Gjindarmeriës në t' ushtris, dhe nga kjo degë n' atë të Gjindarmeriës, bahen me dëshirën e tyne, me pëlqimin e të dy Komandave, dhe me Drekret Presidencjal. Sa për oficerat të gradës Toger e poshtë, transferimi bahet në mënyrë të tregueme, dhe mbasi më parë të ketë krye me zotësië nji shërbim prove prej gjashtë muejsh në degën ku transferohet.

Në rast kur keta nuk tregojnë zotësi prove, kthehen në degën e parë dhe koha prej gjashtë muejsh nuk llogaritet në vjetërsi.

Neni 9. – Ata studenta që mbarojnë me sukses shkollën ushtarake të vëndit, dhe nga shkaku i ngushtësis së kadros, nuk mirren në shërbim aktiv, emnohen oficera rezervë, pagohen me rrogë kapteri, me gradë Aspiranti dhe merren në shërbim aktiv në raste të parë që t' u hapet vend në kadro.

Neni 10. – Ata studenta që kanë pa shkollë dhe mirren në shërbim ushtrije si mbas ligjit të Rekrutimit dhe me sukses mbarojnë kursin e posaçëm për oficera rezervë; emnohen oficera të rezervës.

Neni 11. – Të gjithë të pensionuemit dhe të qitunit jashtë shërbimit me shpërblim, të cilët ma parë kanë shërbye, si oficera

e aspiranta aktivë konsiderohen oficera rezervë kur qi mos të kenë kaluar 61 vjeç, ose mos të jenë qitun nga shërbimi dhe ma poshtë nga 61 vjeç me raporta mjeksore që vërtetojnë pamundësinë.

Neni 12. — Gjith mjekët, veterinarët, e Barnatorët, civila deri në moshën 60 vjeç konsiderohen në kategorin e oficerëvet rezervë dhe në mobilizim të përgjithshmë mirren në shërbim tue ju caktue grada e rroga e tyne prej nji komisionit të formuem prej Ushtris e Shëndetësis.

Gradimi i Oficereve dhe i Aspirantave

Art. 13. — Gradimi në gradën e afërme ma të naltë varet:

a) Piksëpari të ketë mbushë kohën minimale qi ashtë caktue për secilën do gradë;

b) Të ketë vende të çelëta në kadro;

c) Të ketë treguar meritë në shërbim të gradës qi ndodhet:

d) Të tregoje zotësi dhe meritë për gradën qi do të marrë, mbas nji provimi të rregullshëm si në praktikë, ashtu dhe në theorie;

e) Të ketë nji biografi të pëlqyeshme.

Neni 14. — Koha e shërbimit minimal ashtë:

Në gradën		Aspirant	2 vjet
«	«	Nën-Toger	4 vjet
«	«	Toger	4 vjet
«	«	Kapiten II	3 vjet
«	«	Kapiten I	5 vjet
«	«	Major	4 vjet
«	«	Nën-Kolonel	3 vjet
«	«	Kolonel	4 vjet

Neni 15. — Gradimi në gradën Gjeneral Brigade, Gjeneral Divizioni dhe Gjeneralisim, në rast të nevojshmë, ashtë në kompetencën e Kryetarit të Republikës.

Neni 16. — Gradimi i oficerëvet bahet me 21 Kallnuer të ç'do viti. Seksioni personal në 15 Dhjetuer i paraqitë Komandës Armate listën e oficerëve që kanë kompletue kohën për gradim bashkë me letër cilsinat e ardhuna prej eprorëvet të tyne ndër të cilët ashtë shenue dhe merita ose mos merita për gradim. Letër cilsinat nuk janë bazë të domosdoshme për gradim, por nën Kryesin e Komandës Armate formohet nji komision tue pasë për antar Kryetarin e Shtatit-Madhnuer, Inspek-

torin e Ushtris, e Kryetarin e Intendancës, dhe Kryetarët e Seksionevet personal, e të Rekrutimit qi ky komision shqyrton dhe këqyrë letërcilësinat dhe cakton si mbas kadros oficerët që do të gradohen dhe ata qi do t'ju shtohet rroga ashtu edhe ata qi nuk do të gradohen, shkaqet e mos gradimit i u njoftohen oficervet përkatës me shkresa rezervate.

Oficerët e trupave që shërbejnë në Kancelerie për me u gradue duhet të kenë konditë zotësije si në gradën që mbajnë ashtu dhe në gradën që do të marrin. Për veç këtyne kunditave para se të gradohen janë të detyruem të kryejnë me zotësi edhe gjashtë muej shërbim ndër trupa.

Oficerët e Gardës, të Gjindarmeris, dhe ata të Kryesis së Republikës, nuk i shtrohen kësaj dispozite.

Neni 17. — Oficerët Akademiste deri në gradën Toger, gradohen pa provim duke u preferue prej të tjerëvet; por për t'u gradue Kapiten i Kl. II. e Kapiten i Kl. I-rë, dhe Major duhet t'i shtrohen provimit theorikisht e praktikisht. Për me u gradue në grada ma të nalta duhet të tregojë nji zotësi praktike në probleme lufte në manevra. Kursistat e regjimenterët për ç'do gradë duhet t'i shtrohen provimit të rregulltë si në theori dhe në praktikë.

Neni 18. — Oficerët të meritueshëm për gradim në rasë që nuk gradohen shkaku i mos lejimit të kadros, me motin e parë marrin gjysmën e diferencës së rrogës së tyne dhe të gradës që do të gradohen; dhe në vjetin e dytë prap për atë shkak marrin rrogën e plotë e gradës qi do të gradohen.

Neni 19. — Në raste të përmenduna në nenin 18 gradimet për oficerët Akademista, bahen mbas vjetërsisë dhe në njesi vjetërsije merren parasysh dokumentat e zotësisë për oficerat kursistë e regjimentarët gradimet bahen mbas vjetërsis dhe mbas zotësis të tregueme në provimet e përmenduna në nenin 18.

Neni 20. — Koha e luftës njifet për efekt gradimi dy fish për njata Oficerë e Aspiranta që shërbejnë ndër trupa e komanda tuj marrun pjesë në zona të luftës e të operacjonevet qi përfundohen me luftë.

Neni 21. — Dënimi me vendim të Gjyqit që sjellë largimin e oficerëve nga detyra për ma shumë se 45 ditë, dhe hymja e oficerit në nëpunësi civile për ma shumë se gjashtë muej, rëzojnë nji vjet nga vjetërsija për gradim. Koha në të cilën nji student me bursën e Shtetit nuk kryen me sukses mësimet, rrëzohet nga vjetërsija.

Koha e sëmundjes e justifikueme me raport mjeksor nuk i rrëzon vjetërsinë nji oficerit.

Neni 22. — Proponimet prej Komandës Armate bahen në fillim të Kallnuerit duke u paraqit në Kryesin e Republikës tre lista të vërtetueme prej Komisionit nga të cilat njera do të tregojë oficerët që do të gradohen, tjetra oficerët që do të marrin shtesë rroge, e treta ato oficera që kanë kompletue kohën për gradim por nga shkaqet e ndryshme nuk meritojnë gradim ose shtesë rroge. Aspirantat që dalin prej shkolle, gradohen Aspiranta në mbarim të shkollës.

Neni 23. — Transferimi i oficerve prej degës së Rekrutimit, Intendancës e Armatoris, në degën e Kamsoris, bahen mbas nji shërbimi prej gjashtë muajsh të kryemun me zotësi në degën ku transferohen.

Gjith ashtu veprohet dhe për transferimin në Kamsori t'oficerëve t'artileris, mbasi këta të kenë gradën ma të naltë n'armën e tyne.

Neni 24. — Për oficerët rezervë e aspirantat nuk ka gradim të rregullshëm. Nji gradim në gradën e oficerëvet rezervës mund të bahet në plotësimin e konditavet qi vijojnë:

a) Mbas të kryemit e kohës së shërbimit si mbas nenit 14;

b) Mbas nji shërbimi të mirë për shka i përket thirrjes ndër manevra; në thirrjen që bahet për ngrehjen e trupavet të rezervës për qëllime të posaçme dhe mandej në kohë të luftës.

Neni 25. — Oficerët e pensionuem kur me vullnetin e vetë miren në shërbim kancelerije marrin si shpërblim diferencën e rrogës së pensionit e të asaj që i përket gradës së tyne. Por në rast që kthehen prapë në pension nuk ju shtohet koha për pension. Në qoftë se mirren në shërbim aktiv të detyrueshëm konsiderohen si aktivë dhe kanë të tana të drejtat e oficerëvet aktivë dhe kohja e shërbimit i u shtohet në pension.

Neni 26. — Gradime jashtë konditave të përmenduna në këtë ligjë bahen vetëm në rast nevoje ushtarake, ose kundrejt shërbimeve të jashtëzakonshme si në kohë paqe ashtu dhe në kohë lufte. Këto gradime janë në kompetencën e Kryetarit të Republikës.

Gjith ashtu Kryetari i Republikës jep shpërblime, lavdërime, medalje, dekoracione, për shërbime të jashtëzakonshme si në kohë paqe dhe në kohë lufte.

Neni 27. – Dhanja e nji gradës ushtarake si titull nderi mund të bahet:

a) Sidomos oficerëvet me meritim të plotë kur hynë në pension ose mbas hymjes së tyne në rezervë.

b) Personave civıl, të cillët (për shembëll në ngrehjen e formimit të vullnetarve) kanë fitue meritime të posaçme ushtarake për Atdhe.

Me gradën e nderit Ushtarak nuk asht lidh as kur nji e drejtë tjetër për veç se në raste të posaçme shtetnore ata oficera nderi mbajnë uniformën. Të till nuk mund të marrin komandë të trupavet aktive, për veç se me pëlqim të Kryesis së Republikës.

Neni 28. – Të huajtë të cilët pa fitue nënshtetësinë Shqipëtare hyjnë përkohësisht në shërbimet e ushtëris mbesin jasht kadros ushtarake. Të drejtat e detyrat e tyne janë caktue me anë të kontratës. Ata që fitojnë nënshtetësin shqiptare mund të radhohen në kadro ushtarake e gradohen si mbas kësaj ligjë.

Neni 29. – Ata studenta që mësojnë me bursën e Shtetit në shkollat ushtarake të huaja, dhe që mbarojnë me sukses studimet, dhe që marrin dokumentat e mbarimit, marrin gradën në të cilën gradohen dhe nënshtetasit e Shtetit t'asaj shkolle. Oficerët e Aspirantat që me bursën e Shtetit mësojnë në shkollat e huaja për zgjanimin e studimeve ushtarake në mbarim të studimeve me sukses e me dokumenta të mbarimit, konsiderohen shkollarë si mbas gradës së shkollës ku kanë studjue. Për këta nuk ka diferencë vjetërsije për sa kanë studjue në shkollat e jashtme.

Ata që mbarojnë në shkollat e jashtme ushtarake me bursën e Shtetit, janë të detyruem të shërbejnë për **10** vjet si oficera në ushtri.

Neni 30. – Oficerët që kanë shërbyer në Qeverit e huaja e hyjnë me dëshirën e tyre në shërbimet ushtarake të Qeveris Shqiptare, për vjetërsi të gradës që kanë ju konsiderohet fillim, e hymja në Ushtrinë Shqiptare, por në qoftë se kësish oficera kërkohen nga ana e Qeveris Shqiptare, at-herë ju mirret parasysh vjetërsija që kanë pasë dhe në Shtetet e huaja.

Neni **31**. – Civilat me rrogë që shërbejnë si nëpunësa në ushtri për klasin dhe rrogën e tyne do t'i shtrohen kategorizimit e klasifikimit të nëpunsave civil deri sa të bëhet ligja e posaçme.

Neni 32. – Oficerët qi për tre vjet rrjesht ju vërtetohet pazotësija për gradim prej komisionit, transferohen në klasën rezervë.

Neni 33. – Gradat e dhanuna ma parë jashtë kohëvet të caktueme në këtë ligjë nuk mirren prapë, por për oficerët e mbetun pa u gradue pa ndonji shkak ligjor, llogariten kohët përkatëse të çdo gradës, e kështu shifen të meritueshme për kompletimin e kohëvet për gradat ma të nalta.

Neni 34. – Koha e shkueme jashtë shërbimit me dorhekje rëzohet nga vjetërsija.

Neni 35. – Vjetërsija e oficerëve që meritojnë për gradim, dhe nga mos premtimi i kadros nuk gradohen, por vetëm marrin rrogën e plotë të gradës ma të naltë; u njifet prej fillimit të shtesës së rrogës, e jo prej datës së veshjes së uniformës të gradës ma të naltë.

Neni 36. – Oficerët që lihen jashtë shërbimit dhe ma vonë rimirren në shërbim ushtarak koha e jashtme shërbimit nuk ju mirret para sysh për gradim.

Neni 37. – Oficerët e Shtatit Madhnor, fitojnë nji vjet vjetërsi vetëm për atë gradë që kanë kur kompletojnë studimet e shkollës së Shtatit-Madhnoris si mbas nenit 5, e për gradat e tjera i shtrohen plotësisht kohëvet minimale të gradimeve të përmenduna në këtë ligjë.

Neni 38. – Tërë dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligjë anullohen.

Neni 39. – Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 40. – Trupi Ministruer detyrohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetarı i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Këshillit Ministruer;

Mbasi Senati e Parlamenti kanë votue;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi kompletimin e trupit t'oficerëvet, mbi gradimin e Oficerëve e të Aspirantave.

Tiranë, me 9-XI-1927.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
Zav. Ministri Drejtësis
I. VRIONI

Ministri i Arësimit
XH. YPI

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri Bulqësis e Pyjeve
Zëv. Ministri P. Botore
F. VOKOPOLA

Nr. 132

LIGJË, 9 Nanduer 1927.

Mbi transferim kredije për Shkollën e Drejtësis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Nanduer 1927, Nr. 94)

Art. 1. — Kredija për Shkollën e Drejtësis fr. ari 30.000 e votueme nga Dhomat Legjislative në kap. 10 të budgetit t'Arësimit, transferohet po për atë qëllim në budgetin e Ministris së Drejtësis.

Art. 2. — Kapitulli 10 i budgetit t' Arësimit anullohet, e për transferimin e këtij fondi, çilet në budgetin e Ministris së Drejtësis kap. 11 «Shpenzime për Shkollën e Drejtësis».

Art. 3. — Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e Financavet, e Arësimit dhe e Drejtësis, ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris s' Arësimit;

Mbasi Senati e Parlamenti kanë votue;

D E K R E T O J M Ë :

zbatimin e Ligjës mbi transferimin e nji kredije prej fr.ari 30.000 në Budgetin 1927-1928 të Ministris s' Arësimit, qi Na asht parashtrue prej Kryesis Senatit me datë 3-XI-1927 Nr. 188.

Tiranë, 9-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i P. të Jashtme
Zav. Ministri Drejtësis
I. VRIONI

Ministri i Arësimit
XH. YPI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 133

LIGJË, 16 Nanduer 1927.

Mbi ndarjen e 1.000 kuintal misër gratis popullsis së Nikaj-Merturit e Malsis së Jakovës

Art. 1. – Ministrija e P. të Mbrendëshme autorizohet me blé në mënyrë paksimi me anë të Prefekturës së Shkodrës nga dhetarët e atij qarku, nji mij kuintal misër për t'i u nda gratis popullsis së vobekët të Nikaj-Merturit e Malsis Gjakovës në këtë përpjestim : për Nikaj-Merture 700 kuintal, Malsis Gjakovës 300 kuintal.

Art. 2. – Për blemjen e këtij misri i shtohet budgetit të Ministris së Financavet të vjetit 1927-1928, në kapitull të veçantë, nji fond prej fr. ari 20.000.

Art. 3. – Fondi që tregohet n'art. 2, të këtij ligji përballohet në të ardhunat e të mbrapambetunavet.

Art. 4. – Kjo ligjë hyn në fuqi me botimin e sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. – Ministrija e P. të Mbrendëshme, dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrëndëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e Ligjës mbi ndarjen e nji mij kuintalëve misër gratis popullsis së vobekët të Nikaj-Merturit e Malsis Gjakovës.

Tiranë, më 16-XI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 134

LIGJË, 17 Nanduer 1927.

Mbi shtimin e 400 gjindarmëve dhe dy ndihmës inspektorash në kuadrën e Gjindarmeriës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Nanduer 1927, Nr. 95)

Art. 1. – Kuadros së Gjindarmëris në fuqi i shtohet edhe nji fuqi prej 400 vetash si mbas listës së bashkangjitun.

Art. 2. – Kuadros në fjalë i shtohen edhe dy ndihmës inspektora të tjerë.

Art. 3. – Për të përballue rrogat dhe shpenzimet e ndryshme të këtyne si dhe rrogat e oficerave asp. të mbajtun jashta kuad. fros i shtohet budgetit udhtues të gjindarmëris shuma prej Frari 140.000 me kapituj të ndryeshme, si mbas listës dalluese bashklidhun ksaj ligjë, tue transferue shumen në fjalë nga Kap. 2. «Rrogë graduati dhe ushtari» të budgetit 1927-28 të Komandes së P. të Fuqis Armate.

Art. 4. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. – Zbatim'i kësaj ligjë u ngarkohet Ministris së Financavet dhe asaj së P. të Mbrendëshme,

---

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit.

Mbassi Trupi Legjislativ e ka pranuem;

Mbi proponimin e Këshillit Ministruer;

DEKRETOJMË:

Zbatimin e ligjës mbi shtimin e 400 gjindarmëve dhe dy ndihmës Inspektorash në kuadron e Gjindarmëris.

Tiranë, më 17-XI-1927

A. ZOGU

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Lista dalluese mbi shtesat ndër kapituj në budgetin e Komandës së P. Gjindarmëris 1927-28

Kap. 22 «Rrogë Oficeri» i shtohet. .	Fr. ari	13.850. –
Kap. 23 «Rrogë Asp. e Gjindarmi» .	«	123.810. –
Kap. 24 «Shpenzime udhtim e dijete» .	«	2.000. –
Kap. 27 «Qira»	«	340. –
Gjithsejt (Njiqind e dyzetmij)	«	140.000. –

Listë mbi mënyrën e shtimit të kuadros e të krediteve

Rroga (deri në fund të vitit Financjar)

Kapter	10	Fr.ari	4.700	
Reshtarë	20	«	7.500	
Tetarë	40	«	13.300	
Gjind.	330	«	94.000 =	119.500. –
Dy ndihmës Inspektor rrogë. . . .		Fr. ari		8.050. –
Për Insp. Shpenz. udhtimi dhe uniformë		«		2.000. –
Për Insp, qira shtëpije		«		340. –
Rrogë për oficera e aspiranta të ngelun jashtë kuadros 927		«		10.110. –
Shuma e përgjith. (Njiqind e dyzetmij)		Fr. ari		140.000. –

Nr. 135

LIGJË, 17 Nanduer 1927.

Mbi hapjen e nji kapitullit të ri me shifër 22 në budgetin e Misistris së P. Botore, ushtërim 27-28

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Nanduer 1927 Nr. 95)

Art. 1. – Budgetit të Ministris së P. Botore' Titull II «shpenzime të parendëshme» kategori e I. i shtohet nji kapitull me shifër 22 e me emertim «Shpërblim dami Shoqnis Fives Lille».

Art. 2. — Autorizohet Ministria e Financavet, me paksue 130.000 fr. ari nga Kap. 7 ndertime e mbajtje udhash» të Budgetit të Ministris së P. Botore.

Art. 3. — Shumat e paksueme 300.000 Fr.ari si pas nenit 2 të kësaj ligjë i mveshen kapitullit riçelun qi përmëndet në nenin I.

Art. 4. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. — Ministria e Financavet dhe ajo e P. Botore ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtëtit.

Mbassi trupi legjislativ ka pranuem;

Mbas proponimit të Ministris së P. Botore;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi hapjen e nji kapitulli të ri me shifër 22, në Budgetin e Ministris së P. Botore.

Tiranë, më 17-XI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore
H. MOSI

Nr. 136

LIGJË, 16 Nanduer 1927.

Mbi suprimimin e gjendarmëris të qarkut të Leshës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Nanduer 1927, Nr. 95)

Art. 1. — Suprimohet qarku i Gjindarmëris së Leshës tue i lidhun rrethet, Lesh, Pukë e mirditë të këtij qarku qarkut të Gjindarmëris së Shkodrës.

Art. 2 — Kjo ligjë vihet në zbatim që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. — Ministria e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit.

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrëndëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi suprimimin e qarkut të gjindarmëris së Leshës, tue i lidhun rrethet Lesh, Pukë e Mirdi'ë të ktij qarku Qarkut të Gjindarmëris së Shkodrës,

Tiranë, më 16-XI-1927 **A. ZOGU**

Nr. 137

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi bartjen e një shume prej fr. ari 6000 nga Kap. 40 (nxierje punim e bartje kripe në Kap. 32 rrogë personeli Qendër e qarke e ushqim kuajsh

Art. 1. — Për me i bam ballë rrogës së Komiserit të Kontrollimit të veprimeve bankare, Ministrija e Financavet asht e autorizueme me bartë brënda budgetit të sajë 1927-1928, Kap. 40 «Nxjerrje (punim) e bartje krypë» shumën prej Fr. Ari 6.000 në kap. 32 Rrogë personali qendruer e qarkuer e ushqim kualsh».

Art. 2. — Pagesa e rrogës bahet që nga data e emnimit të komiserit.

Art. 3. — Kjo Ligjë vehet në zbatim ditën e shpalljes.

Art. 4. — Ministrija e Financavet asht e ngarkueme me zbatimin e kësaj Ligje.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullii me fuqit Sovrane të Shtetit,

Mbasi trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e Ligjës mbi bartjen e nji shume Fr. Ari 6.000 nga kap. 40 «Nejerrje (punim) e bartje krype» në Kap. 32 «Rrogë personeli qendër e qarkuer e ushqim kualsh».

Tiranë, më 29-XI-1927 **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 138

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi transferim kreditash në budgetin e Ministris së P. të Mbrendëshme t' ushtrimit 1927-1928

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. – Zbriten nga Kap. 1 Art. 1 «Rrogë personali» të degës Admin. së P. të Mbrendëshme fr. ari 19.400 (nandëmbëdhjetëmij e katërqind).

Art. 2. – Zbriten nga Kap. 13 Art. 1 «Rrogë personali» fr. ari 6.000 (gjashtëmijë) dhe nga Kap. 31 «Rrogë e shpenzime» për Specialistin kundra Syfilizit fr. ari 11.000 (njimbëdhjetëmijë) që të dyja të degës Shëndetësis Botore.

Art. 3. – Përmbledhja e shumave të zbrituna prej kapitujve të treguem n'art. 1 e 2 të këtij ligji, fr. ari 36.400 (tridhetë e gjashtëmijë e katërqind) i mveshen kapitujve të poshtshenuem të budgetit të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Kap. 2. art. 1 rrogë Këshill. Admin. ndër male fr. ari 5.640.
Kap. 4. art. 1 Shkresori fr. ari 1.760.
Kap. 4. art. 2 Shtypshkrime fr. ari 1.000.
Kap. 4. art. 2 Zjarm e dritë fr. ari 2.000.
Kap. 8. art. 2 Subvencjon kler të tre besimesh 16.000.
Kap. 12. Shpenzime të mshefta fr. ari 10.000.

Art. 4. - Me zbatimin e kësaj ligjë, detyrohet Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet.

Art. 5. – Kjo ligjë hyn në fuqi që prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi transferim kreditash në budgetin e Ministris së P. të Mbrendëshme 1927-1928.

Tiranë, me 29-XI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 139

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi ndërimin e fjalve të egzistueme në kapituj 20 e 30 të budgetit 1927-1928, të Drejtoris së Përgjithshme të Shëndetësisë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. — Kapitulli 20 i pranuem me emertimet «Çmendime, shpenzime për mbajtjen e shërimin e të smuetvet, shtresa mbulesa e tjera, personeli shërbyes e qira fr. ari 35.000 ndrohet e bahet kështu:

«Çmendina ushqim rrogë personeli, rrogë e specialistit qi do të sillet së jashtmi shpërblim mjekut shikues (vizitues) për deri qi të mrrijë specjalisti, shtresa, mbulesa për mbajtje godina, e të tjera si mbas nevojavet fr. ari 35.000.

Art. 2. — Kapitulli 30 i pranuem me emertimet: shpenzime për luftimin e epidemive vegla disenfekcjoni, llazareti e tjera fr. ari 5.160 ndrohet e bahet kështu:

«Shpenzime për vegla të Spitaleve, dispanserive e laboratoirit të Bakterollogjisë Shtetit fr. ari 5.160.

Art. 3. — Në bazë të kësaj ligje u shtrohen veprimet financjare të këtyne kapitujve për sa kohë ka fuqi budgeti financjar 1927-1928.

Art. 4. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5. — Për zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi ndërimin e fjalëve t' ekzistueme me kapituj 20 e 30 të budgetit 1927-1928, të Drejtorisë së Përgjithëshme të Shëndetësisë.

Tiranë, me 29-XI-1927. **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 140

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi shtimin e nji fondi prej 40.000 fr. ari

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. – Autorizohet Ministria e Financavet me shtue në budgetin e sajë t' ushtrimit 1927-1928, nën Kap. 49 «rrogë për nëpunsat e të gjithë degave t' administratës të mbetun jashta kuadros nji fond prej fr. ari 40.000 (dyzet mij)».

Art. 2. – Shtimi i këtij fondi përballohet nga t' ardhunat e Kap. 9 *b*, «Tatim xhelepi mbi shtaza të trasha» mbassi në kte kapitull parashifet nji e ardhun prej fr. ari 40.000 (dyzet mijë) ma tepër se asht shenjue në budgetin e ushtrimit 1927-1928.

Art. 3. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Me zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet Ministria e Financavet.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,
Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministriës së Financavet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi shtimin e nji fondi prej fr. ari 40.000 nën Kap. 49 «rrogë për nëpunsat e të gjithë degave t'administratës të mbetun jashta kuadros.

Tiranë, me 29-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 141

LIGJË, 24 Nanduer 1927.

Mbi krijimin e Drejtoris së Shtypit pranë Ministris së P. të Jashtme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. — Krijohet Drejtorija e Shtypit pranë Ministris së P. të Jashtme.

Art. 2. — Për drejtimin e kësaj përveç Sekretarit të shenuem në kuadron do të ketë nji Drejtor me nji rrogë mujore 400 fr. ari e 50 fr. ari mujor si allokacjon.

Art. 3. — Shumat e nevojshme për t'i bërë ballë personelit të përmendun n'art. 2, do të paguhen nga fondi i kapitullit 10 të budgetit 1927-1928 të Ministris së P. të Jashtme.

Art. 4. — Rrogat e personelit do të paguhen që nga data e dorëzimit të dekretit ose emnimit përkatës.

Art. 5. — Me zbatimin e kësaj ligjë ngarkohet Ministria e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Jashtme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi krijimin e Drejtoris së Shtypit pranë Ministris së P. të Jashtme.

Tiranë, me 24-XI-1927.

A. ZOGU

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 142

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi anulimin e taksave të shenuemë n' art. 4 e alinjatet a) b) t'art. 22 të ligjës mbi Financat e Bashkive me d. 7-VI-1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. — Taksi i dy uravet të Shkodrës i shenuem n' art. 4 të ligjës mbi Financat e Bashkivet me datë 7-VI-1926, ngrihet.

Art. 2. – Taksi i caktuem n'alinjatet *a)* e *b)* t' art. 22 po të ligjës së tregueme n' art. 1 të kësaj ligjë për barkat me vel e motor anullohet.

Art. 3. -- Kjo ligjë hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministria e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi anulimin e taksave të shenueme n' art. 4 e alinjatet *a)* e *b)* t' artikullit 22 të ligjës mbi Financat e Bashkivet me datë 7-VI-1926.

Tiranë, me 29-XI-1927, **A. ZOGU**

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Nr. 143

LIGJË, 24 Nanduer 1927.

Mbi ngrehjen e ndërtesave Qeveritare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. – Ndërmjet veprave botore të përmenduna n' artikullin e parë të ligjës së Konvencjonit 29 Maj 1925, të huas, e qi do të bahen me mjetet e saj, përfshihen edhe ndërtesat e nevojshme për zyrat qeveritare.

Art. 2. – Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Ministria e P. Botore dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministris së P. Botore;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi ngrehjen e ndërtesave të nevojshme për Zyrat Qeveritare.

Tiranë, me 24-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Minisri i P. Boore
HIL MOSI

Nr. 144

LIGJË, 29 Nanduer 1927.

Mbi nji kredi për rrogë Komiseri të Kontrollimit të veprimeve bankare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. — Për me i bamë ballë rrogës së Komiserit të Kontrollimit të veprimeve bankare, Ministria e Financavet asht e autorizueme me bartë mbrenda budgetit të sajë 1927-1928, kap. 40 «nxjerrjet (punimi) e bartje krype» shumën prej fr. ari 6.000 në kap. 32 «rrogë personali qëndruer e qarkuer e ushqim kualsh».

Art. 2. — Pagesa e rrogës bahet që nga data e emnimit të Komiserit.

Art. 3. — Kjo ligjë vehet në zbatim ditën e shpalljes.

Art. 4. — Ministrija e Financavet asht e ngarkueme me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,
Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi mbartjen e nji shumë fr. ari 6.000 nga kap. 40 «Nxjerrje (punim) e bartje krype» në kap. 32 «Rrogë personalit qendër e qarkuer e ushqim kualsh».

Tiranë, me 29-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 145

LIGJË, 24 Nanduer 1927.

Mbi krijimin e nji Legatës në Pragë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Dhetuer 1927, Nr. 98)

Art. 1. — Krijohet nji Legatë në Pragë.

Art. 2. — Punët e kësaj Legate do të drejtohen prej Titullarit të Legatës s' onë në Beligrad.

Art. 3. — Kjo ligië hyn në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. — Ministrija e P. të Jashtme ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat Sovrane të Shtetit,

Mbossi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së P. të Jashtme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi krijimin e nji Legate në Pragë.

Tiranë, me 24-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Nr. 146

DEKRET - LIGJË 7 Dhjetor 1927.

Mbi zbritje e caktim të tagrit doganuer të disa gjanave të tarifës doganore të vjetit 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 16 Dhetuer 1927, Nr. 99)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbi proponimin e Ministris së Financavet,

Mbassi asht ndigjue e pëlqye vendimi i Këshillit Ministruer me datë 26-VII-1927;

DEKRETOJMË:

Art. 1. — Tagri doganuer i gjanavet qi përfshihen në listën

e bashkalidhun do të merret si mbas shënimëve ripektive që përmban lista në fjalë.

Art. 2. – Kjo Dekret-ligjë hyn në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3. – Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret Ligjë.

Na, Kryetari i Redublikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fupit sovrane të Shtetit,

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e Ligjës mbi zbritje e caktim të tagrit doganuer të disa gjanave të tarifës doganore të vjetit 1926.

Tiranë, më 7-XII-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Shtojcë e tarifës doganore e vjetës 1926

N. rend.	Nr. Tarifës			EMNI I GJASË	Tagri si mbas tarifës	Bahet për kuintal
1	25	d		Bakala e aringa		
	25		1	të kripuna e me shellin	25	25
	25		2	i thatë	50	50
2	46			galeta peksimet etj.		
	46	a		Galeta e peksimet	80	80
	46	b		ekmek kadaif (buk kadaif)	20	90
	46	c		Pet gjylaçi	20%	100
3	66			Konserva pemësh e barishtash e turshina gjithfarësh	120	120
4	73			Anason		
	73	a		Koker	20	20
	73	b		pluhun	20%	30
5	89	b		Faqoll (glukosija) për sheqerxhi	20%	10
6	92	a		Pemë sheqeri të krislizueme	100	10
	92	b		Sheqerna konfeta e bombon	20%	120

N. rend.	Nr. Tarifës	EMNI I GJASË	Tagri si mbas tarifës	Bahet për kuintal
7	117	Voj e undyra të ndryshme		
	117 f 1	Voj margarine	30	30
	117 i 2	tëlynë e undyrë pemësh e margarinë	20%	200
	117 gj	Voj soja	20%	150
8	139 f	Këpucë me shuell druni	20%	250
9	142 d	Kolci (gambali) lekurë	20%	250
10	168 i 4	gjana drunit e tjera të pa përmenduna	20%	100
11	184 ç	Letre transparan me voj	20%	30
12	197	Libra gjithfarësh a, b, nji e 2	60-15	tagri i falun
13	206 c	Tire gjithfarësh për çarap qylyma etj,		
	1	Natyrale	40	40
	2	i zbardhun	50	50
	3	Me ngjyrë	60	60
14	212	Mbas fjalve me nji shtesë tagri 40% i shtohen edhe frazët : kur kanë ma tepër se 15% e deri 49% kanë me u rendue me 60% shtesë mbi tagër kur kanë ma se 49% klasifikohen (me mendafsh natyral Nr. 254 b) me artifiçjal Nr. 254 c).		
15	243 g 4	Dollakë dhe geti	20	300
16	244 ç	Pelhurë artificial e përzieme me pamuk	20%	700
17	265 c	Kapela, fesa, qylaha, takija etj. tagri mbetet si mbas tarifës.		
18	276 a 1	Lineleum për shtroje me ngjyrë a me lule, kuer trashmonija të jetë deri 3 milm.	45	45
	276 a 2	kur të jetë ma tepër se 3 milimetër	45	45
19	276 b	Për mbloje e veshje mobiljesh e e perde dritoresh (tela çerata)	60	60
20	300 c	Krem gjithfarësh për pastrim gjana metali	20%	30

N.rend.	Nr. Tarifës			EMNI I GJASË	Tagri si mbas tarifës	Bahet për kuintal
21	324			Llampa me trum qi ndezen me shpirto gaz ose karbit	400	100
		a		hekurit	400	100
		b		metali tjetër	800	200
22	326			Hekur e çelik i shkrimë		
		a		Qylqe i pa punuem	1	0,50
		b		grimca e pluhun	2	0,80
		c		i vjetër qi nuk hyn në punë për qëllim qi asht bamun	5	2
23	327	a	1	Putrela trena gjithfarësh	5	2
	327	a	2	Hekura e vagona për degovil e pjesët e tyne	5	2
24	345	c		Kakia çerep saça tangar hekuri ose gize	20⁰/₀	10
25	351			Ene hekuri e gize guzhinetre shpijet të		
		a		pa galvanizueme	20⁰/₀	20
		b		të galvanizueme	30	30
26	257			Sumlla, pulla metali vath, unaza me gurë false etj. hekurit e çelikut	85	85
27	360			Cilindra me gasë ose oxsigene	5	5
28	423	a		Makina telegrafi e telefoni e veglat e tyne për veç telave	200	100
	423	b		Makina e aparata radio telegraf, telefon e kalamit (rrufe pritëse)	20⁰/₀	100
29	453			Zyf zere bllak	10	10
30	465	c		Dyll të kuq Cera lacca	20⁰/₀	50
31	480	a		Ballkot (barë me mbyt peshkë)	i ndaluem	i ndaluem
	480	b		Specialitet lang e pluhuna për me mbytë myza e tjera insekte	20⁰/₀	10
32	483	c	1	Surum vaksina neosalvarsan e ekstret e tyne		tagri i falun
	483	c	2	Barë për gelbazë të gjasë së gjallë si fugermal distol etj.	20⁰/₀	tagri i falun
33				Sheqer tepricë fabrikash		60

Nr. 147

LIGJË 16 Nanduer 1927.

Mbi shtimin e 3 policëve në Prefekturën e Korçës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 16 Dhetuer 1927, Nr. 99)

Art. 1. – Kuadros së Policis së Prefekturës së Korçës të caktueme në budgetin e vjetit 1927-28, i shtohen edhe tre Policë të tjerë me nga nji rrogë mujore 150 fr. ari.

Art. 2. – Rroga e Policëve të shenuem n'art. I. e qi kapet në shumën fr. ari 5400 në vjet, do të përballet me kursimet e bamuna në Kap. I. «Rrogë qendër e qarqe» të budgetit të Ministris së P. të Mbrendshme të vjetit 1927-28.

Art. 3. – Kjo ligjë hynë në fuqi ditën që do të shpallet në Fletoren Zyrtare.

Art. 4. – Ministria e P. të Mbrëndëshme dhe ajo e Finan cavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mban Trupi Legjislativ ka pranue ;

Mbi proponimin e Ninistris së P. të Mbrendshme ;

D E K R E T O J M E :

zbatimin e ligjës mbi shtimin e tre Policëve në Prefekturën e Korçës.

Tiranë, me 16-XI-1927

A. ZOGU

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 148

LIGJË, 20 Dhetuer 1927.

Mbi siguririmin e ndihmës për të mjerumit e malsive të Shkodrës, të Kosovës e të viseve të tjera ksodore në Shqipni

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Dhetuer 1927, Nr. 101)

Art. 1. – Për me sigurue bukën deri në fund të marsit 1928. të mjeruemvet qi ndodhen ndër Malsina të Kosovës, Shkodrës, e në vise tjera kësodore të Shqipnisë e qi aproksimativisht

kapin dyzet mij frymë, kanë me u depozituam n' emën të Shtetit njizet e pesë mijë kuintalë misër. Sa për pesëdhjet mijë kuintalët misër që parashifet i nevojshëm për vjetin 1928-29, deri në korrën e re, kanë me u marrun dispozita të veçanta në budgetin përkatës.

Art: 2. — Për fondin e kërkuem prej fr.ari 600.000 për të blemit e 25.000 kuintalëve misër çilet në budgetin e Ministris së Financavet nji kapitull i veçantë nën numrin edhe emnin «ndihmë për të mjeruemit e Malsive të Shkodrës, Kosovës, e të viseve tjera ksodore në Shqipni».

Art. 3. — Shuma e diftueme n' art. 2 ka me u përballuem me kursimet qi Qeverija detyrohet me i ba me budgetin 927-28, dhe në rasë qi këto kursime nuk do të mjaftojnë për me u përbullue, autorizohet Qeverija me i plotësuem të metat me ndihme ose me hua, ose me të dyja.

Për mbledhjen, përndarjen e misrit në fjalë e të ndihmave si edhe për rregullimtn e të gjitha veprimëvet qi i përkasin qëllimit të kësaj ligjë, në Kryeqytet formohet nji komisjon qendrur prej 8 antareve si vijon:

a) Dy Senatorë.
b) Dy Deputetë.
c) Nji përfaqësues i Ministris së P. të Mbrendëshme.
ç) Nji përfaqësues i Ministris së Ministris së Financavet.
d) Nji përfaqësues i Ministris së P. Botore.
dh) Drejtori i Kryqit të Kuq Shqiptar.

Komisjoni i nalt-përmendun ka për detyrë:

Të marrin misrin në proporcjon nga Dhetarët, Myltezimat e visëve qi ka me qenë transporti ma i lehtë, në rasë nevoje edhe nga proprietaret, në këtë mënyrë tue u caktue çmimi, me anën e Këshillave Administrative dhe të Bashkive përkatëse, e si ekspert tue pasun pranë këtyne dy tregtarë të vendit.

Në rast qi proprijetarët e drithit nuk e shesin me vleftën e caktueme prej Këshillës kompetente, komisjoni i qendrës drithin në fjalë ka të drejtë t' a sjellë nga jashtë pa tagër doganuer, në qoftë se kët tmportim e sjell me nji çmim ma të vogël se aj qi mund të blehet mbrenda.

Të kujdesohet për mbledhjen e ndihmavet të nevojshme si mbrenda ashtu edhe jashtë Shqipnis.

Komisjoni ka të drejtë t'emnojë kryetarë edhe antarë nderi prej të huejsh.

Art. 5. – Çmimet e misrit që do të merret mbas dispozitave t'art. 4, Myltazimave u llogaritën në borxhet e tyne dhe proprietarëve u paguhen nga Arka e Shtetit, si mbas diftesave qi u nep në dorë Komisjoni.

Art. 6. – Ky misër ka me u depozitue në Shkodër në Shëngjin, Lesh, dhe në vende të tjera ku ka me qenë nevoja dhe ka për t'u shpërdamun me anën e Komisjonëve ndër Prefektura të përbamë prej Prefektit, e Drejtorit të Financavet, Kryetarit dhe dy antarëve të Bashkis, e prej Nëpunsit të Botores; ndër Nënprefektura të përbame prej Nënprefektit, Kryetarit e dy antarëve të Bashkis, Kryenëpunsit të Financave dhe Nëpunsit të Botores.

Art. 7. – Komisjonët e përbamë n'art. 6 ndodhen nën urdhën e syrvejancen e Komisjonit Qendruer, dhe nën kontrrollimin e Inspektorëve të Shtetit.

Art. 8. — Misri i përmbledhun në bazë të këtij ligji do t'u përndahet vetëm të mjeruemve, të Kosovës, Shkodrës, dhe të viseve tjera kësodore të Shqipnis; ky veprim do të bahet si mbas listave të pregatituna prej Pleqësive të katundve e të vërtetueme prej Këshillave të Nënprefekturave përkatëse.

Art. 9. – Marrësit e këtij misri kurse janë në gjendje qi të punojnë përdoren në veprimet e punimet të botores ndër rruga komunale.

Art. 10. – Veprimet e Komisjonit Qendruer, ekzekutohen prej autoritetve Shtetnore.

Art. 11. – Kjo ligjë hyn në fuqi që ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 12. – Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqit sovrane të Shtetit.

Mbassi Trupi Legjislativ ka pranuem.

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi sigurimin e ndihmës për të mjeruemit e

Malsive të Shkodrës, të Kosovës, e të viseve tjera kësodore të Shqipnis.

Tiranë, me 20-XII-1927.

A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësis
Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i Arësimit
XH. YPI

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore
H. MOSI

Ministri Bujqësis e Pyjeve
F. VOKOPOLA

Nr. 149

LIGJË, 14 Dhetuer 1927.

Mbi lanjen e 4800 fr. ari në dispozition të Drejtoris P të Shëndetsis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Dhetuer 1927, Nr. 101)

Shuma prej 4.800 (katërmij e tetëqind) fr. ari e treguemë në kapitullin 13 «Rrogë personali» në budgetin udhtues të Drejtoris së P. të Shëndetësis, lehet në dispozicion t' asaj Drejtorije, me qëllim qi t' u ndahet atyne Bashkive qi kanë nevojë për përballimin e rrogave të mjekëve të tyne.

Art. 2. — Kjo ligjë hyn në fuqi që prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare. të mveshun prej vullnetit të popuilit me fuqinat sovrane të Shtetit,

Mbasi Trupi Legjislativ ka pranuem.

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi lanien në dispozicjon të Drejt. Përgj. të Shëndetësis fr. ari 4.800 me qëllim qi t' u ndahet atyne Bashkiveqi kanë nevojë për përballimin e rrogave të mjekëve të tyne.

Tiranë, me 14-XII-1927.

A. ZOGU

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 150

LIGJË, 20 Dhetuer 1927.

Mbi rregullimin e shpronësımit të rrugës së ri hapun në tregun e lagjes Kala të Durrsit dhe mbi mënyrën e përkrahjes të së damtuënıve nga tërmeti

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Dhetuer 1927, Nr. 101)

Art. 1. – Taksi 1⁰/₀ i krijuem me ligjën me datë 22-VII-1925 për lulzimin e qytetit të Durrësit shtohet dhe bahet 2⁰/₀. Kjo taksë ka me vazhdue tri vjet prej datës së shpalljes së kësaj ligjë,

Art. 2. – Kjo shtesë taksi do të rezervohet vetëm për çdamimin e të damtuemve nga termeti dhe për përballimin e çpronsimit të rrugës në fjalë shuma që ka me mungue në përmbushjen e qëllimit të nalt-përmendun do të plotësohet me nji për qind pjesën tjetër të taksit të lulzimit.

Art. 3. – Si në çdamimin e damëve të shkaktueme nga termeti ashtu edhe me çpronsimet e bamuna në këtë rrugë merren për bazë rregjistrat shtetnore të vergjisë, vlefta e rregjistrueme në vergji quhet vlefta ligjore e ç' do pronit të çoronësuem ose të shembun nga termeti dhe i paguhet të zotit nga ana e Bashkiës me mënyrën e tregueme në këtë ligjë.

Taksat mbi vleftën e fitueme (sherefije) të pjesave të ngelun dhe tepricat e rrugave i shtrohen dispozitave ligjore në fuqi.

Art. 4. – Shqyrtimi i vleftës të ç' do proni dhe caktimi i mënyrës së pagimit të kësaj vlefte bahet me anë të nji komisjoni të posaçëm i formuem në këtë mënyrë si Kryetar i këtij komisjoni nji Deputet i zgjedhun prej Dhomës së Deputetve, dhe si antarë ñga nji nëpunës prej Ministrive të Mbrendëshme, të Financave, të Botores, dhe nga nji antarë prej Këshillit t' Administratës dhe të Bashkis së Durrësit. Ky misjon ka për detyrë të rregullojë edhe mënyrën që pagesa të vobegtëvet të bahet mbrenda në një mot, dhe gjith të tjerëve mbrenda tri vjetve.

Art. 5. – Vlefta e trojeve qi u ka ngelë të damtuemve në proporcjon me vleftën e rregjistrueme u zbritet nga shuma e vërtetueme në favor të pronarëve. Vlefta e këtyne trojeve të ngelun pronarëve caktohet nga komisjoni i posacëm i formuem si mbas art. 4.

Art. 6, – Vendimet e komisjonit janë të preme. Në mba-

rim të detyrës Komisjoni gjithë vendimet dhe aktet ia referon Bashkisë se vendit e cila si mbas vendimeve të Komisjonit t' interesuemve u nep diftesa detyrimi (bono) për me u pague të drejtat e tyne në mënyrën dhe në kohën e caktueme prej Komisjonitv; ecanërisht komisjoni u nep edhe j' interesuemve nga nji letër dishmi ku do të tregoj kohën dhe sasin e pagesës.

Art. 7. — Prefektura dhe Bashkija e Durrësit janë të detyruem me zbatue vendimet e komisjonit pa ndonji kundërshtim. Bashkıja kur asht në gjendje mund t' i bajë pagesat edhe para afatit të caktuem nga Komisjoni por gjithëmonë tue i preferue ata ma të vobektit.

Art. 8. — Ç' do vendim e detyrim i Prefekturës dhe i Bashkis së Durrësit dhe të Këshillave t' Administratës e të Bashkiës për sa i përket çpronsimit dhe rregullimit të së drejtave të pronarëve të kësaj rruge anullohen dhe ngelin pa fuqi. Veprimet dhe pagesat e deri ıashme me vendimin e komisjonit konformohen me dispozitat e kësaj ligjë.

Art. 9. — Ndërtesat e reja qi kanë me u ngrehë në dy anët e rrugës së re në lagjen Kala të Durrësit mbrenda në nji mot prej shpalljes së kësaj ligjë përjashtohen për pesë vjet nga taksa e vergjisë e ç' do taksë tjatër të Bashkiës.

Art. 10. — Kjo ligjë hynë në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 11. — Ministıia P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqinat sovrane të Shtetit.

Mbasi trupi legjislativ ka pranuem.

Mbi proponimin e Ministris së P. të Mbrendëshme.

DEKRETOJMË:

zbatimin e Ligjës mbi rregullımin e çpronsimit të rrugës së re hapun në tregun e Lagjes Kala të Durrësit, dhe mbi mënyrën e përkrahjes të së damtuemëve nga termeti.

Tiranë, me 20-XII-1927 **A. ZOGU**

Min. i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 151

LIGJË, 20 Dhetuer 1927.

Mbi pranimin e konvincionit për instalimin e fabrikës fliksazhit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Dhetuer 1927, Nr. 101)

Ndërmjet të Ministris së Pyjeve e të Bujqësis të Republikës Shpiptare përfaqësuem prej Z. Ministrit Ferid Vokopola që ka për t' u qujtë tash e mbrapa Qeveria me njenën anë dhe të Shoqënis Italiane të Minjerve të Selenicës me ndeje në Romë Piazza S. S. Apostoli 81 e përfaqësueme prej Z. Marquis Gaetano di Suni, mbas latër përfaqësimit me datën 18 Dhetuer e që ka për tu quejtë tash e mbrapa Shoqënija, në tjetër anë.

Bahet marrëveshtja për instalimin e nji uzinës fliksazhi e seres (bitume) në Shqipni e mbrenda zonës së minjerës Selenicës që të mundë të përdori me shumë puntor për dobie e zhvillim t' industris Shqiptare, dhe n' interesë të vendit, mbassi këto instalacjone bahen në Shqipni me konditat që posht vazhojnë:

1. — Shoqënija ka me pas të drejtë me importue në Shqipni të lirueme nga çdo taksë doganare të gjitha maqinat e materialet vjekse (accesoir) për instalimin e funksjonimin e kësaj uzine si edhe të gjitha maqinat e materialet vjekse të destinueme për bamjen e pregatitjen e ambulllazheve relative.

Nji herë kanë me u përjashtue nga çdo taksë doganore importimi i vojnave të posaçme që shoqënia ka për t' importuem në sasi të nevojshme vetëm për flyksazhin kimik të seres (ziftit) deri sa këto mos t' i gjej në Shqipni me kondita të njinjishme.

2. — Të gjitha shumat që shoqënija do t'i paguej Qevers në bazë të kontratës të konçesjonit të minjerës me datën 20 Qershuer 1922 dhe të listës së lidhun ashtu edhe kontratës së dekovilit me datën 19 Dhetuer 1929, dhe të ligjës së doganës kanë m' u njehsue vetëm mbi sasin e seres së Selenicës së përdorun efektivisht për përzimjen e flyksazhit. Për këtë qëllim për kontrollimin e sasisë së seres së Selenicës qër përmban flyksazhin si edhe për kontrollimin e vojnave të posaçme të përdorun Shoqënija ka për të ruejt gjithmonë të dukëshëm mostrat e prodhimeve të ndryshme dhe regjistrat e ngarkimit dhe zhngarkimit për t' i a parashtrue dhe për t' i a tregue Qeveris gjith sa herë që t' i kërkoj dhe ka për t' ju shtrue masavet të kontrollit

që Qeverija qendrore ka për t'ja pa të nevojshme mbi sa i përket importimit dhe eksportimit të materialeve të sipërme.

3. – Për punimet e flyksazhit Shoqënija përjashtohet prej çdo taksë të re Shtetnore.

4. – Puntorët dhe nëpunësit e marrun prej Shoqënis për këto punime kanë me qenë nënshtetas Shqiptarë për veç personelit teknik e specialistave në qoftë se nuk gjinden Shqiptar me kompetencë të njinjishme.

5. – Shoqënija detyrohet me pague mbrenda afatit të kontratës pa eksеption të gjitha taksat e caktueme në konvencjonin e minjerës dhe të dekovilit deri sa prodhimi mesatar i seres së minjerës së Selenicës mos të kapërcejnë 5.000 tonelata në vjetë:

Në rasë që prodhimi të shtohet edhe ma tepër të gjitha taksat e thanuna sipër kanë për t'u zbrit 25% vetëm mbi sasinat e seres së Selenicës të prodhueme ma tepër se 5.000 tonelatë në vjetë.

6. – Ky konvencjon asht i vlefshëm kontrata e minjerës dhe dekovilit deri me 31 Dhetuer 1960.

7. – Kjo kontratë asht përpilue shqip dhe frengjisht e në rasë kontestimesh kanë me pas vleftë paralelisht të dyja tekstet shqip e frengjisht.

8. – Me zbatimin e këtij konvencjoni ngarkohet Ministria e Bujqësis e Pyjevet, Ministria e Financavet dhe e Botores.

9. – Kjo kontratë ka me qenë e vlefshme që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare

---

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqit sovrane të Shtetit,

Mbassi trupi Legjislativ ka pranuem;

Mbi proponimin e Ministris së Bujqësis e Pyjevet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e Konvencjonit për instalimin e nji fabrikës Flyksazhit prej Shoqënis Italjane të Minjereve të Selenicës.

Tiranë, me 20-XI-1927. **A. ZOGU**

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Ministri i P. Botore
H. MOSI

Mnistri i Bulqësis e Pyjeve
F. VOKOPOLA

Nr. 152

DEKRET-LIGJË, 12 Dhetuer 1927.

Mbi shtimin dhe ndryshimin e disa dispozitave të ligjës së të dhetave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Dhetuer 1927, Nr. 101)

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare, të mveshun prej vullnetit të popullit, me fuqinat sovrane të Shtetit, tue pamë vendimin e Këshillit Ministruer, me datë 16-VI-1927.

DEKRETOJMË:

Art. 1. – Përjashtohen nga taksa të dhetavet të gjitha pemët e frytëshme për veç ullinit, qitrave, gështenjavet e rushit.

Kjo dispozitë do t'inserohet në letër adjudikatat mbi shitje të dhetavet.

Art. 2. – N'ato vise ku nuk gjinden rregjitstrime kadastrorë për shkak se janë zhdukun në kohna të trazimeve e të luftave të ndodhun në Shqipni, të dhetat e bimës e të prodhimeve tjera të pa përjashtuemë, do të shiten me adjudikatë e tue u bazue edhe në dishmina të pleqësive në mënyrë që diftohet n'art. 4, 5 e 6.

Art. 3. – Klientat për me mund me blemë të dhetat në bazë t'art. 3 duhet t'i paraqesin Këshillavet Administrative të vendit nji dishmi të vërtetueme nga pleqësija e lagjës ose e katundit ku zotnojnë pasuninë e patundëshme, si: tokë të livruemë, ullishta, vneshta, livadhet, kullota, e ndërtesa qirajë, me të cilën do të deklarohet edhe se klientat janë dorëvues efektiv vetë ose me pjestarë në të.

Këto pasuni do të jenë nga ajo kategori që japin prodhime të përvjetëshme.

Art. 4. – Dishmija e pleqësive do të përshijë:

a) sasinë e dynymëve të pasunis,

b) pjestarët e saj që nuk do të jenë ma se dy,

c) kufijtë e tashëm,

ç) vleftën me të cilën do mund të shitet pasunija në rasë që nuk paguhet çmimi i të dhetës.

Art. 5. – Vlefta aproksimative e pasunis që do të caktojë pleqësija në dishminë, do të vërtetohet ose të ndryshohet nga ana e Këshillit Administrativ si mbas hetimeve të veçanta e

në bazë të kësaj vleftë do të shitet e dheta pa bamë ndonji shtim krediti mbi te.

Art. 6. – Antarët e Këshillit Administrativ që nuk përkujdesohen me zbulue të vërtetën mbi përmbajtjen të dishmeve e me sigurue Arkën e Shtetit, janë përgjegjës solidarisht për ç' do dam eventual t' Arkës së Shtetit.

Art. 7. – Pleqësitë e lagjeve ose katundeve që dishmojnë kundër të vërtetës në dam të thesarit shtetnuer, dhe kjo konstatohet ma vonë mbas shitjes së të dhetave dënohen me burgime nga 6 deri 18 muej.

Veç kësaj financa e vendit sekuestron edhe pasunitë e tundëshme e të pa tundëshme të pleqësivet e kërkon të shiten për me mbulue damin që i asht shkaktue arkës.

Art. 8. – Dishmitë e pleqësive të plotësuëme si ma sipër e të vërtetueme nga ana e Këshillit Administrativ, do të jenë duplikatë. Njana nga këto i referohet Zyrës së Kadastrës e cila do të marrë shënim në nji regjistër të posaçëm mbi objektin e sajë e nuk do të bajë ndonji veprim mbi pasuniet kësodore pa qenë pague plotësisht të drejtat e shtetit për të cilat janë nën sekuestrim.

Art. 9. – Dishmitë e përmenduna n' art. 8 janë të vleftëshme sa nji regjistrim kadastruer e të respektueshme ndër gjykata.

Art. 10. – Nëpunsit e Financave që nuk bajnë ndjekje ligjore për nxjerrjet e të dhetave e të tretave, në mbarim të afatit të ç' do kisti, tue sikuestrue ma parë pasuniet e tundëshme të blersit si: dritë' bageti e gjana tjera të vleftëshme në bazë të ligjit të dhetavet dhe kjo konstatohet prej nji inspektimi e kontrollimi të Ministris së Financavet, pushohen nga detyra e nuk pranohen ma në shërbim financiar.

Art. 11. – Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 12. – Ministria e Financavet, e Drejtësis, dhe ajo e P. të Mbrendëshme, janë të detyruemë me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Na, Kryetari i Republikës Shqiptare të mveshun prej vullnetit të popullit me fuqi sovrane të Shtetit,

Mbasi Trupi Legjislativ ka pranuem;
Mbi proponimin e Ministris së Financavet;

DEKRETOJMË:

zbatimin e ligjës mbi shtimin dhe ndryshimin e disa dispozitave të ligjës së të dhetavet.

Tiranë, më 12-XII-1927.

A. ZOGU

Zav. Ministri i Drejtësis
Ministri i P. të Jashtme
I. VRIONI

Ministri i P. të Mbrendëshme
A. DIBRA

Ministri i Financavet
S. STAROVA

Nr. 153

RREGULLORE 12 Dhetuer 2927.

E Shkollës së Drejtësiës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Dhetuer 1927 Nr. 102)

Neni 1. – N'eksekutim të ligjës më datë 29-3-927 në Tiranë krijohet Shkolla e Drejtësiës.

Neni. 2. – Shkolla e Drejtësiës perbahet prej tre kursesh vjetorë. mësimet që do të mësohen n'atë Shkollë, në këto tre kursë janë këto:

1) Introdukcioni në shkëncat e Drejtësiës dhe fillozofia e Drejtësiës:
2) Historjja e Drejtësiés;
3) E drejta Administrative;
4) E drejta Konstitucionale;
5) Ekonomië politike;
6) E drejta civile;
7) E drejta dhe Procedura Penale;
8) E drejta Tregtare;
9) Procedura Civile;
10) E drejta Rromake;
11) E drejta Ndër-kombëtare (publike e private);
12) Mjeksija Ligjore;
13) Ushtrime mbi akte Civile dhe Penale;

V I T I I.rë

1) Instrukcione në Shkëncat e Drejtësis fillozofija e Drejtësiës
2) Ekonomija Politike.
3) E drejta Civile.
4) E drejta Penale.
5) Procedura Civile.
6) E drejta Rromakë.
7) E drejta Konstitucjonale.
8) Historia.
9) Pr çedura Penale.

V I T I II.të

1) E drejta Civile
2) E drejta Penale.
3) E drejta Rromake.
4) E drejta Administrative.
5) E drejta Nder-Kombtare Publike.
6) E drejta Tregtare
7) E drejta Financjare dhe Statistika.

V I T I III.të

1) E drejta Civile.
2) E drejta Tregtare.
3) E drejta Romake.
4) Procedura Penale.
5) E drejta Ndër-Kombtare Private.
6) Mjekësija Ligjore.
7) Ushtrime mbi aktet civile dhe Penale.

Neni 3. — Ç'do landë mësimi, do të jepet tre orë në javë minimumi i orëve të ç'do landë nuk do të jetë ma pak se 50 orë në vjetë, ç'do ditë mësimet do të nisin para dreke nga ora 9-12 veç të premtet e të djelat që do të nisin nga 3-6 pas dreqe.

Neni 4. — Rendi dhe rradha e orëvet do të caktohet prej Këshillit të Profesoravet.

P r o f e s o r ë t

Neni 5. — Profesorët e kësaj Shkolle propozohen prej Ministris së Drejtësis dhe emnohen me pëlqimin e Këshillit Ministruer, dhe me Dekret Presidencjal.

Neni 6. — Ministrija e Drejtësiës, në fillim të ç'do viti mbassi të marri mejtimin e Këshillit të Profesoravet, dhe me pëlqimin e Këshillit Ministruer emnon Drejtor nji nga Profesorant e Shkollës.

Neni 7. — Drejtori i Shkollës së Drejtësis do të kujdesohet për administrimin e mirë të kësaj Shkolle dhe për eksekutimin e vendimevet të Këshillit profesoravet.

Neni 8. — Mësimet e seicilit nga Profesorët do të shtypen rradhë mbas rradhe në fashikulla 16 ose 32, faqe me shpenzimet e Ministris së Drejtësis. Fashikullat do të shiten, dhe të hollat do të jepen n'arkë të Shtetit për sa janë shpenzimet e shtypjes. Teprica i jepet si shpërblim Profesorit përkatës.

N x a n ë s i t

Neni 9. — Për m'u shkrue si nxanës i rregullshem në Shkollën e Drejtësiës, duhet qi kandidati të ketë mbarue nji Lyce, ose nji Gjymnaz, Shkollë Tregtare, Normale ose nji Shkollë tjetër të Mesme Ekvivalente ma këto, tue vërtetue mbarimin e nji të tillë Shkollë me Dipllomë të rregullshme.

Neni 10. Ata qi nuk kanë mbarue nji Shkollë të tillë për qi e quejnë vehten t'aftë për me frekuentue kurset e shkollës së Drejtësiës mund të japin nji provim në ndo njenën nga Shkollat e Mesme të Shqipniës, si mbas nji programi qi ka m'u caktue qrej Ministris s'Arsimit mbas këtij provimi mund të pranohen si nxanës të rregullshëm në kët Shkollë.

Neni 11. — Jasht zakonit për të dy vjetët e para të krijimit të kësaj shkolle mund të shkruhen si nxanësa të rregullshëm pa pas titullat shkollore të përmenduna në nenet e ma sipërme, Prokurorat, Antarët të Gjyqevet të Shk. I.rë Gjyqtarët Paqtuesa, Hetuesa, Kryesekretarët e Gjyqevet të Shk. I.rë e të Paqit e Kryesekretarët e Gjyqit të Diktimit.

Neni 12. — Studentat për m'u pranue në Shkollën e Drejtësiës, detyrohen të paraqesin në Drejtorin e Shkollës dokumentat që kànë mbarue shkollat e Mesme të nalt-përmënduna, ose Dekretat e Nëpunsiës së tyne; bashkë me dy kopje fotografie, tue tregue : Emnin, mbiemnin, banimin e gjith-njishëm e të përkohshëm si dhe moshën e vet, për m'u rregjistrue si student në rregistrin shkollorë.

